Xhafer Durmishi

SKENDER

VEPRA
1

PROTESTA E ASPIRATA
1981-1985

Përmbajtja

Hyrje
1. Hyrja ime në Lëvizjen e Jusuf Gërvallës
2. Do të na bashkoj lufta, shoku S.
3. Nekrologji
4. Ju u bëtë pronë e brezave
4. Letër falënderimi për bashkatdhetarët në Nagold
5. Kush e vrau Jusuf Gërvallën?
6. Tre ranë, me mijëra u ngritën
7. Nga një letër Pajazit Ibrahimit në Australi
8. Thirrje për demonstratën e parë shqiptare në Vjenë
9. Fjalim në demonstratën e Vjenës- Zotërinj, dëgjoni zërin e masës
10. Tri epitafe
11. Letër Engjëll Kolanecit
12. Nga një letër dërguar Faridin Tafallarit
13. Në pragun e Pranverës 1981
14. Programi i Bashkësisë së Klubeve
15. Letër Bashkësisë së Klubeve
16. KU DUHET TË MBËSHTETEMI
17. Statut i Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi
18. Programi politik i Lëvizjes për Republikë
19. Mërgimtarët dhe Kosova Republikë
20. Klubet për punëtorët
21. Lidhja e Lezhës me Lëvizjen e Untergruppenbahut
22. Thirrje për demonstratën e parë shqiptare në Suedi
23. Komiteteve Drejtuese dhe Komiteteve të Rretheve të LRSSHJ-së
24. ÇESHTJE TEORIKE DHE PRAKTIKE
    -Një definicion i shkurtë për nocionin “forcë e organizuar”
    -Akuza e sulme “tronditëse”
    -Disa fjalë për Pararojën
    -Jashtë ka gjithçka! Jashtë nuk ka asgjë!
    -Lufta do të vazhdoj
    -Në çfarë plani të vendosen forcat?
    -Kah do të pëlcas bomba më heret? Kujt do t’i ndihet krisma më larg?
    -Gogoli i fraksionizmit
    -Pse do të bëhet Kosova Republikë?

-Kur do të bëhet Kosova Republikë?
-Cilat janë detyrat tona?
-A mund të ndodhë një diçka e tretë?
-Në emër të kujt flasim ne që e nxjerrim këtë gazetë?
-Me cilët indikatorë mund të përcillet vullneti i popullit?
-Çka do të bëhet pas Kosovës Republikë?
-Nuk ka gjë më të vështirë, më të mundimshme e më të poshtër se lufta!
-Nuk ka gjë më të ndershme, më fisnike, më të ndritshme se lufta!
-Cili është kursi i anijes sonë dhe cili është ekuipazhi i saj?
-A ka mbetur ende diçka tjetër pa u thënë?
-Kush je ti?
25. ÇESHTJE RRETH BASHKIMIT
-Bashkimi i llojit të parë
-Cilat motive i paraprijnë këtij bashkimi?
-Bashkimi i llojit të dytë
-Si manifestohen disa vërejtje ndaj bashkimit të llojit të parë?
-Bashkimi i llojit të parë, Varianti i parë
-Bashkimi i llojit te parë, Varianti i dytë
-Ku është burimi i të metave të bashkimit të 17 shkurtit 1982? Pse ekzistojnë ato?
-Po fjala sinqeritet?!
-Të ndalemi pak te kritika dhe autokritika
-A njohin rregulla të lojës djemtë e vyeshëm apo kompetentët?
-A jemi me të vërtetë të pangueshëm?
-Si është gjendja momentale?
-A kemi çka me përmbysë prej mbeturinave të së kaluarës tek ne?
-A flasim ne me fjalë të huaja?
-Çka kërkojmë dhe çka do të japim?
-Bashkimi i llojit të dytë, Varianti i parë
-Bashkimi i llojit të dytë, Varianti i dytë
-Konkluzion për përçarjen
-Pse u përçamë?
-Si duken problemet e brendshme?
-Si nisi me humbë harmonia?
-Si duken problemet e jashtme?
-Kryqëzimi i sherreve të brendshme me ato të jashtme
-Kush jemi ne?
-Konkluzion për bashkimin
26. Letër e hapur e Hysen Gërvallës
27. Përgjigje në letrën e Hysen Gërvallës
28. Baci, Baca dhe Bacaloku
PERFUNDIM
-Tri udhëtime në drejtim të vendlindjes
-Udhëtimi i parë në Tiranë
-Kthimi i parë në Shkup pas 17 vitesh
-Kthimi i parë në Kosovë pas 20 vitesh

Shkurtesat kryesore

LNÇKVSHJ Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi

OMLK	Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës
FKP	Fronti i Kuq Popullor
PKMLSHJ	Partia Komuniste Marksiste-Leniniste Shqiptare në Jugosllavi
LRSSHJ	Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi

Kadri Rexhaj: "*Veprimtari dhe publicisti Xhafer Durmishi, deri më sot, për mendimin tim, është studiuesi më i përkushtuar dhe më objektiv i veprimtarisë atdhetare të Jusuf Gërvallës. Në projektin e tij madhor ai ka punuar me vite të tëra, ka bërë punë me durim, me kujdes, me objektivitet, me dashuri, me shpirt dhe me mendje, sa rezultatin e mirë që ai personalisht e ka arritur me më shumë se 20 veprat e tij kapitale, jam i sigurt, nuk do ta arrinte asnjë institucion shkencor. Nëse në veprat e shkruara të derisotme kushtuar Jusuf Gërvallës (ndër të cilat llogaris edhe librin tim) rrëfejnë autorët e tyre për Jusufin, në veprën e Xhafer Durmishit ndodhë e kundërta: në tryezën e improvizuar të ballafaqimeve për tema të caktuara, flet personalisht Jusuf Gërvalla, i cili me dëshmitë e tij autentike, të lëna me shkrim, qartë dhe kuptueshëm argumenton veprimtarinë e vet, tashmë të vulosur edhe me gjak."*
(Facebook, 17 janar 2023)

Zeqir Rama: "*Të përmendet emri i Xhafer Durmishit dhe të mos i them dy fjalë për të sikur "tradhtoj" respektin tim të madh për të. Që të ndihem rehat me vetveten me plotë gojë them se Xhafer Durmishi është një veprimtar me cilësi specifike njerëzore, me vlera të veçanta atdhetare, me një intelekt të rrallë ku shpalon aftësitë analitike nga të cilat kanë dalë vizionet e tij, që edhe sot mund të merren si referenca edhe për të ardhmen e vendit."* (Facebook, 25 maj 2020)

Xhemajl Shatri: "*Padyshim Xhafer Durmishi është arkiva më autentike për veprimtarinë kombëtare të Jusuf Gërvallës dhe Bardhosh Gërvallës, i cili i ka shkrua mbi 20 libra për Lëvizjen Çlirimtare të Kosovës.*

Për Xhafer Durmishin nuk do të them shumë se nuk jam avokat i tij, por një gjë dua të them, se sa e kam njohur nga afër kam krijue mendimin se është njeri shumë i ngritur kombëtarisht dhe intelektualisht. Xhafer Durmishi është njeri i besës dhe i shkencës, është specialist i librave, dhe është atdhetar i flaktë i çështjes kombëtare." (Facebook, 13 shkurt 2023)

Kadri Mani-Osmani: "*Unë ta kam heq kapelën për publicistikë, e ti duhet të ma heqësh kapelën për gjuhësi.*" (Fjalë të dërguara Xhafer Durmishit, 25 gusht 2009)

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror*." (14 janar 1981)

Hyrje

Si anëtarë i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi, në mesin e korrikut 1981 u gjeta në Shtutgart. Aty kam qëndruar e vepruar pranë Jusuf Gërvallës në gjashtë muajt e fundit e të jetës së tij. Këta muaj kanë qenë shumë dinamik dhe gjatë qëndrimit me te kam pasur rastin të mësoj gjëra nga ai për aktivitetin e tij sidomos nga janari 1980. Për disa aspekte të veprimtarisë së J.G. në pika shumë të përgjithësuara kam shkruar në maj 1992.

Në këtë libër nuk e shtjelloj periudhën e aktivitetit në Shtutgart prej janarit 1980 gjer në janar 1982. Këtu nuk bëjë fjalë hollësisht, më tepër se sa është shkruar në shtyp, as për ngjarje pas 17 janarit 82, për bisedimet e bashkimit më 17 shkurt apo për takimin

dhe mikpritjen e paharrueshme që mu bë në Bern me rastin e ditëlindjes sime më 14 Maj 1982.

Ky libër përmban punime e letra të zgjedhura të cilat i kam shkruar nga korriku 1981 gjer në korrik 1985 nëpër qytete të ndryshme të Evropës. Shumica e tyre janë botuar në shtypin e kohës. Një pjesë janë ribotuar në një publikim, në të cilin autorësia ime nuk është vënë në pah. Këtu ka edhe punime që botohen për herë të parë. Këto shkrime besoj se reflektojnë preokupime me të cilat janë ballafaquar masa më aktive e mërgimtarëve të Kosovës në Evropën Perëndimore. Këtu janë të përmbledhura përpjekjet e mia teorike për t'u dhënë përgjigje disa pyetjeve të asaj kohe.

Dy shkrime; "Komiteteve drejtuese dhe komiteteve të rretheve të LRSSHJ-së" dhe "Letër e hapur e Hysen Gërvallës" nuk janë të miat por i kam zgjedhur pasi punimet e mia janë dhe mund të merren si përgjigje direkte në to.

Ka aktivistë të asaj kohe të cilët edhe pse në disa çështje kanë qenë kundër meje, më kanë pas thënë se unë kurrë nuk mund të akuzohem për mendjemadh. Bile një prej tyre ka shkruar në një libër të lavdëruar, se unë jam apo në një kohë kam qenë, jo pak por shumë i sinqertë. Mund të them se nuk ekziston fjalë tjetër që më disponon më shumë e që më bënë të ndjehem më mirë se sa kur dikush më thotë se je apo ke qenë i sinqertë. Me këtë fjalë mund të çarmatoset edhe kundërshtari më i madh nëse përdoret me vëmendje dhe takt.

Për J. G. kam dëgjuar shumë sa kam qenë në Kosovë. Njohja me te ka qenë një ngjarje me ndikim në jetën time. Pas vrasjes së tij unë nuk kam pritur se mua do të më besohen dhe do të më kërkohen ato detyra që mu dhanë. Puna në ato ditë janari nuk është zhvilluar në stilin se cili është kandidati e cili kundërkandidati. Asgjë nuk është bërë me vota. Kërkesën që unë t'i bëjë shumë punë me shkrim, të punoj në përgatitjen e redaktimin e gazetës (të cilën në muajin Nëntor 1981 e Janar 1982 e kishte redaktuar Jusufi e në përmbajtjen e të cilave kisha kontribuar me 15% në të parën dhe 25% të shkrimeve në të dytën) për muajin Mars 1982 (nga mesi i atyre që kanë qenë në Shtutgart) e kam marrë nga Haxhi Berisha, Naim Haradinaj dhe Hafiz Gagica. Numri i gazetës së Marsit 1982 pati 30% punime të Jusufit.

Një aspekt i këtyre shkrimeve është se në to vërehet qëllimi që ato të kenë bazë orientuese idetë marksiste-leniniste. Pra që në fillim dua ta pranoj se mua Marksi dhe Lenini më kanë marrë në qafë. Atëherë lexoja për luftën për pushtet, luftën e qarqeve mafioze për valuta të forta, por kam besuar se forca lëvizëse e shoqërisë njerëzore është lufta e klasave. Atëherë, kur isha shumë i ri, pajtohesha me mendimin se Karl Marksi është njeriu, idetë e të cilit për një kohë të shkurtë (rreth 70 vjet) kanë pasur aq ndikim në botë sa asnjë mendimtarë e udhëheqës tjetër i çfarëdo lloji para dhe pas tij nuk mund të matet me te, duke u pajtuar me konkluzionin e të tjerëve se atë që e ka bërë ai, me siguri nuk do t'i shkoj përdore askujt tjetër. Besoja gjithashtu në thënien e Leninit se njerëzit do të jenë viktima në politikë derisa pas fjalëve të politikanëve dhe marimangave mafioze të mos shohin interesat e kësaj apo asaj klase.

Mund të them se gjithmonë kam qenë njeri i pasherr dhe i kam besuar çdo kujt që ka folë seriozisht me mua. Gabimi im qëndron në atë se nuk i kam ndjekur këshillat e Nënës që të mos i hypi në qafë askujt. Posa jam ndeshur me Marksin e Leninin në shkrimet e tyre, i kam përqafuar ata. Dhe natyrisht në atë përqafim ata menjëherë më kanë qitë në qafë, në shpatullat, në krahët e tyre dhe më kanë ngritur në maja e lartësi marramendëse për mua. I mahnitur dhe i gëzuar për panoramat që shihja nuk kisha dëshirë të zbrisja poshtë, por xhelozia e forcës së gravitacionit vepronte në mënyrë djallëzore nën rrogoz dhe e bënte të veten. Kam ra prapë në tokë, por shijimi i lartësive me ka lënë me vese të pashërueshme. Prandaj me plotë gojën e them se "mallkimi" im për Marksin e Leninin është: "Më paqin në qafë në këtë dynja dhe në atë dynja."

Tani e shoh se sa "gabim" e kam pasur. Me fakte të panumërta duket se krejt konfliktet; klasore, kombëtare, fetare, racore, gjinore e të gjeneratave të ndryshme lindin dhe vazhdojnë të ekzistojnë, sipas mendimit tim, vetëm e vetëm për shkak se një numër, mjerisht i madh, njerëzish nuk duan të jenë të sinqertë, nuk duan që të gjitha këto probleme të zgjidhin në mënyrë të sinqertë.

Çështje tjetër është ndikimi që kanë pasur tek unë Partia e Punës e Shqipërisë dhe Enver Hoxha.

Qysh si fëmijë, kam pasur një kureshtje dhe dashuri të pashuar për Shqipërinë, e cila është shprehur edhe në dashurinë për E. Hoxhën. I dehur nga kjo dashuri kam shkuar aq larg sa kam menduar se një ditë patjetër do të takohem me Hoxhën. Shkrimet e artikujt e tij jo vetëm që më kanë pëlqyer por tek unë kanë pasur edhe ndikim bindës. Artikujt e tij për Kosovën e për mbrojtjen e flaktë e të argumentuar të kërkesës "Kosova-Republikë" janë të fuqishëm, të madhërishëm dhe të patejkalueshëm.

Vitet kaluan, unë dola në Gjermani. Personalisht me Hoxhën nuk u takova kurrë, por megjithatë një pjesë e ëndrrës fëminore mu realizua. Kam fakte të pamohueshme dhe dëshmitarë të gjallë se në Salzburg, Vjenë dhe Frankfurt më është parafytyruar (jo njëherë por disa herë) vet KryeEngjëlli, KryeEngjëlli i Hoxhës, Engjëll Kolaneci, diplomati kryesor i Shqipërisë që është marrë me çështje e me shqiptarë të Kosovës në Gjermani e Zvicër. Natyrisht se më janë shfaqur edhe engjëj e shpirtra tjerë, por në kategorinë e engjëjve asnjë nuk mund të krahasohet me Engjëllin.

Nuk e di se a është e vërtetë apo jo, por thonë se për t'i takuar rrethit më të ngushtë të Hoxhës, patjetër është dashur të kalosh nëpër duart e xharrahëve, se pa kalua nëpër duart e tyre ka qenë e pamundur me hy në kalanë e tij. Këtu nuk e shohë të arsyeshme e as nuk më takon të zgjerohem në hipoteza lidhur me krimet dhe garat e xharrahëve dhe servilëve. Me këtë rast dua të them se E. Hoxha, për mua dhe për personin që e çmoj më së shumti në këtë jetë - Jusuf Gërvallën, ka qenë një nga inspiruesit e frymëzuesit në luftë kundër pushtetit serb. Në atë periudhë të jetës time, (gjer në vitin 1985) Kosovës, mund të thuhet, se nuk i ka ardhur asnjë e keqe prej E. Hoxhës por vetëm të mira. Duke u bazuar në numrin e tytave të topave e pushkëve, Shqipëria ka qenë mbrojtësja konstante, besnike dhe e guximshme e Kosovës dhe shqiptarëve nën Jugosllavi. Ne që kemi qenë jashtë territorit të RPS të Shqipërisë kemi parë vetëm anët e mira. Ne kemi pasur punë vetëm me engjëj. Është me rëndësi që ta pohojmë këtë fakt dhe kjo nuk duhet të merret si ofendim i viktimave të gjalla e të vdekura të dhunës fizike e psikike të sistemit të tij. Por vlerësimet tona janë të njëanshme dhe mbeten të tilla. Vlerësimin, kritikat, lëvdatat e të tjerat u takojnë në radhë të parë dhe të fundit atyre që kanë jetuar nën regjimin e tij, që kanë pasur punë jo vetëm me të mirat e engjëjve por edhe me trajtimet e xharrahëve.

Sjellja e diplomacisë shqiptare ndaj organizatave kosovare në Evropën Perëndimore në periudhën 1980-1985 është çështje tjetër dhe nuk shqyrtohet këtu.

Ky libër duhet shikuar si përgjigje në kritikat që më janë bërë se gjoja unë nuk kam shkruar mjaft për kohën në fjalë, se unë nuk e kam kryer detyrën ndaj Clios (Hyjneshës së shkrimit të historisë). Ka disa fakte, interpretime dhe përjetime që nuk i kam thënë në mënyrë më të plotë për atë që e kam njohur më afër, Jusufin, për të cilin shkurtimisht kam shkruar pas atentatit dhe në disa përvjetore.

Megjithatë, me shumë keqardhje mund të konstatoj se deri më sot nuk kam mundur ta them ndonjë fjalë me rëndësi për figurat e rëndësishme, kolosale dhe të njohura të çështjes sonë siç janë Baci, Baca dhe Bacaloku. Shkak për këtë është fatkeqësia ime, pozita ime e pavolitshme, pasi unë nuk kam pasur privilegjin t'i njoh nga afër sepse jam ndodhur në periferinë më të skajshme të tyre.

5 maj 2005, Trier

Adem Dema Demaçi-Jusuf Gërvalla-Metush Krasniqi

Adem Demaçi **Jusuf Gërvalla** **Metush Krasniqi**

Adem Dema-*Demaçi:* ***"Jusufin e kam njohur pas daljes nga burgu i parë. Ai ka qenë i lidhur me ne... Jusuf Gërvalla ka mbetur i pazbuluar. Kanë mbetur edhe grupe të pazbuluara, sepse ne bënim ç'është e mundur të ruanim konspiracionin. I tillë ka qenë edhe ai i Jusufit. Jusufin e kam njohur, Bardhin e kam njohur."***

Xhafer Durmishi: "*Është meritë e Sabri Novosellës që e organizoi Jusuf Gërvallën në Lëvizje, i cili i vuri aftësitë e tija fizike, mendore dhe intelektuale në shërbim të atdheut, në mënyrë të organizuar."*

Shefik Sadiku: "*Metush Krasniqi ishte përpjekur, me tërë qenien e tij, që energjitë atdhedashëse të të gjithë veprimtarëve, pa dallim ideje, t'i shkrijë në dobi të çështjes kombëtare, për Shqipërinë.*

Se puna e tij ishte në frymën e bashkimit kombëtar, e paraqes një fakt konkret: Metushi organizoi një pritje të ngrohtë në shtëpinë e vet, në Dajkoc të Dardanës, më 2, 3 dhe 4 shtator të vitit 1974, bashkë me Adem Demaçin, Mulla Ramë Govorin, Hyrije Hanën, Ahmet Haxhiun, Selman Ramadanin, Fehmi Bajramin, Sylë Krasniqin (pleqnar), Hazir Krasniqin (kushëri). Në këtë takim ishin edhe Ilmi Ramadani, student, si dhe Emin e Besnik Krasniqi, nxënës.

Nga këto biseda me ndjenja të larta atdhedashurie u arrit marrëveshja e pajtimit në ide e veprime dhe u vendos që të vazhdohet lufta nacionalçlirimtare e Kosovës e viseve tjera në ish-Jugosllavi vetëm me një "Platformë Politike Kombëtare", as në të majtë e as të djathtë, nga i cili takim, në vitin 1974, do të lind "Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës" dhe, më vonë, LNÇKVSHJ-ja e viteve 1976/77." (Me rastin e shënimit të 35 vjetorit të Heroit, Metush Krasniqi, kjo kumtesa u lexua ne Tryezën e mbajtur më 15.10.2021 në Prishtinë. E organizuar nga Këshilli Organizativ "Pranvera Shqiptare '81"!)

17-1. Hyrja ime në Lëvizjen e Jusuf Gërvallës

Xhafer Durmishi: "*Shkollën fillore e kam mbaruar në fshatin Prilluzhë. Në dy vitet e para mësim më ka dhënë Qerkin Peci. Në këto dy vite, përveç Qerkinit praktikën si mësues e ka bërë Sheremet Saraçi, i cili e ka zëvendësua Qerkinin për dy muaj. Në klasën e tretë dhe të katërt mësuese e kemi pas Hanëmshahe Pasomën. Pas mbarimit të shkollës fillore në fshatin Prilluzhë, me sukses shembullor, d.m.th. pa asnjë katërshe gjatë tetë viteve, regjistrohem pa provim pranues në Qendrën Shkollore Teknike "Nikolla Teslla" në Obiliq. Kjo shkollë nuk ka qenë shkollë komunale por pronë e Kombinatit të Obiliqit, dhe ka pas për detyrë të shkolloj punëtorët e kuadrot e profileve të ndryshme për Kombinatin.*

Në shkollën e mesme në Obiliq, shok të ngushtë e kam pas Hakif Krasniqin nga fshati Zhilivodë. Me Hakifin nuk më ka lidhë shumë interesi i lëndëve shkencore në shkollë si kimia, fizika e matematika (për diskutimin e këtyre lëndëve kam pas një rreth krejt tjetër) por interesi ynë i përbashkët ka qenë për gjuhën e letërsinë shqipe dhe leximi i veprave të letërsisë shqipe deri tek ato të realizmit socialist, të botuara në Shqipëri e të cilat na kanë ra në dorë, apo i kemi huazuar në biblioteka.

Hakifi me vëllaun e vetë më të vogël Hasanin dhe nanën kanë jetuar në Zhilivodë. Sa motra më të rritura i ka pas nuk më kujtohet. Por e di se një motër e tij më e madhe, Bedrija ka qenë e martuar me Ismet Saraçin, nga fshati Bivolak. Ismeti ka qenë shok i ngushtë me Sheremetin dhe këta të dy së bashku shokë me Shefqet Jasharin nga Strofci. Përmes shokut tim të shkollës së mesme Hakifit jam njohur me Ismetin dhe rinjohur me Sheremetin (pasi Sheremeti më kishte dhënë dy muaj mësim në dy vitet e para të shkollës fillore). Në fillim të vitit 1978, Ismet Saraçi, pasi më kishte takuar shumë e shumë herë më ka folë për Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi, më ka propozuar të anëtarësohem dhe unë jam pajtuar. Ismeti më ka anëtarësuar në Lëvizje në shtëpinë e tij në Bivolak. Viti 1978 është viti i 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit dhe në këtë vit puna ime si anëtar i Lëvizjes është një pikë ujë në deti në krahasim me punën pothuajse krejtësisht zyrtare për të kujtuar 100 vjetorin e Lidhjes." Përmes Hakifit jam njohur edhe me Behxhet Krasniqin, i cili përmes meje është anëtarësua në LNÇKVSHJ."

Çerkin Peci: "I respektuari dëshmor i Kosovës, Jusuf Gërvalla, ndihem krenar që Të kisha prijës në LNÇKVSHJ ! Përkujtim atdhetar deri në përjetësi!"
(17 janar 2016 www.facebook.com/jgervalla)

Qerkin Peci

PECI QERKIN; Aktgjykim: "*QERKIN PECI, i biri i Hajdarit dhe i Halimes, e gjinisë Haziri, i lindur më 20.04.1944 në fshatin Zhazhë komuna e Mitrovicës së Titos, vendbanimin e ka në Mitrovicën e Titos në lagjën "Tamnik" rruga 8 nr. 30, shqiptar, shtetas i RSFJ, profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, ka të kryer Fakultetin filozofik - grupi i albanologjis, i martuar, babë i 3 fëmijve të mitur, shërbimin ushtarak e ka rregulluar në Nish më 1971, gjindet në EU pranë KK Mitrovicë e Titos, i pa dekoruar, me gjendje të mesme ekonomike, më parë jo i dënuar, kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej 05.08.1982,...*

Gjykon – Të akuzuarin Qerkin Pecin ME DËNIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 3 (tri) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05.08.1982 e tutje deri në plotëfuqishmërin e aktgjykimit....

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË E TITOS

P-nr. 9/83, - më 27.05.1983"

Elhame e Sheremet Saraçi dhe fëmijët Kujtimi e Arbëria

Ty

Ty që vajzën Arbërie e linde për ARBËRINË!
Ty që për këtë Yll-Atdhe – fale dashurinë!
Ty që Kujtimit i belbëzoje për LIRINË!
Ty borxh ndër mote ta kemi PAVDEKËSINË.
Ty që Gëzimin e porosite „Kjo Tokë është e jote" !
Të paçim përherë Kurorë Lavdiplote!
Ty të pata besnike me dëshira të zjarrta
Ty në belbëzime të kujtojnë Albani- Norë arta.
Ty që Shkumbinin e rrite duke i kënduar Bacë Bajramit
Ty s'ta harrojmë Porosinë për Dashurinë ndaj Vatanit
Ty që fëmiun e fundit e pagëzove Durim

Ty bashkëluftëtare, të kujtoj me mallëngjim...
Ty që Skënderit* e Aliut*- strehë të ngrohtë iu fale
Ty në mermer të skalita për të larta IDEALE...
Sheremet SARAÇI, 1990

*Skënderi - Xhafer Durmishi dhe * Aliu - Asllan Muharremi (anëtarë të Familjes së Sheremet Saraçit)

Marly (Zvicër) më 20 tetor 2016
Përshëndetje Xhafer,
Sa për informim: Më datë 15 tetor 2016, së bashku me Asllanin jemi takuar me Ismet Saraçin, të cilit në prezencë të Asllanit ia kam dhënë letrën me zarf të mbyllur, pra ashtu si ma ke dërguar përmes postës. I kam bërë disa foto kur ia kam dhënë letrën dhe do t'i dërgoj përmes postës elektronike. Letrën që po ta dërgoi e kam marrë nga Ismeti më datë 17 tetor 2016, të hapur, në të njejtin vend, në një mini-Restorant të një Qendre Tregëtare afër Spitalit në Prishtinë.
Shumë të fala nga unë Shaban Muharremi.

Unë ndihem i privilegjuar dhe shumë krenar

I nderuari dhe shumë i respektuari shoku Xhafer,
Më lejoni së pari të të falenderoj përzemërsisht për shënimet dhe fjalët që i pranova nga Ti përmes Shaban Muharremit. I lexova me plotë mall dhe emocione. Më dolën përpara të gjitha ato momente dhe peripeti e sakrifica që i përjetuam së bashku. Siç dihet, takimi im i parë me ty ishte në vjeshtë të vitit 1973, si nxënës i Shkollës së Mesme Teknike "Nikolla Teslla" në Obiliq. Aty kisha edhe vëllaun e gruas Hakif Krasniqin.

Shaban Muharremi (majtas), Ismet Saraçi (në mes) dhe Asllan Muharremi, në Prishtinë më 15 tetor 2016

Ishit në vitin e parë. Më foli Hakifi për mbështetjen qoftë materiale qoftë shoqërore që jeni duke ia bërë. Isha kurreshtar që të njoh për së afërmi. Me fjalët e para që i ndërrova

me Ty, aty kuptova se keni një shpirt të madh, human dhe keni një vizion të përkushtuar për zgjidhjen e çështjes kombëtare deri në fund. U bëre pjesë e shpirtit tim. Dhe takimet tona filluan të shpeshtohen. Po edhe ato takime ishin shumë të frytshme veç sa u forconin idealet tona. Në vitin 1978 isha i kyçur në Lëvizje, dhe sipas statutit duhej ta zgjeroja anëtarësinë sipas kritereve. Xhaferi nuk i plotësonte kushtet për shkak të moshës së re. Mirëpo unë këmbëngula dhe mora përgjegjësinë, e thirra një ditë në shtëpinë time e njoftova me statutin e Lëvizjes. Kjo ishte në vitin 1978. E pranoi me plotë vullnet dhe pa kurrfarë hezitimi e dha betimin. Kur filluam me disa aktivitete Xhaferi gjithmonë ishte në ballë dhe i kryente me sukses.

Gjatë vitit 1980 Sheremet Saraçit iu dha për detyrë të shkoj në Stamboll për një takim me Sabri Novosellën, në banesën e Tefik Strajës. Për takimet vijuese Sheremeti me Sabriun u morën vesh që të dërgohej Xhafer Durmishi sepse e dëshmoj vehten se ka një pjekuri politike e morale dhe i guximshëm. Në janar të vitit 1981, unë dhe Sheremeti ia ndihmojmë udhëtimin për Stamboll. Mori me vete numrin e telefonit të Tefik Strajës. Takimi ishte i suksesshëm.
Unë ndihem i privilegjuar dhe shumë krenar që e kam pasë fatin ta kem anëtarë të Lëvizjes.

Ismet Saraçi (17 tetor 2016 Prishtinë)

Sabile Basha: Mustafë Sh. Shyti – Dritë e pashuar në altarin e lirisë

MUSTAFË SH. SHYTI – DRITË E PASHUAR NË ALTARIN E LIRISË
(Bedri Tahiri, FLAKADANI I LIRISË: Monografi për mësuesin, poetin dhe dëshmorin Mustafë Shyti, Armagedoni, Prishtinë, 2025) E marte, 11.03.2025, 08:36 PM, zemrashqiptare.net
Nga **Prof. Dr. Sabile Keçmezi-Basha**

Mustafë Shyti

Sabile B: ”*Në mozaikun e jetës së Mustafë Sh. Shytit, një nga pjesët më të ndritshme, më të guximshme dhe më përfaqësuese të shpirtit të tij kryengritës është ajo që autori e ka titulluar me shumë ndjeshmëri e simbolikë: “Normalisti kryengritës”. Kjo nuk është vetëm një metaforë — është një përkufizim që ngërthen në vete kontrastin e bukur dhe të fuqishëm mes dijes dhe rezistencës, mes bankës së shkollës dhe barrikadave të mendimit të lirë, mes mësuesit dhe luftëtarit të fjalës.*
Në këtë pjesë, autori na zbërthen me ndjeshmëri dhe saktësi një faqe të veçantë të jetës së Mustafës — kohën kur ai, ende në moshën e formimit, në gjurmët e dijes dhe në rrugët e ndërgjegjësimit, bëhet pjesë e ilegalitetit atdhetar, duke u rreshtuar në radhët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe të Viseve Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVShJ). Ai nuk ishte thjesht

një emër në një listë aktivistësh — ai ishte një zë që ngjitej përmes errësirës, një shpirt që nuk pranoi të heshtte përballë padrejtësisë, një dritë që lëvizte nën hije, por me besim të plotë në dritën e lirisë që do të vinte.
I përkushtuar dhe me bindje të thella, Mustafë Shyti angazhohej në treshen ilegale së bashku me Ismet Saraçin dhe Xhafer Durmishin — një treshe që nuk bashkonte vetëm emra, por zemra që rrihnin për të njëjtin ideal, për të njëjtën ëndërr të madhe: çlirimin e shqiptarëve nga zgjedha jugosllave. Ata ishin ushtarë të heshtur të fjalës dhe veprimit, të shpërndarjes së vetëdijes dhe të kultivimit të rezistencës në rrënjë të popullit.
Por ajo që e bënte Mustafën të veçantë, ajo që e ngrinte përtej strukturave organizative, ishte mënyra e tij e veprimit — dialogu i qetë, biseda e mençur, komunikimi i ngrohtë me nxënësit e tij. Ai nuk shpërndante vetëm trakte, ai shpërndante mendim të lirë, vetëdije kombëtare, frymë që ngjallte pyetje dhe zgjonte ndërgjegje. Me fjalë të buta dhe zemër të zjarrtë, ai mbillte në shpirtin e të rinjve farën e atij mendimi të rrezikshëm për regjimin, por të shenjtë për popullin — se shqiptari duhet të jetojë i lirë në tokën e vet."

1. Do të na bashkoj lufta, shoku S.

Gjatë ditëve të demonstratave, shoku im S. kishte një hall. Ai është një nga bijtë e shumtë, që brengat e popullit me kohë i ka bërë të vetat. Në demonstrata ishte shumë aktiv, me të gjithë vëllezërit dhe shokët. Po gjëja që e mundonte ate, ishte se ai kurrsesi nuk po mund të lidhej me qendrën e demonstratave. U mundua mjaft shoku S. por qendrën nuk e gjeti. Dhe s'donte të bindej se demonstratat, në përgjithësi kishin shpërthyer spontanisht.

Në ndërkohë siç thamë edhe më lartë shoku S. nuk qëndroi duarkryq, por veproi aq sa mundi e diti. Zemra më bëhej mal kur e shihja se si përleshej si luani me milicinë serbe, të kthente prapa bombat lotsjellëse të hedhura nga gjakësorët, kur e shihja se si vet përpiqej ta mbante rregullin, të drejtonte mirë turmat e njerëzve, të ndihmonte shokët e plagosur etj.

Tani çfarë t'i themi shokut S. për atë hallin që e mundon? Unë do të thosha se ai veproi si ai njeriu, të cilit iu thye qerrja në mal, e thirri nevojën por ajo s'i erdhi, dhe ai e ndreqi vetë. Kësisoji kanë vepruar të gjithë ata patriotë që nuk janë të përfshirë në pararojën revolucionare.

Kush mendon pak më thellë, do të kuptoj se kësaj radhe nuk pati qendër të vetme organizimi e koordinimi të demonstratave. Dhe shoku S. është merakosur pa nevojë se si të njihet me njerëz të organizuar. Siç po shihet, këta njerëz po e njohin shokun S. dhe i kanë parasysh virtytet e tij revolucionare. Shoku S. duhet të gëzohet bashkë me ne për faktin se demonstratat, megjithëse jo krejtësisht të organizuara, shënuan një rrjedhje të ngjashme, gati identike nga dita në ditë dhe nga vendi në vend, u hodhën parulla të njëjta, rendi, qetësia, shkathtësia e gjeturia u vërejtën pothuaj në çdo qendër ku shpërthyen demonstratat. Pararoja e organizuar në njërën anë, por edhe tërë ajo rini kolosale në anën tjetër, u dhanë demonstratave tona heroike një orientim të drejtë e përmbajtje të shëndoshë.

Ndodhi kështu, sepse, kur ngritet i tërë populli në këmbë, ai e di se çfarë kërkon, ndërsa uniteti i tij i plotë është garanci për fitoren e tij të sigurt mbi çdo armik.

Shokut S. po i themi se do të njihemi më mirë e do të sqarohemi në aksionet, demonstratat e ardhshme, ose në fund të fundit, në malet e Kosovës, kur të kërcasin pushkët e lirisë.

Korrik 1981, Zurich (Zëri i Kosovës, Organ i LNÇKVSHJ, nëntor 1981, faqe 13)

2. Nekrologji

Jusuf Gërvalla lindi më 1 tetor 1945 në Dubovik afër Pejës. Shkollën fillore e kreu në Pejë, ku vazhdoi mësimet në shkollën e qytetit. Studimet albanologjike i kreu në Prishtinë. Në Universitetin e Prishtinës kreu shkallën e tretë, por për shkaqe që dihen nuk pati kohë t'i nënshtrohet provimit të diplomës mbi studimin e veprës së Nolit.

Punoi si gazetar, njëherë në "Flakën e Vëllazërimit" e më vonë në "Rilindje". Më 1975 aktiviteti i tij patriotik bie në sy edhe më tepër, i cili kishte zanafillën që para demonstratave të vitit 1968. Në vitin 1975 pranohet anëtarë i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ).

Fushata e arrestimeve në vitin 1979, nuk e kurseu as Jusufin. Por kësaj here u shpëtoi kthetrave të UDB-ës. Emigroi në Gjermaninë Federale ku i punonte i vëllau. Në Gjermani aktivitetin e tij e zhvilloi me një hov të madh, hov i cili i kaloi shumë caqe. Ishte drejtues i Komitetit të LNÇKVSHJ për Evropën Perëndimore. Me plotë suksese redaktoi dhe udhëheqi revistën patriotike "Lajmëtari i Lirisë", e cila bëri aq jehonë tek shqiptarët e Kosovës. Ishte anëtarë i KQ të LNÇKVSHJ. Aktivitet të bujshëm zhvillon sidomos pas demonstratave të Pranverës 1981. Si anëtarë i KQ, ai ishte edhe kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë në të cilën ishte deri në çastin e vdekjes.

Jusuf Gërvalla u vra në mbrëmjen e 17 Janarit të vitit 1982, afër banesës së tij në Untergruppenbach, por emri i tij do të jetoj përherë në zemrën e popullit dhe do të shërbej si frymëzim për të gjithë luftëtarët e lirisë.

Bardhosh Gërvalla, djali i tretë në familjen Gërvalla, lindi në Dubovik më 25 shkurt 1951. Si i ri së bashku me familjen, për të siguruar ekzistencën shkoi në Jesenicë, ku edhe mori shkollimin fillor dhe të mesëm në gjuhën sllovene. Në Universitetin e Prishtinës studioi gjuhën angleze. Më 1974 shkon në Gjermani si punëtor social ku pati rastin të njihet me shumë mërgimtar. Në këto kontakte erdhi në shprehje bujaria e tij, qëndrimi burrëror dhe i prerë para padrejtësive të ndryshme që iu bëhen punëtorëve tanë nga kapitalistët e ndryshëm.

U bë mbështetja më e fortë e Jusufit në vazhdimin e punës patriotike jashtë atdheut. Anëtar i LNÇKVSHJ ishte nga viti 1977. Për meritat e mëdha dhe besnikërinë ndaj atdheut u zgjodh sekretar i degës së LNÇKVSHJ për Gjermaninë Perëndimore. Bardhosh Gërvalla si shumë bashkatdhetarë shkoi me mall të Kosovës, sepse pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi larg saj. Vdiq, duke e mundur vdekjen, më 17 Janar 1982 si luftëtar i pa kompromis për të drejtat e popullit shqiptarë në Jugosllavi. Bardhoshi (Besniku) do të jetoj përgjithmonë në zemrën e popullit.

Kadri Zeka lindi më 25 prill 1953 në fshatin Poliçkë. U shkollua në Gjilan, ndërsa shkollimin e lartë e vazhdoi në Prishtinë ku punoi si gazetar i Radio Televizionit të Prishtinës. Aktiviteti i tij patriotik u hetua më 1978 kur ai largohet nga atdheu dhe shkon për në Zvicër dhe merr azil politik. Ishte anëtarë i një organizate motër. Atë mbrëmje ndodhej tek vëllezërit Gërvalla për bisedime, të cilat bëhen në mes luftëtarëve, shokëve të idealit. Kadri Zeka vdiq si burrë që luftoi për lirinë e Kosovës. Edhe Kosova do ta çmoj punën e tij dhe do t'i jep vendin e merituar në mesin e bijve të saj.

Janar 1982, Untergruppenbach (Zëri i Kosovës, Organ i LNÇKVSHJ, mars 1983, f.2)

3. Ju u bëtë pronë e brezave

17 Janari i vitit 82 do të jetë një datë historike për të cilën brezat e ardhshëm do të mësojnë nëpër shkolla. Do të mësojnë se në këtë mbrëmje, në mënyrën që i karakterizon vrasësit më barbarë, u vranë Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla.

E shënuar do të jetë kjo ditë për punëtorët në mërgim, ditë në të cilën ne u ndamë nga vëllezërit tanë. Neve këtej na nxorën regjimet që shtypin klasën punëtore, na nxorën këtej duke na thënë se nuk kemi kualifikime në mënyrë që këtu të punojmë punët më të vështira dhe me krahun tonë t'i sigurojmë Jugosllavisë së molisur devizat me të cilat ajo po i paguan UDB-ashët e vet për të vrarë bijtë tanë.

Këta pasi u shpëtuan arrestimeve të para disa viteve, erdhën në mesin tonë për të na ndihmuar që të njohim më mirë fajtorin e të gjitha të këqijave tona. Disa nga ne, në fillim mendonim se a do të dimë të merremi vesh me shkollarët tanë. Por shumë shpejt e kuptuam njëri tjetrin. Morëm vesh se këta kalonin net të tëra pa gjumë vetëm që të na afronin sa më tepër. U lidhën me ne, shtresat më të gjëra të popullit sepse na u afruan si vëllezër e si shokë. Pranuan me ne biseda të hapura e na i dëgjuan fjalët tona edhe kur nuk ishin me vend, me durim të madh. Na thirrën në demonstrata dhe ne u përgjigjëm njëzëri. Dolëm në demonstrata jo pse na paguan me marka si rrenin shovinistët e Beogradit, por pse në fjalët e tyre e pamë të vërtetën. Ata me gjithë shpirtin u mbështetën tek ne.

Ata ishin të thjeshtë e të gatshëm të bisedonin me të gjithë. Vinin tek ne darkave e pasdarkave e bisedonin kokë më kokë me ne për problemet e punës, për familjet e për të rejat nga Kosova. Lajmet e shkëputura që ua sillnim ne nga Kosova, ata na i jepnin të shtypura në faqe gazetash. Nuk pritonte Bardhoshi ta merrte çiftelinë e Jusufi t'ia thoshte këngës nëpër dhomat tona e nëpër manifestime të ndryshme, e të na bëjnë për disa çaste t'i harrojmë vuajtjet e në fytyrat tona të dukej buzëqeshja. Po ta japim fjalën shoku Jusuf se edhe pse çiftelisë nuk dimë t'i biem, kënga "Për mëmëdhenë" nuk do të pushojë kurrë.

Nuk do ta harrojmë as zërin tënd nga megafoni shoku Zeqë, me të cilin na përcolle nga demonstrata në demonstratë.

U njohëm me ju në kurbet, dhe ne na lidhën fortë fatet e njëjta. Fjalët tuaja të thëna me gojë si dhe ato të shkruara do t'i kujtojmë dhe do t'i ruajmë me kujdesin më të madh. Ju kemi lakmi juve dëshmorë, për veprën e madhe, ndërsa tek prindërit tuaj shohim fytyrën e vërtetë të nënës e të babait shqiptar, të cilët na duket se kanë dalur nga këngët kreshnike dhe legjendat, e qëndrojnë këtu mes nesh.

Ju sigurojmë, ashtu siç keni qenë edhe ju të sigurt, se familjet tuaja do t'i rrethojë tërë populli, e kujtimin tuaj do ta ruaj thellë në gji.

Çdo kush prej nesh krenohet me shumë të drejtë, sepse patëm rastin që për një kohë shumë të shkurtër qëndrimi me ju, mësuam aq shumë për historinë e popullit, për luftërat që kemi pasur dhe ajo që është më e rëndësishmja për luftërat që na presin. Me të vërtetë ne kemi një pasuri të madhe, të cilës do t'ia kanë zili brezat e ardhshëm. Nëse neve me arsye na shkon mendja, nga emocionet, të kishim qenë bashkëluftëtarë të Skënderbeut, të kishim qenë në njësinë e Mic Sokolit, të ndodheshim afër Bajram Currit në shpellën e Dragobisë, foshnjet e sotme nesër do të thonë: Të ishim bashkëpunëtorët e bashkëluftëtarët e këtyre trimave.

Nesër kur historinë do ta nxjerrim në dritë ju do të bëheni pasuri e brezave.

Nesër në ditën e lirisë, toka e lirë shqiptare do t'u thërret ashtu siç thirri Abdylin, Gurakuqin, Naimin, Hasanin etj. Derisa të vijë ajo ditë varrezat tuaja këtu do të jenë vend i shenjtë për të gjithë shqiptarët jashtë atdheut. Nga vizitat që do t'u bëjmë do të

mbushemi me frymëzime dhe do të betohemi se do të vazhdojmë luftën deri në realizimin e idealeve tona të përbashkëta.

LAVDI DËSHMORËVE!

Ky fjalim i shkruar nga Xhafer Durmishi u lexua me rastin e varrimit të vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, më 5 shkurt 1982, nga Remzi Ademaj, nga Zhuri i Prizrenit. (Zëri i Kosovës, Organ i LNÇKVSHJ, mars 1983, faqe 7-8)

4. Letër falënderimi për bashkatdhetarët në Nagold

Të dashur bashkatdhetarë të Nagoldit!

Na lejoni që të përfitojmë nga rasti për t'ju falënderuar përzemërsisht për kujdesin e madh që treguat me rastin e ngjarjes së hidhur që ngjau në mbrëmjen e 17 janarit në Untergruppenbach.

Ju falënderojmë për të gjitha, për telegramet, për vizitat në familje, ku na erdhët menjëherë me të dëgjuar lajmin që ta ndani hidhërimin me ne, për pjesëmarrjen në marshin protestues për të shprehur hapur revoltën e cila na ka përfshi të gjithëve, për nderimet e fundit që u bëmë dëshmorëve ku ju edhe njëherë treguat respektin për veprën e tyre, për ndihmat materiale të pakursyera me të cilat na ndihmuat aq shumë. Pjesëmarrja juaj me gjithë zemër na e zvogëloi shumë dhembjen tonë.

Ju falënderojmë të gjithëve që në këtë dhe të huaj na rrethuat ngrohtësisht, duke e kuptuar gjendjen se sa fortë ia kemi nevojën njëri-tjetrit.

Për aq sa kemi mundësi, ne nuk do të kursejmë veten tonë dhe do të mundohemi ta arsyetojmë ndihmën dhe kujdesin tuaj.

8 shkurt 1982 Untergruppenbach

Kjo letër e shkruar nga unë u nënshkrua "Shoqëria e punëtorëve të Shtutgartit"

5. Kush e vrau Jusuf Gërvallën?

Konsullata jugosllave në Shtutgart na e ka borgj gjakun e të treve

"....UDB-a Jugosllave na vrau...!" Ishin këto fjalët e fundit që i tha Jusuf Gërvalla para se të pushonte jeta e tij.

Vrasjet e UBD-së Jugosllave të 17 janarit 1982, kur vrasësit e paguar e profesional i vranë Vëllezërit Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zekën në një fshat gjerman, pran Shtutgartit do të mbesin përherë të freskëta e të pa harruara te ne punëtorët e Kosovës që punojmë në RF të Gjermanisë. Para syve tanë kemi gjakun e vëllezërve tanë, kemi lotët e grave dhe vajin dhe thirrjet e fëmijëve të tyre,..."zgjohu babë!" Parasysh kemi Nanën e vëllezërve Gërvalla duke i puthë dëshmorët në ballë, përpara e kemi babën e Kadriut, atë burrë krenar. Gjithnjë i kemi parasysh të gjithë ata prindër e familje të gjithë atyre dëshmorëve të popullit të Kosovës që u vranë nga fillimi i demonstratave 1981 e gjer më sot.

Larg Kosovës gjendemi por mirë i ndijmë zingjirët e tankeve dhe zhurmën e aeroplanëve e helikopterëve që fishkëllojnë mbi djepat e Kosovës, i shohim prangat në duart e disa dhjetëra mijëra të burgosurve. Por neve punëtorëve kosovarë na djeg për së afërmi kjo vrasje këtu në mes të Evropës, në mes të Gjermanisë, pran nesh. Dhe mendojmë si t'ia bëjmë?! E dimë ne fare mirë se çfarë duhet bërë dhe me atë me siguri nuk do të vonojmë shumë, por shqiptari e ndjek rendin sipas rregullit e traditës. E kemi

shprehi të flasim me vepra e fjalë por kemi borxh ndaj mikpritësit pasi këtë krim e përjetuam në vendin e tyre, prandaj po i presim si po na përgjigjen. Administrata dhe organet shtetërore të RF të Gjermanisë i din fare mirë të gjitha veprimet terroriste të Jugosllavisë në Kosovë, por e din edhe atë se terrori i UDB-së jugosllave i ka kaluar shumë herë kufijtë e RSFJ, se ajo i ka vra më tepër se 80 qytetarë të RSFJ vetëm në Gjermani, e në mesin e tyre edhe këta TRE.

Që nga koha e vrasjes e deri më sot organet hetuese gjermane nuk na komunikuan asnjë lajm për masat e ndërmarra as ndaj vrasësve direkt as ndaj Konsullatës Jugosllave në Shtutgart e as ndaj qeverisë së Beogradit e cila është organizatore dhe zbatuese e këtyre krimeve në territorin e RF të Gjermanisë. Përkundrazi u dëgjuan edhe disa dilema të pregaditura nga Beogradi, mbi ”mundësinë e qërimit të hesapeve të brendshme” etj. JO! Jusuf Gërvalla nuk la dilema. Ai i pa dhe e diti se ishin njerëzit e UDB-së ata të cilët kryen atentat mbi te. Andaj për dilema nuk ka aspak vend.

E qartë është se para së gjithash Konsullata Jugosllave e Shtutgartit është zbatuese e këtij krimi. Është e pamundur që ne si punëtor të bëjmë zbulime të thella. Ne e dimë se kush na i ka drejtua plumbat. Ne nuk do të caktojmë njerëz me detyra për veprim, por cili arrin i pari dhe cili e ka hallall gjakun e qumështin e Nënës shqiptare i din detyrat e veta. Megjithatë edhe një kohë do të presim fjalën e organeve të shtetit Gjerman dhe sigurisht do të dëgjojmë mendimin e popullit dhe të Lëvizjes së tij për Republikë.

25 shkurt 1982

Ky tekst i shkruar nga Xhafer Durmishi në atë kohë, 20 ditë pas varrimit u nënshkrua: ”Punëtorët kosovarë në regjionin e Shtutgartit” dhe u shpërnda në formë trakti nëpër qytete të ndryshme të Evropës.

6. Tre ranë, me mijëra u ngritën

Shovinizmi serbomadh i mbytur në gjakun e popullit shqiptarë e gjithashtu edhe në gjakun e popullit serb po afrohet nga dita në ditë me shpejtësi në buzë të greminës. Populli shqiptarë ka vendosur një herë e përgjithmonë të bëhet zot në vatrën e tij. Ai i ka vu bijtë e tij në ballë dhe u ka thënë: Merrni nga urrejtja ime për kolonizatorin dhe me te çani përpara. Nga urrejtja e tij e pakufi morën për luftën e tyre edhe Jusuf e Bardhosh Gërvalla me Kadri Zekën. Dhe në një natë me hënë Kosova i përcolli për në mërgim, por përcjellja e tyre kishte diçka të veçantë. Këta nuk ishin si të tjerët. Nuk i përcollën këta në mërgim pse kishin pritë me vite para enteve të inkuadrimit, por pse në orët e vona të natës ishin takuar shpesh në mbledhjet ilegale. I përcolli Kosova vetëm me një kusht: që këta të mos e harrojnë ate. Dhe bijtë besnik kudo që u ndodhën u treguan patriotë të vërtetë të cilët me shembullin e tyre frymëzuan shumë bashkatdhetarë.

U njoftuam me ta në lokalet e "Rilindjes" e Radio Prishtinës, në odat e Dukagjinit, në korzon e Prishtinës, në klubet e punëtorëve, në barakat tona të thjeshta ku i prisnim deri në orët e vona. Ju pamë me plis në kokë, me çifteli e megafon në dorë dhe me këngë e buzëqeshje në gojë. Na trokitët derë më derë, na ftuat në manifestime për festat kombëtare. Kur vëllezërit dhe motrat tona u mbytën në gjak, para se të vraponim ne tek ju, vrapuat ju tek ne. Na shpjeguat me durim të gjitha, dhe ne ua falëm besimin. Na thatë se duhet të solidarizohemi me vëllezërit dhe motrat tona. Nga baballarët kishim mësuar se lufta bëhet vetëm me pushkë në grykë të Kongjulit e në lug të Baranit, në fushën e Kosovës dhe në Bjeshkët e Nemuna. Por ju na mësuat se lufta mund dhe duhet të bëhet edhe në rrugët e Munihut, Gjenevës, Shtutgartit, Duseldorfit dhe Zurihut dhe atë me

shumë efekt. Dhe ne dalëngadalë, kush më herët e kush pak më vonë u bindëm se luftën duhet zhvilluar aty ku të gjendemi. Shkruat thirrje, siguruat flamuj, formuluat tekstet që në fakt ishin ato që i bartnin rinia nëpër rrugët e Prishtinës. Kërkuam edhe ne bukë, Republikë dhe punë. Udhëtuam nga largësi të mëdha dhe me ditë tëra i dogjëm të gjitha demagogjitë që u bënë në kurrizin tonë.

Armiku e pa se humbi shumë teren dhe duart e agjentëve të tij u shkurtuan në një masë të madhe. Dhe në momentin kur lufta jonë po shënon ngritje të reja, serbomëdhenjtë pas kalkulimeve të tyre menduan se më llogari do të kenë t'i vrasin se të mendojnë me arsye. Dhe çfarë janë arritjet. U VRANË TRE, tre kuadro të rëndësishëm të Çështjes Shqiptare, e U NGRITËN ME MIJËRA.

Vepra e tyre, puna e tyre u rritë bashkë me punën tonë dhe ata nuk vdiqën. Gjaku i tyre e thelloi edhe më tej hendekun në mes të popullit dhe shovinistëve të Beogradit. Ky gjak i derdhur do të na bëjë edhe më të vendosur dhe të papajtueshëm deri në fund me shtypjen. Kjo ngjarje na i nxehë gjakrat edhe neve që deri dje thonim se këto punë nuk na interesojnë. Nga kjo vrasje mizore ne e pamë edhe më tepër pafuqinë e armikut, për të vazhduar me demagogjinë e tij të preferuar e cila kurrsesi nuk po mund ta kryej misionin e saj nëse nuk e ka tankun te bishti. Nga kjo ne mësuam edhe njëherë se kurrë nuk mund të presim asnjë të mirë nga Beogradi. Me këtë akt shovinistët e zbuluan edhe njëherë fytyrën e tyre të vërtetë, pranuan para botës se e kanë përballë një popull bijtë e të cilit dinë ta udhëheqin në luftën e tij të drejtë, pranuan se nuk ishin të zotët ta vazhdonin luftën me ato mjete të cilat i përdorën kundërshtarët e tyre. Me këtë vrasje ata pranuan se kanë përpara një kundërshtar të vendosur i cili do t'u nxjerrë punë edhe nuk do t'i lejë kurrë të qetë. Ky akt brutal tregon se ata ua kishin shumë frikën këtyre trimave dhe po t'i lente gjallë, këta do t'i prishnin shumë punë shovinistëve të Beogradit. Ne duhet të jemi të bindur se paraqisnin rrezik të madh për shovinizmin serbomadh dhe për ekzistencën e tij, përndryshe ai për pak arsye nuk do t'i vriste. Kjo d.m.th. se shovinizmit po i lëkunden themelet, se ai nuk ka baza që nuk mund të bëhen copë e grimë.

Kur këta të tre paskan mund ta dëmtojnë aq shumë shovinizmin serbomadh atëherë çka mund të bëjmë ne mijëra punëtorë. Ne duhet ta kuptojmë se çfarë force të madhe paraqesim, duhet pra përfundimisht të kuptojmë se armiku na e ka frikën, në qoftë se e kupton se kemi lexuar qoftë vetëm një artikull e lere më ma tepër. Lufta jonë pos të tjerëve tani ka edhe heronjtë Jusuf, Kadri e Bardhosh për të cilët foli tërë bota.

Shovinizmi serbomadh na dëmtoi ne punëtorëve kosovarë në mërgim, por njëherazi edhe na e shtoi urrejtjen të cilën do ta shpërndajmë nëpër të gjitha poret e popullit tonë.

Ne do ta vazhdojmë luftën e madhe pa kuadrot tona të çmuara, por atë do ta vazhdojmë sepse përpos bindjeve tona tani kemi edhe dëshmorët tanë. Edhe nga varri ata do ta godasin shovinizmin serb.

LAVDI DËSHMORVE MË TË RI TË KOSOVËS!
KOSOVA–REPUBLIKË!
Rroft simboli i rezistencës sonë – Adem Demaçi!
Mars 1982, Shtutgart
(Zëri i Kosovës, Organ i LNÇKVSHJ, mars 1982, faqe 1-2)

Zëri i marsit 1982, i përgatitur përmbajtësisht nga Xhafer Durmishi-Skenderi dhe grafikisht nga Suzana Gërvalla

ZËRI I KOSOVËS

Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi

Në ballë të këtij populli dhe këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme. Jusuf Gërvalla

Nr. 3 Mars 1982

Bardhosh Gërvalla | Jusuf Gërvalla | Kadri Zeka

TRE RANË, ME MIJËRA U NGRITËN

Fajtorit i ka faj çdo kush. Shovinizmi serbomadh i mbytur në gjakun e popullit shqiptar e gjithashtu edhe në gjakun e popullit serb po afrohet nga dita në ditë më shpestësi buzë greminës. Populli shqiptar ka vendosur një herë e përgjithmonë të bëhet zot në vatrën e tij. Ai i ka vu bijët e tij në ballë dhe u ka thënë: Merrni nga urrejtja ime për kolonizatorin dhe me te çani përpara. Nga urrejtja e tij e pa kufi morën për luftën e tyre edhe Jusuf e Bardhosh Gërvalla me Kadri Zekën. Dhe në një natë me hënë Kosova i përcolli për në mërgim, por përcjellja e tyre kishte diçka të veçantë. Këta nuk ishin si të tjerët. Nuk i përcollën këta në mërgim pse kishin pritë me vite para enteve të inkuadrimit, por pse në orët e vona të natës ishin takuar shpesh në mbledhjet iligale dhe vendimet e tyre populli i futi thellë në gjirin e tij. I përcolli Kosova vetëm me një kusht! që këta të mos e harrojnë ate. Dhe bijët besnik kudo që u ndodhën u treguan patriotë të vërtetë të cilët me shembullin e tyre frymëzuan shumë bashkatdhetarë.

U njoftuam me ta në lokalet e «Rilindjes» e Radio Prishtinës, në odat e Dugagjinit, në korzon e Prishtinës, në klubet e punëtorëve, në barakat tona të thjeshta ku i prisnim deri në orët e vona. Ju pamë me plisë në kokë, me çifteli e megafon në dorë dhe me këngë e buzqeshje në gojë. Na trokitët derë më derë, na ftuat në manifestime për festat kombëtare. Kur vëllezrit dhe motrat tona u mbytën në gjakë, para se të vraponim ne tek ju, vrapuat ju tek ne. Na shqjeguat me durim të gjitha, dhe ne ua falëm besimin. Na thatë se duhet të solidarizohemi me vëllezërit dhe motrat tona. Ne që ishim mësuar të shkurtojmë dru ahu dhe të rrimë në odë deri në orët e vona, rrëzë Karadakut e Çyçavicës, nga baballarët kishim mësuar se lufta mund të bëhet vetëm me pushkë në grykë te Konxhulit è në lug të Baranit, në fushën e Kosovës dhe në Bjeshkët e Nemura. Por ju na mësuat se lufta mund dhe duhet të bëhet edhe në rrugët e Mynhenit, Gjenevës, Shtutgartit, Dyseldorfit e Cyrrihut dhe ate me shumë efekt. Dhe ne dal nga dal, kush më më herët e kush pak më vonë u bindëm se luftën duhet zhvilluar aty ku të gjendemi. Shkruat thirrje, siguruat flamuj, formuluat tekstet e parullave që në fakt ishin edhe ato që i bartinin rinia nëpër rrugët e Prishtinës. Kërkuam edhe ne bukë, republikë dhe punë. Udhëtuam nga largësi të mëdha dhe me ditë të tëra i dogjëm të gjitha demagogjitë që u bënë në kurriz tonë.

Partia Komuniste (PKMLSHJ*): "Jusuf Gërvalla ishte një kolos i pazëvendësueshëm i çështjes kombëtare. Prandaj, përpjekja për zëvendësimin e tij ishte një gabim fatal, që i kushtoi shumë shtrenjtë gjithë çështjes kombëtare shqiptare, e veçmas organizatave (komuniste-shën. i Xh. D.) politike që vepronin në atë kohë!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

7. Nga letra dërguar Pajazit Ibrahimit në Australi më 7 mars 1982

Shoku Pajazit,

Përgjigjen në letrën time e mora nga shoku prej të cilit ta kam dërguar...

Revistat me sa e kuptova u paskan pëlqyer dhe për këtë jemi të gëzuar. Edhe ne na erdhi mjaft mirë që kishit dërguar ata ekzemplarë të numrit 16 të gazetës së Shoqërisë "Bajram Curri." Herave tjera na dërgoni më tepër, sepse ndikojnë mirë tek punëtorët në Perëndim, të cilët janë të shumtë dhe që shkojnë shpesh në Atdhe.

……

Mendoj se unë dhe ti përbëjmë një rast të mirë që të ndikojmë në afrimin e Lëvizjes dhe Shoqërisë "Bajram Curri" në Australi. Kështu përveç këmbimeve të letrave tona private të bëhet komunikimi në mes Komitetit Vëllezërit Gërvalla, Komitetit të Lëvizjes në Zvicër dhe Shoqërisë për Bashkim Kombëtar "Bajram Curri" në Australi. Këtë po e përfundoj me kaq duke ju nisur njëherit disa ekzemplarë të Zërit të Kosovës, të janarit 82, me bindjen se po u plotësoj dëshirën ju dhe bashkatdhetarëve tjerë. Shkruani për aktivitetin, për jetën dhe peripetitë e bashkatdhetarëve në Australi.

Përshëndetje vëllazërore dhe revolucionare nga ne të gjithë.

Kosova-Republikë!

P.S. Personalisht ti dhe Shoqëria Bajram Curri, Familjes Gërvalla mund t'i drejtoheni në adresën:

Familja Gërvalla, Habichtchöhe str. 40, 7101 Untergruppenbach, West Germany

8. Thirrje për demonstratë në Vjenë

-demonstratën e parë shqiptare në Austri për datën 24 prill 1982, 24 vjet para bisedimeve të Vjenës të organizuara nga faktori ndërkombëtar

Vëllezër dhe motra në mërgim!

Kjo është thirrja e njëmbëdhjetë, e cila u drejtohet punëtorëve kosovarë në mërgim.

Çfarë t'ju themi ne me këtë thirrje përveç t'ua përsërisim ato që ua kemi thënë edhe më parë. Pra të njëjtat halle. Na mbet ky amanet brez pas brezi, prej shpatës së Skënderbeut e deri sot. Iu përgjegj shqiptari thirrjes kudo që u ndodh, gjatë gjithë historisë së tij në mënyrë që brezit tjetër të ri t'i krijoj një vend për të jetuar i lirë me pjesën e tokës dhe të diellit që na takon. U derdh gjaku lum gjersa u fitua një tokë e lirë shqiptare. Edhe në pjesët e tjera të copëtuara të cilave u ra të ndërrojnë vetëm zgjedhat, nuk u kursyen sakrificat gjer në atë supreme.

Përkundër këtyre të gjithave deri më 11 Mars 1981 liria nuk u fitua, edhe pse disa lëshime u bënë hap pas hapi dhe dalëngadalë nga jugosllavët, dhe të cilat na kushtuan shumë. Populli ynë shfrytëzoi me kujdes dhe në mënyrë efektive këto hapësira për ta ngritur vetëdijen e tij deri në atë shkallë në të cilën po e shohim nga 11 Marsi e këtej, e që në mënyrë edhe më madhështore do ta shohim nesër.

Njëri nga udhëheqësit e lartë të Lëvizjes Revolucionare të Kosovës, Jusuf Gërvalla thoshte se: "NJË POPULL PUSHON TË JETË I ROBËRUAR NGA AI

MOMENT QË NGRITET KUNDËR ROBËRISË, I VENDOSUR QË TË LUFTOJË DERI NË FUND DHE ME BINDJE TË PALËKUNDUR NË FITOREN E TIJ". Kjo ndodhë tani edhe me popullin tonë, i cili u ngrit në këtë luftë të cilën armiku e quajti kundërrevolucion e që në fakt këto janë vetëm fillet e një Revolucioni, nëse zgjedhja e çështjes kombëtare dhe klasore e shqiptarëve në Jugosllavi nuk zgjidhet në mënyrë demokratike. Dhe pikërisht ky citat i marrë nga vepra e teoricienit tonë të madh është shkruar duke u bazuar në rezistencën e popullit të Kosovës nga 11 Marsi e këtej.

Këto vlime në këto përmasa flasin aq qartë sa janë të detyruar t'i pranojnë me plotë gojën edhe kundërshtarët tanë. Përmasat dhe vazhdimësia flasin në mënyrën më serioze se kjo punë kërkon zgjidhje të drejtë.

Në planin e brendshëm po duket se kjo luftë nuk mund të pushojë përkundër burgosjeve e vrasjeve masive. E njëjta u vërtetua edhe sa i përket planit të jashtëm, siç u pa në demonstratën e Bonit. Nëse Beogradi ka menduar se me vrasjet e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit ka arrijtë të bëjë shumë punë, dhe për të parë se si do të shkojë puna ka dërguar edhe ndonjë kriminel të dëgjoj anash me aparat fotografik nën sqetull, ka pasur rastin ta shoh se sa lart qëndrojnë ata. E panë se ata kanë hyrë në zemrën e popullit, se vepra dhe kujtimi i tyre ishin një mobilizim i madh që të paraqiteshim sa më shumë në demonstratë dhe kjo të kaloj në mënyrë sa më shembullore.

Merita për këtë, dalja jonë në numër të madh, na takon të gjithëve, i takon gatishmërisë sonë të madhe. Kështu ka qenë edhe më parë, natyrisht në një masë më të vogël, sepse nuk dinim se si e qysh të veprojmë në këto dhera të huaja. Sot rrugën e kemi të trasuar, të shtruar mirë edhe me gjak, prandaj ata që përpiqen për të na ndalë në këtë rrugë, pa mëshirë, do t'i shkelim.

Njoftim

Njoftojmë bashkatdhetarët se kjo demonstratë thirret nga punëtorët kosovarë me punë në Evropën Perëndimore, si pjesë e pandashme e popullit të Kosovës.

Tubimi do të bëhet në stacionin hekurudhor Westbanhnhof të Vjenës, në ora 11.00.

Pas demonstratës është organizuar vizita në grupe në muzeun Belvedere të Vjenës, që të shohim armët e Skënderbeut.

Pas kësaj vizite do t'i shijojmë më mirë fjalët e bilbilit të gjuhës shqipe, Naim Frashërit, i cili para shumë viteve tha:

"Lum ti moj Shqipëri thash
armët e tij kur pash
Në Belvedere në Vjenë
Sikur pashë Skenderbenë"

Kosova – Republikë!

9. Zotërinj, dëgjoni zërin e masës
Fjalim në demonstratën e Vjenës, 24 prill 1982

Kaloi viti që kur populli shqiptar shtroi para Lidhjes së Komunistëve dhe qeverisë së Jugosllavisë që Kosovës t'i njihet statusi i republikës së federuar.

Kjo kërkesë e shtruar edhe më parë nga intelektualët Kosovar dhe udhëheqëja krahinore nuk u përfillë nga qeveria federative. Kjo e shtyri popullin tonë dhe forcat e tij të organizuara që të ngriten maovikisht në demonstrata.

Edhe para demonstratave të vitit të kaluar udhëheqjes krahinore dhe asaj federative i është e njohur se populli nuk është i kënaqur me ritmet e zhvillimit të ekonomisë, se ai nuk mund të pajtohet me shitjen e rrymës, qymyrit dhe mineraleve të cmuara me cmime qesharake, se ai më nuk do të duroj ndarjen e viseve dhe popullit shqiptar në mes të tri republikave jugosllave, se nuk pajtohet me trajtimin e tij si pakicë kombëtare. Jo një herë është kërkuar në diskutimet në mbledhjet e ndryshme zhvillimi i Kosovës, korigjimi i kontratave të njëanshme të bëra nga spekultorët serbo-malazezë në kurrizë të ekonomisë së Kosovës.

Disa herë para 11 Marsit të vitit 1981 u tubuan studentët në sallën e menzës së Universitetit dhe kërkuan nga drejtori dhe kompetentët tjerë përmirsimin e standartit të studentëve, por në vend të dëgjimit të fjalëve tëtyre, udhëheqësit partiak në fletoret e tyre shënonin vetëm emrat e tyre që guxonin të lypin bukë. Punëtorët të cilët ankoheshin për padrejtësitë që u bëheshin nëpër organizatat punuese, që kritikonin familjarizmin dhe kërkonin rritjen e pagave, etiketoheshin dhe ndaj tyre hapej procedura penale.

Ldhjes Komuniste dhe Qeverisë Jugosllave i është tërhequr vërejtja si nga klasa punëtore ashtu edhe nga forcat e organizuara që të merr masa për ndryshimin e situatës dhe të merr inisiativën për zgjidhjen e cështjes së pavarsisë dhe barazisë klasore e nacionale të klasës punëtore dhe të popullit shqiptar në Jugosllavi, respektivisht që Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi t'u njihet statusi i Republikës, përndryshe nëse ajo këtë cështje nuk e rregullon, klasa punëtore dhe populli shqiptar do të deyrohen që të drejtat e tyre të ligjëshme t'i fitoi me rrugën revolucionare.

Ndaj grevave dhe demonstratave tona paqësore u përdor dhuna e egër. Masat popullore duke përfshirë edhe fëmijët u sulmuan me rafale automatikësh, u shkelën me tanke dhe u helmuan me gazëra nga helikopterët. Menduan me këtë ta frigojnë popullin shqiptar, por me këtë vetëm zbuluan fytyrën e vetë të okupatorit. Ndërsa udhëheqësia e Kosovës me qëndrimin e vetë tregoi se është qeveri kuislinge. Ajo me këtë rast u distancua nga populli si tradhëtare e interesave të tij.

Kush nuk mbeti pa u akuzuar nga Beogradi për vlimet revolucionare në Kosovë. Akuzat e saja në adresa të gabueshme dhe inskenimet e poshtra të trashiguara nga kralët e carët e tyre të mëparshëm, dështuan me turp dhe ato në vend që të arrinin qëllimin e dëshiruar të srbomdhenjëve, u ktheheshin si bumerang "politikanëve të mëdhenjë të Beogradit".

Të zënë ngushtë nga kërkesat e drejta të popullit tonë, forcat anti popullore dhe antisocialiste jugosllave hodhën në veprim kartën e njohur, të cilën e përdorën edhe qeveritë fashiste; ndërsimit e njërit popull kundër popullit tjetër. Por edhe në këto pika këto foca kanë dështuar, sepse këto forca reaksionare me veprimet e tyre janë të rrezikshme për të gjithë njësoj.

Shkaqet dhe shkaktari i krizës në Jugosllavi dhe i gjendjes në Kosovë dihen. Moszgjidhja me kohë dhe në mënyrë të drejtë të cështjes së pavarsisë dhe barazisë së

plotë klasore-nacionale, masat degjeneruese dhe shkombëtarizuese, shtypja dhe terrori që u ndërmorrën mëse dyzet vite me radhë në kurriz të popullit shqiptar, gjendja e mjeruar ekonomike e sociale në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare në Jugosllavi; mardhaniet shoqroro-ekonomike dhe mardhaniet tjera kapitaliste të trashëguara nga Jugosllavia e para luftës së dytë botërore në njërë anë dhe në anën tjetër depërtimi i forcave shoviniste, kolonial hegjemoniste dhe unitariste jugosllave në të gjitha organet shtetroretë Jugosllavisë dhe deri në udhëheqësi të LKJ, të cilat nga aty rafinuan dhe vunë në përdorim metodat shfarosëse kundër shqiptarëve.

Sot kemi aq shumë serbomdhenjë të verbuar nga ndjenja e shovinizmit, të cilët shpeshëherë nuk dinë të mëshehin dhe të manifestojnë hapur, që nga bashkësia më e vogël lokale e deri tek organet më të larta të qeverisë, ushtrisë dhe të Lidhjes Komuniste, qëellimet e tyre të errëta.

Klasa punëtore dhe populli shqiptar luftojnë dhe do të luftojnë deri në fund për realizimin e të njëjtave qëllime për të cilat luftoi krah për krah me popujt tjerë të Jugosllavisë. Lufton që të realizohen marëveshjet që u bënë gjatë luftës Nacionalclirimtare. Popullit shqiptar atëherë iu premtua se pas mbarimit të luftës ai do të jetë i lirë, i pavarur dhe i barabartë. Marveshje dhe premtime të cilat nuk u mbajtën pas LNC, nga ana e qeverisë jugosllave.
Pas LNC, Jugosllavia u rregullua në bazë të një sistemi federativ të përbërë prej shumë shtetesh apo republikash socialiste të cilat formuan edhe partitë e tyre politike nacionale, të cilat do t'i mbronin interesat dhe do ti përaqësonin kombet dhe punonjësit e tyre në federatë. Popullit shqiptar as kjo nuk iu lejua. Përkundrazi, ai dhe viset e tija u ndanë në mes tri republikave jugosllave. Kuadrot shqiptare të cilat i kishin prirë popullit në LNC u egzekutuan në mënyra të ndryshme, ca u shpërndanë e ca të tjerë përqafuan tradhëtinë. Popullin shqiptar mbeti ta përfaqësoi Dushan Mugosha, Svetozar Vukmanoviq Tempo e "komunistë" të tjerë serb, malazias e maqedonas.
Sot i tërë populli shqiptar në Jugosllavi i bashkuar në kërkesë dhe veprim si një grusht i vetëm, nuk ka forcë që mund ta ndali. Ai ka vendosur dhe do ta coj gjerë në fitore luftën e tij, pamarrë parasysh ndjekjet arrestimet, vrasjet dhe sakrificat e tjera. Populli shqiptar s'ka cka të humb. Ai në këtë luftë vetëm do të fitoj.
24 04 1982 Vjenë
(Disa fjali vazhduese nuk i kam përfshi këtu).

10. Tri epitafe

Fjalë të gdhendura në gurët e varreve që për 20 vite qëndruan në Shtutgart
Epitafi në gurët e varreve të Jusufit dhe Bardhoshit, në bazë të Programit të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, u shkrua nga Xhafer Durmishi-Skenderi.

Epitafi në gurin e Jusufit:
“Luftoi dhe mbeti yll i pashuar në qiellin shqiptar”

"Në fshatin Untergruppenbach afër Shtutgartit të Gjermanisë, mbi varrin e një të riu shqiptar, 31 vjeçar gjendet ky epitaf

'Këtu prehet dhe pret një ditë Besniku i Kosovës'.

Mbase do të mjaftonin këto dy radhë për të shprehur dramën e këtij të riu, të cilën në njëfarë mënyre e përjeton sot Kosova, me të vetmin ndryshim që dita e shumëpritur sot duket më e afërt se kurrë. Është fjala për Bardhosh Gërvallën." (Lutfi Dërvishi, Nga fjala në tubimin përkujtimor mbajtur në Tiranë më 1992)

Nga riorganizuesit e OMLK-së për gurin e varrit të Kadri Zekës, në bazë të Programit të OMLK-së u shkrua ky epitaf:

"Lavdi komunistit dhe organizatorit të paepur gjer në fund"

11. Shoku Engjëll

(Engjëll Kolaneci, diplomat në Ambasadën e Shqipërisë në Vjenë)
Nëntor 1982

Në prag të festës Faridini më njoftoi për bisedën telefonike që paska pasur me ju. Me këtë rast më tregoi se tek ju paskan ardhur letrat e Suzanës. Siç ju pata thënë edhe më parë, neve na u deshtë që gurët t'i rregullojmë me çdo kusht para festës, dhe siç mund t'ju ketë treguar shoku Faridin, ata (gurët) u vendosën e me sa duket janë të punuar mirë. Edhe njerëzit kanë dhënë vlerësime të mira, por ndonjë fotografi ende nuk ma kanë sjellë shokët. Ne huazuam një shumë të hollash për këtë rast dhe paguam një pjesë për të cilën

të kam pas treguar. Firma e gurëve, në të vërtetë më kompetentja, se këto rregulla këtu unë nuk i di, por si më kanë treguar e ka bërë punën në atë mënyrë që, kur të kthehet letra e Suzanës do të na kthehen të hollat. Siç e dini, në atë letër Suzana autorizon një njeri që të përgjigjet në çdo rast për sigurimin e gurit të të shoqit, për arsye se ajo nuk ka banim të përhershëm në mërgim.

Përndryshe ne jemi mirë, edhe punët janë duke shkuar mirë.

Te fala, Xhaferi

12. Nga letra dërguar Faridin Tafallarit më 20 dhjetor 1982

Shoku Faridin,

Angazhohu për këto porosi që ua dhashë e t'i kryeni pa u vonuar. Se disa gjëra që ia thash Mejdiut vlejnë edhe për ty. E për disa gjëra që do t'i bëni, sidomos tani e tutje, i aprovojnë ata duke i pyetur më parë se kështu do të zhvillohet iniciativa tek ata dhe do ta ndiejnë veten më mirë. Numri i telefonit që ia ke dërguar Muharrem Gjocajt nuk është i Sejdi Bytyqit (në New York) por i një Nezir Sumajt, farefis i familjes Gërvalla.

Mos u vono hiç, por gjeje kohën një ditë dhe duku tek avokati me Hafizin dhe pyetni për pensionin e Tushës dhe ato të holla ia dërgoni përmes kushëririt të saj Miftarit. Gjithashtu ia dërgoni ndonjë fotografi të varreve.

Të fala, Xhaferi

Hafizi – Hafiz Gagica; Mejdiu – Mejdi Rexha nga Korisha
Tusha – gruaja e Brardhosh Gërvallës

13. NE PRAGUN E PRANVERES 1981

Pjesë nga një fjalim i mbajtur më 9 korrik 1983 në Zvicër para aktivistëve kryesor të klubeve shqiptare në Evropë

Çfarë baze ka ky vlim kaq i madh revolucionar, në një plan më të përgjithshëm e kanë dhënë tre artikujt e "Zërit të Popullit" të datave 8 e 23 prill dhe 17 maj.

Momenti historik

Ashtu siç kishin ndikuar aq fort në demonstratat e vitit 1968 organizimet për shënimin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, edhe në hapjen e dekadës së viteve 80-të ka vulën e saj jehona e kremtimit të 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Të gjithë nxënësit e shkollave të mesme e fillore patën për detyrë shtëpie të mësojnë himnin e Rilindjes Kombëtare, vjershën e Pashko Vasës, "O moj Shqypni". Të gjitha shkollat, në planprogramet e tyre kishin tema nga aspekte të ndryshme të Lidhjes.

Ekspozita madhështore e artistëve të Shqipërisë, e cila qëndroi hapur me javë të tëra në Prishtinë dhe Prizren, bëri jehonë si kurrë më parë. Jo vetëm qytetarët e Prishtinës, por e gjithë Kosova u kënaq e inspirua.

Të gjitha gjinitë e kulturës dhe artit u vunë në shërbim të kësaj ngjarjeje edhe në Kosovë. Në këtë drejtim u dallua kryevepra e Ekrem Kryeziut (aktivistin e Lëvizjes), drama "Epoka para Gjyqit".

Viti 1979 kaloi në shenjë të shkrimit të parullave, të shpërndarjes së trakteve, të burgosjeve masive, e sidomos gjysma e dytë e tij shënon edhe fillimin e patrullimit të çdo shkolle pothuaj të çdo fshati, në çdo pëllëmbë të Kosovës.

Ndikimi i muzikës

Shoqëritë kulturore artistike dhanë një kontribut jashtëzakonisht të madh. Në këtë drejtim meriton të dallohet Shoqëria Kulturore Artistike "Afërdita" nga Mushtishti.

Gjatë verës së vitit 1979 nëpër Kosovë bëri një turne të gjatë Trupa e Radiotelevizionit Shqiptar. Ditën kur kjo trupë u largua nga Kosova, sheshi para Grand Hotelit qe bllokuar nga masa e popullit. Disa dhjetëra koncerte dha kjo trupë, nganjëherë nga kërkesa e madhe e masave edhe nga tri për një ditë. Mbresa të pashlyeshme para publikut kosovar lanë edhe grupi muzikor nga Shkodra dhe Kukësi i ri. Në njërin prej koncerteve të fundit në Hallën 25 Maji në Prishtinë, kur solistët po ia thoshin këngës "Luftë bënë shqipja me shtatë krajli", një shikues në publik nuk mund të përmbahet, nxjerrë revolen dhe i përshëndet këngëtarët me të shtëna në ajër gjer në fishekun e fundit.

Botimet e veprave teorike dhe historike

Botimi i një seri veprash të Enver Hoxhës, siç janë "Vetadministrimi jugosllav teori dhe praktikë kapitaliste", "Imperializmi dhe Revolucioni", "Shënime për Kinën" dhe leximi i tyre përmes valëve të Radio Tiranës kanë bërë një efekt shumë të madh. Në të njëjtën kohë çdo lexues i shtypit ilegal në Kosovë, nuk e ka pasur aq të vështirë që të vij tek këto vepra. Si rrallë ndonjë libër tjetër, në Kosovë ndikim të madh dhe zgjim të lartë të vetëdijes kombëtare ka bërë libri "Shota dhe Azem Galica" i Ajet Haxhiut, pastaj romanet e Sylejman Krasniqit dhe vëllimet me poezi të Agim Gjakovës e Adem Istrefit.

Ndikimi i Televizionit Shqiptar

Katalizatori më efektiv, i cili ndikoi shumë për shpërndarjen e mjegullës që okupuesit ia kanë hedhur popullit tonë para syve, për një kohë të shkurtë ishte Televizioni Shqiptar, të cilin nga fundi i 1979 pati mundësinë ta përcjellë pjesa më e madhe e Kosovës. Ka qenë pamje e rëndomtë që në autobusa e trena të takosh vazhdimisht njerëz me antena nën sqetull, për kanalin 12. Familjeve patriotike dhe në zë edhe më tutje u analizoheshin kulmet e ndërtesave, por tani fokusimi nuk ishte tek oxhaku por vetëm në bazë të llojit dhe drejtimit të antenave të televizionit. Kur shfaqej drama "Gërsheti i luftërave", në Drenicë tërë natën dëgjoheshin krisma armësh e nuk mungonte as thirrja "O prite Azem Galicën". U pëlqyen shumë emisionet dokumentare kushtuar luftërave për liri e pavarësi në rubrikën "Ngjarje e data". Por mbi të gjitha, nga emisionet për fëmijë, populli i Kosovës e pa se çka d.m.th. me qenë i lirë, me qenë zot në shtëpinë tënde. Kjo ndjenjë e çoi peshë atë sërish në vitin 1981.

Ndikimi i shtypit ilegal

Mbi të gjithë këta faktor, në këtë situatë me erë baroti, faktori që në rrethe të tëra krijoji një entuziazëm të papërshkrueshëm dhe që rriti besimin në forcat tona, qe lulëzimi i shtypit ilegal gjatë vitit 1980. Garancioni më i madh dhe shenjat më bindëse se gjendeshim para ngjarjeve të mëdha ishin shpërndarja e revistave Bashkimi, Lajmëtari i Lirisë dhe Liria. Korrik 1983

14. Programi i Bashkësisë së Klubeve

Nga ”Programi Aksional i Bashkësisë së klubeve të punëtorëve shqiptarë nga Jugosllavia në Evropën Perëndimore”

Për qëllimet dhe interesat e tyre, në fillim, iniciativën për hapjen e klubeve shqiptare e përkrahën edhe policët e sigurimit jugosllav të veshur me petkun e diplomatit. Ata ushqenin shpresat se me ndihmën e klubeve do të kryenin më lehtë misionin e tyre të spiunazhit.

Shikuar realisht, po të kishte nisje nga qëllime të mira, krejt puna në këtë drejtim do të duhej të kryhej nga ana e përfaqësuesve të RSFJ, të cilët këtë punë edhe e bëjnë kur janë në pyetje klubet e kombeve dhe kombësive tjera nga Jugosllavia, të cilave pos ndihmës së ndryshme administrative u ofrohen edhe ndihma materiale.

Kur planet djallëzore me shqiptarët u dështuan, atëherë edhe çjerrja e maskës dhe zbulimi i vërtetë i planeve të tyre nuk ka vonuar të duket. Disponimi i përgjithshëm antishqiptar i shovinistëve të Beogradit dhe sidomos i politikës së tyre të jashtme antishqiptare erdhi në shprehje edhe në qëndrimin e tyre ndaj shqiptarëve të mërguar nga Jugosllavia, si thonë në mënyrë ironike “me punë të përkohshme”. Duke u nisur nga ky qëndrim, ku më herët e ku më vonë filluan presionet ndaj aktivistëve të ndryshëm që kishin kontribuar më së shumti në tubimin e shqiptarëve të shkapërderdhur, duke i etiketuar si element armiqësorë dhe ndaj pjesës dërmuese të tyre u morën masa të ndryshme; prej marrjes së pasaportave e deri tek burgosjet e rënda.

Këto fërkime në mes punëtorëve e aktivistëve të ndryshëm dhe ambasadave e konsullatave jugosllave arritën kulmin në momentet pas shpërthimit të demonstratave në Kosovë, të cilat pos të tjerash çuan edhe tek tubimet e shumta nëpër klubet shqiptare, të organizuara nga përfaqësitë jugosllave, të cilat nga punëtorët shqiptarë në mërgim kërkonin të dënonin vëllezërit dhe motrat e tyre në Kosovë. Konsullatat, vet, në emrin e disa klubeve dërguan telegrame në Radio Prishtinë, sipas të cilave bashkatdhetarët në botën e jashtme i dënonin demonstratat në Kosovë. Gënjeshtrat e tilla u denoncuan në mënyrën më kuptimplote me anën e tetë demonstratave që u organizuan vetëm në Pranverën dhe Verën e vitit 1981 e që do të vazhdonin edhe në vitin 1982.

Nga ngjarjet më të ndryshme të të gjitha llojeve në këtë kohë nuk u kursyen as klubet e shqiptarëve. Sot është fakt me rëndësi se këto klube dita ditës po grumbullojnë rreth vetes gjithnjë e më shumë anëtarë të rinj dhe në përgjithësi po konsolidohen. Kjo i dedikohet më së shumti faktit se mërgimtarët po e kuptojnë se një prej detyrave të para për ta është ajo, që në këto momente të jenë sa më të bashkuar.

Që kjo punë të intensifikohet edhe më shumë, deri në atë shkallë që e kërkojnë interesat e kohës, më 9 korrik 1983, nga përfaqësuesit e shumicës së klubeve dhe rretheve të dalluara të shqiptarëve në Evropën Perëndimore u vendos që të themelohet BASHKËSIA E KLUBEVE DHE RRETHEVE SHQIPTARE NE EVROPEN PERENDIMORE.

Ideja themelore e Bashkësisë është solidariteti.

Bashkësia me punën e vetë ka për qëllim:

-Të koordinojë punën e të gjitha klubeve në Perëndim, duke aplikuar përvojën e përparuar të ndonjë klubi në një tjetër; të bëjë njohjen e tyre reciproke, të organizojë mbrëmje të përbashkëta në mes klubeve fqinje dhe të atyre më larg, të cilat do të shkojnë në interesin e mërgimtarëve.

-Të ndihmojë me të gjitha forcat, me njerëz, me mjete materiale dhe me ndihmë morale në hapjen e sa më shumë klubeve, duke organizuar sa më shumë mërgimtarë që të tubohen rreth tyre.

-Edhe pse përfaqësitë diplomatike dhe të gjithë mekanizmat tjerë të RSFJ-së, që kanë kontakte më të shpeshta me ne, duke u nisur prej një diplomati e deri tek një polic i thjeshtë në autostradë apo tren po sillen ndaj nesh tejet armiqësisht, ne do të vazhdojmë të respektojmë simbolet e RSFJ, ashtu siç veprojnë edhe klubet e kombeve e kombësive tjera megjithëse trajtimi i tyre në krahasim me ne është diametralisht i kundërt.

-Bashkësia do të përkrahë kërkesën e popullit shqiptarë "Kosova-Republikë" dhe në këtë drejtim ajo e shikon me simpati punën e Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi. Konsiderata e lartë e Bashkësisë ndaj Lëvizjes i vjen sidomos kur të kihet parasysh fakti se Lëvizja u ngritë lart duke pasur në themelet e saj edhe gjakun e freskët të tre heronjve që ranë afër Shtutgartit.

Bashkësia me këtë punë, me koordinim të aktivitetit, ka për qëllim që në kushtet e ashpërsimit të krizës t'i ndihmojë mërgimtarët tanë në mundësitë e veta që problemet e tyre që po u shtohen dita ditës, t'i përballojnë më lehtë.

Bashkësia është e vetëdijshme për situatën e rëndë të popullit të Kosovës dhe këtë situatë ajo e vlerëson si të jashtëzakonshme, situatë që u afrohet kushteve të luftës, andaj ajo me ndihmën e mërgimtarëve do të ndërmarrë hapa të atillë që i kalojnë kufijtë e aktivitetit të Bashkësisë në kushte normale. Kjo do të thotë pos të tjerash se Bashkësia, pjesën më të goditur të popullit të Kosovës për aq sa i lejojnë mundësitë, do ta ndihmojë edhe materialisht.

Gusht 1983, Saarlouis

15. Letër Bashkësisë së Klubeve

Letër dërguar delegatëve të Bashkësisë së Klubeve dhe Rretheve Shqiptare në Evropën Perëndimore

1 nëntor 1983

Siç jeni në dijeni, Bashkësia e klubeve, më 16 tetor 1983 thirri mbledhjen e vet të parë, në të cilën pos të tjerash u miratua Statuti i Bashkësisë dhe u zgjodh organi udhëheqës i saj.

Në vazhdën e vendimeve u vendos që organi udhëheqës i Bashkësisë të mblidhet një herë në tre muaj. Në bazë të këtij vendimi Këshilli Drejtues i Punës së Bashkësisë së bashku me këshilltarët e vet do të mblidhet më 14 janar 1984 e do të diskutoj e marrë vendime mbi aktivitetin e mëtejshëm të klubeve dhe rretheve shqiptare në Evropën Perëndimore.

Duke pasur parasysh këto rrethana, Bashkësia e klubeve përmes delegatëve të vet u bënë me dije klubeve shqiptare dhe rretheve të ndryshme që gjatë muajit nëntor të këtij viti të mblidhen udhëheqësitë dhe anëtarët e klubeve për të përpiluar programet e tyre njëvjeçare. Në këtë drejtim ata duhet që në pika të ndryshme të ndalen rreth aktivitetit të tyre të gjertanishëm, të vërejnë sukseset dhe dobësitë dhe në këtë bazë të përpunojnë planet e tyre të punës se ku është qëllimi ynë që të arrijmë pas një viti. Si udhërrëfyes, gjatë përpilimit të planprogrameve, të shërbej Statuti i Bashkësisë në të cilin Bashkësia ka treguar qëllimin e vet. Si rrjedhim i kësaj, vendimet që merren duhet të jenë në frymën e Statutit të Bashkësisë, i cili u miratua në mbledhjen e parë të saj.

Qëllimi kryesor gjatë përpilimit të planeve njëvjeçare duhet të jetë masovizimi i klubeve me sa më shumë anëtarë, si dhe krijimi i lidhjeve sa më të shumta me grupe të ndryshme punëtorësh, të cilët edhe nëse nuk mund të bëhen anëtarë për arsye të ndryshme, ta propagandojnë klubin dhe ta ndihmojnë atë materialisht. Rëndësi të madhe, më të madhe se gjer më tani t'u kushtohet kontakteve me organizata të jashtme të vendeve në të cilat punojmë.

Rëndësi t'i kushtojmë konsolidimit të grupeve muzikore, mbledhjes sa më të mirë të materialit filmik.

Njoftoni Bashkësinë me të gjitha vendimet që merrni, të cilës sipas një vendimi, duhet t'i dërgohen raporte të rregullta mbi punën e klubeve dhe për çështje diskutabile kur nevojitet mendimi i Bashkësisë. Në bazë të planprogrameve të secilit klub, Këshilli Drejtues i Punës (KDP) do të përpunojë planin njëvjeçar të Bashkësisë në tërësi, në mbledhjen e vet më 14 janar 1984.

Të dashur shokë delegatë, të dashur shokë të udhëheqësive të klubeve!

T'i përvishemi punës me të gjitha forcat, të shkundemi nga përtacia e të mos lejojmë që asnjë minutë të na shkoj kot.

Bashkësia e klubeve i shikon me sy jo të mirë disa dukuri në disa klube të reja për të cilat u angazhuam me sa e sa mundime që t'i krijojmë, kur ende pa u konsoliduar mirë klubet, ngrihen thirrje nga individ të ndryshëm që të ndërrohen udhëheqja e ndonjë klubi, apo e ndonjë anëtari të kryesisë, thuase klubet na kanë munguar vetëm e vetëm pse nuk kemi pasur njerëz për t'i caktuar për kryetar.

Të dashur shokë, klubet në disa vende na kanë munguar dhe na janë minuar nga shovinist të ndryshëm dhe vegla të tyre që janë armiq të përbetuar të popullit tonë, të cilët nuk kanë dëshirë t'i shohin edhe dy shqiptarë së bashku. Në të gjithë veprimtarinë tonë, në të mirën e popullit, duhet të punojmë për atë që të shfrytëzojmë në maksimum mundësitë legale dhe t'i bashkojmë njerëzit e jo të ngremë çështje që nuk shkojnë në interesin e përgjithshëm. Pa sakrifikuar nuk mund t'i ndihmojmë interesit të përgjithshëm, e në grupin e sakrificave hynë edhe ajo ndjenjë e durimit për zgjidhjen e problemeve.

Deri në rregullimin e çështjes së adresës së përhershme të Bashkësisë, të cilën së shpejti do ta zgjedhim dhe për këtë do t'ju njoftojmë, raportet i dërgoni në adresën e kryetarit të Bashkësisë.

Ju dëshirojmë punë të mbarë.

Saarlouis

15.KU DUHET TË MBËSHTETEMI PËR T'I KRJUAR BËRTHAMAT E REJA

Shkurt-mars 1984

Burgosjet e shumë forcave të organizuara patriotike-revolucionare i kanë shkaktuar Lëvizjes sonë dëme bukur të mëdha; sepse shumë shokë aktivist kanë përfunduar në burg, e si rezultat i kësaj janë shkaktuar dy dëme të përhershme: në një anë është burgosur aktivisti dhe në anën tjetër, për shkak të punës në kondita të ilegalitetit, shumë shokë kanë mbetur të shkëputur. E njejta gjë ka ndodhur edhe nëse ndonjë shok është detyruar të arratiset nga vendlindja e tij e dashur.

Krahas kësaj, burgosjet masive të më se dhjetë mijë shqiptarëve, në mesin e të cilëve gjenden shumë militant të shquar të Lëvizjes sonë i kanë shkaktuar edhe të keqen tjetër; largimin nga aktiviteti të shumë kuadrove të përgatitura, të cilët kanë poseduar përvojë të pasur revolucionare..

Duke shpresuar se e tërë puna ka mbetur tek ndonjë individ, nga emri i të cilit tmerroheshin serbomëdhenjtë, këta të fundit e shtrinë dorën e tyre tinëzare duke vrarë kështu shokët tanë më të mirë.

Mirëpo megjithë burgosjet masive, megjithë vrasjet tinëzare, lufta vazhdoi dhe çdo ditë e më shumë duke tendenca e konsolidimit edhe më të mirë, sidomos të atyre që e bartin barrën kryesore të saj.

Efektin që e ëndërruan serbomëdhenjtë, se duke vrarë e duke arrestuar do ta mposhtin popullin tonë të pamposhtur, jo vetëm që nuk e arrijtën dot, por përkundrazi, ato ëndrra iu dështuan me turp, si të gjitha tjerat më parë. Ata ëndërronin se do t'i mbysin forcat patriotike-revolucionare, por e vërteta ua hedhi poshtë çdo pretendim të tillë të ultë. Rinia sypatrembur e Kosovës martire jo vetëm që nuk iu frikësua këtij kërcënimi, që shovinistët e bënë duke dënuar e vrarë, por ajo ia bëri të qartë kujtdo, e në radhë të parë serbomëdhenjve, se me këtë gjak të kuq e të ri të popullit shqiptar nuk mund të luan askush.

Pas gjithë atyre dënimeve që i janë të njohura opinionit vendas dhe atij ndërkombëtar, serbomëdhenjtë dhe lakejt e tyre i bënin vedit qejf duke deklaruar se: "armikut iu thye kurrizi", kurse realiteti i detyroi të lëpijnë atë që e pështynë, kur ishin të obliguar të pohojnë, se: "të gjitha grupet e dënuara gjatë vitit 1983, ishin formuar pas ngjarjeve të pranverës '81". Kjo tregon më së miri se sa ndikuan dënimet drakoniane në popull, se sa e frikësuan dënimet rininë e kuqe të Kosovës, se sa ndikuan pozitivisht apo negativisht dënimet e tilla, rast që shihet kjartë se dënimet dhe vrasjet që iu bënë bijve më të mirë të popullit, e indinjuan popullin dhe e hidhën në veprime të reja e të guximshme të luftës për dritë e liri.

Në këtë situatë të rëndë, kur armiqtë e popullit shqiptar përpiqen me të gjitha forcat që t'i shkatërrojnë forcat patriotike-revolucionare, kurse në anën tjetër, bijtë e popullit kërkojnë të organizohen, Lëvizja shtron detyrë para të gjithë militantëve, detyrë të një rëndësie jetike, që kërkon edhe zgjedhje të saktë, të përpiktë.

Sot, si detyrë e rendit të ditës shtrohet; krijimi i bërthamave të reja të Lëvizjes, pa të cilat nuk do të mundemi t'i mobilizojmë të gjitha forcat që i duhen luftës sonë. Pra të punojmë parreshtur për konsolidimin e dhe mobilizimin e të gjitha forcave revolucionare në ato bërthama.

Bëhet pyetja; ku duhet të mbështetemi për këtë punë? Kush duhet të jetë gjaku dhe kocka e këtyre bërthamave? Në këtë rast do t'i cekim disa nga pikat mbështetëse, të cilat Ju duhet t'i pasuroni me përvojën Tuaj dhe të shokëve Tuaj.

-Të gjitha bërthamat e organizuara apo individët e organizuar, t'i mobilizojnë të gjitha forcat që i kanë në dispozicion, t'i organizojnë ato në bërthamat e LRSSHJ-së që nga celula. Bazë mbështetëse për këtë organizim elementët më të shëndoshë, elementët më të sprovuar e të kalitur nëpër aksione e sprova tjera, pra të gjithë ata element që krahas dashurisë për çështjen, posedojnë aftësi edhe më të mëdha për të vepruar me sukses në kushtet e ilegalitetit që na e imponon lufta.

Në këtë hap që duhet ta bëjmë, të kemi busollë edhe të kaluarën, anët pozitive e negative të saj, në mënyrë që të metat ekzistuese t'i mënjanojmë, kurse të mirat apo anët pozitive t'i pasurojmë edhe më tutje në rrethana të reja. Të veprojmë ashtu si thotë populli: "Të masim shtatë herë – e të presim një herë!" Të mos nxitohemi kurrë për të mbaruar

atë punë që sot nuk e ka radhën! Pra, bërthamat që do t'i krijojmë, duhet të jenë të forta, të sigurta e me element të shëndoshë. Të mos llogarisim kurrë në ata që bëjnë shumë zhurmë, e në fakt punojnë pak ose shumë pak. Shokët që pranojnë në radhët e Lëvizjes elementët jo gjithmonë armiqësor, por që nuk duhet t'i pranojnë në radhët e organizuara, përgjigjen për lëshimin e bërë.

Popullit shqiptar kurrë nuk i kanë munguar bijtë që e duan Lirinë dhe që për liri kurrë nuk e kursejnë jetën e tyre. Detyra e jonë është që nga gjiri i popullit të nxjerrim e të zgjedhim nga më të mirët, e për t'i arritur këto, duhet punë e palodhshme, duhen shumë net pa gjumë, duhet mirëkuptim reciprok... Për t'u arritur kjo punë e dëshiruar dhe aq e nevojshme për çështjen tonë të përbashkët, duhet edhe një faktor tjetër për t'i verifikuar ata, e kjo është koha.

Detyra e jonë, e të gjithë militantëve, është mobilizimi i të gjitha forcave të cilat i duhen çështjes dhe gjithmonë duke hulumtuar në të gjitha shtresat e popullit. Në këtë drejtim, krahas me rininë punëtore, fshatare e studenteske, një kujdes i veçantë t'i kushtohet punës me rininë e shkollave të mesme. Duhet të punojmë që rinia e shkollave të mesme të piqet, formohet e edukohet edhe në frymën revolucionare, ta mësoj artin e luftës psiko-fizike etj.

Nga kjo rini, nga ky brez i mrekullueshëm nuk do të mungojnë heronjtë e ri, kuadrat e pjekura e të formuara, kuadrat e ngritura nga aspekti ideo-politik, patriotik e revolucionar, të cilët, të cilët luftës sonë do t'i dhënë formën dhe ngjyrën që e meriton. Natyrisht, puna me rininë është një punë shumë e rëndësishme e që do vigjilencë, zgjuarsi e durim të madh.

Të mos harrojmë që në këto bërthama të futen sa më shumë shoqe e motra të idealit, sepse ashtu si thotë Sami Frashëri: "Gruaja është gjysma e popullit", kurse ne, pa ndihmën e motrave tona as që mund të fitojmë.

Pra edhe njëherë po e përsërisim pyetjen: Me kë do të krijojmë ne bërthamat e Lëvizjes? Me kënd tjetër, përgjigjemi ne, pos me shokun, me shoqen tonë më të mirë, me të cilin je ulur në një bankë shkolle me vite, me të cilin-cilën punon me vite të tëra në një vend pune, me të cilin ke derdhur lot në kurbet – me dashurinë për vendlindjen, për mallin që të ka kapluar aq shpesh. Me askënd tjetër, pos me shokë – shoqe të tilla, duhet t'i mbushim bërthamat tona të reja. Bërthamat që do të përbëhen me shokë të tillë, me shokë që e duan njëri-tjetrin aq shumë, sa të mos kursehet as jeta për shokun, me shokë që kanë dashuri të zjarrtë e të sinqertë mes vedit, sa një ditë të kaloi pa e parë njëri-tjetrin u duket e gjatë; janë vëllezër e motra në plotkuptimin e fjalës...

Në bërthamat tona nuk kanë vend ata që kanë histori apo të kaluar të njollosur, ata të cilët nuk kanë sjellje të mira së pari në familjet e tyre e tek pastaj edhe në shoqëri në përgjithësi. Aty duhet të hyjnë vetëm ata njerëz e kuadra, në të cilët vet populli i ka sytë dhe shpresat.

Pra, shokë militant! Përpara në luftë për të drejtat e ligjshme të popullit tonë të shumëvuajtur.

Ç'ËSHTË CELULA E LRSSHJ-së?

Celula është bërthama bazë e LËVIZJES. Ajo përbëhet prej tre shokësh të një njësie punuese; tre shokësh fshati, tre shokësh klase apo katedre, uzine apo Kombinati... Pra, celula është bazë e Lëvizjes e futur thellë në kapilarët e gjakut të popullit. Natyrisht, elementët që e përbëjnë këtë celulë duhet të jenë shembull për të mirë në rrethin ku militojnë.

Në celulë gërshetohet puna kolektive me atë individuale, sepse në një anë punohet në mënyrë kolektive (tre shokët e organizuar në celulë), kurse në anën tjetër, shokët posedojnë edhe lidhje individuale tjera jashtë celulës. Ky gërshetim i punës individuale me atë kolektive duhet respektuar, duke dalluar si njërën ashtu edhe tjetrën, por edhe duke përdorur metoda të ndryshme – si me njërën ashtu edhe me tjetrën. Preferohet që, pa marrë parasysh se me cilën punë kemi të bëjmë, duhet të respektohet KONSPIRACIONI, duke ditur të vlerësohet se ku çka është e nevojshme të mbetet konspirative, e çka jo.

Celula drejtohet nga KOMITETI i DEGËS së LËVIZJES. Lidhjet nëpërmes celulës dhe Komitetit të Degës mbahen në mënyrë individuale, duke zbatuar gjithmonë konspiracion të hekurt.

KOMITETET E DEGËVE TË LËVIZJES

Komitetet e degëve të Lëvizjes përbëhen prej pesë ose më shumë anëtarësh, për çka vendos vet KOMITETI QENDROR i LËVIZJES PËR FORMIMIN E REPUBLIKËS SOCIALISTE SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI, faktor që mvaret nga madhësia e qytetit dhe nga numri i celulave ekzistuese.

Krijimi i Komitetit të Degës së Lëvizjes (KDL), është një domosdoshmëri jetike për punën e mëtejshme të Lëvizjes, sepse pa një organizim të vërtetë revolucionar nuk ka as punë e as aktivitet revolucionar. Këtë e ka vërtetuar edhe puna e gjertanishme, ku shumë grupe kanë lindur pikërisht duke mos patur askush t'i vej ata në një front të luftës.

Ekzistimi i shumë celulave të shpërndara, i ka dhënë luftës jo rrallë edhe karakterin e punës spontane.

Për të krijuar Komitete të Degëve të Lëvizjes (KDL), duhet punë e palodhshme, duhet një klasifikim i forcave të aktivizuara dhe prej tyre të seleksionohen ata më të mirët, që njëherit do të jenë edhe garancë për një qëndrueshmëri dhe punë të suksesshme apo efektive.

KDL, i cili merret me aktivitetin e një qyteti, drejton punën e tij por edhe të çdo celule në te. Me vendimin që e aprovon KDL, formohen celulat, por edhe celulat drejtuese (të cilat janë bërthama që drejtojnë disa celula në një bashkësi lokale apo qytet).

KDL punën me nëndegë dhe celula e bënë në mënyrë individuale. KDL vendosë për çdo aksion në përmasa qyteti, por edhe jep urdhëra ndonjë celule për kryerjen e ndonjë aksioni lokal.

Komiteti i Degës së Lëvizjes është i drejtuar nga Komiteti Qendror i Lëvizjes, kurse lidhjet i mban në mënyrë individuale.

K.Q. i Lëvizjes vendosë për shkarkimin apo ngarkimin e ndonjë shoku në këtë forum, në pajtim me vendimin e aprovuar nga KDL.

KDL posedon edhe me fondin material, i cili pasurohet nga ndihmat dhe kuotizacionet. Ky, një pjesë të këtij fondi e venë në dispozicion të KQ të Lëvizjes. Sasia e tillë mvaret nga nevoja e paraqitur, por edhe nga mundësia, se sa do ta ndihmojë Dega Lëvizjen në përgjithësi.

KDL nëse disponon me kuadra të përgatitura në pikëpamje intelektuale, punimet e ndryshme i shpërndan nëpërmes organit të vet, apo edhe si materiale të KDL-së, materiale këto që i shpërndanë dorë më dorë nëpër celula e anëtarë. Materialet me rëndësi i drejton edhe në K.Q. si dhe në Organin qendror-"Z.K."

Komitetet e Degëve të LRSSHJ-së, një punë të veçantë duhet ta përqendrojnë në Universitetin "Kosova", ku një pjesë e madhe e militantëve militon me plotë sukses, kurse nga këtu mund të ndihmohen gati të gjitha rrethet tjera.

KDL-të drejtuara nga K.Q. apo nga një KDL, duhet të formojnë KDL të reja në çdo fakultet të Universitetit "KOSOVA" nëpër katedra të ndryshme, pastaj në Shkollat e larta në qytetet tjera të Kosovës, si dhe nëpër qendra të ndryshme. Këto Komitete duhet të drejtohen nga KDL që vepron në qytetin përkatës. Krahas kësaj, edhe nëpër shkolla të mesme, në Organizatat Bazë të Punës së Bashkuar, në Ente e BVI duhet të përqendrohet një punë e rregullt dhe e vazhdueshme, në mënyrë të veçantë, që edhe atje të formohen së pari celulat e pastaj edhe Komitetet e degëve të Lëvizjes e që do të drejtohen nga KDL për qytet.

QËNDRIMI NDAJ LK DHE LSR

Në të kaluarën, në disa mjedise ka mbretëruar mendimi se: njerëzit e ndershëm nuk duhet të hyjnë në radhët e Lidhjes së Komunistëve. Një mendim të tillë ua ka imponuar vet sjellja e disa anëtarëve të LK, që janë sjellur në mënyrë vërtetë udbeske, por mendimi i tillë është i gabuar, sepse si na mëson Lenini: "...duhet punuar atje ku ka masë." Praktika e ka vërtetuar gjithashtu se nga radhët e Lidhjes së Komunistëve kanë dalur shumë militantë të shquar të LRSSHJ-së.

Veprimet e militantëve nga pozitat e LK nuk kanë munguar as gjatë pranverës së lavdishme '81 e as më vonë, kurse kohëve të fundit ajo veprimtari është shtuar dukshëm. Është detyrë e të gjithë militantëve që mund të depërtojnë e të infiltrohen në radhët e Lidhjes Komuniste, që atë veprim ta bëjnë me hapa të matur, me vetëdije se kjo është një detyrë shumë e rëndësishme.

Duke vepruar nga radhët e LK, ti do të shfrytëzosh çdo mjet të luftës legale në të mirën e çështjes për të cilën je përcaktuar. Ti nga këto pozita, në një anë do të shfrytëzosh pozitën tënde duke bërë propagandë të shëndoshë, e nga ana tjetër, do të ipet rasti të futësh edhe shumë shokë që veprojnë nga këto pozita. Kuptohet, çdo hap që do ta bësh do të jetë në marrëveshje me shokët. Ti kështu do të kesh nderin të veprosh nga dy pozita: edhe me shokët, edhe me shokët tjerë që do t'i gjesh në zemër të armikut.

Nëse ke rastin të veprosh nga këto dy pozita, ti duhet të jesh shumë aktiv, të veprosh për t'u njohur me sa më shumë anëtarë të LK, t'i klasifikosh ata, ta dish se kush në ç'pozita gjendet e vepron, por edhe në popull puna jote të duket se shkon në dobi të tij, si për shembull: nga përpjekjet që do të bësh drejt emancipimit të gruas, nga sjelljet me nxënës e student, me palë e me kolegë, me shokë e me qytetarë... Syrit të madh e vigjilent të popullit nuk do t'i shpëtosh pa të parë se kush e çfarë je...

QËNDRIMI NDAJ PROPAGANDËS LEGALE

Nga ana e jonë, gjer më tani nuk është shfrytëzuar sa e si duhet propaganda legale. Kjo është një e metë të cilën duhet ta mënjanojmë njëherë e përgjithmonë. Duhet të mos harrojmë se vetëm propaganda ilegale nuk është e mjaftuar për t'i frymëzuar, përgatitur e kalitur të gjithë ata që e kërkojnë dhe e presin një libër ilegal, me padurim për ta lexuar. Në një anë kjo propagandë (literaturë), sigurohet me vështirësi dhe në anën tjetër, libra të ndaluar nuk guxojmë t'i japim çdokujt.

Pra, edhe ky është një prej atyre faktorëve që na shtynë të mos e lëmë anash propagandën legale.

Është e vërtetë se literatura me të vërtetë revolucionare është e kufizuar, por ajo që është duhet të shfrytëzohet maksimalisht.

Pikërisht me literaturën legale duhet ta fillojmë punën me të rinjtë, që ata vetë të gjejnë në të rrugën e tyre...

Përse të mos i orientojmë të rinjtë nga shkrimtarët përparimtarë shqiptar dhe ata botëror?! Përse të mos i propagandojmë veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit, kur ajo është edhe domosdoshmëri.

Punët e tilla që i parasheh pararoja e popullit shqiptar në Jugosllavi – LRSSHJ-ja-duhet t'i bëjmë me zot patjetër.

KOMITETI QENDROR i LRSSHJ

17. STATUT I LEVIZJES PER REPUBLIKEN SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI

I

Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi është përfaqësuesja e interesave të vërteta të popullit shqiptar në Jugosllavi. Aktualisht ajo është luftëtarja më e denjë për realizimin e këtyre interesave.

Lëvizja është një bashkim luftarak vullnetar patriotësh e revolucionarësh të popullit shqiptarë që jeton në Jugosllavi dhe i asaj pjese të tij që fati historik e detyroi të mërgoi nëpër shtete të ndryshme të botës, të cilët përpara interesit të përgjithshëm i kanë sakrifikuar të gjitha interesat tjera.

LRSSHJ u ngrit mbi bazën e organizatave LNÇKVSHJ, PKMLSHJ, OMLK dhe FKP dhe mori një orientim të tillë për kërkesën "Kosova-Republikë" nga përvoja e demonstratave masive të mbarë popullit shqiptar në Jugosllavi gjatë Pranverës së vitit 1981.

Qëllim i Lëvizjes është që të grumbulloj aq forca rreth vetes, sa me atë forcë të grumbulluar t'i bëjë presion udhëheqjes federative, dhe me këtë t'ia imponoj kësaj të fundit një situatë të atillë në të cilën ajo do të detyrohet që popullit shqiptarë në Jugosllavi t'i njehë të drejtën për formimin e një republike siç janë gjashtë të tjerat në RSFJ.

Për të arritur gjer tek ky qëllim, Lëvizja do të shërbehet me metoda të ndryshme të luftës që ia lejon etika revolucionare dhe që janë të njohura në praktikën e luftërave të popujve për liri.

II
ANETARET, TE DREJTAT DHE DETYRAT E TYRE

1. Anëtarë të Lëvizjes mund të bëhen të gjithë shqiptarët në Jugosllavi dhe pjesa e tyre në botën e jashtme, të cilët kanë kaluar moshën 18 vjeçare dhe që pranojnë programin dhe statutin e LRSSHJ.

2. Anëtarë është ai i cili pranon Programin e saj, që e ndihmon materialisht dhe që merr pjesë personalisht në një nga celulat e saj.

3. Anëtari ka për detyrë:

a) të ruaj dhe të luftoj për unitetin e Lëvizjes. Lëvizja nuk lejon ekzistimin e fraksioneve në gjirin e vet,

b) të zbatoj vendimet e Lëvizjes, të respektoj statutin e saj, të propagandoj traditat patriotike të popullit tonë. Ai gjithmonë duhet të veproj nga pozita revolucionare,

c) të ngritet teorikisht, të mendoj, punoj e jetoj si revolucionar dhe luftën për formimin e Republikës Shqiptare në Jugosllavi ta vej në plan të parë në të gjithë veprimtarinë e tij,

d) të forcoj lidhjet me masat, të jetë i drejtë, i ndershëm, i dashur për popullin, të jetë armik i mendjemadhësisë, karrierizmit, indiferentizmit dhe i frymës së komandimit kundrejt njerëzve,

e) të jetë propagandist, agjitator dhe mbrojtës i flaktë i qëllimit të Lëvizjes,

f) të jetë kritik, autokritik dhe të luftoj vetëkënaqësinë,

4. Anëtari ka të drejtë

a) të marrë pjesë në diskutimin e problemeve të luftës së Lëvizjes,

b) të kritikoj sjelljet e anëtarëve dhe veprimet e padrejta,

c) të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet udhëheqëse

d) t'u drejtohet për çështje të ndryshme me pyetje, kërkesa dhe propozime organeve udhëheqëse të Lëvizjes

5. Pranimi në Lëvizje bëhet në mënyrë individuale, pas një njohje të gjatë dhe të hollësishme.

6. Lëvizja anëtarëve të vet nuk u shpërndan libreza.

7. Anëtari ka përgjegjësi të madhe për njerëzit që pranon në Lëvizje.

8. Kur anëtari tre muaj rresht nuk merr pjesë në mbledhje ose nuk paguan kuotizacionin a anëtarësisë, celula duhet ta shqyrtoj qëndrimin e tij në mbledhjen e vet.

9. Kalimi i anëtarëve prej një celule në një celulë tjetër bëhet sipas rastit me udhëzime të organeve udhëheqëse të Lëvizjes.

10. Anëtari i Lëvizjes që vepron në shtete të ndryshme të botës nuk guxon të bien me sjelljet e veta në kundërshtim me ligjet e vendeve në të cilat vepron dhe as nuk guxon në asnjë mënyrë të përzihet në punët e brendshme të atyre shteteve.

11. Për faje e gabime të palejueshme anëtari përjashtohet nga Lëvizja.

12. Nëse verifikohet se përjashtimi ka qenë jo i drejtë, atëherë kthimin mund ta bëjë vetëm celula që ka miratuar përjashtimin.

III
NDERTIMI

13. Parimi udhëheqës i ndërtimit organizativ të Lëvizjes është centralizmi demokratik. Kjo do të thotë:

a) të gjitha organet zgjidhen nga poshtë lartë, nëpër tubime të ndryshme, në forma që do të gjenden më të përshtatshme, ashtu siç na i imponon veprimtaria në ilegalitet,

b) organet udhëheqëse janë të detyruara që kohë pas kohe të japin llogari para celulave të Lëvizjes,

c) organet bazë japin llogari para organeve më të larta.

14. Lëvizja ndërtohet në bazë të territorit (lagje qytetesh e fshatra), baza prodhimi (fabrika e kombinate), në institucione të ndryshme (fakultete, shkolla të mesme, shoqëri kulturore etj.) dhe nëpër koloni të ndryshme shqiptare në mërgim.

15. Të gjitha problemet celulat i zgjedhin vetë por me kusht që zgjedhja e tyre të jetë në vijën e Lëvizjes.

16. Lëvizjen e udhëheq Komiteti Qendror, nën vartësinë e të cilit veprojnë të gjitha komitetet e degëve si në atdhe ashtu edhe në mërgim.

17. Komitetet e degëve të LRSSHJ, janë organe të cilat koordinojnë aktivitetin e disa celulave dhe janë të lidhura me KQ të Lëvizjes.

IV
ORGANET

18. Organi më i lartë organizativ i Lëvizjes është Kongresi. Në kushtet ekzistuese të cilat Lëvizja i gjykon si të jashtëzakonshme nuk mund të flasim për intervale të caktuara kohe të thirrjes së Kongreseve. Aktualisht Lëvizja lidhur me këtë çështje do të thërras Kongreset në përputhje me zhvillimin e situatës.

19. Pas Kongresit, organ më i lartë është Konferenca e KQ.

V
CELULAT

Themel i Lëvizjes janë celulat e saj të cilat ngrihen në të gjitha vendet.

20. Celulat lidhin masat e qytetit dhe fshatit me organet udhëheqëse.

21. Detyrat e celulave janë

a) të zhvillojnë punë politike, ideologjike dhe organizative për zbatimin e programit të Lëvizjes, të vendimeve dhe direktivave të saj,

b) të bëjë shpërndarjen e shtypit, ta zbërthej atë dhe të forcoj influencën e Lëvizjes,

c) të raportojnë për punën e tyre para organeve më të larta,

d) të ngriten ideologjikisht dhe të ndihmojnë në ngritjen e rrethit ku veprojnë

VI
MJETET FINANCIARE

22. Të ardhurat financiare përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë.

23. Kuotizacionet mujore janë 5% e të të ardhurave mujore të anëtarit.

24. Anëtarët që nuk kanë rrogë të caktuar ndihmojnë sipas mundësive dhe u ndihmohet sipas mundësive.

25. Qarkullimi i mjeteve materiale nga poshtë-lartë dhe anasjelltas bëhet sipas rregulloreve që përpunohen për raste të veçanta.

26. Lëvizja pranon ndihma materiale e morale nëse ato janë të pakushtëzuara.

Janar 1984, Shtutgart

18. Programi politik i Lëvizjes për Republikë

Lëvizja për Republikë është një organizatë masash, që lindi si formë e rezistencës së organizuar e popullit shqiptarë në Jugosllavi.

LRSSHJ është sintezë e një vazhdimësie dhe përvoje të grupeve të ndryshme revolucionare që vepruan në Kosovë për një kohë të gjatë, që në pjekurinë e saj të sotme kanë ndikuar rreth 20 demonstrata masovike, por spontane në Kosovë dhe 15 të tjera të organizuara në Evropën Perëndimore.

Kjo pjekuri u arrit duke bërë reflektime të thella lidhur me faktet dhe rrethanat që u krijuan pas demonstratave të Pranverës 81 në Kosovë, në Jugosllavi dhe në botë, i studimit të mundësive reale në përputhje me interesat e popullit shqiptarë dhe të gjithë popujve në Jugosllavi. Nga eksperienca e ngjarjeve të dendura, forcat e organizuara kërkesat e tyre i bënë një me ato të popullit dhe me të gjithë potencialin e tyre u orientuan për kërkesën ”Kosova Republikë”.

Qëllimi i Lëvizjes është që të grumbulloj aq forcë rreth vetes, sa me atë t’i bëjë presion të vazhdueshëm udhëheqjes federative dhe me këtë t’ia imponoj kësaj të fundit një situatë të atillë në të cilën ajo do të detyrohet që Kosovës t’ia njeh të drejtën për ngritjen nga KSA e Kosovës në Republikë të Kosovës.

Lëvizja lufton për krijimin e Republikës së Kosovës.

Lëvizja për Republikë nuk ka si qëllim luftën për pushtet.

Lëvizja njeh pushtetin e LKJ (Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë) në të gjitha Republikat jugosllave duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës.

Lëvizja nuk kërkon prishjen e sistemit aktual jugosllav të vetë-qeverisjes.

Lëvizja do ta njeh Lidhjen Komuniste të Republikës së Kosovës.

Të gjithë atyre që thonë se Jugosllavia është revizioniste ne u themi se ne nuk na prishë aspak punë që edhe Republika e Kosovës të jetë Republikë revizioniste.

Lëvizja, në të gjithë veprimtarinë e vetë udhëhiqet nga idetë marksiste-leniniste dhe të gjitha ngjarjet me të cilat ndeshet përpiqet t’i shqyrtoj nga prizmi i këtyre ideve.

Çështjes kombëtare marksisti i kombit të madh dhe marksisti i kombit të vogël i afrohen nga kënde (anë) të kundërta. Sipas parimit leninist, marksisti i kombit të madh duhet të propagandoj lirinë e shkëputjes për kombet më të vogla, ndërsa marksisti i kombit të vogël e propagandon lirinë e bashkimit. Këtë parim ne e quajmë të drejtë dhe

mendojmë se kombet e mëdha e kanë përgjegjësinë më të madhe dhe atyre u takon iniciativa.

Për këtë qëllim, para saj, para anëtarëve të saj, para të gjithë atyre shokëve që kanë më shumë njohuri teorike, Lëvizja shtron detyrë me rëndësi dhe afatgjate që kjo teori të përvetësohet nga rrethe sa më të gjëra.

Kërkesa Kosova Republikë është në përputhje dhe gjen mbështetje të plotë në mësimet e marksizëm-leninizmit. Kjo kërkesë në thelb është përparimtare, sepse shkon në të mirën e të gjithë popujve të Jugosllavisë dhe në të mirën e popullit serb në veçanti, i cili me formimin e Republikës së Kosovës çlirohet nga reaksionarët serb rrënjët e të cilëve shpesh ujiten me pretekstin e mbajtjes së Kosovës. Kosova si Republikë jo vetëm që nuk do të mbyllet ndaj të tjerave, por përkundrazi ajo do të hapet shumë më tepër, pasi marrëdhëniet do të bëhen nga pozita të barabarta.

Nga zhvillimi ekonomik e kulturor që do të bëhet me formimin e Republikës, nga populli

-historikisht më i lashti në Jugosllavi,

-më i ri për nga mosha mesatare

-i tretë për nga madhësia numerike, do të merr një shtytje shumë të madhe revolucionare dhe do të bënë hapa të mëdhenj përpara gjithë RSFJ.

Vënia e theksit të Lëvizjes për kërkesat kombëtare jo vetëm që nuk është në kundërshtim me mësimet e marksizëm-leninizmit, por është e vetmja mënyrë lufte e drejtë dhe e mundshme në këtë etapë historike të zhvillimit të ngjarjeve në Kosovë dhe më gjerë.

Fitoret në të drejtat kombëtare të popullit shqiptar, janë në të njëjtën kohë fitore të mëdha klasore për të gjithë popujt dhe klasën punëtore në Jugosllavi. Duke u nisur nga kjo e vërtetë e madhe popujt tjerë duhet ta ndihmojnë dhe t'i dalin krah popullit shqiptarë në Jugosllavi, kurse populli ynë duhet të mësoj shumë më tepër për rrugët e afrimit me të tjerët, në mënyrë që të lidhen sa më ngushtë interesat e klasave punuese dhe popujve në mënyrë që këto të mos lejojnë të manipulohen nga klika shoviniste.

Lëvizja do të përpiqet që atyre shkëndijave të arsyes ku sot janë të ndezura, t'u jap zjarr edhe më shumë dhe të ndez të tilla në çdo vend ku ka mundësi. Gjendja e rëndë të cilët e kanë krijuar serbomëdhenjtë në të gjitha anët e RSFJ na jep prova se shkëndija të tilla të arsyes në të shumtën e rasteve do të shkrepin.

Mars 1984, Paris

Ky Program është shkruar për atë rreth aktivistësh që e kanë përkrahur Zërin e Kosovës si gazetë (në formatin A3), numri i parë i të cilës u botua në qershor 1984 në Paris dhe që më vonë vazhdoi të botohet deri në korrik 1985 në Stockholm.

19. MERGIMTARET DHE KOSOVA REPUBLIKE

Më 14 korrik 1984, patriotë mërgimtarë të rretheve të ndryshme u mblodhën në Bern të Zvicrës, duke iu përgjigjur thirrjeve që lëshohen në emër të LRSSHJ dhe të "Kosovës Republikë".

Demonstrata e 14 korrikut në Bern qe një prej atyre shumë demonstratave që bënë jehonë për çështjen shqiptare, dhe një prej atyre që kohëve të fundit individët duke shfrytëzuar gatishmërinë e popullit për të luftuar për "Kosovën Republikë" duan të sigurojnë kapitale politike për t'u zgjatë jetën veprimeve spontane.

Kush u bë "zëdhënës i denjë i propagandës së Beogradit?"

Shkaqet lidhur me mosparaqitjen e një numri patriotësh në mërgim, në demonstratën e fundit në Bern, nuk është vështirë për t'u gjetur. Para së gjithash ato mund t'i gjejmë të përmbledhura në thirrjen e cila u lëshua për këtë demonstratë.

Shumë mërgimtarë kishin vërejtur më parë gjëra të papëlqyera që bënin individët në emër të LRSSHJ. Sjelljet në formën: "Pse e bëtë këtë punë pa e pyet Lëvizjen?", "Nuk bënë të përgatitet kjo dramë pasi nuk e ka dhënë pëlqimin Lëvizja!", "Pse u ndihmua familja e filanit?", "Atij e atij iu ka hap dosja në Lëvizje!" ishin bërë një dukuri.

Para këtyre sjelljeve, megjithëse mërgimtarët patriotë nuk i pëlqenin e as aprovonin, pakënaqësia e tyre e përmbajtur shprehej me fjalët si: "Ata duhet t'i dinë më mirë këto punë", "ata duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të kenë përgjegjësi për çdo fjalë që thonë." Edhe kur hasnin në devijime flagrante, punëtori ynë i thoshte vetes: "Ndoshta kështu po u dashka se ata janë më të ditur". Me një fjalë ishte aso gjendje kur thuhej: "Ka thënë Lëvizja dhe mos e nga më tutje!"

Në këtë përshtypje është mbështetur edhe autori i thirrjes së demonstratës së Bernit, por për fatin e tij të keq dhe për fatin e mirë të popullit nuk është më ashtu. Ajo kohë kaloi dhe nuk kthehet më. Dhe ne gëzohemi për vigjilencën e shtuar të punëtorëve tanë të cilët i kanë bërë sytë katër dhe e lexojnë nga disa herë edhe një fjalë të vetme. Kështu rezultoi se vepruan edhe me thirrjen e demonstratës së Bernit e cila përfundonte me kryethirrjen: "… të mblidhemi dhe t'ia dridhim themelet Jugosllavisë fashiste!"

Pasi e lexuan disa herë i thanë vetes: Ç'thotë ky? Po kështu është duke folur Beogradi natë e ditë, se ne nuk jemi duke kërkuar Republikë, por duami që ta shkatërrojmë Jugosllavinë. Po a tha kështu Bajrush Xhemaili e Ramadan Veliu. Ne nuk kemi punë me Jugosllavinë e as me themelet e sistemit të saj.

Atij që ka punë me themelet e Jugosllavisë fashiste, me sistemin e saj politik, me kënetimin e pushteteve, me mbretërit e kuq, i qoftë rruga e mbarë pa ne.

Kush po i shantazhon punëtorët?

Redaktori i "Zërit origjinal" ka turpin të akuzoj dikend për shantazhim të punëtorëve. Shpjegimi i fjalës "shantazh" gjendet në fjalorin e gjuhës shqipe me këtë shënim plotësues: "Shtrëngim që i bëhet dikujt për të plotësuar një kërkesë të papranueshme prej tij duke e kërcënuar se do të zbulohet një e fshehtë që e dëmton, se do të rrezikohet ai vetë apo ndonjë i afërm i tij." Është e ditur se njerëzit me qëllime të errëta u afrohen të tjerëve sipas devizës: "Kompromentoje e pastaj tërhiqe nga të duash."

Prej të gjitha qyteteve në Perëndim ku gjenden më së shumti ata shqiptarë që janë nxitur haptazi të eksponohen para përfaqësive diplomatike të Jugosllavisë? Në cilat qytete thuren intrigat më të mëdha kundër shoku-shokut? Në cilat qytete bien "këmbanat e alarmit" me rastin e afrimit të zgjedhjeve vjetore pranë "Klubeve të punëtorëve shqiptarë nga Jugosllavia" në të cilat krijohet aso gjendje thuase Republika e Kosovës do të shpallet në ato klube?! Çdo njeri me një informim sado sipërfaqësor, pa u hamendur do të përgjigjet se këto dy qytete janë Dusseldorfi dhe Gjeneva. Vetëm në këtë të fundit gjenden mbi 100 të rinj që e kalojnë sezonin e dimrit në një gjendje tejet të vështirë, pa guxuar të shkojnë në familjet e tyre. Në këto dy qytete keqpërdorimi me ndjenjën e pastër të patriotizmit ka shënuar vlera ekstreme.

Siç shihet këtu nuk kemi të bëjmë me atë daljen e domosdoshme në sipërfaqe të disa individëve në një situatë të vrullshme revolucionare që ishte karakteristike për Pranverën 81, por kur puna për kompromentimin e punëtorëve para diplomacisë jugosllave është shndërruar në sistem. Në klubet e këtyre dy qyteteve, punëtorët tanë nga 'patriotët' deri në palcë provokohen e fyhen me fjalë të ulëta si në stilin: "Mos i keni krijuar familjet në ymyd të pasoshave të Jugosllavisë".

Të tillët përpiqen që çdo klubi t'i japin vulën e "antijugosllavizmit", t'u thuhet udhëheqësve të klubeve të dërgojnë letra në Biel-Bienne, sepse me to duhet të "bindin popullin se masa është me ne", siç vepruan me letrën e klubit "Asim Vokshi" të Llozanës. Siç dihet edhe anëtarët e klubit "Asim Vokshi" janë shqiptarë që vazhdimisht udhëtojnë për tek familjet e tyre, por për këtë dikujt nuk i bëhet vonë që anëtarët e klubeve të dënohen e torturohen, sepse lot kanë me bollëk, e njëkohësisht t'u thuhet të tjerëve: Ç'na duhet Republika nën Jugosllavi, kur ndodhi si ndodhi ajo do të na burgosë! Pra dihet shumë qartë se kush i shantazhon punëtorët tanë në mërgim.

Shtator 1984, Stockholm

20. Klubet për punëtorët

Nëpër klubet e punëtorëve është bërë dhe vazhdon të bëhet një punë e mirë në interesin e popullit tonë. Për këto klube është shkruar nga pozita të ndryshme edhe nëpër faqet e shtypit, por shumë më pak se sa që ka qenë e mundur dhe se sa është dashur të shkruhet. Për shkak se materiali për këtë temë është i madh, ne në këtë shkrim do të përmendim vetëm kalimthi disa çështje që kanë të bëjnë me klubet, të cilat në kushte më të mira do të mund të zbërtheheshin më gjerë, duke trajtuar secilën nga këto si një temë më vete.

Lindja e klubeve në mërgim (Evropën Perëndimore) është e lidhur me ardhjen e punëtorëve. Në saje të vetëdijes politike, përkundër "mundësisë së lehtë të politizimit" (nëse mund të shprehemi kështu), mërgimtarët tanë nuk iu qasën emigracionit të vjetër. Para vitit 1981, bashkimi i punëtorëve tanë nëpër qytete të mëdha nuk ishte penguar (hapur) nga ambasadat jugosllave. Ngjarjet e Pranverës 81 ndryshuan shumë gjëra. Klubet u treguan si qendra shumë të papërshtatshme për dezinformimin e mërgimtarëve, përkundër telegrameve të rrejshme që u dërguan në emrin në tyre. Viti 1981 është një vit dinamik për klubet. Nga ky vit filloi të flitet për klubet "me konsullatë" dhe ato "pa konsullatë", dhe kryesisht në bazë të këtij kriteri të gjykohet për to dhe sidomos për potencialin e tyre patriotik. Atmosfera elektrizuese e këtyre viteve hyri edhe në klubet tona në mërgim duke e polarizuar secilin prej tyre veç e veç dhe duke krijuar një heterogjenitet (të paktën sipërfaqësor) në jetën e tyre të mëtejme e në raportet me njëri tjetrin.

Për të orientuar në atë drejtim, kah e do interesi i përgjithshëm, dhe në bazë të shembullit të Bashkësive të klubeve të kombeve tjera, nga aktivistë të klubeve shqiptare lindën zëra të cilët kërkonin themelimin e Bashkësisë së klubeve shqiptare nëpër shtete të ndryshme. Kjo Bashkësi do t'i shtronte vetes për detyrë që në klube të ngushtoj hapësirën e veprimeve spontane dhe të ndikoj që të gjitha klubet të bashkëpunojnë e afrohen në mes veti. Një Bashkësi e tillë u themelua dhe pati një fillim të mbarë dhe premtues. Por në punët e Bashkësisë ndërhynë element të jashtëm duke bërë që përfaqësuesit e klubeve të mos vijnë në shprehje.

Aktualisht ka dy qëndrime lidhur me klubet:

Qëndrimi i parë është ai sipas të cilit klubet duhet ndihmuar me të gjitha mënyrat, por në asnjë mënyrë nuk bënë të përzihemi në punët e tyre, e sidomos të mos u imponohen gjëra që nuk i aprovon masa e anëtarëve të tyre. Që në këto klube të mos hyj asnjë gazetë ilegale, dhe ndihma organizative t'u jepet këtyre klubeve pa kushte, e jo të shtrohet çështja se ai klub i cili nuk vepron sipas tekeve të disa individëve duhet shkatërruar. Këtë qëndrim e mbajnë dhe përkrahin shumica e klubeve.

Qëndrimi i dytë është ai sipas të cilit secili klub duhet ta ketë ”vulën antijugosllave”, në to të shpërndahet shtypi ilegal, në to të bëhet thirrje e hapur për përkrahjen e gazetave ilegale si dhe për mbulimin e shpenzimeve për telefon dhe udhëtimeve zyrtare të disa ”politikanëve të mëdhenj”. Që në këto klube të rekrutohen sa më shumë emigrantë të përhershëm, të cilët duhet ta ”freskojnë mërgatën”, sipas parullës së ideologëve të kësaj taktike që është: ”T’ia bëjmë Jugosllavisë edhe një armik më shumë!”

Ne jemi këmbëngulës për qëndrimin e parë i cili shprehë vullnetin e shumicës. Akuzat demagogjike se kërkojmë apolitizim të klubeve nuk kanë vend. Edhe po të duami ne ato nuk mund të apolitizohen, sepse ku ka masë ka edhe politikë. Ne kërkojmë që dominuese të jetë politika e klubit. Vetëm nëse plotësohet ky kusht një politikë do të jetë edhe në interesin e Kosovës. Janar 1985, Stockholm

21. Lidhja e Lezhës me Lëvizjen e Untergruppenbahut

Më 17 janar 1468, në Lezhë mbylli sytë trimi legjendarë i popullit tonë, Gjergj Kastrioti.

Më 23 janar 1916, në Podgoricë, buzë lumit Moraqa u vra gjeneral Isa Boletini.

Më 17 janar të këtij viti mbushen tri vite nga mbrëmja e errët e 17 janarit 1982, kur në fshatin Untergrupenbach, u vranë nga policia sekrete e Serbisë Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla.

Më 11 janar 1985 mbushet një vit që kur në pjesën më të varfër të qytetit të Prishtinës, ranë heroikisht Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha.

Janari, muaji i parë i viteve, tek populli i robëruar i Kosovës do të vazhdoj të sjell heronj të rinj për çdo vit. Në këtë muaj edhe në të ardhmen do të vazhdojnë të hapen varre të reja që do ta ruajnë përgjithmonë gjelbërimin e majit, e djepa të rinj do ta fillojnë përkundjen në shekuj.

Heroizmi masiv i viteve 80-të i popullit shqiptarë nën Jugosllavi është i mishëruar edhe me veprën e atyre bijve të cilët i qiti në skenë gjatë këtyre viteve të fundit. Një vend nderi në mes tyre zënë Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla, Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha.

Përmes shekujve e dekadave, përmes një vargu të shumtë luftërash e përpjekjesh për liri, Kosova gjëmëmadhe me shtatin e saj me shumë plagë, por kurrë të përkulur hapi një nga faqet më të lavdishme të historisë së saj, me fillimin e viteve 80-të. Energjitë e saj të shumta ishin akumuluar për një kohë të gjatë, dhe presionet e serbomëdhenjve që hapësira e frymëmarrjes sonë të jetë sa më e vogël, bënë ashtu si edhe në të kaluarën që një pjesë e këtyre energjive të veprojnë edhe nga mërgimi.

Atë punë që në të kaluarën e kishin bërë në qytetet e perëndimit Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Fan Noli, Avni Rrustemi e shumë të tjerë, atë punë të cilin nuk kishin arrit ta kryenin shumë emigrantë nga Kosova pas vitit 1945, do ta fillonin një grusht patriotësh kosovarë në mesin e të cilëve u dallua si një luftëtar i pakrahasueshëm për kohën në të cilën veproi, njëri prej bijve më besnik dhe më të dashur të popullit shqiptar, një prej figurave më të pastra të historisë sonë, Jusuf Gërvalla, i cili nuk pyeti për kërcënimet e policisë serbe, as për thashethemet e mërgimit.

Koha e shqetësimeve të mëdha si rrallë ndonjë tjetër, në ato ditë të Pranverës 81 do ta vente në lëvizje intensive e të pandërprera Kadri Zekën, i cili kontribuoi shumë në organizimin e tetë demonstratave që u organizuan në mërgim, nga prilli gjer në korrik 81.

Kalimi i viteve kurrë nuk do të mund ta zbehë kujtimin e veprës së Bardhosh Gërvallës, gojëmbëltit e zemërzjarrtit, mbrojtësit të palodhshëm dhe të patrembshëm të interesave të punëtorëve tanë në botën e jashtme, heroit të nderuar të Kosovës.

Qe tri vite për këta heronj është shkruar në shumë raste, duke u ndalur me theks të veçantë në kohën e veprimtarisë së tyre në mërgim. Për ta në këto tri vite janë thurur shumë këngë e u janë kushtuar shumë poezi. Jusufi, Kadriu e Bardhoshi janë refleksi i një kohe heroike, vepra e të cilëve është e lidhur ngushtë me mjediset në të cilat vepruan, me ato masa të mërgimtarëve tanë të cilët i bënë heronj. Me emrat e tyre është e lidhur më së ngushti lindja e publicistikës ilegale kosovare. Këta punuan në nxjerrjen e organeve ”Bashkimi”, ”Lajmëtari i lirisë”, ”Liria” dhe ”Zëri i Kosovës”.

Por të gjitha këto organe më shumë se me këdo tjetër, marrë në përgjithësi, janë të lidhura me emrin e Jusuf Gërvallës, personin e parimeve që sheh përtej interesave të grupeve të ngushta, energjitë e mëdha të të cilit janë derdhur në të gjitha këto organizata të cilat kanë qëndruar pas këtyre gazetave, ashtu si një lum i rrëmbyeshëm që me dalje nga shtrati i tij ujit fusha të gjëra shkretire dhe lenë pas vetes një lym shumë të pëlleshëm. Ai redaktoi dhe shkroi artikujt kryesor të tre numrave të ”Bashkimit” prej gjithsej katër numrave që dolën, nxori vetë ”Lajmëtarin e lirisë”, ndihmoi në nxjerrjen e organit ”Liria” me artikuj të ndryshëm dhe i radhiti tre numra të saj (Nr.3, 4 dhe 5 prej gjithsej gjashtë numrave që dolën dhe redaktoi dy numra të ”Zërit të Kosovës” (nëntor 81 dhe janar 82).

Në policitë e Gjermanisë dhe të Zvicrës vazhdojnë të qëndrojnë dokumentet e marra pas atentatit, të cilat flasin për punën e tyre dhe bashkëpunimin e tyre njëvjeçar.

(Zëri i Kosovës, Janar 1985, Stockholm)

22. Thirrje për demonstratën e parë shqiptare në Suedi

për datën 16 mars 1985

Të dashur bashkatdhetarë,

Në këtë vit mbushen katër vite nga mbrëmja e 11 marsit 81, kur në mensën e Universitetit të Prishtinës, shtypja e egër serbomadhe e derdhi edhe një herë kupën.

Në kuadrin e këmbënguljes për të drejtat tona, me rastin e katërvjetorit të demonstratave të mëdha të Pranverës 81, Lëvizja për Republikë përpos manifestimeve nëpër vende e pika të ndryshme në botën e jashtme thërret një demonstratë e cila do të bëhet më 16 mars 1985 në qytetin Malmö të Suedisë.

Bashkatdhetarë me banim në Suedi,

Për shkak të largësisë së madhe nga qytetet tjera të Evropës, shumë bashkatdhetarë tanë nuk do të mund të jenë fizikisht me ne në ditën e 16 marsit në Malmö. Për këtë arsye, sa do të ngritet zëri ynë na ky vend i veriut, sa do të bëjmë që bota të dëgjoj për ne, kësaj radhe kjo barrë më së shumti do të bie mbi supet tuaja. Ne shpresojmë se ju do ta jepni me sukses këtë provim nderi.

Tubimi do të bëhet në ora 12.30, në sheshin e madh të Malmös (Stortorget) i cili është në qendër të qytetit.

Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi

23. KOMITETEVE DREJTUESE DHE KOMITETEVE TE RRETHEVE TE LRSSHJ-së

Shokë dhe shoqe,

Kohëve të fundit, në KQ të LRSSHJ-së, nga grupe individësh në botën e jashtme kanë ardhur kërkesa (gojore e me shkrim) me dëshirën për të ardhur deri te një bashkim. Këto grupe gjatë viteve 1982 e 1984 dolën nga LRSSHJ dhe një pjesë e tyre nxori organin "Punëtorët" e një pjesë tjetër nxori në Suedi gazetën me të njëjtin emër si të organit të LRSSHJ-së "Zëri i Kosovës" duke formuar një "Lëvizje" të re për Republikën e Kosovës.

Të gjithë ata që po kërkojnë bashkim nuk kanë shtruar asnjë kusht.

Duke e ditur dëshirën dhe vullnetin e mirë të elementëve dhe kuadrove të shëndoshë, patriotëve dhe revolucionarëve, posaçërisht nga radhët e klasës punëtore që punon dhe vepron këtej, si dhe duke e parë të nevojshme dhe parimore që secilit që dëshiron për të luftuar në një front të përbashkët për realizimin e kërkesave të popullit të Kosovës, t'i krijohet mundësia për t'u bashkuar në organizatën gjithëpopullore – LRSSHJ, KQ është i mendimit që t'i marrë parasysh këto kërkesa që janë bërë dhe, juve, shokë e shoqe po ua paraqesim si Propozim për diskutim këto KUSHTE që do t'u parashtronim këtyre grupeve për BISEDIME rreth bashkimit.

Grupet që kanë kërkuar bashkimin, a janë grupe me celula apo pa celula. Nëse janë grupe pa celula, atëherë nuk mund të shtrohemi për bisedime si me palë.
Nëse këto grupe me celula, e konsiderojnë veten organizata (pavarësisht se këto dikur qenë ndarë nga gjiri i LRSSHJ-së), le ta dëshmojnë ekzistencën e vetë dhe punën e tyre si organizata duke treguar rrjetin e tyre organizativ, si jashtë ashtu edhe brenda.

(Këtë punë verifikimi duhet ta kryej një komision i posaçëm i LRSSHJ-së, dhe pastaj (të vendosim se a të) të shtrohemi apo të mos shtrohemi për bisedime).

Gjatë bisedimeve rreth bashkimit si kushte do t'u paraqesim këto:

Të dënohet bashkimi i 17 shkurtit dhe 15 majit 1982, i cili ishte një bashkim krerësh e jo organizatash dhe nuk ishte aspak bashkim e organizim i masave.

Një bashkim dhe organizim të masave, si jashtë ashtu edhe brenda, e patë shtruar drejtë në verën e vitit 1981 OMLK në "Teza rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës" dhe në përpjekje e sipër për t'i vënë në jetë ranë shokët: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. Këto "Teza..." u shkelën pikërisht një muaj pas rënies së tyre, në bashkimin e 17 shkurtit 1982.

Të definohet se çfarë organizate po ndërtojmë: Parti a organizatë të masave apo front popullor i gjithë masave.

Të ndërpritet agjitacioni e propaganda dhe veprimet kundër marksizëm-leninizmit, veprime këto që shkojnë në dëm të unitetit dhe luftës sonë për Republikë.

Në bisedime të marrin pjesë nga tre përfaqësues prej secilës palë.

Në bisedime nuk mund të marrin pjesë krerët e bashkimeve të 17 shkurtit dhe 15 majit 1982.

Ndonjë bashkim eventual mund të bëhet dhe shpallet vetëm si bashkim i emigracionit përparimtar jashtë Kosovës dhe i organizuar në kuadër të një dege të jashtme të LRSSHJ-së që duhet të ndërtohet, zgjerohet dhe funksionoj brenda në Kosovë.

Nëse këto kushte, që do t'u vihen për bisedime atyre që po kërkojnë bashkimin do të diskutohen, plotësohen dhe të bëhen vërejtjet dhe orientimet e nevojshme edhe nga ju (që të aprovojmë unanimisht) ne do t'u hyjmë bisedimeve për bashkim; në të kundërtën duhet t'u themi qartë përse nuk duam as bisedime, as bashkim!

Përshëndetje revolucionare
KQ i LRSSHJ Prill 1985

(Ky shkrim është i Lëvizjes që kishte qendrën në Zvicër - shën. im).

24. ÇËSHTJE TEORIKE DHE PRAKTIKE

DISA ÇESHTJE TEORIKE E PRAKTIKE, AFATSHKURTA DHE AFATGJATA TE FORCAVE TONA TE ORGANIZUARA NE PERGJITHESI DHE ATYRE NE MERGIM NE VEÇANTI

Ky artikull nuk ishte i planifikuar për këtë numër. Shkrimi i tij ndikoi në vonimin e daljes së këtyre numrave dhe botimit të tyre bashkë. As koncepti i tij në pika të shkurta nuk ka qenë i bërë. Mund të ju duket e çuditshme por është e vërtetë se nëntitujt e tij i ka përcaktuar kryesisht receptori i telefonit.

Ky artikull duhet të kuptohet si një përgjigje në thashethemet e ndryshme me të cilat po torturohen sot punëtorët tanë në mërgim me shprehjet si: "Po u jepka Republika me vit të ri", "Udba po u ndihmon për nxjerrjen e gazetës!", "Do të ndalet gazeta". Përgjigja në thashethemet se do të bëhet bashkimi, dhe si disa e kuptojnë atë është duke u gatuar dhe do të dalë me kohë.

Një definicion i shkurtë për nocionin "forcë e organizuar"

Mbi shpjegimin e nocionit "forcë e organizuar", në kuptimin e përgjithshëm kemi shkruar në një nga numrat e kaluar të gazetës. Për këto forca do të flasim në këtë artikull, duke u ndalur tek ato në Kosovë dhe që kanë të bëjnë me të.

Forcat e organizuara janë grupe shoqërore, të organizuara në organizata apo parti, të cilat kanë tipare karakteristike të njëjta, që janë me prirje e drejtime të njëjta dhe që kanë qëllime të përbashkëta.

Të gjithë ata që luftojnë për Republikën e Kosovës brenda RSFJ, përbëjnë një forcë shoqërore.

A mund të themi se kjo forcë është e organizuar?

Jo. Bashkimin ideologjik i një numri të madh njerëzish ende nuk mund të quhet bashkim i organizuar, por një është një bashkim i cili është i domosdoshëm dhe që i prinë bashkimit të organizuar. Atëherë cilat janë forcat e organizuara që luftojnë për Republikë?

Të gjithë ata njerëz që janë me pikëpamje identike, dhe të cilët janë të lidhur me një qendër përmes një gazete, përmes letrash e raportesh, përmes direktivash, përmes një programi dhe një statuti, këta njerëz mund të quhen të organizuar, dhe se bëjnë luftë të organizuar për "Kosovën Republikë". Sa janë në gjendje të korrigjojnë vetveten lidhur me drejtësinë e pikëpamjeve që propagandojnë dhe metodave tyre të veprimit, kjo është çështje tjetër.

Në luftë për Republikë, këto forca mund të jenë legale dhe ilegale. Forcë që vepron nga pozitat ilegale është LRSSHJ, kurse forcë legale mund dhe duhet të jetë LK

e Kosovës. Për shkak të ndikimit të madh të shovinizmit serbomadh në jetën e LKJ, kërkesat e LK të Kosovës për Kosovën Republikë janë luftuar me ashpërsi në çdo kohë që janë shtruar. Për hir të "qetësisë e unitetit" LKJ ka bërë presion mbi LK të Kosovës që ajo të heq dorë qoftë edhe përkohësisht nga kërkesa "Kosova Republikë". Këto rrethana kanë ndikuar që pas vitit 1981 me kërkesën 'Kosova Republikë' të merret vetë populli, duke bërë kështu që për këtë kërkesë sot të veprojnë edhe organizata siç është LRSSHJ dhe dhjetëra të tjera, nga pozitat ilegale, për një kërkesë pa përmendjen e së cilës sot nuk mund të mendohet asnjë mbledhje e çfarëdo rangu, në Beograd dhe qytete tjera.

Zgjidhja e çështjes se si lufta për një kërkesë kaq legale, kaq të afirmuar, kaq të ngulitur në mendjen e popullit tonë, do të legalizoj edhe format e saj të organizimit është një çështje me rëndësi të dorës së parë. Nëqoftëse ne do të dimë me mbledhë forca, me ndihmua edhe në zgjidhjen e shumë çështjeve teorike në këtë kalim, atëherë ne do të kursenim jashtëzakonisht shumë kohë dhe shumë sakrifica.

Në vazhdim do të merremi vetëm me shqyrtimin nga disa drejtime të forcave të organizuara ilegale.

Forcat e organizuara ilegale, në Kosovë filluan të konsolidohen dhe të ngriten në një shkallë më të lartë sidomos prej vitit 1980, sepse në këtë vit fillon publicistika ilegale kosovare që ka karakter më masiv dhe siç dihet në politikë ka rëndësi vetëm ajo që ka karakter mase.

Sot pa gazetë as që mund të bësh fjalë për një forcë të organizuar politike. Gjithashtu gazeta na jep pasqyrën më të drejtë për gjendjen e një organizate, për pjekurinë e saj, për jetën e saj të brendshme. Nëqoftëse këtë, shumë punëtorë tanë në mërgim dhe sidomos punëtorët në Kosovë dhe rinia jonë nuk e dinë, atëherë na duhet të themi se udba të gjitha këto i dinë shumë mirë. Andaj t'ju tregojmë diçka më shumë edhe mërgimtarëve tanë, dhe të gjithë lexuesve në këtë temë. Me siguri që atyre do t'u interesonte shumë, ndërsa unë jam i vetëdijshëm se po i prishi edhe njëherë keq punët me blankistët tanë, pasi po i "dekonspiroj sekretet". Kjo bëhet aq më e nevojshme për gjendjen aktuale të LRSSHJ-së.

Akuza e sulme "tronditëse"

Para katër muajsh erdhi një letër në redaksinë tonë, e shkruar krejt në frymën e logjikës dyfytyrëshe, në të cilën në mes tjerash shkruante:

"Qëllimi juaj nuk është të viheni në krye të Lëvizjes për të udhëhequr luftën, por për të shtënë në dorë LRSSHJ-në dhe mandej ta shuani luftën revolucionare në Kosovë. Se kështu ju porositë Beogradi dhe instruksionet e veprimtarisë suaj janë të përgatitura prej tyre".

Kur dyfytyrëshi (mikroborgjezi) e kritikon a e sulmon një dyfytyrësh tjetër, atëherë dyfytyrëshit të sulmuar i cili vetvetiu është një frikacak i papresedan, i shtohet edhe një frikë më tepër, i shtohen edhe disa net pa gjumë.

Kur nga pozita e klasës sulmohet një dyfytyrësh, atëherë ai çmendet dhe gjatë gjithë jetës së vet nuk është në gjendje të fitoj qetësi.

Kur dyfytyrëshi sulmon në drejtim të klasës më armike të tij, atëherë ai bëhet aq i vajtueshëm sa është i denjë për tallje.

Po nga e njëjta frymë ne sulmohemi edhe nga një pozitë tjetër. Pozita tjetër (akuza) është ajo, sipas së cilës programi ynë nuk qenka frymëzues e stimulues (sic), se ne nuk jemi mjaft ambicioz etj. Me të vërtetë njeriu për të bërë një vepër duhet të udhëhiqet nga disa motive, duhet të jetë i motivuar. Për të gjithë ata që na kritikojnë në

këtë formë na duket se me të vetmen mënyrë ata mund t'i motivosh, duke u vu të gjithë gradat që mund të gjenden në garderobat ushtarake dhe civile.

A e shihni se këta tipa, të cilët gjithnjë luftojnë në "mes dy zjarresh" edhe ne na futën në luftë në mes zjarreve të tyre.

Disa fjalë për Pararojën

Para se t'u përgjigjemi akuzave "tronditëse" të ndalemi dhe të shohim më afër se çka është pararoja, pasi për këtë kanë nevojë të dinë "udhëheqësit e luftës" në Kosovë.

Pararoja është organizata e cila në mendime dhe në veprime gjendet në ballë të popullit, i prinë atij dhe i drejton aksionet e masave. Dikujt i duket se pararojë do të thotë gjithnjë të luftosh për pushtet. Mjafton të thurësh disa fjalë kundër një qeverie, kundër burgosjeve në përgjithësi, dhe ja u "krye" roli i pararojës.

E çfarë organizate mund të quhet ajo e cila nuk lufton për pushtet? Atëherë pse të burgoset ajo? Pse të organizohet fare ajo, mund të thonë.

Po ne themi se ka organizata që zhvillojnë një punë të madhe në fushë të propagandës, të organizimit të grevave e demonstratave dhe që nuk e shtrojnë çështjen e pushtetit. Po të ishte kërkesa "Kosova Republikë", një kërkesë që mund të barazohej me çështjen e një revolucioni, atëherë kritikat që na lëshohen do të mund të arsyetoheshin, sepse gjëja më elementare e një revolucioni është pikërisht çështja e pushtetit, e ndryshimit të sistemit politik. Le të shohin edhe njëherë se sa shumë janë ngatërruar "kompetentët tanë". Duke analizuar kritikat e tilla në çfarë konkluzionesh mund të vijmë? Vijmë në përfundim se këtu me të vërtetë kemi me një frymë shumë të ngushtë të shikimit të gjërave, me një egoizëm të nivelit më të ulët, me një frikë të tmerrshme se mos po bëhet tjetërkush i parë e jo unë.

Koha në të cilën u themelua LRSSHJ ishte një kohë plotë me aktivitete në të gjitha anët sidomos në mërgim. Çdo kund shqiptarët patriotë ishin vënë në lëvizje, ishin shqetësuar për gjendjen në Kosovë, çdo kund ngrenin zërin e tyre. Krejt puna ishte që ky aktivitet të zhvillohej në emrin e ndonjë organizate. Dhe kjo u bë e mundshme me formimin e LRSSHJ. Të gjithë filluan të veprojnë në emrin e saj. Në të u përzien element me pikëpamje nga më të llojllojshmet, dhe me këtë laramani idesh nuk mund të shkohej gjatë. Format e vjetra të frymës së grupeve filluan të gjallërohen duke iu përshtatur formës së re. Ngjarjet po zhvilloheshin me shpejtësi sa që ne nuk po mund t'i përcillnim ato. Ne ishim shumë mbrapa në përvojë dhe në përgatitje teorike ashtu siç jemi edhe sot.

Se si funksionon një organizatë, se ç'duhet të bëjë ajo në çdo çast me efektivin e saj, se kush mund të quhet anëtarë e kush jo, ne të gjitha këto nuk ia kishim qartësuar vetes. Krejt kjo punë ishte e lidhur me atë se si do të dilte gazeta. Çdo gjë shikohej përmes saj. Dhe as që kishte mundësi të ndodhte ndryshe. Kjo ishte e drejtë.

Në kohën kur ishte duke u përgatitur Nr.2 i "Zërit të Kosovës", (tetor 1982) u ndan më vete përkrahësit e idesë, sipas të cilës, për të luftuar për Republikë duhet të organizohemi në Parti Komuniste, e cila do ta "qeverisë Republikën e Kosovës, e cila do të hyj në bisedime me LKJ nga pozita të barabarta, pa lejuar në ndërhyrjen në punët e brendshme të Kosovës, se në këtë mënyrë ajo do të veproj me të gjitha organizatat në botë." Këto ide u shprehën në fletushkën "Punëtorët".

Që nga shtatori 1982 e deri në qershor 1985, kanë dalur tetë numra të kësaj fletushke. Çka do të thotë se brenda këtyre tri viteve ka dalur një numër në çdo 4,5 muaj. Mbani mend këto të dhëna se do të na nevojiten më poshtë.

Po të llogaritet dalja e "Zërave" para dhe pas ndarjes si në Zvicër ashtu edhe në Suedi, gjerë në fund të vitit 1984, do të del se raporti do të jetë 1:1,36 respektivisht 1:1, 4 numra në muaj.

Kjo është pra tablloja e gjendjes në forcat e organizuara të Kosovës, që kanë gazeta dhe që luftojnë, apo thonë se luftojnë për Republikë në kuadrin e RSFJ. Sipas të dhënave të deformuara të statistikës Jugosllave në vitin 1981 thuhet se në Jugosllavi kishte 1739 364 shqiptarë. Nga këta, sot në burgjet e Jugosllavisë gjenden mbi 10 mijë veta, të cilët janë dënuar për Kosovën Republikë, pa llogaritur dhjetëra mijëra të tjerë që i kanë mbajtur nga dy muaj burg me qëllim që të shpallen të papërshtatshëm. Pastaj rreth tre mijë është numri i atyre që kanë ikur jashtë nga terrori serbomadh, prej vitit 1981 e deri në këtë vit. Këto të dhëna të përafërta i themi me disa shokë me të cilët jemi në kontakte dhe që kanë qenë nëpër kampet e ndryshme të njohura të Evropës për refugjatë. Merrni edhe 100 mijë shqiptarët që punojnë nëpër Evropë, merrni numrin e përafërt të dhjetëra mijëra demonstruesve nëpër 20 demonstratat e Kosovës në Pranverën e vitit 1981, llogaritni edhe demonstratat në mërgim dhe milionat që kanë derdhur mërgimtarët gjatë udhëtimeve nëpër këto demonstrata së bashku me mbrëmjet e shumta, merrni të gjitha këto dhe llogaritni me numrin e gazetave dhe tirazhin e tyre dhe bëni llogari se çka do të del rezultati: A do të del se ne jemi pararojë apo praparojë? Me siguri se do të del kjo e dyta.

Çfarë forcash nevojiten për nxjerrjen e revistave që dalin sot në Evropën Perëndimore e që luftojnë për kërkesën “Kosova Republikë”?

Për të nxjerr një fletushkë si "Punëtorët" në Gjermani (fatkeqësisht që shumica e shokëve nuk e kanë pa atë në 20 faqe të formatit A4 të shkruar me makinë të thjeshtë) njëherë në 4,5 muaj, mjafton vetëm një njeri, me aftësi mesatare, për të shkruar vetë të gjithë artikujt, bërë punën teknike, të punoj në një punë nga tetë orë në pesë ditë në javë dhe vetë të përballoj shpenzimet për nxjerrjen e më së shumti 300 ekzemplarëve në 4,5 muaj. Shumëzimin në pak ekzemplarë e konstatojmë nga shpërndarja e vogël e saj në mërgim. Çka është karakteristikë me rëndësi nga të tetë numrat e fletushkës "Punëtorët" lexuesi i vëmendshëm mund të konkludoj se shokëve të "Partisë" nuk iu është afruar asnjë anëtar i ri pos atyre që i kanë tërhequr pas vetes në start (marrë si dhuratë nga Ambasada shqiptare në Vjenë).

Ja, pra kjo është forca e Partisë, e Sindikatave, e Grave, e Pionierëve dhe e të gjitha levave tjera të "Partisë". Ndoshta u gabuam se mund të na thuhet se Partia nuk mund të gjykohet nga gazeta, sepse ajo në sektorin e propagandës ka ndarë vetëm 0,0001 % të të ardhurave të veta dhe vetëm 0,0001 % të forcave të saj njerëzore. Ndoshta është kështu, por ja që me këtë formë shqyrtimi u nisëm nga vetja. Shokët e Partisë mund të na shajnë edhe njëherë për këto dekonspirime. Po mos u mërzitni aq shumë shokë të Partisë. Në mos askush tjetër të paktën ju e dini se udba e dinë se çfarë forcash intelektuale e punëtore mund të gjenden pas "Punëtorët". Këtë e dinë ajo shumë mirë, dhe ju me fjalët e mëdha të "Revolucioneve" dhe "Përpjekjeve", vetëm që ia qitni gazin, ndërsa në Lagjen e Llapit në Prishtinë, ju me parullat tuaja me të vërtetë keni mund të leni përshtypje dhe këtë ndoshta mund ta bëni edhe në të ardhmen. Pse? Sepse kjo lagje është tmerrësisht e varfër dhe ajo përpiqet të gjejë rrugë për të dalë nga gjendja e mjerueshme. Andaj na u dashtë t'u tregojmë rinisë dhe punëtorëve të kësaj lagjeje, se për të botuar një organ si "Punëtorët" çfarë mundi duhet, pasi këtë polici e udbashi që i rri te koka e di shumë mirë. Këtë ne ia themi jo që ta 'ftohim' por që të peshoj gjërat me mendje të kthjellët.

Për të botuar një numër i organit siç është forma e atij në Zvicër apo në Suedi në 1,36 apo 1,4 muaj janë të nevojshëm tre shokë, të cilët mund të jenë të gjithë të inkuadruar, dhe të përballojnë shumicën e artikujve. Po të marrim se ata shtypen në 1500 ekzemplarë, atëherë ata, varësisht prej firmave do të kushtojnë 1300-1500 frang Zviceran në muaj, që së bashku me shpenzimet e postës mund të mbërrijnë në 2000 frang në muaj. Këtë shumë

mund ta përballojnë 20 veta, të cilët janë anëtarë aktiv dhe që të paguajnë rregullisht nga 100 frang në muaj për gazetë.

Të gjithë mund ta sillni kokën dhe të pyesni e thoni se ç'prapambetje?

Dhe tani po ju pyes a e dini ju se si jemi munduar ne ta mbulojmë këtë prapambetje?

Me punë! Me seriozitet! Me shikim të të vërtetës në sy!

Jo. Me asnjë prej këtyre, jo. Ne këtë jemi munduar ta mbulojmë me fraza të thata, me emra bombastik si KQ, të tjerët thonë jo. KQ është i vogël, s'ekziston fare, por Komiteti Drejtues (KD) është ai "kryesori" i cili i ka të gjitha fijet e punëve tona në dorë. Pra një i quajtur KD pas "Punëtorëve" qenka më i madh se dy KQ pas dy "Zërave".

Kur fjala nuk përputhet me veprën atëherë ajo quhet gënjeshtër. Disa mund të këmbëngulin dhe të na thonë edhe më tej se gënjeshtra kur është në të "mirë" të popullit është e justifikueshme. Përralla. Kaloi koha e përrallave, e fallit dhe magjive edhe në Kosovën tonë të varfër e të prapambetur me plotë gjurmë të së kaluarës.

Disa mund të na shajnë, duke na thënë se po i ftohim punëtorët duke "mos ua bërë interesant" punën për nxjerrjen e një gazete. Me të vërtetë mund të ftohen. Me të vërtetë dikush dobësohet nga kjo. Me të vërtetë dikush forcohet nga kjo. Të shohim si qëndron puna. Ne themi, "forca jonë do të jetë aq e madhe sa më shumë shokë që të kemi të cilët janë të pajisur me të vërtetën", kurse disa të tjerë thonë, jo. "Ne jemi aq më të fortë sa më shumë njerëz të verbër që të kemi pas veti, të cilët as që na e bëjnë fjalën dy, për të na vozitur prej Kölni në Düsseldorf apo prej Berni në Gjenevë."

Ndoshta do të ftohen me dhjetëra, apo me qindra. Dhe kjo është shumë më mirë që këta t'i rrëzojmë që në këtë provim se sa t'i lejojmë të shkojnë më të lartë në mënyrë që të rrëzohen nga poshtë e të shpëtojnë se sa të rrëzohen nga lartë e të bëhen cop-cop. Ndërsa me mijëra të tjerë do të thonë se vërtetë kur tre veta me një grusht shokësh përreth janë në gjendje të bëjnë gjëra të tilla, po të bashkohemi edhe ne e të mos bëjmë sehir me thashetheme çdo të bëhet.

Tani konkludoni edhe vetë, e keni më të lehtë ta kuptoni falsitetin e fjalëve pompoze të udhëheqjes së luftës në Kosovë. Sikur ne me këto forca të kishim qenë me të vërtetë udhëheqësit e rezistencës në Kosovë, atëherë shovinizmi serbomadh do të flinte zbathur. Në Kosovë po bëhet një luftë e ashpër kundër shovinizmit serbomadh në shumë mënyra. Dhe 'kompetentët' e jashtëm, shpesh herë marrim poza të fryra duke qitur me grushta në ajër, sikur disa shikues kur shohin dy boksier në ring, dhe kërcënohen me zë të lartë kundër boksierit që nuk e duan.

Çka mund të konkludojmë nga këto që thamë më lartë?

Ne provuam se në jetën politike të Kosovës ne nuk jemi pararojë, por praparojë dhe këtë fakt disa provojnë ta kalojnë me sy mbyllur si lojtarët e cirkut mbi ndonjë litar.

Ne nuk do të ndalemi kësaj radhe për të analizuar situatën nga këndi se sa i drejtë e sa jo është formimi i grupeve të reja në Kosovë. Ne me këtë rast do të mjaftohemi vetëm me përmendjen e fakteve se përkundër gazetave tona në Kosovë grupet po lindin, dhe lindja e tyre e ka një bazë reale, bazë të cilën duhet ta analizojmë me kujdes e kurrsesi ta injorojmë. Këtu ne po tregojmë se ne jo vetëm në zotërimin e formave legale jemi të dobët, por edhe në format ilegale ku pretendojmë se jemi të përsosur e zot në atë fushë, pavarësisht nga gradat, po guxojnë të na "përzihen".

Jashtë ka gjithçka! - Jashtë nuk ka asgjë!

Kur jemi tek organizimi jashtë, në mërgim, kemi shumë çka të themi. Këtu do të ndalemi të shikojmë disa veçori dhe teorizime që bëhen jashtë lidhur me atë se, a duhet të organizohemi apo jo?!

Megjithëse në këtë drejtim është shkruar pjesa më e madhe e artikullit, këtu çështjen do ta prekim edhe nga një kënd prej të cilit nuk është vështruar gjerë më tani. Nuk na e merr mendja se mund të gjendet qoftë edhe një aktivist i cili ka shpërnda edhe një numër të ndonjë gazete e të mos e ketë dëgjuar frazën "Prej s'jashtmi nuk ka asgjë. Brenda është krejt puna, brenda janë të gjitha problemet".

Këto fjali do t'i ndajmë në mënyrë të prerë për të mos lënë vend për asnjë dredhë. Të thuash se çështja e Kosovës varet plotësisht nga zhvillimi i ngjarjeve në Kosovë, të mbrosh këtë pikëpamje, do të thotë se ke një qëndrim të qartë dhe të drejtë. Këtë askush nuk guxon ta mohoj. Propagandimi i idesë se puna kryesore bëhet jashtë, se rreziku më i madh i shovinizmit serbomadh i vjen prej emigracionit shqiptar mund t'i shkoj përshtati vetëm udbës dhe vetëm ajo e përhapë këtë ide me të gjitha mjetet e saj, në çdo rast kur bën fjalë për emigracionin. Dhe ajo këtë e bën për disa arsye:

1. Me qëllim që të krijoj përshtypjen sikur brenda nuk ka kundërshtarë të shovinizmit serbomadh por kanë mbetur vetëm ata që janë jashtë, dhe se çdo manifestim dhe turbullirë në Kosovë të shpjegohet me ndikimet e jashtme. Kjo do t'i pëlqente së tepërmi shovinizmit serbomadh sikur të ishte kështu. Kjo do t'i nevojitej si për opinionin brenda por me theks të veçantë për ate jashtë.

2. T'u krijohet përshtypja forcave që janë brenda në mënyrë që të gjitha shpresat t'i varin jashtë, dhe njëkohësisht të nxitin në këtë mënyrë shumë të rinj që të dalin jashtë sepse vetëm prej së jashtmi qenka e mundur të bëhet ajo lufta e "vërtetë" kundër shovinizmit serbomadh.

Këto janë pra objektivat e udbës, që ajo ia shtron vetes si detyrë në çështje të propagandës. Këtij qëllimi i shërbejnë deri në një masë edhe propagandimet e personave të rrymave të ndryshme të emigracionit, emrat e të cilëve botohen shpesh edhe me germa të mëdha si tituj në gazetat serbe. Siç po shihet, propaganda sipas të cilës e gjithë puna bëhet jashtë, se qendra e gravitetit është bartur jashtë, mund të shkoi vetëm në mullirin e armikut tonë më të egër.

E pamë përmbajtjen e fjalisë "Krejt puna bëhet jashtë". Këtë na u deshtë ta shpjegojmë më parë, pasi vetëm si rrjedhim i këtij shpjegimi mund të kuptohet qartë edhe fjalia tjetër: "Prej s'jashtmi nuk ka asgjë". Të shohim çka do të thotë kjo!

Po i biem shkurt. Veprimtaria e vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës në mërgim e hedhin poshtë këtë fjali, këtë konkluzion. Nëqoftëse na thonë se tjetër kanë qenë ata e tjetër jeni ju, ne iu themi: Stop! Mos bëni dredhi, nuk e patëm thelbin e çështjes tek personat, por thelbi qëndron se a ka mundësi të bëhet punë edhe prej së jashtmi apo jo. Kësaj duhet t'i përgjigjesh vetëm me 'po' ose vetëm me 'jo'. Ne e provuam se kësaj pyetje mund t'i përgjigjesh vetëm me 'po'.

Ka dy kategori mikroborgjezësh, prej miliona kategorive të kësaj shtrese, në meset tona në mërgim, të cilëve përgjigja negative në këtë çështje ua mëlmon plagët.

a) Kategoria e parë janë ata të cilët veten e kanë vënë në rolin e bariut të qitur jashtë nga Kosova për të ruajtur kopenë e emigrantëve që të mos hyj në "kallamoqe të huaja". Kur ata e shohin se s'mund të jetë ashtu, atëherë ata e shfryjnë pezmin e tyre duke thënë se "jashtë s'ka asgjë" dhe

b) Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë individ, të cilët deri dje kanë qenë aktiv, kurse tani pasi kanë gjetur nga një qoshe të "Evropës së bardhë", në ndonjë qytet a qytezë ku ka mundësisht sa më pak "auslenda" dhe ku raporti në mes gjinive është i përshtatshëm, thonë: "jashtë s'ka asgjë".

I patë dy taktikat e udbës, i patë dy arsyetimet tjera. Ç'të themi ne? A t'ia bëjmë si pleqnarët e mesit të art: "As me ata, as me ata." E vërteta gjendet në mes dy të kundërtave, kështu që këtij 'pazari' po i biem në mes!"

Jo, kjo mënyrë e shtruarjes së çështjes është e denjë vetëm për pleqnarin e mesit të artë. Ne këtë çështje do ta shikojmë me syrin tonë, me logjikën tonë, dhe jo me një sy të udbës dhe me një të sharlatanëve. Këtë do ta shikojmë me të dy sytë tonë. Sot në qytete të mëdha të Evropës Perëndimore gjenden me mijëra punëtorë, gjenden me mijëra refugjatë politikë të ikur pas vitit 1981, të cilët në këto rrugë janë plotësisht në mëshirën e fatit. Askush nuk kujdeset për ta përveç disa veglave të udbës, të cilët ajo përpiqet t'i shtie në dorë për fazën e dytë të punës së saj, pasi e para veç ka përfunduar kur i ka detyruar të dalin jashtë. Këta lloj agjentësh i vizitojnë kampet e refugjatëve dhe u bëjnë lloj-lloj shantazhesh të arratisurve shqiptarë, të cilët duke mos pasur asnjë rrugë tjetër i hapin sytë me një shpresë të akullt para premtimeve udbeske, ashtu si një i sëmurë i rëndë i cili pasi nuk ka arrit të gjejë vend për t'u shtrirë në spital, vrapon të kërkoi shërim nëpër sharlatan.

Policitë e Gjermanisë, Zvicrës, Belgjikës dhe të disa shteteve janë duke u sjellur tepër keq me refugjatët shqiptarë. Këtë duhet ta dinë të gjithë, edhe shokët në Kosovë, të cilëve udba u thotë se shqiptarët në Bruksel e gjetiu ndihen si në "shtëpinë e vetë". Asgjë të vërtetë nuk ka në këtë drejtim. Asnjë në Kosovë nuk duhet të u besoj këtyre gënjeshtrave. E vërteta duhet të dihet dhe kjo e vërtetë le të bie si bombë mbi propagandën serbomadhe. Për të provuar këto gënjeshtra, po përmendim faktin se nga viti 1981 e gjerë më tani, numri i personave që kanë marrë statusin e refugjatit në Gjermani, Zvicër, Belgjikë e Suedi është disa dhjetëra, në kohën kur në të gjitha këto shtete janë duke pritur me qindra e qindra për t'u rregulluar me dokumente. Këtyre shqiptarëve të vuajtur ne sikur të kishim mundësi do t'u ndihmonim, përderisa të jenë jashtë. Por duhet ta dinë të gjithë se ne këtë mundësi nuk e kemi fare, se ne nuk kemi mundur ta shpëtojmë askend. Në mesin e atyre që i dërgojnë prej kampit në kamp, prej burgut në burg dhe prej aeroportit në aeroport jemi edhe ne.

Do të ishte një gjë e turpshme dhe shumë e ulët sikur dikush t'u shtronte këtyre kushte, se kend e përkrahë dhe nga kjo pozitë t'u bëjë maltretime.

Ne popullit tonë në Kosovë do t'i themi nga gazetat tona: Kërko bukë në mbledhjet e hapura kur të vijnë të komunës për mbledhje diferencuese. Kërko bukë, punë e Republikë në mbledhjet e hapura, e jo të çohesh e të shkruash natën parulla, për të cilat të dënojnë me vite të tëra në burg. Kështu efekti yt do të jetë njëqind e njëmijë herë më i madh. Atëherë shovinizmi serbomadh nuk do të ketë mundësi të të dënoj si një njeri i ndonjë organizate i lidhur me "emigracionin". Në këtë rast ai mund të dënoj dy muaj. Kështu ti do ta mundësh urinë gjatë kësaj kohe. Do të ngranësh mish më shpesh se sa në shtëpinë tënde. Dhe atëherë ty popull, shovinizmi serbomadh do të përpiqet të qes prej burgu jashtë, do të përpiqet të gjej ndonjë rrugë tjetër për të zhdukur fizikisht. Ju mund të thoni si mund të bëhet kështu. Po kjo është eksperienca e Evropës së kulturuar. Duhet të mësojmë nga përvoja e saj, pasi historia e saj është shumë e pasur. Dhe atëherë le të provoj shovinizmi serbomadh për ta bindur botën se "irredentistët" dhe "ekstremistët" e jashtëm i shtyjnë shqiptarët në Jugosllavi që të kërkojnë për të ngrënë bukë tri herë në ditë.

Ne që ndodhemi jashtë do të përpiqemi që të bëjmë gjithçka që është në mundësitë tona. Nëqoftëse gjerë më tani në disa raste me disa fakte mund të na thuhet se puna nga jashtë në ndonjë rast ka qenë më e dëmshme se sa e dobishme, ne do të themi se këto janë raste të cilat ne nuk na lejohet t'i ngrisim në lartësinë e një parimi. Ne mund të bëjmë shumë, ne mund ta bëjmë atë punë çka nuk mund ta bëjnë në Kosovë. Ne duhet ta zhvillojmë luftën tonë në çdo vend që të ndodhemi, duke e rreshtuar veten përkrah forcave më përparimtare në luftë kundër reaksionit të errët.

Lufta do të vazhdoj

Lufta e popullit shqiptar në Jugosllavi për të drejta të barabarta do të vazhdoj dhe do të rritet gjithnjë e më shumë, duke gjetur rrugët e saj më të përshtatshme.

Pse do të vazhdoj kjo luftë?

Sepse popullit tonë nuk i janë dhënë as të drejtat më elementare dhe ai vazhdon të shtypet egërsisht. Për këtë do të vazhdoj ajo dhe jo pse ne kemi luajtur një rol të madh deri më tani e që do të ndikonte dukshëm dhe shpejt në jetën politike të Kosovës. Për këtë po marrim një shembull me të cilin do të vërtetojmë ate që u tha më lartë:

Në muajin mars 1983, gjatë përgatitjes së numrit të dytë të gazetës, në Gjenevë, do të botonim "Paralajmërimin", me të cilin ne i kërcënoheshim Jugosllavisë me demonstrata të reja, ndërsa për demonstratën e mbrëmjes së 11 marsit 83 do të mësonim vetëm nga radioja. Krahasoni edhe njëherë të dhënat lidhur me nxjerrjen e gazetave, dhe nxirrni vetë konkluzionet se sa, ne, jemi në gjendje që sot të ndikojmë në ngjarjet në Kosovë. Po të shkohet në këtë mënyrë edhe më gjatë ka rrezik që prapë vala e spontanitetit ta bëjë të veten.

Në çfarë plani të vendosen forcat?

Ne gjithashtu kemi qëndrime të ndryshme ndaj zhvillimit të ngjarjeve, shfrytëzimit të pozitave legale. Në një kohë kur krejt populli është i shqetësuar, kur diskuton për politikë, kur kërkesat tona janë krejt demokratike për të cilat mund të flitet hapur, disa këmbëngulin akoma me disa artikuj që i nënshkruajnë me emra heronjsh, sa për t'ua rritur efektin, se gjithë barra e aktivitetit duhet të jetë në celulat ilegale.

Unë nuk them kështu. Organizimi ilegal duhet të zhvillohet, aparati konspirativ duhet të përsoset, por për një aparat të tillë të shkathtë dhe operativ do të mjaftonin në gjithë Kosovën 60-80 veta.

Ta vendosim drejtë planin e forcave sepse dhjetëra mijëra të rinj, punëtorë dhe fshatarë të cilët duan të kontribuojnë dhe që ende nuk i kanë gjetur rrugët, nuk mund të futen në celula ilegale dhe të organizohen në grupe me emra të ndryshëm, në një situatë siç e kemi ne në Kosovë. Të thuash se vetëm nga celulat ilegale duhet të veprojnë këta njerëz dhe në to të organizohen të gjithë ata që janë të gatshëm, s'do të thotë gjë tjetër pos të rekrutosh njerëz për burgje.

Pastaj duhet të bëjmë një dallim që ka rëndësi të dorës së parë: Se prej çfarë pozitash ne vazhdojmë ta intensifikojmë kërkesën "Kosova-Republikë"? Ne e dimë se ajo edhe më 1981, edhe pse në rrugë, është shtruar si kërkesë në përputhje me frymën dhe pozitat e LKJ-së dhe jo nga pozitat e ndonjë organizate tjetër ilegale.

Atëherë çka iu nevojitet organizata ilegale mund të na thonë për kërkesën "Kosova-Republikë"?

Organizatën ilegale me parime marksiste na e imponon prania e organizatave, grupeve dhe individëve serbomëdhenj si brenda ashtu edhe jashtë LKJ, të cilët kundër zhdukjes së tërësishme të popullit shqiptarë veprojnë herë më hapur e herë më fshehur. Taktika mund t'u ndryshoj në situata të ndryshme, strategjia e tyre mbetet gjithnjë e njëjte. Ajo na nevojitet për organizimin e demonstratave dhe grevave të ardhshme. Në këtë pikë ne po të zgjatemi më shumë, ndoshta edhe mund të themi gjëra të gabuara, pasi nuk e kemi rrahur këtë çështje më parë. Andaj po ndalemi me kaq. Mendjen do ta vrasim edhe më tej se ç'duhet bërë në këtë drejtim, se si duhet shtruar ky raport.

Përndryshe pa organizim të mirë, demonstrata të fuqishme është e pamundur të organizohen. Organizimi është i rëndësishëm sidomos në fillim, pasi me zhvillimin e ngjarjeve vetë lufta do të qetë në sipërfaqe individ të shquar ashtu siç qiti më 1981, ku as

2% e udhëheqësve kryesor që kanë qenë në ballë të demonstratave, nuk kanë qenë anëtarë të organizatave që kanë vepruar para vitit 1981.

Populli Shqiptar në Jugosllavi ka forca si kurrë më parë dhe ai nuk mund të përkulet e as të detyrohet të heq dorë nga kërkesa e tij "Kosova-Republikë" sepse kjo kërkesë është jeta e tij, ndërsa jetën e tij nuk ka forcë shoviniste që mund ta mbysë. Kjo luftë e tij do të çoi në realizimin e Kosovës-Republikë.

Shkurtimisht treguam se ku gjendemi. Sa do të jemi në gjendje të organizohemi, nëpër çfarë fazash do të kaloj ngritja e publicistikës për Kosovën Republikë, sidomos jashtë nga ne, këtë do ta shohim në të ardhmen. Ne në këtë rast edhe njëherë deklarojmë se nga vetja do të japim maksimumin, dhe të gjitha aftësitë tona do të përpiqemi t'i vëmë në shërbim të popullit tonë.

Punëtorët tanë në mërgim gjatë këtyre pesë viteve kanë patur rastin të mësojnë shumë. Në këtë rast duhet theksuar edhe njëherë se për punëtorët tanë më aktiv është e një rëndësie të dorës së parë të kuptojnë se në cilën klasë bëjnë pjesë, dhe me këtë të kuptojnë se si të pozicionohen pa frikë në luftë për të drejtat e tyre, se ata nuk ka nevojë t'i kaploj frika e pakufi e "kuadrove të përgatitura" dyfytyrësh e egoist.

Punëtorët duhet të shtrëngohen për pozitat e tyre të klasës, çdo gjë t'a shikojnë me syrin e tyre, dhe atëherë ata do të jenë të pagabueshëm, atëherë ata nuk do të arrij t'i ndaj nga "tufa" asnjë ujk me lëkurë qingji. Shumë punëtorë tanë në mërgim janë të shqetësuar se si po shkojnë punët, kend janë duke e përkrahur, mos po gënjehen nga moskuptimi i ideve. Të tjerë që veç kanë marrë qëndrime të caktuara përpiqen të na e thurin gardhin me këto fjalë: "Kujdes e të mos na nxirrni më telashe, sepse bani e dual prapë ndonjë fjalë atëherë s'kemi kujt çka me i thanë." Dhe ne u themi: "Te ne çdo gjë në rregull! Hiç mos u bëni merak, kurse të tjerëve nuk do t'u shkoj larg." Përafërsisht me një intensitet shumë më të madh nëpër telefona, nëpër mbrëmje, për ndryshim që ne po e themi hapur, edhe të tjerët i thonë të njëjtat gjëra për ne. Dhe çka bëjnë punëtorët. Hapin sytë, hapin veshët, mbajnë vesh kur do të pëlcet bomba.

Kah do të pëlcas bomba më herët? - Kujt do t'i ndihet krisma më larg?

Ne e ndiem si obligim me iu tregua këtyre shokëve që po merakosen e të cilëve sa herë u cingëron telefoni, thonë çka ka?

Studimi i psikologjisë së klasave dhe përzierjes së tyre në luftë të jep në dorë aso mundësish që parimisht të shohësh, apo të përcaktosh në vija të përgjithshme ngjarjet që të presin përpara. Konkretisht punëtorët më aktivist mund ta shtrojnë çështjen në këtë mënyrë:

A ka ndonjë dimension të së vërtetës në gjithë këto intriga e në këtë zhurmë?

Dhe nëqoftëse ka diç të vërtetë çka është në pyetje?

A ka probleme në Zvicër dhe të çfarë natyre mund të jenë ato?

A ka probleme në Suedi dhe të çfarë lloji mund të jenë ato?

Ku janë më të mëdha? Kush mund të del më i padëmtuar nga problemet e reja?

Dhe në cilën anë ka gjasa që eksplodimi të jetë më i fuqishëm?

Dhe kur mund të ndodhë eksplodimi përafërsisht, pasi teknika e sotme ka prodhuar mina me orë, por edhe aparate për t'i zbuluar këto dhe për t'i ç'aktivizuar. Dhe në fund do të pyesim pse na janë të nevojshme të gjitha këto, ku është ai virus që po ua zen tharmin problemeve. Kush po e qetë një mollë të egër në qumësht e po na e bënë detin kos?!

I gjithë problemi mund të kuptohet vetëm po ta kuptojmë psikologjinë e sjelljes së individëve në bazë të interesave të cilës klasë mbrojnë, respektivisht gënjeshtrave të tyre lidhur me atë se me çfarë etiketash shërbehen. Po mund të na thoni ju qe disa herë na

e keni përsëritë se lufta jonë nuk është klasore? Se nuk është me karakter të theksuar klasor se është një luftë thjesht demokratike. Kjo është e vërtetë. Këtë ua kemi përsëritur disa herë dhe ashtu është. Por duhet të dihet se, a është karakteri i luftës, kërkesës, demokratik apo tjetër, kjo aspak nuk e ndryshon thelbin e çështjes, se të gjithë ata që luftojnë për një kërkesë, mund ta shikojnë këtë nga prizmi i tyre, nga logjika e tyre, e interpretojnë sipas mënyrës së tyre të të menduarit. Po ju mund të na thoni prapë, se pasi ja keni nisur me këtë fjalën klasë, mos po na e teproni sikur disa të tjerë që edhe ju vetë sa e sa herë ua keni parë për të madhe. Pastaj populli ynë nuk është aq i pasur me shtresime politike. Se nuk janë të pranishme të gjitha këto klasa, se kjo nuk vërtetohet as me gjendjen materiale.

Së pari ne me fjalën klasë po merremi më konkretisht sepse vetëm përmes saj do t'i kuptojmë në thelb problemet, ndërsa përmendja e shpeshtë në këtë numër le të kuptohet nga fakti se përpara e kemi përdor vetëm pak. Por ne do të përpiqemi të ruajmë një kufi dhe të mos e bëjmë bozë. Mosndryshimet e theksuara në gjendjen materiale mund të të japin një pasqyrë të gabuar për kuptimin e ekzistencës së klasave, ekzistencës së shikimit të tyre me sy të ndryshëm. Një njeri mund të jetë shumë i uritur, mund të flejë nën ura, por kjo nuk e përjashton mundësinë që ai të ketë një mënyrë të të menduarit të borgjezit të madh apo të vogël. Por tek ne ma së shumti ka kokëçarje me ata të "mesit të art", me ata që nuk e kanë "keq me askend".

Të kthehemi në temë. Për ndarjen ka ekzistuar një bazë reale, një themel i fortë mbi të cilin ajo ka arritur të ngritet dhe të qëndroj. Por shkëndija e saj është ndezur në terrenin mikroborgjez. Pa dalë gazeta në Suedi, për shkak të gjuhës së njëjte, më shumë janë përmendur pretekstet se sa shkaqet e vërteta, megjithëse shkaqet kanë qenë një mal i tërë në krahasim me një "grusht kashte" pretekstesh. Me fjalë më të qarta po doni se këto sjellje rrotull po u duken më të vështira për të kuptuar se çka dua të them. Po dua të them se për aq sa ndarja është bërë nën ndikimin e faktorëve mikroborgjez për aq ne sot jemi të përzier në të dy anët. E këta faktor janë të mëdhenj.

Që jeni të përzier e të bërë lesh e li këtë po e shohim, por nuk po e dimë se a është e njëjta gjë në thelb në të dy anët, a dredhi në të dy anët, kush është në pozita realisht më të këqija, dhe nëqoftëse ka ndryshime të çfarëdo forme atëherë tregona dhe na e mbushni mendjen me fjalë sa më të thjeshta. Për me na e thënë ne punëtorëve të vërtetën juve nuk ju duhen shumë rrotulla, shumë dredha e përdredha po fjalë konkrete e të thjeshta, mund të na bombardojnë me pyetjet tjera.

Do të përpiqemi të jemi sa më konkret, e mos me lënë vend për interpretime të dyfishta, do të përpiqemi që shpjegimin të mos e bëjmë me gjuhën idiote të pleqnarëve të mesit të art.

Situata është kësisoji: Për shkak të përzierjes, mund të ketë asi individësh që sot janë më afër me trup tek gazeta në Zvicër e mendja u rrinë tek ajo në Suedi dhe kanë simpati për të dhe anasjelltas. Ka sot asi individësh që puna i ka zënë të jenë afër gazetës në Suedi por "me dorë zemër" ata janë më afër të asaj të Zvicrës. Cilat janë ndryshimet thelbësore në mes këtyre rrymave, simpatizuesve ilegalë, apo "dezertorëve"? Meqë këtu kemi të bëjmë e një terminologji ushtarake atëherë po ia lamë fjalën një eksperti ushtarak, që t'ua shpjegoj ai vetë ndryshimet pasi ato jo vetëm që ekzistojnë por janë edhe shumë të mëdha. Ai do të thoshte përafërsisht kështu: Në Zvicër ka njerëz të "kompetencave të mëdha", njerëz me "përvojë të madhe", ku është një "Qeveri me renome", ku ka "gjeneral të sprovuar", gjenden shumë ushtarë, të cilët e ndiejnë veten keq dhe i urrejnë gradat që ua kanë ngjitur sepse ata gjithmonë i kanë urryer gradat e birucave, gradat që s'kanë qenë të popullit. Këta njerëz, këta "ushtarë të pagdhendur" e gjejnë veten më tepër në faqet e "Zërit" me adresë në Suedi.

Në Suedi kemi tabllonë e kundërt: Për shkak të programit pa fjalë bombastike, për shkak të mungesave së gradave të mëdha, për shkak të moshës së re, disa "gjeneral të mençur" ka mundësi të dalin nga ai mes dhe të kenë më shumë simpati për ata në Zvicër, të cilët luftojnë "pa kompromis" dhe të cilët "dinë çka duan", për ndryshim prej atyre të rinjve të cilët kanë "ide të ngatërruara" (sic), dhe të cilët nuk "din çka duan!" Kështu pra diçka mund të ketë. Vetëm mbi këtë bazë mund të kuptohen zierjet e brendshme. Kur mund të vlojnë, sa mund të jenë të rrezikshme për secilën palë dhe kush frikohet më shumë nga këto, këtë po ua lëmë ta shqyrtoni vetë.

Cila do të ishte fjala jonë për punëtorët, në këtë rast për ata mërgimtarë që na ndihmojnë, dhe të cilët nga të gjitha këto nuk mund të mos e pyesim veten: Kah jemi duke shkue, kah janë duke na drejtua pasi u kemi besue? Përgjigjet që do t'ua japim shokëve tanë që na kanë ndihmuar vlejnë në të njëjtën kohë edhe për ata të cilët na kanë sharë e të cilët janë idhnuar me ne duke menduar se ne i penguam në rrugë, se po të mos i shihte syni i keq, ata tani do të ishin në cak.

Ne shokë, siç e dini që nga momenti i parë që u ndamë më vete kemi thënë: "Ne kurrë nuk u nisëm nga parimi se një gazetë do të jetë në rregull vetëm nëse e botojmë ne, dhe nuk do të jetë në rregull nëse e boton tjetërkush, pavarësisht se çfarë do të shkruhet në të dy rastet. Ky parim për ne ka qenë i huaj. Ne nuk themi se na ka dalë mjekra në revolucione. Përkundrazi themi se plot e plot gjëra ne nuk i dimë por të cilat po i mësojmë dalëngadalë. Këto gjëra dhe të gjitha, kur një ditë nuk do të ketë asgjë që s'do të dimë ne, kur nuk do të ketë kala që nuk do ta pushtojmë, do t'i arrijmë vetëm gjatë rrugës duke ecur, duke mos pranuar me u ndalë, pavarësisht nga të gjitha belbëzimet tona. Se ne ende kemi shumë nevojë për njohjen e literaturës e të teorisë. Se ne kur u thërrasim në tubime për të diskutuar vepra teorike të ndryshme e bëjmë jo vetëm t'u dhënë ide të reja juve por edhe vetes.

Ne ju themi që të mësojmë sa më shumë sepse nga arrestimet dhe burgosjet e shumta brenda, nga aksionet e udbës terroriste jashtë, masës iu kanë hequr elementët më militantë, më të shquar të cilët kanë luftuar me një aktivitet dhe një energji shumë të madhe, se përkundër humbjes së tyre ne sot gjendemi në pozita shumë më të mira se ata, se kemi rrethe më të mëdha shokësh dhe më shumë kontakte, më shumë ndihma materiale se ata. Kjo zbrazëti e madhe që e krijoi udba, nuk mund të mos lente gjurmë të thella siç është forcimi i veprimeve spontane në krahasim me ato të menduara dhe të logjikuara me objektivitet.

Qëllimi ynë, duke u ndarë pasi s'kishte mbetur tjetër rrugë (nëse kishte mbetur le të na e provojnë këtë) ishte që t'i japim një grusht sa më të pamëshirshëm këtij spontaniteti. Kur të kthehemi prapa ne shohim se me të vërtetë i kemi dhënë grushte të merituara spontanitetit se ato veprime vështirë se do të këndellen.

Gogoli i fraksionizmit

A duhet të kemi frikë nga fjala fraksion nëqoftëse kundërshtarëve tanë u pëlqen të na quajnë fraksion. Ka fraksione e fraksione. Kudo në botë u shtofshin fraksionistët si ne dhe që gjykojnë si ne. Ju lumtë të gjitha fraksioneve si ne. Ne nuk trembemi kur të tjerët duan të na frikësojnë me gogolin e "fraksionizmit".

Se ne jemi munduar që programi ynë të jetë një program me baza reale, e jo një koleksion i dëshirave të mira dhe kaçamakut të ideve. Ne kurrë nuk kemi thënë që çështjet jetike popujt nuk i zgjedhin me forcën e tyre. Por ne, forcën e popullit shqiptarë në Jugosllavi e shohim në madhësinë e tij numerike, në klasën e tij punëtore që po piqet e rritet, në rininë e etshme për dije e për liri, në Universitetin e Prishtinës dhe jo në ndonjë valixhe me dy automatik e dy revole.

Pse do të bëhet Kosova Republikë?

Sepse populli shqiptar në Jugosllavi u rezistoi të gjitha planeve të errëta të shovinizmit serbomadh duke i ruajtur e zhvilluar të gjitha traditat dhe gjuhën e tij, i ruajti të gjitha ato tipare duke i quar në atë nivel që mund t'u afrohen kombeve të qytetëruara të Evropës.

Ekzistenca e shtetit të pavarur shqiptar nuk ka mund të qëndroj as sa bryma e mëngjesit, për t'u përdorur si argument kundër "Kosovës Republikë". Konstituimi i Republikës së Kosovës është një proces objektiv historik i zhvillimit të kombit tonë, në të cilin përkundër vërragëve të shëmtuara të politikës imperialiste e shoviniste nuk u arrit të ndalet. Kosova Republikë do të bëhet jo për atë se ky është vullneti i një numri të vogël personash. Realizimi i saj nuk do të mund të ndalohet prej çfarëdo force shoviniste. Vetëm e vetëm pse është kështu ne mund të themi se realizimi i kërkesës "Kosova Republikë" është i padiskutueshëm.

Kur do të bëhet Kosova Republikë?

Kjo është çështje objektiviteti. Se realizimi i kësaj kërkese do të bëhet në ato kushte objektive, kur forcat progresive në Jugosllavi edhe në çështjen e Kosovës Republikë të triumfojnë mbi forcat e reaksionit. Puna e popullit shqiptar në Jugosllavi, duhet të jetë në këtë pikë, vendimtare në taborrin e forcave progresive.

Atëherë çka do të bëjmë ne në mërgim, ashtu edhe ata brenda derisa të rëndoj peshorja më shumë në krahun tonë?

Cilat janë detyrat tona?

Ne do të luftojmë që populli të bashkohet sa më shumë ideologjikisht rreth kësaj kërkese dhe të veproj praktikisht në mënyrë sa më të organizuar, me një taktikë unike dhe një program sa më të qartë.

Çka duhet të bëjmë ne konkretisht, pra ne që "filozofojmë" me fjalë dhe ju që na ndihmoni me të holla, që jeni ndodhur tani afër nesh? Ne nuk shohim detyrë më të rëndësishme se grumbullimin e forcave për nxjerrjen e një gazete sa më të rregullt dhe sa më të qartë, e cila gjeri sa mos të dali të paktën dy herë në muaj, nuk do të mund ta kryej detyrën e vet, nuk do të jetë në gjendje jo më t'u prij ngjarjeve (të jetë pararojë), por as të eci paralel me to (të jetë një përshkruese), por do të mbetet në bisht të tyre dhe me një britmë të vajtueshme do të thërret me një zë të humbur: "Ku po më leni, merrmëni edhe mua me vete, ku po na e leni KQ dhe alametet tjera që vijnë me të".

A do të na i kryej të gjitha punët një gazetë e tillë?

Për ne, një gazetë e tillë është çështja kryesore. Me te ne do të ecnim, do të jetonim me situatat dhe nuk do të numëronim në vend. Po pa gazetë a mund të bëhet diç?

Si jo! Ne edhe deri më tash kemi jetuar pa to.

Pa gazetë ne kemi me u kënaqë duke ndejtë kafeneve, s'kemi me pas telashe me "fraksionizma" dhe kemi me shkue nëpër falltor të cilët duhet me na tregue se çka ka me u ba Kosova pas kaq e kaq vitesh. Apo hiq pa fall, ne me qenë pak si pedant e të zgjuar do të mësojmë shumë për perspektivën edhe nga horoskopat. Pa gazetë pra këso mrekullish ne do të jemi në gjendje të bëjmë.

Meqë ngulni këmbë për gazetë atëherë çka ju nevojitet që ta kemi një në çdo 15 ditë?

Do të na nevojiteshin së paku 5-6 veta, me njohuri mesatare të vendosur në një qytet. Mos po doni me thënë 5-6 të pagabueshëm? Jo. Gjashtë veta që gabojnë të gjithë, por që kanë me pas guxim me e shikuar gjithmonë të vërtetën në sy. Gjashtë veta të tillë mund të jenë vetëm ata element të brumosur me frymën proletare, që rrjedhin nga thellësitë e pastra të kësaj klase, apo edhe ndonjë prej shtresave të mesme të cilët gjatë luftës kanë kaluar nëpër aq prova sa veset mikroborgjeze i kanë humbur qoftë edhe për ndonjë vit.

A mund të ndodhë një diçka e tretë?

Po a mund të ndodhë diçka e tretë, para atij momenti kur kushtet objektive do të bënin të mundshme realizimin e Kosovës Republikë? Çfarë janë këto mundësi që do të ç'vendosnin përkohësisht rrjedhën e ngjarjeve apo këto përpjekje për të kthyer rrotën e historisë prapa?

Një diçka e tretë mund të ndodhë. Kjo e tretë mund të jetë vetëm intervenimi i ndonjërës nga superfuqitë në Jugosllavi e Ballkan. Në atë rast ne do të luftojmë së bashku me të gjithë popujt e Jugosllavisë kundër agresorëve imperialistë dhe lufta jonë do të jetë një luftë e drejtë. Në atë rast ne do të përpiqemi dhe nuk do të kursejmë asgjë që luftën tonë çlirimtare, patriotike ta lidhim dhe ta shndërrojmë në luftë civile në vendin që ka sulmuar. Gjatë zhvillimit të kësaj lufte në të njëjtën kohë do të luftonim edhe kundër të gjitha forcave shoviniste tek të gjithë popujt.

Po ta zëmë se kjo e tretë nuk ndodhi, se ngjarjet rrodhën pa diçka të jashtëzakonshme, se sinteza e punës së gjithë faktorëve çoi në realizimin e kërkesës Kosova Republikë.

Atëherë ne çdo të bëjmë?

Ne sikurse tani edhe atëherë, të vetëdijshëm se lufta në mes forcave progresive dhe reaksionit, si në një shtet ashtu edhe në shkallë ndërkombëtare do të jetë aq e gjatë sa tani për tani as që mund të përcaktojmë një kufi kohor se kur kjo luftë do të shuhet, ne gjithmonë do të qëndrojmë përkrah forcave progresive, përkrah klasës punëtore, për të ruajtur dhe siguruar fitoret e saj, për t'i bërë ato të pacënueshme përgjithmonë. Kaq mund të themi tani për tani.

Për ta bërë edhe më të qartë këtë përgjigje do të japim këtë shpjegim edhe me një plotësim tjetër me rëndësi megjithëse mund t'u duket si largim nga tema në dukje të parë.

Për çka do të na duhet të sqarohemi tash, për t'u fituar pasqyra e drejtë në pyetjen e lartpërmendur? Do të sqarohemi në atë se

Në emër të kujt flasim ne që e nxjerrim këtë gazetë?

Mos do të themi se kështu do të bëjë populli, apo të flasim në emrin e tij, dhe të marrim pozat e falltorëve duke thënë se populli do të bëjë kështu e ashtu! Jo. Shpjegimi ynë dhe përgjigja jonë në këtë rast nuk do të jetë aspak në emrin e popullit të Kosovës. Në emër të popullit ne sot mund të themi vetëm "Kosova-Republikë", e cila është e padiskutueshme, dhe ne këtë të gjithë e themi me zë. Por rrugët dhe mënyrat me të cilat mendojnë të arrijnë tri gazetat në mërgim, pasi janë të ndryshme do të thotë se që të tria janë shumë të diskutueshme. Duhet të jesh demagog i klasit të parë që t'i ngjyrosësh idetë e tua shumë të diskutueshme me kërkesën e padiskutueshme "Kosova-Republikë", në mënyrë që këto ide t'i shesësh kontrabandë më lehtë me etiketën e kësaj kërkese.

Në bazë të provave të shumta që dëshmohen në praktikë, jemi të bindur se ne qëndrojmë më së afërmi me kërkesën dhe mënyrën e shtruarjes nga populli.

Me cilët indikatorë mund të përcillet vullneti i popullit?

Me cilët shembuj mund të përcillet vullneti i popullit më së miri? Dihet se më 1981 populli doli në rrugë për t'i shtruar kërkesat e tij. Ai kërkoi bukë, liri dhe Republikë. Nga ana e shovinistëve serbomëdhenj vullneti i popullit u shkelë edhe njëherë me forcën e armëve. Nga masa e gjerë popullore ku më shpejt e ku më ngadalë u burgosën shumë bij e bija të popullit të cilët ishin dalluar në shtruarjen dhe mbrojtjen e kërkesave të tij. Në hetuesi ata dhanë deklarata. Tekstet e këtyre deklaratave janë dokumentet tona më të fuqishme me anë të të cilave ne mund të përcjellim vullnetin e popullit. Shembuj dhe të dhëna nga burime të tjera më të fuqishme se këto deklarata ne as nuk mund të gjejmë dhe njëherë përnjëherë as që do të kërkojmë.

Natyrisht të burgosurit janë me mijëra, që rrjedhin nga shtresa të ndryshme sociale dhe që gjenden në shkallë të ndryshme të formimit të botëkuptimeve të tyre. Ka nga Kosova, ka edhe nga emigracioni. Ka që kanë qenë në përbërje të forcave të organizuara ilegale dhe ka asi që nuk kanë qenë fare. Parimisht dihet se të gjithë e kanë përkrahur "Kosovën Republikë" dhe se me këtë kërkesë, kanë thënë se nuk nënkuptojnë prishjen e sistemit politik të RSFJ. Ne do të marrim dy të burgosur të cilët mund të pranojmë se me mendimet e tyre përfaqësojnë të gjithë të burgosurit shqiptarë në Jugosllavi. Meqë ne veprojmë si të organizuar, atëherë këta të burgosur i zgjodhëm prej radhëve të organizuara. Pasi për "Kosovën Republikë" veprohet edhe nga Kosova edhe nga mërgimi, njërin e morëm nga Kosova i cili nuk ka parë të "mirat" e emigracionit, dhe njërin nga emigracioni. Dhe meqë sot në mërgim nxirren dy gazeta më kryesore që thonë se luftojnë për Kosovën-Republikë, dhe që kanë pikëpamje të ndryshme, ne që të dy këta të burgosur i zgjodhëm nga ato radhë, të cilët, ata që na shajnë se ne e kemi keq, i llogarisin si shokë të vet . Këta dy të burgosur janë Bajrush Xhemaili dhe dëshmori ish i burgosuri Zija Shemsiu.

Bajrush Xhemaili: "Me Kosovën Republikë, vendi ynë nuk do të humbiste asgjë nga tërësia e vet. Ne nuk atakojmë dhe as nuk dëshirojmë të shkatërrojmë sistemin ekzistues. Ne kërkojmë që të jemi të barabartë, se pa barazi ekonomike nuk ka barazi politike."

Zijah Shemsiu, i pyetur nga shovinistët serbomëdhenj se si e kupton "Kosovën Republikë" ai u përgjegj në të njëjtën mënyrë si Bajrush Xhemaili. Kur i qitën citate nga "Zëri i Kosovës" ai deklaroi se nuk i ka lexuar. Zijah Shemsiu si shumë ne të tjerë u kishte besuar fjalëve të disave, por kur ai vetë u ballafaqua drejtpërdrejtë në betejën e madhe me shovinistët serb, ate, trimëria, shpirti i njeriut të aksionit pa pretendime, pozita e tij që gjithë jetën e çoj i shtypur dhe i vuajtur nga ai shovinizëm, e quan në konkluzione të pagabueshme. Ai mbrojti pikëpamjet e shokut të tij të burgut të Kosovës dhe i braktisi fjalët e shokut të vet të cilat i kishte lexuar.

Populli është një masë. Në të ka borgjez të mëdhenj, borgjez të vegjël (edhe nëse jo gjithë në pozitë materiale, këta mendojnë dhe reagojnë si të tillë), fshatarë të pasur, fshatarë të mesëm e të varfër, punëtorë, intelegjencë, rini, pastaj hajna, pijaneca, njerëz që flejnë trenave dhe oborreve të ndërtesave fetare. Por në mes të gjithë këtyre, klasa punëtore dhe ajo fshatarësi e cila lidhet me këtë klasë janë klasat më përparimtare të popullit, janë ato që e mbajnë gjallë gjithë shoqërinë, janë krijueset e të gjitha të mirave, prandaj vetëm këto të dyja merren si përfaqësuese të popullit, vetëm me këto dy klasa mund të identifikohet populli ashtu siç identifikohet një gjini e artit me veprat e veta më të mira. Prandaj sa herë të përmendim popullin duhet të nënkuptojmë këto dy klasa në krye të të gjitha të tjerave dhe sa herë të flasim për këto dy klasa duhet të nën-kuptojmë popullin.

Vetëm fashistët huligaj, rrugëve të Evropës mundohen që me sjelljet e disa lumpenëve të popujve të jugut të Evropës dhe të kontinenteve tjera të identifikojnë edhe popujt. Vetëm serbomëdhenjtë janë ata të cilët mundohen që duke marrë ide nga më të çorodituratë të disa individëve dhe t'i afirmojnë ato si kërkesa të të gjithë popullit.

Të na falin lexuesit që na u dashtë të zgjatemi pak, para se të përgjigjemi në mënyrë më të plotë se ç'do të bëjmë ne pas Kosovës Republikë. Por na u dashtë të zgjatemi sepse tek ne ende diku është zakon që kur mendimi i një personi, pa kaluar nëpër kurrfarë kontrolli, të ketë etiketën e kërkesës së popullit dhe e gjithë kjo për turpin më të madh të quhet modesti.

Të flasim në emër të popullit këtë askush nuk na e lejon. Këtë të drejtë as populli ynë sot, përveç në kërkesën "Kosova Republikë" nuk na e ka dhënë. Por t'ia shprehim mendimet popullit tonë ne bijtë e tij, këtë askush nuk mund të na e mohoj.

Mund të na thonë se ju nuk mund të quheni bij të popullit, se populli ka shumë më të mirë se ju. Se populli ka një milion herë bij me të mirë se ne, këtë askush nuk mund ta mohoj. Se, edhe ne nuk jemi ata bij, në mesin e të cilëve siç thuhet kafeneve, mund të ketë të mirë, të këqij, heronj të vërtetë apo të vetëshpallur, demagog, "vegla të udbës" etj. as kjo nuk mund të mohohet. I kemi ra hise. Sot bijtë më të mirë të popullit, më të dalluarit janë në varre ose në burgje. Çka të bëjmë ne? Të vajtojmë se bijtë më të mirë janë të vrarë e në burgje andaj neve "fëmijëve të papjekur" nuk na lejohet të mundohemi.

Po udba pikërisht për këtë i ka vrarë e izoluar që ne t'ia plasim vajit. Por jo, ne të cilët kemi qenë me këta shokë bashkëluftëtarë për një kohë, për ditët tona më të mira, dhe të cilët para këtyre shokëve nuk jemi dukur dhe as nuk dukemi as sa miza, para armikut tonë serbomadh duhet të dalim në proporcione pak më të mëdha.

Nga shpjegimet e mësipërme duket qartë se në këtë pyetje do të përgjigjemi (flasim) vetëm në emrin e atyre shokëve që nga Kosova na dërgojnë informata të paktën një herë në muaj dhe në emrin e atyre shokëve jashtë të cilët për çdo muaj na ndihmojnë materialisht me shuma të caktuara të hollash. Pra vetëm në emrin e këtyre shokëve ne mund të diskutojmë rreth Kosovës Republikë, mund të diskutojmë se çka mund të sillet rreth kësaj kërkese dhe këto mendime t'ia shprehim popullit, i cili varësisht nga ajo se sa kemi qenë në gjendje t'i përcaktojmë këto mendime në përputhje me interesat e zhvillimit të tij historik, do t'i aprovoj.

Çka do të bëhet pas Kosovës Republikë?

Tani të kthehemi tek plotësimet në përgjigjen çdo të bëhet sipas mendimit tonë dhe çdo të bëjmë ne pas Kosovës Republikë.

Pas Kosovës Republikë, mendojmë ne, populli Shqiptar në Jugosllavi, me një shpejtësi shumë më të madhe do t'i zhvilloj forcat e tij prodhuese. Një zhvillim të tillë të shpejtë dhe të lirë do ta garantoj Republika e Kosovës. Se shtresimi i popullit, ndarja në mes të popullit shqiptarë në Jugosllavi në pjesën revolucionare dhe konservative do të jetë shumë më e lehtë. As gjatë Luftës së Dytë Botërore as në këto dyzet vite lufta serbomadhe nuk ka qenë një luftë gjoja kundër "reaksionarëve" shqiptarë. Ajo që nga viti 1941 e deri më sot vetëm maskën e ka pasur dhe e ka të tillë, sepse ajo ka qenë dhe mbetet një luftë për zhdukjen e popullit shqiptarë si komb. Se ndarja e diferencimi i popullit tonë në formën e lartpërmendur do të jetë i mundshëm vetëm me zhvillimin ekonomik. Se një ndarje e tillë nën sundimin serbomadh do të jetë tmerrësisht e vështirë në mos e pamundur. Pikërisht këtu qëndron progresiviteti i Kosovës Republikë, dhe në mohimin e saj serbomëdhenjtë mund të kenë vetëm përkrahjen e forcave më reaksionare.

* * *

Si ka mundësi që ata të cilët na udhëhoqën në luftë kundër Hitlerit dhe Musolinit, në një numër të konsiderueshëm të kenë depërtuar idetë reaksionare dhe të jenë distancuar prej popullit?

Kjo u bë e mundur sepse shumë element përparimtarë, internacionalist të shquar të cilët kanë qenë edhe në luftën e Spanjës, filluan me ngranë atë çka nuk ka mundësi me e ble e sigurua populli, të veshin çka nuk vesh populli, të pinë çka nuk pinë populli, të pushojnë si nuk pushon populli, të flejnë si nuk flen populli. Të gjitha këto ndryshime sasiore çuan në ndryshimet cilësore dhe bënë që ish partizanët legjendarë ta ndërrojnë mënyrën e tyre të të menduarit dhe ëndërruarit. Nëqoftëse sot Veselin Gjuranoviqi, Rade Galebi, Boshko Kruniqi, Marjan Rozhiqi, Peko Dapqeviqi, Jure Biliqi etj. thonë ndonjë fjalë që u therrë në zemër punëtorëve në fabrika e bujqve në ara, të gjitha këto ne nganjëherë mund të na duken si manifestime të një "sëmundjeje të vjetër" që lajmërohen nganjëherë tek njeriu i "shëruar".

Se sa e rrezikshme dhe e lehtë bëhet ndërrimi i mënyrës së të menduarit nga ndryshimi i mënyrës së të jetuarit do ta provojmë me dy shembuj të thjesht.

I pari: Familja e një shoku, në shkollën e mesme, para disa muajsh, i binte atëherë, kishte blerë një televizor. Shoku im i klasës i cili e përcillte shumë Hajdukun dhe Jugoplastikën, gjithë pushimeve në mes orëve na fliste se kush është fajtori për humbjen dhe ai më i merituari për fitoren, dhe kërkonte mendime nga të tjerët. Kështu ky iu kishte tekë shokut të vet të bankës se a e kishte parë ndeshjen, derisa një ditë ai u detyrua t'i thotë se nuk e kishte parë pasi nuk kishte televizor. Pra ai kishte harruar plotësisht se atë ditë që kishte blerë televizor familja e tij, nuk kishin blerë edhe të tjerët.

I dyti: Po një shokë i shkollës, i cili vraponte pas konkurseve për t'u punësuar si teknik në një kombinat të madh të Kosovës, pasi ka qenë nxënës shumë i mirë dhe me gjendje të keqe ekonomike, kishte marrë premtime nga ish profesori se do ta ndihmonte. Shoku ishte nga një fshat i thellë malor ku nuk kishte rrymë. Atij për çdo ditë i duhej të bënte nga disa kilometra rrugë deri sa të vinte në qytet për të marrë vesh çdo të bëhej me lutjen e tij. Dhe po të dihej se do të pranohej, ai do t'i harronte të gjitha. Një ditë profesori i thotë: Nesër do të merret vesh, nuk ke nevojë të vish deri tek puna ime, por ma jep numrin e telefonit e të lajmëroj. Iu deshtë shokut një debat i gjatë për ta bindur profesorin se nuk kishte telefon.

Neve serbomëdhenjtë na kanë mbyllur dhe nuk kemi pasë mundësi të zgjedhim rrugën tonë. Ne vetëm kemi dëgjuar kur në stacione të ndryshme na kanë thanë: Dushan Mugosha e shprehu vullnetin tuaj e jo ndonjë shqiptar, foli, jo në Prizren, po në Beograd. Qitni armët. Vetëqeverisja. Ligji i punës së bashkuar. Programi i stabilizimit. Ne nuk shihnim asgjë. Kur britmat tona ua shurdhuan veshët e shurdhër, thanë: U mjafton autonomia, dhe flamuri me të cilin derdhët gjakun deri në Trieshtë. Por serbomadhi ne nuk na u hoq nga shpina. Ju popuj të Jugosllavisë lirinë e shihni të realizuar vetëm përmes republikave tuaja, vetëm përmes tyre ju e ndieni vetën më të siguruar nga unitarizmi serbomadh. Ky ligj na çon peshë edhe ne për Kosovën Republikë.

* * *

Pas realizimit të Kosovës Republikë, populli ynë nga fushëgropa e autonomisë, fushëgropë në të cilën serbomëdhenjtë me të gjitha forcat po luftojnë që ta shndërrojnë në varr, do të ngritet në atë rrafsh lirie që quhet REPUBLIKË. Atëherë nga ky rrafsh, ne nga Kosova jonë do të kemi një panoramë krejt tjetër të botës dhe të Jugosllavisë. Atëherë nga rrafshi ynë nuk do të shohim vetëm Centralni Zatvorin e Beogradit, nuk do të shohim

vetëm Beogradin e Karagjorgjeviqve, Obrenoviqve e Rankoviqve por do të shohim edhe Beogradin tjetër të çekanit, do të shohim edhe Beogradin e Dimitrije Tucoviqit, Beogradin e qindra mijëra punëtorëve të cilët me njëmijë halle e presin fundin e muajit, fundin e ditës dhe agimin e mëngjesit, të cilëve sot Rankoviqët dhe pasuesit e tij, (në kongreset e LKJ, për ironinë më të madhe të njerëzimit kanë me u ngritë në Kongresin e XIII të LKJ dhe para fillimit të punimeve të tij kanë me e kënduar pa Internacionalen) përpiqen që rrënjët e fatkeqësive të tyre (punëtorëve të Beogradit) t'ua "zbulojnë" në Manastirin e Deçanit.

Do të shohim edhe panoramat e qyteteve tjera në Jugosllavi. Atëherë ne do të shohim se si është Nju Jorku e Moska, Tokioja e Parisi, Stockholmi e Johanesburgu. Atëherë në antenat tona, të vendosura sot poshtë, nuk do të regjistrojmë vetëm luftën e zezakëve të Afrikës së Jugut, demonstratat në Santiago, dhe krismën e bombave në Irlandën e Veriut. Atëherë antenat e larta të Republikës së Kosovës do të regjistrojnë edhe lëvizjet e mizave.

Çfarë janë pozitat e klasës punëtore në Jugosllavi, çfarë forcash janë në konfrontim, sa janë përmasat e këtij konfrontimi, se çfarë kahje ka marrë zhvillimi i ngjarjeve në Jugosllavi, ne tani në vorbullën e autonomisë është vështirë ta dimë, sepse e pamura jonë tani është e dobët. Megjithatë, nga dobësia e të pamurit e nga uria jonë, na janë zhvilluar më shumë ndoshta se tek tjerët aftësitë e të dëgjuarit, dhe po të themi tani për tani më shumë, ka mundësi që: ose ne nuk do të na besojnë, ose zëri ynë i lirisë nga poshtë gjatë ngritjes nëpër muret që na i kanë vënë përreth serbomëdhenjtë me shumë pengesa, të deformohet dhe internacionalizmin tonë ta deshifrojnë para popullit të vet dhe opinionit ndërkombëtar si nacionalizëm.

Si janë duke u zhvilluar këto procese këtë më mirë mund ta dinë ata që janë në rrafshet e Republikave të tyre. Ne u drejtojmë zërin tonë të gjithë punëtorëve të Jugosllavisë: Zgjatnani dorën tuaj që të vijmë edhe ne tek ju, dhe atëherë ne me të vërtetë do të jemi me ju. Indiferentizmi juaj ndaj nesh do të jetë humbje e rëndë si për ju ashtu edhe për ne.

Klasa punëtore e Kosovës e ngritur dhe e fuqizuar në Republikën e Kosovës do të jetë një aleate e sigurt e klasës punëtore të Jugosllavisë dhe gjithë botës. Se si do të zhvillohet lufta e kësaj klase, në cilat faza të kohës ç'rrugë organizative do të ndjekë këtë ne tani nuk mund ta dimë. I gjithë problemi për ne në mërgim qëndron, që të mos harrojmë për asnjë çast se cilës klasë i takojmë, dhe në mullirin e cilës klasë do të çojmë ujë. Kjo është puna kryesore e të gjitha punëve. Të gjitha të tjerat do të zgjidhen me mënyra e rrugë të pakufizueshme praktike fare lehtë po e lidhëm gjithçka me interesin e klasës.

Kjo do të ishte përgjigja jonë në pyetjen se çdo të bëjmë ne, deri në realizimin e kërkesës Kosova-Republikë dhe pas saj. Me hipoteza, me premtime, me ëndrra karrieriste, me rrahje gjoksi se "me nënshkrim timin nuk ka me u pushkatue askush", "se unë nuk kam besim të punoj me filanin në një ministri", se këto do të bëhen pas një muaji, e këto pas pesë vitesh, se ky apo ai vend do t'i takoj heroit të vetëshpallur, me të gjitha këto fëlliqësi punëtorët e ndërgjegjshëm duhet t'i lënë të merren elementët me njëqind fytyra.

Kështu pra, i shohim ne çështjet që shtruam në këtë artikull. Kthimi dhe lidhja sa më e fortë me klasën të cilës i takoni, ja receta jonë, ja ilaçi ynë që ua rekomandojmë shokë mërgimtarë për të ju shpëtuar nga frika ngjitëse e sharlatanëve. Provoni t'i merrni këta hapa dhe me siguri do t'u kthejnë qetësinë e gjumit dhe ju më nuk do të shihni ëndrra të liga por do të shihni ëndrra të kuqe. Dhe atëherë kur ju do të ktheheni në taborrin e klasës suaj, lufta për liri kombëtare e lidhur pazgjishmërisht me lirinë e të gjithë shokëve

tuaj nëpër botë, do të jetë për ju kënaqësia më e madhe. Atëherë tek ju do të kthehet gazi, freskia dhe fuqia e cila do t'u shtohet gjithnjë e më shumë.

Nuk ka gjë më të vështirë, më të mundimshme e më të poshtër se lufta!

Shumë e poshtër është lufta në terrenin e fushës mikroborgjeze. Të luftosh në këtë terren do të thotë të bësh një jetë në ankth, do të thotë të luftosh deri sa ta humbësh kokën a ta thesh qafën, sipas parullës: Ja ai-ja unë, ose-ose, "ili-ili". E drejtë, me të vërtetë duhet të pranojmë se e poshtër dhe e fëlliqur është lufta në këtë terren, por s'kemi ç'të bëjmë, e tillë është jeta e shtresave dhe rrjetave dyfytyrëshe, e këtyre "pleqnarëve të mesit të art", e tillë është pozita e tyre klasore në mes "dy zjarreve".

Nuk ka gjë më të ndershme, më fisnike, më të ndritshme se lufta!

E këndshme, fisnike, e ndritshme është lufta në terrenin e klasës punëtore. Të luftosh në këtë terren do të thotë të jetë plotësisht i lirë nga fëlliqësitë e dyfytyrësitë. Të luftosh në këtë terren do të thotë të luftosh sipas parullës: ose na (të shtypurit e gjithë botës) ose ata (shtypësit e gjithë botës). Në këtë terren ka vetëm një vijë, ka vetëm një këndvështrim me të cilin merret pjesë në zhvillimin objektiv të këtyre ngjarjeve. Në këtë terren kanë shkëlqyer element me prejardhje borgjeze, por të cilët në luftë për çlirimin e klasës punëtore kanë mësuar nga ajo, e kanë përgjithësuar përvojën e veprave të saj, dhe vetë kanë rënë në terrenin e saj. Pikërisht nga kjo shtresë, klasës punëtore i kanë ardhur në ndihmë ideologët më të shquar të saj, të pajisur me një kulturë të lartë dhe një dije gjeniale, dhe të cilët gjatë luftës së tyre nëpër dekada u transformuan plotësisht duke marrur vetitë e klasës për të cilën sakrifikuan gjithçka. Disa prej këtyre ideologëve kanë pasur rastin të bëhen edhe "mbretër të kuq e të përjetshëm", siç do të shprehej ndonjë liberal yni me kasketë marksisti.

Cili është kursi i anijes sonë dhe cili është ekuipazhi i saj?

Kjo është rruga jonë. Ky është kursi i anijes tonë të cilin e mbajtëm në ndeshje me të gjitha dallgët, në të gjitha mjegullat në të gjitha zonat e "zërit të sirenave". Dhe pas të gjitha këtyre furtunave po e shihni se nuk dolëm të gabuar. Anija jonë e vogël, e shigjetuar, e goditur me njëqind predha, me shumë kapedanë të vrarë e të burgosur erdhi në një port të sigurt dhe bëri mbarimin e ciklit të parë historik të udhëtimit të saj, të cilin ne nuk do ta harrojmë kurrë. Për në këtë port të Marksit e të Leninit, ishin mësyrë shumë shokë tanë të vrarë e të burgosur. Në këtë port me plotë guxim mund të themi se në maj të vitit 1985 na ra nderi që për një kohë të shkurtë, të ndalemi për një pushim, (para se të nisemi në betejat më të mëdha), ne, fraksioni i LRSSHJ-së që nxjerrë "Zërin e Kosovës" me adresë në Suedi.

Para se të hyjmë në këtë port dhe të lëshojmë spirancën, ne rojtarëve të portit, të cilëve nuk mund t'u hedhë pluhur syve askush, do të duhet t'u japim një informatë të saktë mbi ekipin e anijes sonë. T'i bëjmë një inspektim anijes sonë në sy të ideologëve tonë. Atyre u intereson kjo gjë.

Në anijen tonë gjenden:

Grupi i parë: 40 veta. Kush jeni ju?

-Ne, të gjithë jemi punëtorë edhe fshatarë, të cilët i kemi lënë familjet tona dhe kemi ardhur në Evropën Perëndimore që t'u sigurojmë bukën e gojës. Askush si ne nuk e ka ndier peshën e robërisë nën shovinistët serbomëdhenj. Gazetat që na i keni dërguar na janë dukur se luftojnë me gjithë mend kundër shovinizmit serbomadh. Me ua thënë të

drejtën shumë gjëra nga ato që keni shkruar nuk i kemi kuptuar gjer në hollësitë. Bile shpesh ju kemi shkruar edhe letra se nuk na vjen mirë për disa polemika që po bëhen në faqet e saj. Ne kontakte me të tjerë aq edhe nuk kemi pasur. Me ju jemi pas takuar së pari, e adresat tona vetëm ju i keni ditur. Ju kemi ndihmuar materialisht, kemi ardhur bashkë me ju në demonstrata e në aktivitete të ndryshme. Kur keni pas ndonjëherë nevojë ju kemi përcjellë nëpër kufij të ndryshëm, apo ua kemi dhënë pasaportat tona. Të gjitha këto i kemi bërë me shpresë se ndihmën po e japim në vend të mirë.

Grupi i dytë: 10 veta. Ju kush jeni? A e dini se ku ndodheni?

-Si, nuk po na njeh?! Ç'tu paska rritur mendja. Po kemi qenë fqinjë, kemi qenë në shkollë bashkë, i kemi pasur livadhet afër. Kemi besuar se e keni drejt, por në ne ka ndikuar afërsia e njohjes së vjetër.

Grupi i tretë: 10 veta. Po ju?

-Ne njëherë kemi folë. Mirë mirë, keq keq, kemi thënë se së bashku do të luftojmë, pa të del ku të del!

Grupi i katërt: 5 veta.

-Ju?

-Ne kemi kryer aksione të ndryshme. Që prej kohësh kemi qenë në korrent të shumë gjërave. Ne kemi shpërndarë njëherë "Komunikata të Komitetit Qendror". Nëpër prova të shumta kemi kaluar, të infektuar me frymë të shpirtngushtësisë kurrë nuk kemi qenë. Jemi ata të radhës së parë që me këtë gazetë kemi ardhur deri në këtë pikë, duke ndihmuar me të gjitha mundësitë dhe aftësitë tona.

Grupi i pestë: 3 veta. Po ju, a e dini se ku gjendeni? Se në çfarë porti keni ardhur? Se çfarë flamuri ka anija jonë?

-.....

Këta po heshtin. Çudi pra. Të gjitha rrobat sikur tonat i kanë. Edhe në kokë nganjëherë një kasketë e qesin. Kushedi, për modë. Po na luten që të mos u themi se kush janë, por që në të vërtetë edhe ju, sidomos ata të grupit të parë menjëherë t'i njohin këta tre veta e kanë pak të vështirë, bile në fillim edhe mund të çuditen. Por këta nuk flasin si ne. Këta nuk e dinë gjuhën tonë. Këta në gjuhën tonë flasin me një tonë fals dhe shumë metalik, vetëm sa për demagogji, për përfitime, për histori.

Le t'u drejtohemi tani të gjithëve me radhë, me një fjalë rasti dhe le të dëgjoj Lenini se si do të merremi vesh.

Ju shokë të grupit të parë, duhet ta dini se ne luftojmë për atë ditë kur nuk do të ketë në asnjë vend burgje, as ushtri, as polici, as kufij në mes shteteve. Kur të gjithë popujt do të jetojnë të vëllazëruar në mes veti. Kur njerëzit do të punojnë sipas mundësive të tyre dhe do të marrin sipas nevojave. Ne luftojmë që ta zhdukim dallimin në mes punës mendore dhe fizike. Deri sa të mbërrijmë në këtë ditë, derisa të vijnë të gjithë njerëzit në këtë port, në të cilin ju sollëm për një çast ne, është një rrugë shumë e gjatë që kërkon shumë mund dhe sakrifica, por të cilat ne nuk do t'i kursejmë. Ne tani kush më shumë e kush më pak e disponojmë një njohuri me të cilën nuk do të frikësohemi për të kthyer në furtunat më të mëdha të oqeanit.

Shokë të grupit të dytë, të afërm!

Ne tani afërsisë sonë do t'i japim një përmbajtje krejt të re, e cila ndryshon tërësisht nga ajo e mëparmja. Ne këtë afërsi do ta shikojmë me një prizëm tjetër. Deri më tani kemi qenë më shumë afër nga këmbët, nga trupi, nga duart, kurse tani do ta vejmë në provë afërsinë tonë edhe nga mendimi, nga bindja, dhe këndvështrimi i problemeve dhe i situatave të vështira me të cilat jemi të vetëdijshëm se kemi me u ndeshë. Dhe pikërisht se ne po zgjedhim një rrugë të vështirë por të drejtë, ky testim i afërsisë dhe ky paralajmërim bëhet i domosdoshëm. Dhe ja ku po ua themi se ne shokë dhe të afërm,

fqinjë të përjetshëm dhe të dashur jemi me ata që do të arrijmë në konkluzione të njëjta për çështje të ndryshme qoftë ky dajë, fqinjë i parë me një mur në mes, fqinjë në një ndërtesë shumëkatëshe, apo qoftë ky fqinjë edhe në Argjentinë apo Zelandë të Re.

Ju shokë të fjalës duhet të mësoheni se nuk bënë t'i japim fjalën çdo kujt. Ne do t'u japim fjalën e nderit e idealeve tona, mësuesve tanë të cilët na e treguan rrugën, të cilët na bënë të fortë, e të pathyeshëm. Tani më ju nuk keni nevojë të thoni; të del ku të del. Për ku jemi mësy po e shihni. Hapni sytë, mësoni t'i lexoni koordinatat se si jemi duke e mbajtur kursin, dhe ta ruajmë këtë kurs së bashku.

Ashtu është. Ju shokë të grupit të katërt keni bërë punë të mëdha, po shpërndatë edhe disa "komunikata". Se bilanci i punës suaj ka një vlerë jashtëzakonisht pozitive, është punë e padiskutueshme. Ne kemi menduar t'i injorojmë disa gjëra, por nuk mundëm të ndalemi pa folur. Kishim tri pikëpamje që na thonin se do të mbërrijmë gjerë në Republikën e Kosovës. Ne pikëpamjet tona i kemi shprehur hapur, kemi qenë të bindur se pikëpamja jonë është më drejta. Këtë tani po na e provon edhe koha e realiteti se ne e kishim më së drejti. Atëherë ju pyesim; si ka mundësi që një pikëpamje e drejtë të fitoj terrenin nëqoftëse nuk lufton kundër çdo pikëpamje të gabuar, sado të shumta që të jenë ato, sado të forta (në pamje të parë) të duken ato?

Ja në fund po merremi edhe me këta tre të grupit të fundit. Ju të tre 'shokë' nuk i keni pikëpamjet tona. Ju nuk e keni mënyrën e të menduarit sikur ne. Ne përfundimisht mbrojmë interesa të ndryshme. Ju gabimisht i keni marrur emrat tanë. A se shihni se të gjithë po qeshin. Ju erdhët me ne sepse menduat se në mjedisin e Kosovës ne jemi më të shumtë. Por kjo juve nuk duhet t'u prishë punë. Ju sot jeni në fuqi, keni shokë më shumë në pushtet në të gjithë botën. Keni raketa. Keni më shumë para. Nejse gabuat. Po po, gabon njeriu. A e shihni, këta shokët më lartë asnjë nuk ishte i pastër si loti, e pa gabime, apo të qartë deri në pikën e fundit. Por ja që me ta u morëm vesh shumë lehtë vetëm me fjalë. Kurse me ju nuk mund të merremi vesh me fjalë, megjithëse ju thoni se keni liri, demokraci etj. Ju na shani se pushkatojmë njerëz të pafajshëm e pa gjyq, se i "vrasim shokët" (sic), e çka jo. Por ja që ne nuk jemi të tillë. Ne jemi më të mirët, ne jemi ata që do të ndërtojmë lirinë e vërtetë. Nëqoftëse iu vjen fjala agjent tepër e rëndë, atëherë mos u afroni me ne, mos i veshni rrobat tona, lene kapelën me yll në vendin e vet, dhe ne atëherë nuk do t'iu themi agjent. Atëherë ne me të vërtetë do të mund t'ju quajmë me tjetër emër. Ne pushkatojmë njerëz pa gjyq! Gënjeshtër. Ne bëjmë gjyqe të hapura. Ne ju kemi dënuar me vdekje. Natyra ju ka dënuar me vdekje, kurse ne do të jemi vetëm ekzekutorët e dënimit. Gjyqin e hapur ua kemi bërë më 1848. Kurse për herë të parë në bankë të zezë iu kemi qitë më 1871 në Paris. Prandaj këtu nuk ka asgjë të fshehtë, këtu nuk ka asnjë befasi, këtu nuk ka asnjë skandal nga ato që ndodhin për çdo ditë tek ju. Kur do të ekzekutohet dënimi ndaj jush, këtë e keni në dorën tuaj, kjo do të varet prej poshtërsisë suaj. Nëqoftëse do t'u mbushet mendja më shpejt me jetue si ne, ju do të vdisni me më pak dhimbje. Nëqoftëse do të përpiqeni të bëni rezistencë më të madhe atëherë edhe metodat tona kundër jush do të jenë më adekuate. Por kjo luftë kundër jush në shtete të ndryshme do të ketë forma të ndryshme. Ne do të mësojmë se si t'ju dënojmë dhe zhdukim nga ato vende ku sot jeni të mundur. Por ama edhe ju nuk duhet të bëni sehir. Edhe ju duhet të mësoni se si është më lehtë me vdekë. Kjo është në interesin reciprok apo jo?!

Tani çfarë të bëjmë me këta tre, kur veç ua komunikuam gjykimin, se cilat mendimet tona, mendimet tona të sinqerta për ta?

Këtyre po u japim të zgjedhin dy rrugë:

-Ose brenda një afati prej një muaji të largohen nga anija jonë dhe të gjejnë shokët e tyre dhe atëherë kur të ndeshemi herën tjetër flasim nga pozitat ashtu siç jemi me të

vërtetë të dy palët, ose të qëndrojnë këtu. Nëse qëndrojnë këtu prapë i paralajmërojmë për dy mundësi të përfundimit të tyre:

E para. Këta njerëz të cilëve kurrë nuk u besojmë, do t'i detyrojmë të punojnë nëse duan të jetojnë me ne. Në atë moment që ta ngrenë dorën kundër nesh, të pushkatohen menjëherë në vendin e krimit, pasi formalitetet e gjyqit i kryem që tani.

E dyta. Këta e kanë mundësinë të jetojnë midis nesh. Gjatë gjithë kohës deri sa të vdesin nga pleqëria (nëse rrinë urtë) ne do t'u vejmë një njeri që t'i ruaj e t'i ketë nën mbikëqyrje.

Me të gjithë shokët e lartpërmendur u morëm vesh. Të gjithë janë të bindur se ata më kurrë në jetën e tyre nuk do të gabojnë rëndë. Ata janë trima të mëdhenj për të bërë autokritikë, andaj edhe nuk do të gabojnë më sepse kurrë nuk kanë bërë gabime me qëllime të ulëta e me dredhi si ju.

Po këta tre të fundit mund të na thonë se edhe ne po bëjmë autokritikë. Kjo është demagogjia e tyre më e rrezikshme në të cilën nuk guxojmë të biem. Këta nuk kanë gabuar nga ndërgjegjja e pastër. Këta kanë gabuar sipas një “vendi që u takon”. Çfarë vendi është ky që po u takoka? Kush ua paska lënë me tapi atë vend?

-Ah po, po! Këta janë djemtë e “mëdhenj e me stazh", “djemtë e vyeshëm të Haxhi Babës" i cili këtyre ua la zotshpillakun, se këta janë më të pjekur, se kanë pas rast me pa çka nuk kemi pa ne. Prandaj këta edhe autokritikë kur të bëjnë duhet ta keni të qartë se këtë do ta bëjnë gjithmonë sipas vendit që u takon. Këta gjithmonë do të gabojnë e do të luajnë me ne derisa t'i vendosim në vendin që u takon.

A ka mbetur ende diçka tjetër pa u thënë?

-Kush je ti?

-Unë!

Ku na doli prapë në rrugë ky "Uni" i poshtër i vetës së parë. Edhe me këtë lloj "uni" do t'i qërojmë hesapet mirë e mirë. Edhe në këtë fushë do t'i vëmë fëshisën mykut rrenacak të njëqind fytyrave.

Në "mesin e art" nuk ka kurrfarë rregulli. Aty zhvillohet tregtia më e madhe e ideve dhe e parimeve në botë. Aty secili mundohet të vjedhë sa më shumë prej njëri tjetrit. Propozimet nuk e presin njëra tjetrën. As nuk dihet se kush i bënë, e as në emër të kujt i bënë, e për materializmin e tyre të mos flasim fare. Po ua jap një shembull të thjesht, por shumë kuptimplotë, për të kuptuar se si manovron mikroborgjezi me fantazinë e tij: Ai pra është njeri që libra nuk lexon, por ide i duhet të jap. Kur të takohesh me te, je i detyruar të ndahesh me përshtypjen se deri në atë ditë ke jetuar kot. Mikroborgjezi i shkretë jeton me thashetheme. Çka ndodhë me te në shumë raste. Ai sillet në rreth të mbyllur. Përsëritë thashethemet me kend të takohet. Ndodhë që një mendim të cilin e ka dëgjuar prej teje, vetëm pas dy orësh të kthehet ty, duke harruar se e ka dëgjuar prej teje, fillon të të mbaj ligjërata se si i ka pjellur një ide.

Kjo mund të thoni ju s'është edhe aq tragjike, bile mund të më qortoni se pse merrem me cikërrime të tilla. Keni të drejtë, po të ishte vetëm kjo, me të vërtetë kjo do të ishte vetëm një komedi. Por të gjitha punët e tyre në këtë formë zhvillohen, dhe këtu qëndron fati tragjik i psikologjisë së tyre. Nëqoftëse del ndonjë e mirë (nëse mund të bëjmë fjalë për punë të mirë tek këto shtresa) atëherë këtë e ka bërë "uni". Po nëqoftëse del keq atëherë këtë e bëri jo "ne apo uni" por "ju" që nuk e kuptuat thelbin e idesë së "unit".

Për raportin "unë-ne", do të flas në ndonjë rast tjetër. Por, neve na e pohuan me gojën e vet kundërshtarët dhe na thanë se nuk jemi të sëmurë nga liderizmi, se qëllimi ynë nuk është që të udhëheqim me çdo kusht. Por ata na ngjitën bishta në qëndrimet tona. Jo karrierizmin tonë ata u përpoqën ta shpjegojnë si njerëz me “kompetencë”, me baza, bile “shkencore”.

Çka na thanë?

Një palë: Ju nuk jeni për liderizmin, për krye të oxhakut, se kështu ju mësoi udba!

A ua provuan gjatë gjithë këtij shkrimi se kjo nuk është e vërtetë?! A ua provuam se nëqoftëse udbës nuk do t'i mbetej rrugë tjetër për të zgjedhur pos pikëpamjeve tona në mërgim, atëherë cilën rrugë e cilën propagandë do ta pëlqente më tepër? A ua provuam se ne jemi shumë më afër mendimeve të Bajrush Xhemailit dhe Zijah Shemsiut? Këto të gjitha ua provuam.

Nëse nuk jeni të dirigjuar prej udbës, atëherë nuk jeni të qartë? Nuk dini çka kërkoni! Nuk keni "radni stazh" sa duhet! Jeni të ngatërruar!

A ua provuam se përkundër mungesave të mëdha, jemi shumë më të qartë se "vëllaznit e mëdhenj", "djemtë e vyeshëm të Haxhi Babës"? Këtë ne ua provuam. Këtë tani nuk ka fuqi askush ta mohoj dhe ta provoj të kundërtën. Këtë e panë të gjithë.

Dhe kur falimentuan në këto dy pikëpamje, çka po na thonë tash? Tash po na thonë: Drejt e paskeni pasur, por a nuk kishte tjetër mundësi pos asaj që e zgjodhët duke u ndarë më vete? Përkundër drejtësisë suaj mos në bilancin e përgjithshëm kjo punë çoi më shumë ujë në mulli të armikut tonë shtypës sesa popullit tonë të shtypur? As kjo nuk është e vërtetë. Këtë do t'ua provojmë herën tjetër, pasi do të na duhet të ndalemi më gjatë në këtë temë. Le t'u mjaftoj kësaj radhe edhe kaq.

Edhe për vete do të flas. Nuk ma merr mendja se në bazë të kësaj çka kam thënë gjerë më tani të më mbani për gënjeshtar. Do të njihemi me të vërtetë shumë më mirë se sa jemi njohur deri më tani. Edhe me 'shokët e partisë” do të njihemi në mënyrë të sinqertë.

Tani kemi lënë mbrapa jo thashetheme, por një etapë të tërë. Prapa kemi lënë të burgosur e të vrarë. Tani do të shohim në çdo imtësi se çka kemi mësuar për katër vjet. Tani ne do t'i shohim të gjithë hapat që kemi lënë pas dhe me një mënyrë më të plotësuar dhe të sistemuar të të menduarit po ju garantoj se do t'i dimë të gjitha fazat e kaluara. Natyrisht se duhet të fokusohemi në mbrojtje nga shovinizmi serbomadh. Por po ju pyes a e dini ju se sa ditë ne i kemi matur forcat me shovinizmin serbomadh?

Po e marr vetëm kohën prej vitit 1981. Ne me shovinizmin serbomadh jemi matur shtatë ditë. Prej të enjtes së fundit të marsit gjerë në të premten e parë të prillit 81. Pra këto janë ditët kryesore të luftës sonë ballë për ballë me shovinizmin serbomadh. Kundër shovinizmit serbomadh ne kemi luftuar edhe nëpër sheshet e Evropës, por për sa kohë; Nga një orë, më së shumti dy. Në këto ditë, ne i kemi mbledhur forcat tona, i kemi renditur në rresht dhe jemi mësyrë. Në momentet e sotme kur nuk jemi ballë për ballë me shovinizmin serbomadh, kush është armiku ynë kryesor? Tani për tani armiku ynë kryesor janë çështjet tona të brendshme të pazgjidhura që kanë të bëjnë me organizimin dhe gjithçka që është e lidhur me te.

* * *

Tani ne po e shohim të gjerë horizontin. Tani mendimet tona do të jenë shumë më të liruara, më të rrjedhshme, më të kuptueshme. Tani mendimet tona më nuk do të kenë asnjë dredhë sado të vogël të mbeturinave mikroborgjeze. Tani ne do të kthehemi menjëherë në det dhe do të luftojmë krah për krah me ata të cilët na sollën deri këtu. Tani ne u kemi borxh atyre. T'ua kthejmë borxhin dhe të fusim të tjerët në borxh. Tani ne nuk

kemi sekrete puçiste. Anija jonë është e tejdukshme dhe këtë ka të drejtë ta shikoj çdokush, por askush nuk do të ketë çka t'i bëjë! Kjo është pathyeshmëria e ideve tona!

Tani ne, o të dashur bashkëluftëtarë besnik mund të diskutojmë çka të dëshirojmë.

A dëshironi me diskutua për përsosjen e programit?

A doni të diskutojmë për emrin e organizatës?

A doni të diskutojmë për emrin e gazetës?

Për çfarë dëshironi, ne do të flasim.

A po e kuptoni tani, se në çfarë rruge jemi, e sa trima e të fortë jemi? Kjo pra është gjuha jonë. Gjuha e simpatizuesve të "mbretërve të kuq". Në këtë gjuhë na marrin lakmi edhe simpatizuesit e "luftës së të kundërtave të tyre", por ata këtë gjuhë nuk dinë me e mësua, edhe pse siç po e shihni ne flasim ndërsy tyre dhe të gjithëve.

Çlirohuni! Merrni frymë lirisht! Rrugë të gjatë kemi bërë. Na lejohet një frymëmarrje e thellë në ajër të pastër. Na lejohet t'ia themi një kënge me sa fuqi që kemi. T'i shërojmë plagët tona në ajër të pastër, le t'i shohin plagët tona të gjithë! Të veshim rrobat e pastra për betejat e reja. T'i ngjeshim shpatat të cilat në çdo betejë veç sa kanë me na u mprehë më shumë. Të shkojmë në vendet më të rrezikshme, në valët më të tërbuara, sepse këtë tani na e mundëson qartësia e jonë! Tani i dimë përafërsisht të gjitha pritat ku na kanë vrarë! Tani i dimë të gjitha kthesat ku shumë shokë na kanë mbetur në rrugë, të mashtruar.

Ah, në këtë luftën finale, me këngën e të gjithë punëtorëve të botës në gojë, e pakufishme le të jetë kënaqësia jonë!

Kosova do të bëhet Republikë!

Socializmi do të fitoj në gjithë botën?

(Skicat e këtij punimi i kam bërë gjatë qëndrimit tim në Paris, (Zëri i Kosovës, Maj-qershor 1985, Stockholm)

25. ÇESHTJE RRETH BASHKIMIT

Bashkimi bënë fuqinë! Trimi i mirë me shokë shumë!

Sa herë i kemi dëgjuar këto shprehje, sa herë e ka provuar jeta vërtetësinë e tyre edhe tek populli ynë. Për bashkimin e popullit shqiptar është folur shumë, për të është folur vazhdimisht, për të po flitet edhe tani. Flitet për bashkimin sa më të ngushtë rreth "Kosovës Republikë", po flitet për një bashkim sa më optimal të atyre forcave që veprojnë në emrin e kësaj kërkese. Për bashkimin e forcave të organizuara ilegale tek ne është shkruar edhe në shtyp.

Është edhe një e vërtetë e hidhur në këtë drejtim, se më shumë se sa është punuar për ushqimin e një bashkimi, me poza megalomane është bërë zhurmë e madhe për veprat e mëdha e sakrificat e ndonjë personi se si ka bërë shumë për bashkimin! Si është realizuar ky bashkim, cilat janë gjithë ato iniciativa historike që janë marrë, çfarë gjurmësh të këtyre iniciativave do të mbesin të fiksuara, që do t´i bëjnë ballë kohës, këtë gjë iniciatorët e nderuar e kanë vështirë të na e thonë, dhe jo vetëm që nuk kanë marrë mundim të na qartësojnë, por si duket ata as që janë fare të ndërgjegjshëm se me ato që thua duhet t´i mbushësh mendjen dikujt.

Për bashkimin po flitet kohëve të fundit nëpër disa qytete të Evropës Perëndimore. Disa thonë do t´i bashkojmë të gjithë! Të tjerë ua presin se do të bashkojmë masën pa krerët, se masa nuk bënë të përçahet! Të tjerë thonë se masën do ta tërheqim pas vetes, se duhet të tjerët të bëjnë autokritikë tek ne. Me çështje që kanë të bëjnë me bashkimin e forcave të organizuara jashtë, do të merremi në artikullin e mëposhtëm. Gjatë leximit të

tij e paralajmërojmë lexuesin se prania e madhe e shpjegimit të ngjarjeve në bazë të kujtimeve është pasojë e mungesës së dokumenteve pasi shumë gjëra kanë mbetur pa u shkruar. Futja e disa elementeve letrare është bërë me qëllim që problemi në fjalë të kuptohet nga një pjesë sa më e gjerë lexuesish. Sikur të ishin kushtet më të mira ky artikull do të dilte më i plotë dhe i ndarë në kapitujt e tij më qartë. Kjo punë ndoshta do të bëhet në një rast tjetër, ndërsa shkrimi i tij dhe hedhja në dritë e këtyre fakteve ka për qëllim të shpjegoj disa çështje të ngutshme pothuaj të karakterit praktik.

Është e qartë se për disa veta e vërteta është gjithnjë e hidhur. Ata mund të çirren për dekonspirim gjërash e përralla të ngjashme. Dhe kush janë këta? Pikërisht ata intrigant që farën e përçarjeve me viktimat e tyre e kanë nisur në stilin: ”Si, nuk të paskan tregua ty a?!”, ”Si mos me të besua ty!”, ”Të poshtëritë e kanë pasur veç sa me të shfrytëzua!”, ”Nuk ta kanë dhënë hakun!”, ”Ti je i denjë për kryetar sindikatash, anëtarë të Komitetit Qendror, ministër!”

Është e vërtetë se ne asnjë shoku premtime si ato të lartpërmendurat nuk u kemi dhënë, ndërsa për atë se kush bënë dredhi në kurriz të shokëve të vet mund të konkludohet edhe nga ky shkrim.

Gjatë veprimtarisë sonë në organizata politike kemi hetuar dy lloj bashkimesh.

Bashkimi i llojit të parë

Ky është bashkimi më i lehtë, më i shkurtër, që kërkon më pak mund, bashkim që nuk kërkon shumë kohë dhe i cili nuk ka nevojë për shumë njerëz (por ”konspiratorë” të fortë). Ky lloj bashkimi është bashkimi i krerëve në të cilin sintetizohen të gjitha vetit e frymës së grupeve. Frymë e cila bënë be e rrufe se më nuk ka me u paraqitë me format e vjetra por ka me iu përshtatë edhe formës së re, se krahas emrit të vjetër ka me u shërbye edhe me emrin e ri.

Cilat motive i paraprijnë këtij bashkimi?

Motivet më të ulëta siç janë: përshtypja se historia u pasurua me datën më të rëndësishme që ka mundur ta mendoj ndonjëherë, demagogjia në kulm, dredhat e përdredhat e llojeve të ndryshme, mosnjohja reciproke apo vetëm e njërës palë, taktika e vënies para aktit të kryer, përzierja e ideve të ndryshme e të papajtueshme, tradhtimi i parimeve dhe një pajtim krerësh sa për sy e faqe. Ky bashkim mund të sjell ndonjë sukses afatshkurtër sidomos në ato raste kur lëvizja revolucionare është shumë e re për nga mosha (megjithëse protagonistët e këtyre bashkimeve gjithmonë thirren në përvojë dhe stazh të gjatë pune).

Ka raste që suksese çasti të arrihen me këso lloj bashkimesh. Këto bashkime nuk mund të kenë jetë të gjata. Këto janë karakteristikë e lëvizjeve dhe partive të reja politike që bashkëshoqëron fazat e para me rëndësi të jetës së tyre. Mund të quhen edhe bashkime të shkallës së parë apo bashkime të një shkalle më të ulët.

Bashkimi i llojit të dytë

Bashkimi i llojit të dytë ndjek një rrugë tjetër, një rrugë të diskutimit publik, një rrugë më të vështirë, më të ngadalshme, por shumë më të sigurt dhe më stabile dhe si bashkim i tillë ka jetë më të gjatë. Ky është bashkimi i udhëheqjes dhe i bazës i sheshimit të gjërave gjer në hollësitë. Këtij bashkimi i prinë një fazë e gjatë bashkëpunimi. Ky nuk është një bashkim çasti, një dëshirë e dikujt. Përmes bashkëpunimit provohet afërsia e ideve dhe e programit të përbashkët. Ky bashkim kërkon më shumë njerëz, publicitet dhe njohje nga të gjithë, kërkon që të jetë i çliruar nga të gjitha fëlliqësitë e konspiracionit të ndyrë. Ky bashkim u qëndron besnik parimeve dhe nuk vrapon pas sukseseve të çastit.

Si manifestohen disa vërejtje ndaj bashkimit të llojit të parë?

Tek realizimi i bashkimit të llojit parë kanë marrë pjesë një grup i vogël njerëzish. Kur të fillojnë me kutërbua të ”mirat” e bashkimit historik, protagonistët vrapojnë tek masa e befasuar dhe ”jokompetente” për ta bindur se kush është fajtori. Masa jo kompetente mund të përgjigjet: Kur ju jeni bashkuar ne nuk e kemi ditur, ju nuk jeni konsultuar me ne. Ju jeni bashkuar vetë në mes veti bile ”sinqerisht”, kurse tani drejtoheni tek ne. Sqaroni vetë konfliktet tuaja.

-Jo ne nuk po mundemi vetë!

-Atëherë ne nuk pranojmë të vihemi para akteve tuaja të kryera, para gënjeshtrave të reja që ju të ”sinqertit”, kur të prisheni prapë me njëri tjetrin të drejtoheni tek ne për ndihmë. Më nuk do t’ia bëjmë ashtu!

Kështu pra mund të duket dialogu me punëtorët këto ditë. Kështu mund t’i përgjigjen ata çdo iniciative të mëtejshme të bashkimeve (me nga tre përfaqësues) në kohën tonë të re me mbeturinat e iniciativave të së djeshmes.

Kur janë manifestuar tek ne elementet e rrugës së parë?

Janë manifestuar kah fundi i vitit 1981 gjatë bashkimit të Organizatës së Marksist-Leninisteve të Kosovës me Frontin e Kuq Popullor. Një nivel më i avancuar ku kemi edhe elementet e bashkimit të llojit të dytë është shfaqur në bashkimin e 17 shkurtit e 15 majit 1982.

A ka mundur të ndodhte ndryshe më parë?

Ndoshta ka mundur por probabiliteti ka qenë shumë i vogël.

Po a është në bilancin e përgjithshëm efekti pozitiv apo negativ që janë bërë disa bashkime jo të përsosura në krahasim me ecjen vetëm. Shumë më mirë që janë bërë disa bashkime me të meta por të cilat na kanë çuar mjaft përpara dhe na kanë përgatitur për bashkimet e reja, të cilat nuk mund të çanin kurrë rrugën e tyre pa bashkime të këqija.

Pra kurrë në të ardhmen nuk do të lejojmë që të bëhen bashkime si në të kaluarën. Këtë nuk e lejon vetë gjendja jonë. Bashkimet e viteve 1981 e 1982 janë bashkime që i takojnë etapës së djeshme.

Aktualisht nga tri kënde është duke u shikuar problemi i bashkimit, dhe secili këndvështrim e dëshiron një bashkim sipas mënyrës së vet. Tri apo katër nuanca që nuk e ndryshojnë thelbin e dy ndarjeve në fillim (të udhëheqësve dhe të bazës), hetohen në diskutimet e ndryshme për bashkimin e pajtimin e divergjencave të LRSSHJ.

Bashkimi i llojit të parë
Varianti i parë

Me gojë, me telefona, në diskutime me punëtorë në rrethe të ngushta në të cilat shprehen mendime se mund të bashkohemi sikur të tjerët të bëjnë autokritikë para nesh. Kjo do të thotë jo të bashkohemi por të na bashkohen.

Bashkimi i llojit të parë
Varianti i dytë

Përmes letrash, ”historike” dhe mundësisht sa më sekrete siç janë letrat e përfaqësuesve të PKMLSHJ të cilat po i botojmë.

Letra e parë:

Shokëve të LNÇKVSHJ 13 shkurt 1985

Në bazë të situatës aktuale dhe të kërkesave të masave për sanimin e marrëdhënieve në LRSSHJ, u drejtohemi me anën e kësaj letre përmes së cilës u ofrojmë edhe njëherë bashkëpunim dhe aktivitet të përbashkët duke u mbështetur në vendimet e 17 shkurtit 1982.

PKMLSHJ dhe LNÇKVSHJ si forca themeluese të LRSSHJ kanë përgjegjësinë historike për fatin e LRSSHJ. Andaj e shohim të arsyeshme që edhe njëherë t´i përtërijmë përpjekjet e sinqerta për mënjanimin e të gjitha pengesave përçarëse dhe të vazhdojmë luftën të bashkuar në LRSSHJ.

Të vetmin kusht që e shtrojmë është zbatimi i vendimeve të 17 shkurtit 82 në mënyrën më të përpiktë me forca të përbashkëta.

Njëkohësisht kërkojmë nga ju që t´i shtroni të gjitha vërejtjet tuaja në punën tonë nga bashkimi gjer më tani, dhe t´i jepni vlerësimet tuaja se si duhet gjykuar ato.

Jemi të gatshëm të përmirësojmë çdo lëshim që ka mundur të ndodhë gjatë aktivitetit tonë, të japim autokritikë dhe përgjegjësi konkrete, ashtu siç do t´i kërkojmë këto edhe nga të tjerët.

Kritizimet e pavenda do t´i luftojmë, ashtu siç do të jemi këmbëngulës në zbatimin e përcaktimeve themelore për çështje të atdheut.

Përgjigje në letër presim gjer më 15 mars 1985.

Përfaqësuesit e PKMLSHJ në LRSSHJ

Letra ka 5 nënshkrime tri prej të cilëve janë: Kushtrimi (Kushtrim Kosova), Halimi, Qemali. Të tretë pjesëmarrës të bisedimeve më 17 shkurt 82. Në mesin e të nënshkruarve është edhe Luani i Partisë "Komuniste" Nuhi Sylejmani.

Letra e dytë

Shokë të OMLK dhe LNÇKVSHJ

Pasi që në letrën tonë të afatizuar të 13 shkurtit nuk na erdhën përgjigjet nga ju, po e përshkruajmë tërësisht edhe njëherë përmbajtjen e kësaj letre dhe në përfundimin e saj do të bëjmë një shtojcë tjetër.

(përmbajtja e letrës tonë të 13 shkurtit 1985)

Shokë (të OMLK – të LNÇKVSHJ) 13.II.1985

Në bazë të situatës aktuale dhe të kërkesave të masave për sanimin e marrëdhënieve në LRSSHJ, u drejtohemi me anën e kësaj letre përmes së cilës u ofrojmë edhe njëherë bashkëpunim dhe aktivitet të përbashkët duke u mbështetur në vendimet e 17 shkurtit 1982.

PKMLSHJ, LNÇKVSHJ dhe OMLK, më pas, si forca themeluese të LRSSHJ kanë përgjegjësinë historike për fatin e LRSSHJ. Andaj e shofim të arsyeshme që edhe njëherë t´i përtrijmë përpjekjet e sinqerta për mënjanimin e të gjitha pengesave përçarëse dhe të e vazhdojmë luftën të bashkuar në LRSSHJ.

Të vetmin kusht që e shtrojmë është zbatimi i vendimeve të 17 shkurtit 82 në mënyrën më të përpikët me forca të përbashkëta.

Njëkohësisht kërkojmë nga ju që t´i shtroni të gjitha vërejtjet tuaja në punën tonë nga bashkimi gjer më tani, dhe t´i jepni vlerësimet tuaja se si duhet gjykuar ato.

Jemi të gatshëm të përmirësojmë çdo lëshim që ka mundur të ndodhë gjatë aktivitetit tonë, të japim autokritikë dhe përgjegjësi konkrete, ashtu siç do t´i kërkojmë këto edhe nga të tjerët.

Kritizimet e pavenda do t´i luftojmë, ashtu siç do të jemi këmbëngulës në zbatimin e përcaktimeve themelore për çështje të atdheut.

Përgjigje në letër presim gjer më 15 mars 1985.

Përfaqësuesit e PKMLSHJ në LRSSHJ
(fund i letrës së 13 shkurtit 1985)

Shokë,

Pas letrës së 13 shkurtit 1985 erdhëm dy herë në… dhe në rastin e parë u takuam me… ndërsa në rastin e dytë u takuam me shokun… Me këta shokë biseduam afërsisht dhe në mes neve pati një mirëkuptim vëllazëror. Megjithate ata nuk patën mundësi që të na përgjigjen për çështjet që u shtruam ne pasi ata deklaruan se nuk kanë kompetenca për përfaqësim. Mirëpo ne bisedum gjërësisht e shoqërishtë me ata dhe të gjithë i shprehëm mendimet tona duke u pajtuar me faktin se sanimi i marrëdhënieve dhe arritja e forcimi i unitetit janë të domosdoshme. Shoku… pos të tjerash i shprehu disa ide të veta mbi rrugën deri te ky qëllim, dhe ne pranë asaj që i paraqitëm qëndrimet tona të palëkundshme se do të qëndrojmë pranë Vendimeve Themeluese të bashkimit të LRSSHJ i premtuam se në ato ide do të përgjigjemi pas konsultimeve me shokët e bazës. Përgjigja jonë si tërësi është që para së gjithash çdo gjë duhet të fillohet nga vendimet e 17.II.1982 që ishin dhe mbesin kushte themeluese të bashkimit të LRSSHJ dhe që nga këto baza pastaj ka mundësi të bëhen edhe plotësime e ndryshime tjera. Edhe biseda që u zhvillua me shokun… ishte e frytshme, dhe ajo burrëri e tij dhe qëndrimi i tij se duhet të vazhdohet me zbatimin e vijës së LRSSHJ sipas vendimeve themeluese të bashkimit, na inkurajoi në rrugën tonë që të arrihet uniteti i plotë.

Ju komunikojmë edhe njëherë se qëndrojmi para asaj që u tha edhe në letrën e 17.II.1985, dhe nga ju kërkojmi që sa më parë të na paraqitni përfaqësuesit kompetent të OMLK e LNÇKVSHJ të mëparshme që sa më shpejt që është e mundur të bëjmi një takim. Edhe në bisedat që i patëm me shokët që i cekëm kemi theksuar dhe po ju lusim edhe njëherë që në mesin e atyre që do të ju përfaqësojnë të mos jenë ata që deri më tani penguan bashkimin dhe që shkaktuan përçarjet, që ishin zbatues të komploteve, që kanë bërë veprime antiparti e antilëvizje dhe ata që kanë patur çfarëdo kontakti me reaksionin e vjetër ballisto-ustash. Sepse ata që kanë punuar kundër bashkimit dhe që janë kundër tij, sigurisht që këtë rrugë do ta vazhdojnë.

Presim përgjigje me shkrim gjatë muajit Qershor.
shokët e PKMLSHJ

Shikoni këto mrekulli! Realitet i hidhur ky! Shikoni se sa e gjallë është fryma e grupit në mërgim! Shikoni grupashët!

Shikoni se si erdhën këta elementë si cjapi tek kasapi. Letra e 13 shkurtit është drejtuar në adresë të redaksisë.

Së pari u bëjmë me dije se adresa e ”Zërit të Kosovës” në Suedi nuk është adresë e LNÇKVSHJ, e as organi nuk është i saj. Është krejt tjetër çështje nëse me këtë organ

janë elementët më të shëndosh të ish-LNÇKVSHJ. Pra letra është drejtuar në adresë të gabuar, është në një adresë të diçkafit që për ne më nuk ekziston. Prandaj në mënyrë të drejtpërdrejtë shokëve të Partisë nuk do t'u përgjigjemi. Ne do t'u përgjigjemi shokëve tanë në mënyrë që ata të mos na thonë se pse nuk na keni treguar, ndërsa shokët e Partisë mund të mbajnë vesh e t'i hapin sytë që të shohin se si merremi vesh ne me bazën tonë.

Ne shokë, nuk mund ta marrim seriozisht këtë letër.

Pse?

Ne jemi bashkuar më 17 shkurt 1982. Në ato bisedime kemi thënë se kemi të drejtë të flasim në emrin e shokëve të LNÇKVSHJ, dhe jemi për bashkim sepse me këtë shprehim vullnetin e tyre, pasi ata janë për bashkimin.

Për çfarë bashkimi?

Për çdo bashkim që është në interes të popullit të Kosovës, duke e realizuar një bashkim për aq sa kanë qenë aftësitë tona. Ne u ulëm. A u bashkuam? Po. Mirë apo keq? Kjo le të gjykohet qoftë nga puna e gjertanishme, qoftë nga shkrimi i këtij artikulli dhe nga e ardhmja.

Ku është burimi i të metave të bashkimit të 17 shkurtit 1982? Pse ekzistojnë ato?

Ka shumë arsye. Disa që kishin "njohuri të mëdha" dhe "stazh", sigurisht e dinin që po i kap historia, andaj bashkimi duhet të kishte vulën e tyre. Disa kishin njohuri më të pakta dhe nuk u shkonte mendja tek historia, por që kishin dëshira të mira, por nuk ishin aq të ndërgjegjshëm (vetëdijshëm) se çka do të thotë që në raste të tilla të ngulësh këmbë jo në fjalitë dhe shprehjet por edhe në presjet. Shtojani të gjitha këtyre edhe kohën e shkurtë. Debatet e rrahjet e pikëpamjeve, janë bërë për më shumë se një muaj, ndërsa bisedimet kryesore janë kryer brenda një nate.

Çka ka qenë më së tepërmi diskutabile më 17 shkurt 1982?

Ka qenë çështja e emrit: a të quhet organizata e re Parti apo Lëvizje? Dy përfaqësuesit e LNÇKVSHJ kanë ngulur këmbë që organizata e re të quhet Lëvizje. Arsyetimi: kthesa e forcave të organizuara në luftë për republikë e bënë këtë emër më të përshtatshëm. Të paktën ky ka qenë arsyetimi im. Se emri Parti në luftë për republikë është më i papërshtatshëm. Tre përfaqësuesit e PKMLSHJ nuk kanë ngulur këmbë që të kundërshtojnë në këtë pikë. Bile njëri prej tyre, propozoi që organizata e re të quhet LRSHJ. Të gjithë njëzëri e aprovuam këtë emër. Emri dukej i përshtatshëm. Pra ne u bashkuam në LRSHJ, nga dy organizata u vendosë që të formohet vetëm një. Kjo është e vërteta. Për këtë qëllim ishim ulur në bisedime dhe jo në formën: PKMLSHJ dhe LNÇKVSHJ themeluan një organizatë të tretë përmes së cilës do të bashkëpunojnë, duke i ruajtur emrat e tyre të mëparshëm, duke pasur frikë të largohen nga fryma e ngushtë e grupit, siç na del tani nga letra e shokëve të Partisë.

Kështu u kishim thënë shokëve para se të ulemi në bisedime, se aty do të themelohet një organizatë e vetme, me këto bindje ishim ulur, nga ky qëllim i zhvilluam diskutimet, me këtë përshtypje i mbyllëm ato. Kompetentët e partisë në letrën e tyre nuk e shtrojnë çështjen kështu. Ata vetë propozuan që organizata e re të quhet LRSHJ. Ne aprovuam. Pas çajave të parë, teoricienët e Partisë vazhduan diskutimin në formën: Lëvizja është lëvizje, ajo nuk është organizatë, atë duhet udhëhequr.

-E kush duhet ta udhëheq?

-Partia!

-Cila?

-PKMLSHJ!

Atëherë të bëjmë të gjithë urra! Prina Parti!

-Po ku është Partia?

-Askund!

Ky është një emër fiks, një emër në ajër, një rrenë e trilluar.

Jo, militantët më të mirë u burgosën! S'është e vërtetë! Serbomëdhenjtë burgosën shumë intelektualë dhe për t´i dënuar me dënime të rënda ishte një pretekst shumë i përshtatshëm që t´u thuhet se kanë qenë anëtarë të PKMLSHJ. Pastaj ata nuk ishin udhëheqja. Ajo kishte mbetur e paprekur. Ajo mbeti për me ta vazhdua luftën e për t'i "bashkua grupet".

Dy përfaqësuesit e LNÇKVSHJ nuk kundërshtuan e nuk ngulën këmbë që të mos diskutohej për parti e levat e saj, por dihet se të gjitha ato punë nuk mund të kryheshin brenda një nate. Ne u bashkuam në LRSHJ dhe brenda saj ne do të vendosnim të gjitha duke respektuar vullnetin e shumicës.

Më 22 shkurtit 1982 autori i këtij shkrimi dhe Halimi, një përfaqësues i Partisë, u kthyem nga Stambolli në Shtutgart që të punojmë së bashku. Bashkëpunimi qe i shkurtër dhe preokupimi themelor i përfaqësuesit të Partisë ishte që të mbledhë ndonjë të pakënaqur, por në këtë punë dështoi tërësisht.

Për një analizë objektive të gjërave, për sheshimin e fakteve, për ballafaqim me realitetin shokët e Partisë u treguan aq frikacak të vajtueshëm sa s´ka ku shkon më tej. Por frika e tyre nga fakti se ishin disa zero në fushë të teorisë nuk i pengoi që të jenë intrigantë të klasit të parë në praktikë. Prandaj edhe shpjegimi i divergjencave të sotme që mund të duken sikur janë pasoja të një bashkimi ku gjërat nuk janë precizuar mirë që në fillim nuk qëndrojnë.

-Pse?

Sepse në këto dallime e që mund të shihet edhe më qartë në propozimet e fundit asgjë parimore nuk ka. Në tërë vijën dhe zikzaket e tyre dominon fryma e grupit, frymë e cila përshkon çdo gjë që thonë. Po të kishte gjë parimore në këtë mes ata mund të thoshin: Më 17 shkurt 82 ne themeluam Partinë bashkarisht por meqë ju nuk u treguat të gatshëm, apo nuk patët asnjë njohuri në këto punë, ne ecëm përpara dhe e formuam atë duke ua provuar me fakte se ne patëm më drejt se ju, dhe shihni se ku ju solli mosrespektimi e moskuptimi i ideve tona. Të mbështetur në këtë logjikë po që se nuk do të ishin grupash, ata, po ta marrim rastin më ekstrem ta zëmë se mund të thirreshin në PKMLSHJ. Por vetëm fakti se ata përmendin vetëm LNÇKVSHJ në një letër e më pas e shtojnë edhe OMLK tregon se ata jetojnë me emrat e para 17 shkurtit 1982.

Se ata kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë ide tepër të çoroditura për relacionin Parti-Lëvizje, parti-popull, pararojë-masë, kjo duket sheshit. Prandaj diskutimet më 17 shkurt 82 në çështjen se si të quhemi, Parti komuniste apo Lëvizje për Republikë, faktet e tanishme të japin me kuptua se në këto diskutime për ata që thirren në përvojë e stazh të gjatë qenësorja ka qenë tingëllimi i fjalëve, e kaluara, emri, se sa ndalja në të menduarit e brendisë dhe skeletit të organizatës.

Asgjë parimore nuk ka në këto propozime. Asgjë të qartë nuk ka. Shikoni të parën, ka 5 nënshkrime dhe figuron vetëm LNÇKVSHJ. Shihni të dytën, erdhi edhe OMLK, ndërsa nënshkrimet nga frika si duket vrapuan të fshihen dhe të vështrojnë qetë e qetë zhvillimin e ngjarjeve. Kanë rëndësi këto gjëra për ata që merren me politikë të hollë, për ata që do t´i kap historia.

Po fjala sinqeritet?!

Me fjalën sinqeritet nënkuptohet një grumbull vetish njerëzore nga më të mirat, që hetohen me vepra, që ndihen me zemër dhe jo me vesh. Sa më shumë dredha, sa më shumë gënjeshtra, sa më shumë qëllime të errëta që të ketë aq më shumë shtrohet nevoja që këto vepra të liga të mbulohen me zhurmën e fjalëve të ëmbla e me fjalën ”sinqeritet”. Sot kjo fjalë nuk përdoret në asnjë vend më shumë se sa në zyrat e hetuesisë së udbës. Po të vazhdojnë me na shurdhue me këtë fjalë, ndoshta pikërisht fjalën ”sinqeritet” do të detyrohemi ta marrim si njësi matëse për të përcaktuar vëllimin, peshën specifike, masën, temperaturën, presionin, pikën e vlimit e pikën e ngrirjes, tejdukshmërinë e dredhisë, përpjekjeve për mashtrim, dyfytyrësisë dhe të poshtërsisë.

* * *

Këtyre letrave nuk u besohet sepse nënshkruesit nuk dinë: A janë Lëvizje apo Parti, a quhen PKMLSHJ apo LRSSHJ? A janë bashkuar (shkrirë) në LRSSHJ, apo LRSSHJ është formuar në mënyrë që PKMLSHJ, OMLK dhe LNÇKVSHJ të bashkëpunojnë në ato pika që mund të merren vesh, e në ato pika që nuk merren vesh të veprojnë nga foletë e tyre. Së pari këtë ata nuk e kanë të qartë dhe së dyti ata i përziejnë gjërat sipas situatës, sipas sjelljeve të ”komplotistëve” me të cilët ndeshen. Këta kanë gënjyer shokët e tyre të cilëve u kanë thënë se po bashkohemi, po flasim në emrin tuaj. Prandaj ata që i kanë gënjyer shokët e vet do t´i gënjejnë të gjithë.

Të ndalemi pak te kritika dhe autokritika

Kush jeni ju që ne po u dashka të bëjmë autokritikë para jush?

Kush jeni ju që gabimet tona paskeni mundësi t´i rregulloni para popullit dhe të gjithë shokëve? Ne nuk kemi kurrfarë obligimi që të përgjigjemi për asnjë çështje të vetme para jush. Ne japim llogari vetëm para shokëve tanë që na përkrahin, japim llogari para popullit tonë të cilit i takojmë.

Kush jemi ne që ju të bëni autokritikë para nesh? Kush jemi ne që i paskemi ato kompetenca që gabimet tuaja t´i mbulojmë si me shkop magjik? Ju nuk keni gabuar në emrin tonë! Ju keni folur në emrin e shokëve tuaj, ju keni folur në emrin e popullit. Ju duhet të jepni llogari para shokëve tuaj sado pak qofshin ata, ju jeni përgjegjës para popullit. Në këtë kuptim ju jepni llogari edhe para shokëve tanë të bazës ashtu siç japim ne para shokëve tuaj. Vetëm në këtë kuptim mund të bëhet fjalë për kritikë dhe autokritikë e në asnjë mënyrë tjetër.

Ne themi se bashkim i mundshëm për aq sa mund të realizohet në mërgim, në kushtet tona, është ai i hapur, i diskutimit publik të gjërave rreth Kosovës Republikë, duke mos lënë asgjë me dy nënkuptime e me dredha.

Hetojeni edhe një moment me rëndësi që u paska rënë në sy edhe kompetentëve të Partisë. Ata thonë (luten) që të kemi vigjilencë ndaj përçarësve sepse ata që kanë qenë kundër bashkimit do të jenë prapë. Po të vazhdojmë përkthimin kjo do të thoshte se ata që kanë gënjyer do të gënjejnë prapë.

Kjo është plotësisht e vërtetë. Por do të na duhet ta zgjerojmë edhe më tej këtë konkluzion, ta qërojmë nga mjegullinat dhe poshtërsitë. Se kanë gabuar ata në Zvicër kjo dihet. Këtë e pranojnë edhe ata vetë. Ata bënë autokritikë. Çfarë autokritike? Autokritikë brenda katër mureve, autokritikë ”sipas vendit që u takon”. Gabime keni bërë edhe ju shokë të Partisë. Edhe ju tregoheni të gatshëm të bëni autokritikë në letra të mbyllura.

Edhe ne kemi bërë gabime, por gabimet tona ne i qesim në faqet e gazetës. Ne po i tregojmë popullit se ku kemi gabuar dhe pse kemi gabuar.

Përderisa ju si më të "mëdhenj", më të "pjekur", gabimet nuk guxoni t'i qitni para popullit do të thotë se keni gabuar me qëllim, sepse bëri e u tha dikush që ju nuk dini apo nuk keni ditur ju jeni në gjendje me i mbet në qafë, sepse me këtë vihet në dyshim "përvoja juaj e gjatë, stazhi juaj".

Çka del nga gjithë kjo? Del se ju keni gabuar për shkak të verbësisë nga interesat e ngushta, në emrin e interesave të ngushta keni shkelur në interesat e përgjithshme. Kjo do të thotë se ju keni gabuar me qëllim dhe si të tillë prapë do të gaboni.

Po ne?! Ne me qëndrimin tonë dëshmojmë se kemi gabuar nga mospërvoja, bile thelbi i atyre gabimeve mund të gjendet në ato nyje ku nuk kemi ditur t´u kundërvihemi me sukses për të mbrojtur interesat e përgjithshme prej egoizmit tuaj. Kjo do të thotë se ne kemi gabuar pasi nuk kishim njohuri (në dredhi kuptohet), se kurrë nuk kemi gabuar për interesat tona të ngushta. Këtu qëndron baza e asaj që ne nuk kemi asnjë frikë të hyjmë në çfarëdo diskutimi me popullin dhe t´ia themi të gjitha atij. Ne kemi aq guxim që të japim llogari para tij, të bëjmë autokritikë para tij e kurrsesi para jush apo atyre në Zvicër.

Ta ndriçojmë edhe më tej përgjithësimin e mjegullt: "Ata që kanë gabuar do të gabojnë prapë".

Fakti se ju ("Punëtorët") dhe "Zëri origjinal", që pretendoni në grada dhe kompetenca, që thoni se as frymë nuk merrni pa e pyet popullin, që pretendoni në përvojë dekadash, do të thotë vetvetiu se keni gabuar me qëllim, andaj ju prapë do të gaboni.

Ju do të gaboni vazhdimisht dhe qëllimisht.

Edhe ne do të gabojmë në të ardhmen, por do të gabojmë shumë më pak se në të kaluarën. Pse ne do të gabojmë prapë? Ne do të gabojmë në ndonjë çështje edhe në të ardhmen sepse ka gjëra të cilave nuk mund t'u ikësh, janë rrjedhim i kushteve objektive. Këto gabime ndodhin pasi ne punojmë dhe veprojmë në natyrë, ku kryhen procese të pakthyeshme, se ne nuk e demonstrojmë veprimtarinë tonë në laborator.

Ua provuam frymën e grupit të shokëve të Partisë. Kjo frymë mbretëron edhe në redaksinë e Zvicrës, me të cilën shokët e Partisë kanë këmbyer letra të sinqerta për një kohë të gjatë duke bërë politikë për histori, në mes veti. Ndoshta nga ajo praktikë u nisën kur drejtuan këto letra tek ne, por siç po shihet u mashtruan.

Çka mund të konkludojmë në bazë të këtyre provave?

Mund të konkludojmë se pretendimet për partishmëri e principialitet si të "Punëtorëve" ashtu edhe të "Zërit" në Zvicër nuk kanë lidhje me realitetin. Se pretendimet e tyre lidhur me mosrespektimin e vendimeve të 17 shkurtit 82 nuk janë të vërteta. Pretendimet e tyre se mbrojnë vullnetin e shumicës janë të pa baza.

Tek ne ka parime. Ne kemi respektuar vullnetin e shumicës. Ne nuk kemi marrë kurrë poza megalomane. Shokët e partisë kur hasën në kundërshtimin e shumicës ndaj absurditeteve të tyre, për të cilat nuk kishin fuqi të na e mbushin mendjen, për të cilat nuk arrinin të zgjeroheshin më shumë se në kufijtë e disa letrave intriguese u larguan nga mbledhjet. E para mbledhje me këta shokë së bashku me ata në Zvicër, njëkohësisht ka qenë edhe e fundit më 14-15 maj 82. Ne qëndruam dhe luftuam për mbrojtjen e vijës për kërkesën "Kosova-Republikë", dhe për ndërtimin e një taktike patriotike revolucionare në mërgim. Ne ishim në shumicë. Afër organit në Zvicër filloi të shtresohet oportunizmi i cili u shndërrua në shumicë. Por shumica oportuniste kishte fituar vetëm në forumin qendror dhe jo në të gjitha rrethet dhe shokët aktiv. Autori i këtij shkrimi duke e parë se nuk respektohej vullneti i shumicës kërkoi dorëheqje nga Qendra Ekzekutive. Dorëheqja nuk u aprovua. Provuam të vazhdojmë më tutje por nuk shkoi. Atëherë ne u hodhëm në luftë kundër shumicës oportuniste në një rreth qendror për të mbrojtur vullnetin e shumicës së LRSSHJ, rreth i cili e çoroditi organin, keqpërdori mjetet materiale, formoi

lloj-lloj komitetesh, forumesh e qeveri prapa kurrizit të LRSSHJ. Ne u ndamë më vete sepse ne mbronim vullnetin e shumicës jashtë, vullnetin e shumicës absolute brenda.

Prandaj asnjë akuzë kundër nesh se e filluam përçarjen nuk qëndron. Asgjë të vërtetë nuk ka nga kjo. E vërteta qëndron aty se përçarja ishte bërë fakt, ajo na u imponua dhe ne e sfiduam.

Të kthehemi te shokët e Partisë.

Ne ju themi se pranojmë vetëm një rrugë të diskutimeve për bashkimin: rrugën në të cilën do të merrnin pjesë një rreth i gjerë i shokëve të sprovuar në mërgim, të cilët janë dalluar shumë gjatë këtyre katër viteve. Me sa duket ju keni tepër frikë nga kjo.

Pse?

Mundësia e parë është: Ne me gjuhën tonë mund të lakuriqojmë të gjitha të "mirat" e juaja, dhe ju të cilët merrni poza të fryra para shokëve tuaj të pakompetenca, për të cilët ne kërkojmë që edhe ata të marrin pjesë në tubime dhe të jenë të involvuar në procesin e bashkimit, vdes mundësia që t'i manipuloni ata kundër nesh. Nga tubime të tilla ju do të dilni të demaskuar. Prej asaj "trimërie" e autoriteti të ngritur me lajka dhe jo me nder nuk do të mbetej asgjë. Ky do të ishte njëherit përfundimi juaj moral dhe me këtë përfundimi juaj në çdo pikëpamje.

Mundësia e dytë, zjarri i dytë u vjen prej masës së pranishme, në emër të së cilës ju i jepni vetes të drejtë të flisni në çdo vend dhe në çdo kohë. Ajo në një mbledhje të mundshme mund të thotë: "Leni thashethemet e liga dhe përmbajuni vetëm parimeve. T'i sheshojmë gjërat që i kemi përballë sot, dhe pa u ndalë në të gjitha hollësitë, të ndërtojmë taktikën më të drejtë."

Ne jemi në gjendje të pranojmë edhe këtë mundësi dhe në bazë të të gjithë të kaluarës, jemi të bindur se kemi aq fuqi argumentuese dhe shpresojmë se shumica absolute do të votoj për pikëpamjet tona. Ju e njihni veten se nuk mund të punoni në bazë të vullnetit të shumicës, t'i bindeni asaj dhe të punoni ku t'ju vendosë ajo, sepse ju i keni do grada që ia keni dhënë vetes, sepse ju siç kemi dëgjuar nga shumë veta e keni shpalluar veten heronj, se ju po e ditkeni se për ju qenkan të rezervuara disa vende (sipas librave të shenjtë ndoshta mund të jenë rezervuar për ju dyzet vjet para lindjes tuaj) të cilat po u takokan.

Dhe kur masa bëhet e ndërgjegjshme se çfarë force paraqet ajo, kur ne nuk do të kemi nevojë të vrapojmë herë në një qytet e herë në një tjetër për t'i treguar asaj se kush i luajti fjalët, pasi ajo me praninë e vet veç e di se si është vendosur dhe me këtë nuk do të ketë nevojë për të dëgjuar fjalën sinqeritet. Ajo do të jetë vetë në gjendje të dalloj se kush janë ata që nuk i binden vullnetit të shumicës.

A e dini ju se me çfarë sinqeriteti do të flasë ajo?

Dy të shtypur, njëri me çekan e tjetri me drapër do ta fusin në mes dy zjarreve të reja renegatin gënjeshtar. Njëri do t'i qohet me çekan në mes dy brirëve, dhe në atë gjendje agonie drapri do ta ketë kryer detyrën e tij, atë detyrë që e kryen me misrin e pjekur në vjeshtë. Dhe ç'bëhet më tej me renegatin gënjeshtar që luan me interesat e shumicës: atij i mbetet që t'i rrezit dhëmbët në ledinë për një kohë të gjatë ashtu siç ka pas ndodhur njëherë me pelën e Rezallës kur e ka pas zënë një lis.

Por ju mos u frikësoni, se ju pa popullin nuk bëni asgjë. Ne vetëm po fantazojmë, po flasim vetë më vete në bazë të disa shenjave.

A njohin rregulla të lojës djemtë e vyeshëm apo kompetentët?

Shokët tanë mund të thonë: si s'keni frikë ju? Jeni shumë më pak, si dje ashtu edhe sot. Ju jeni në rrezik në këtë luftë, ju mund të goditeni nga shumë anë, pasi kundërshtarët tuaj të penës janë më të shumtë. Kjo nuk është fer!

E ku keni parë ju të dinë djemtë e vyeshëm për ferplej. Ju mos u bëni merak fare dhe vetëm kënaquni sot duke shikuar nga bregu, nga prapavija se çfarë bëjmë ne. Të gjithëve me radhë, herë në grup e herë një nga një do t'ua bëjmë shosh mantilat dhe kasketat. Dhe kur kjo do të bëhet në mënyrë aq të qartë, çka do të thonë këta atëherë?

Do t'ia plasin vajit dhe do të shajnë!

Ata do të thonë: shihni komplotistët, fraksionistët, përçarësit e uzurpatorët çka na bënë! A të gjithë ne qenkemi të këqij e vetëm këta të mirë a?!

Këtu është rreziku më i madh që ju, kur t'i shihni këta tipa të përlloçur, të cfilitur e të demaskuar si mos më keq, të prekeni nga sentimentalizmi e nostalgjia dhe t'u vjen keq për ta.

Pasi qenka rrezik të prekemi prej gjendjes së tyre të mjerë, si të shpëtojmë?

Pështyni me neveri për atë se pse ju kanë mashtruar gjer më tani dhe më pas plasjani gazit që shpëtuat prej tyre.

A po filloni me e qartësua mendimin për atë se kush jemi ne?

Po ju tregojmë diçka në besim se çka thonë vëllezërit e mëdhenj për ne, kur janë së bashku në ato çaste të shkurtra, d.m.th. kur i kanë muajt e mjaltit. Ata thonë: "Ku ta kesh një tubë të mirë shokësh dërgoi këta aty nëse donë me t'i ba pikë e pesë!" Apo në stilin: "Oh, po ju kemi tregua se me ta nuk mund të bëjë askush!"

Pasi ne qenkemi të papjekur, pasi nuk po ditkemi çka duam, pasi jemi fëmijë, pasi jemi "politiçki ždrijepca", pasi jemi të pashoqërueshëm, pasi ju asnjë nga këto gabime nuk i keni, por në të kundërtën – jeni më të pjekur, dini çka doni, keni motive, keni grada, keni stazh, keni qeveri, keni ide dhe përkundër ndryshimeve në ide Atdheun të gjithë pa shibla e doni, dhe këtë dashuri ndaj atdheut ia njihni njëri tjetrit, atëherë bashkohuni ju.

Kur ju të gjitha këto kushte i plotësoni, kur atdheun të gjithë e doni, kur iniciativë keni, atëherë pse nuk bëheni të mirë e të na tregoni se çka ju pengon ju që të mos bashkoheni?

Çka ju pengon ju së bashku që të mos mundeni me ecë me ne duket sheshazi, për këtë ju jeni të qartë.

A e dini se çka ju mungon deri sa të uleni në bisedime?

Ju mungon një rezidencë e bukur, me një kopsht me lule, me shkallë nga jashtë. Gjejeni një të tillë, fotografojeni, jepuani pionierëve që ta shikojnë se a do t'u pëlqente ta kenë në abetare e libra leximi, dhe nëse kalohet edhe ky testim me rëndësi, pasi është dëshmuar se fëmijët dallojnë disa elemente në piktura e fotografi që nuk i hetojnë as gjenitë, atëherë ju nuk keni nevojë t'i shtyni bisedimet për asnjë minutë.

Ju dini të bëni politikë, dini me taktizua. Tek ne nuk gjetët LNÇKVSHJ siç keni gjet OMLK në adresa tjera, por nëqoftëse ju ngulni këmbë se nuk do t'i filloni bisedimet pa qenë 'u punom sastavu' (në përbërje të plotë), atëherë shtrohet pyetja se për çka rrimë ne këtu? Vetëm e vetëm për t'ua plotësua dëshirën dhe lutjet tuaja. Lutjet tuaja kurrë nuk kanë me ra në vesh të shurdhër. Do t'ua dërgojmë edhe "kompetentin" e LNÇKVSHJ.

Mund të na qortojnë për shakat. Nuk kemi kohë për shaka! Është e vërtetë, por për t'u marrë vesh me disa njerëz e vetmja mënyrë është shakaja.

A jemi me të vërtetë të pangueshëm?

Nëqoftëse nuk na qortoni shumë për shakat, atëherë me sa duket jeni bërë gati të na qortoni për atë se pse nuk po bëhemi më të dëgjueshëm ndaj djemve të mëdhenj e të vyeshëm, pasi ata janë më të moçëm, se kanë punua para nesh, ashtu si kanë ditur e mundur, prandaj ku po dilni ju tash si "mazi para pele".

Kjo kritikë e cila është e bazuar në thashetheme dhe tradita patriarkale, nuk është e vërtetë. Do t´u tregojmë se është pikërisht e kundërta.

Ne kemi pasur dhe kemi respekt për punën e tyre që e kanë bërë dje, dhe gabimet e së djeshmes po i shpjegojmë se kanë qenë pjella të kohës së tyre dhe si të tilla kanë qenë të pashmangshme. Se të gjitha moralizimet në të mirë të atdheut, kur na janë thënë gjëra që shpesh nuk janë përputhur me të vërtetën ua falim. Këtu qëndron ndoshta edhe merita e tyre. Këtë askush nuk mund t´ua mohoj. Këtë punë ne e nderojmë. Por thelbi i çështjes qëndron tjetërkund. Gabimi i tyre qëndron në atë se ata nuk ecën me kohën, nuk e kuptuan ndryshimin e etapave. Faktor të shumtë historik objektiv dhe subjektiv bashkëvepruan në kohë dhe hapësirë, që popullin shqiptar në Jugosllavi e sollën gjer në ditët e sotme. Edhe këta shokë të së djeshmes zunë vendin e vet në këtë grumbull faktorësh e kryqëzim interesash. Rezultanta e përgjithshme e tyre çoj në konsolidime dhe fitore të vazhdueshme të popullit tonë. Koha eci shpejt dhe këta element me frymë grupi e humbën hapin.

Si duan këta ta kompensojnë humbjen e hapit?

Me të pavërteta, me mburrje se gjithçka është rezultat i punës së tyre, me megalomani të shfrenuar se Kosova filloi ta gjej veten vetëm pas vitit 1975 dhe kjo se për shkak se u formua PKMLSHJ, me mburrje stazhi 10 a 20 vjeçar. Kjo është një mendjemadhësi e paturpshme e cila mund të ilustrohet në mënyrë më karikaturale me shembuj nga jeta e forcave të organizuara ilegale.

Siç na e thonë me gojën e tyre edhe stazhistët, ne ishim të padjallëzuar. Ne ishim modest, i respektonim këta të vjetër, i çonim në qiell para shokëve të tjerë. Sa më modest që ishim ne, aq më shumë këtyre "kompetentëve" u rritej mendja dhe qeshnin e talleshin me ne, pas sysh e parasysh.

Kur organizuam demonstratën e Bonit na e quajtën punë fëmijësh. Pasi nuk na trullosën e përrallat e tyre dhe pasi u ikën mbledhjeve, na quajtën "element antiparti e antilëvizje". Kur nuk lëshuam pe në asnjë pikë në vijën për Republikë, ndaj atyre që kishin bërë zhurmë gjoja në mbrojtjen e kësaj vije, na quajtën tradhtarë të atdheut dhe budallenj të papjekur.

A po e shihni se ne në asnjë rast nuk e rritëm mendjen dhe nuk ishim përçarës, se mendimi ynë politik ishte gjithnjë konstant ndërsa i të "pjekurve" lëkundej edhe nga puhiza më e lehtë. Pas këtyre shembujve duhet të bëhet e qartë se çdo kritikë lidhur me karrierizmin tonë, mosdëgjueshmërinë tonë nuk ka as bazën më të vogël.

Dyfytyrëshit i fluturon fantazia prej 0-180 gradë njëqind herë brenda ditës. Ne ua kishim dëgjuar "zanin e madh". Brenda një kohe të shkurtë kontakti po çuditeshim nga lëkundjet e tyre, nga ndërrimi i ngjyrave të tyre, nga mënyra e të menduarit të tyre. Këta ishin në gjendje që brenda disa orësh të të quanin edhe shokë edhe fëmijë, edhe shokë edhe përçarës, edhe shokë edhe tradhtarë. Se në lagjen më të varfër të Prishtinës, ku ka shumë shtëpi përdhese, në të cilat nuk dihet se cila është derë e cila është dritare, në lagjen ku shiten farmerkat e Italisë, ka shumë fëmijë pesëvjeçar të cilët brenda një ore sa shahen sa gjuhen me gurë e sa kapen për qafe për të luajtur, këtë e dinim. Me këto panorama ishim mësuar. Por se gjëra të tilla të ndodhin në organizata që shërbehen me emra të mëdhenj, këtë nuk na e kishte marrë mendja, këtë kurrë nuk do ta besonim pa e pa me

sytë tonë. Dhe nga kush të gjitha këto? Pikërisht nga ata që përbehen në fytyrë, në moshë, në stazh e në nder të familjes.

Këta njerëz që pretendojnë në kompetenca, ku secili thotë se ka bërë më shumë se tjetri, se ka merita më shumë se tjetri, ku sot të gjithë thirren në emër të organizatave të para vitit 1982, dhe si mbeturina të një kohe që sapo perëndoi thirren në emra grupesh duke e paraqitur veten si fuqi të pavarura që kërkojnë bashkim me të tjerët, këta element, në mërgim, prej vitit 1981 e gjer më 1985 paralel me zhvillimin e suksesshëm të shumë punëve e aktiviteteve, në të cilat është vula e masave të gjëra, në jetën e brendshme të LRSSHJ, për aq sa patën mundësi, për aq sa patën në dorë, për aq sa u polli fantazia, prapa kurrizit të shokëve, në kundërshtim me çdo normë elementare organizative formuan organizata në organizatë, formuan forume në forum, formuan qeveri ilegale, ndryshuan nenet e statuteve sipas dëshirës për të nxjerrë gazeta të veçanta, nxorën gazeta pa pëlqimin e shumicës, krijuan skandale shkallë-shkallë gjer tek autorët e tyre të frymës më puçiste të cilët gjithmonë jetojnë nën përshtypjen e tmerrshme se janë të rrethuar prej njerëzve të pabesueshëm, duke i thënë njëri tjetrit brenda natës herë vëlla e herë agjent, krijuan aso gjendje që në popull definohet me shprehjen lamë thiu.

Pra e keqja e tyre, fataliteti i tyre nuk qëndron në faktin se këta tipa, dje u janë bashkuar disa shokëve që ia filluan punës para nesh. Fati i tyre tragjik qëndron tjetër kund. Fatkeqësia e tyre është pjellë e mendjemadhësisë së tyre, kur thonë se dje ka pasur gjithçka, dje ka pasur vëllezër të dëgjueshëm e të harmonishëm, dje kemi pasur punë me heronj të kombit e sot kemi mbet me fëmijë të cilët nuk po dinë me ecë mirë. Këta vajtojnë se kanë ra prej kalit në gomar, e hipur mbi gomar dera e historisë nuk u çilet. Pra këta element nuk qenë në gjendje me i përcjellë shpirtërisht situatat, nuk qenë në gjendje të ecin me to, dhe prapambetjen e tyre të dukshme u përpoqën ta kompensojnë me gënjeshtra dhe skandale. Këtu qëndron debakli i tyre i vërtetë.

Janë pikërisht këta element grindavec që në dorë mbajnë gjithmonë dy flamuj: të përçarjeve dhe të bashkimeve. Askush, në disa raste nuk çirret më shumë se këta për bashkimin, për unitetin. Ne tani i njohim dredharakët dhe intrigantët, andaj nuk duhet të na trullosë aspak zhurma e tyre për bashkimin, sepse e dimë se për çfarë bashkimi e kanë fjalën. Këta gjithmonë kur diskreditohen si mos më keq, kërkojnë armëpushim për të fituar pozitat e humbura. Por ne pasi u kalitëm këtë mundësi nuk do t´ua japim fare.

Ne krerëve me kompetencat e tyre të mendjemadhësisë dhe të të gjitha mbeturinave të së djeshmes nuk do t´u japim asnjë sekondë pushim.

Kujt do t'i japim armëpushime?

Atyre të cilët i kemi dëgjuar duke thënë: "Çka qenka politika? Çka qenka çështja? Njëqind herë kisha luftuar më lehtë me pushkë se sa të jetoj e luftoj me gjithë këtë lum intrigash. As kokën nuk e di ku e kam! Ndodhem në mes dy zjarreve, nuk di a të shkoj me ata apo ata!" do t'u japim armëpushime të merituara derisa të freskohen plotësisht.

Si do të realizohet ky armëpushim?

Ne shokë, ne të cilët na llogaritni si udhëheqës tuaj, kurrë nuk do t'ju themi të hyni aty ku nuk hyjmë ne. Përkundrazi ne u themi se ju nuk keni aspak nevojë të hyni në të gjitha vendet ku hyjmë ne, t'u bini trup të gjitha ujërave që mund t'u duken herë të kthjellëta e herë të turbullta, ashtu siç u biem ne.

Pse themi kështu?

Sepse lufta e ditëve të sotme është e këtillë. Kjo është lufta më e vështirë, kur ajo më shumë bëhet me fjalë, ku ka shumë intriga e gënjeshtra, ku shpërdorimi i fjalëve është gjëja më e zakonshme. Në numrin e kaluar dhe në ndonjë tjetër u kemi përmend Lasalin dhe Karl Kautskin. Ju ende nuk e dini se kush janë këta. Ne dimë diçka për Marksin dhe Leninin, por për Dimitrovin, Dicgenin, Libknehtin, Kugelmanin, Zorgen, Bebelin,

Sverdlovin, Kirovin, Klara Cetkininin, Ulbrihtin, Bertolt Brehtin, Tucoviqin, Krupskajan, Telmanin ende nuk dimë.

Ne kemi dëgjuar për Bismarkun vetëm në relacion me Kongresin e Berlinit. Tani do të mësojmë më shumë për te në relacion me Parisin, do të mësojmë për Tjerin, Galifen, Lasalin, Prudonin, Bakuninin, Mileranin, Martovin, Martinovin, Struven, Trockin, Bernshtajnin dhe shumë të tjerë si këta.

Duhet të bëhemi gati sa më parë që të mësohemi me këta emra, sepse kur të hyjmë në det, në valët më të egra, më të mërzitshme, do të ndeshemi me këta, andaj duhet të dallojmë se kush çka është dhe kush me kend është. Me ndihmën e grupit të parë dhe përkrah tyre, disa prej nesh, do t'ia hyjmë një lufte të gjatë dhe të egër kundër bandës së fundit. Kjo pra është ajo lufta e vështirë, që juve punëtorëve iu vjen më e vështira ta shihni, më e vështira ta kuptoni. Kjo do të jetë një luftë e gjatë. Në këtë luftë ju do të jeni në radhë të dytë, ndërsa ne do të jemi në radhët e para dhe do të hyjmë në mes njëqind zjarreve.

Pas shumë vitesh, pas shumë betejash, pas shumë bashkimesh dhe përçarjesh, kur ne, pas secilës prej tyre do të jemi më të fortë, një ditë do të vejmë në rrethim Peterburgun, Berlinin, Parisin dhe Nju Jorkun, në bazë të gjitha rregullave të artit, duke i sistemuar forcat tona në mënyrë të përsosur. Dhe atëherë lufta e gjatë me dekada, lufta e shpatave, lufta e fjalëve do të merr fund. Atëherë do të filloj lufta e gjëmimit të topave. Atëherë ju do të dilni në radhë të parë, do të dilni në rrugë, në demonstrata, ndërsa ata që ju kanë sistemuar aq mirë do të qëndrojnë në prapavijë dhe do të drejtojnë të gjithë sulmin. Lufta e juaj do të jetë shumë më e shkurtë, disa ditë, ndërsa ata që do t'ju drejtojnë e meritojnë këtë, nëse do t'i kalojnë me sukses të gjitha provat.

Ne do t'iu themi të gjithë aktivistëve të klubeve, pjesëmarrësve më aktiv të demonstratave në mërgim gjatë këtyre pesë viteve, se ata nuk kanë aspak nevojë të vendosen para dilemash, e as t'a ndiejnë veten të vendosur në mes dy zjarresh, se me kend me shkuar; me "ata" apo "ata". Ne ua kemi provuar me punën tonë se ju jo vetëm që nuk gjendeni në mes dy zjarresh por jeni pikërisht ju që do t'u veni zjarrin të tjerëve dhe do t'i kallni.

Si është gjendja momentale?

Udhëheqësit e Zvicrës u thonë atyre punëtorëve që kanë ndikim në ta: ndezni kerret, vraponi, demaskoni veglat e udbës, gënjeni sa të mundeni sepse u lejohet ta bëni këtë për "atdheun", se luftë është kjo, ose-ose. Kështu pra u thonë ata shokëve të vet. Po shokëve tanë çka u thonë, si merren vesh me ta?

Shokëve tonë ata u thonë: shikoni, mos folni keq për ne, se ne ndoshta bashkohemi prapë, e bëjmë gazeta së bashku, e ku mbeteni ju pastaj?

Shikoni çfarë dredhish, çfarë çoroditjesh, çfarë ngatërrimesh!

Çka do të themi ne?

Ne shokëve tanë do t'u themi ashtu siç u kemi thënë më parë: ju nuk keni kurrë nevojë të gënjeni për llogari tonë, në të "mirë të atdheut". Kjo është luftë e vështirë. Andaj larg nga terreni i luftës me anë të intrigave. Të gjithë ju shokë, si më të afërm, ashtu edhe ju simpatizantë të dyshimtë e të pavendosur, të gjithë ju që do të dëgjoni këtë fjalë, të gjithë ju të lodhurit, largohuni me një disiplinë ushtarake, me hapa sa më të rregullt nga kjo luginë e turbullt e me mjegulla të dendura dhe dilni në bregun më të afërt.

Po ju mund të thoni se jemi në luftë, e nga lufta nuk tërhiqemi!

Nuk e patëm fjalën të largoheni nga lufta, por vetëm nga fusha e intrigave, nga ai terren i cili sot për sot nuk është i juaji, dhe nëpër të cilin ju nuk dini me ecë mirë, ju nuk shihni kleçkat e kurthat në çdo hap, ju nuk dini se ku ju pret mina e kurdisur.

Përkundër sakrificave nuk tërhiqemi! Gjatë tërheqjes mund të marrim ndonjë plumb shpinës dhe atëherë për ne nuk do të ketë varr. As këtu nuk keni të drejtë! Ju keni sulmuar shumë, dhe keni fituar një terren të madh, dhe me armët që dispononi nuk mund të luftoni dhe ta mbani atë pa armëpushim. Pastaj duhet ta dini se ai që nuk di të tërhiqet, ai nuk di as të sulmoj. Por gjatë tërheqjes kujdes, ajo nuk guxon të shndërrohet në panik. Tërhiquni ballë për ballë me hapa të sigurt prapa. Posa të largoheni nga mjegulla, nga rrëmuja, ta dini se tërheqja ka marrë fund.

Tash ju nga bregu keni mundësi të shihni më mirë se si luftohet. Nga distanca e fituar ju do të keni një pamje më të mirë të skenës së betejës. Shumica dëgjuan dhe po vendosen në pozicionet e tyre, në pritat e tyre ku dinë aq mirë të qëndrojnë, në ato vende ku nuk kam fije dyshimi se do ta dallojnë të bardhën nga e zeza. Por ka disa që nuk do të na dëgjojnë kësaj radhe, nuk do të dëgjojnë fjalën tonë, kur ajo u thuhet për herë të parë. Këta janë disa punëtor të korruptuar.

Si do t'i presim?

Mos do t'i trullosim edhe më tmerrshëm, duke u thënë që të mos flasin keq për ne, se nesër mund të ndodhë që të ulemi me "ideologët" e tyre për të bërë gazeta së bashku, e ku do të mbeteni ju pastaj?

Në asnjë mënyrë nuk do t'u themi kështu!

Ne kësaj radhe vetëm do t'i ç'armatosim. Do t'u themi se sado inat që të kenë, kjo është punë e skllavit për zotëriun. Juve ju kanë thënë: dili te dera, pa ardhë akoma tek ne dhe paaftësoje, se ti ke çekan dhe drapën, të cilët janë më të rrezikshëm se shpata e tyre. Ty të shkon fjala më fort se ne. Asnjë të dredhur s'kanë me ua pritë. Kjo ndodhë aq më tepër kur ju i keni pasur shokë më parë. Kështu ua thanë fjalët së bashku me vendin e merituar në "Komitetin Qendror."

Këta, edhe pse do t'ua dridhim trurin që t'u dalë pija, nuk do të këndellen menjëherë se janë infektua keq. Dozën e antibiotikut të mjaftueshëm kemi me ua dhënë pas një muaji, ku besojmë se të gjithë ata që nuk kanë marrë sëmundje kronike do të shërohen.

Kur do të na ndeshemi me këtë grup punëtorësh, pasi sa i përket anës tonë ne jemi të lirë gjithë javën. Këta do të na dalin përpara të shtunën, sepse ditëve të tjera punojnë në tri ndërrime dhe bukën në çantë e marrin. Këta të shtunën do të shkojnë në vendin e tyre të rojës, pas orarit, në detyrën që ua ka besua "populli dhe atdheu." Dhe ja ku dolën përpara! Shikoni si e kanë ndërruar uniformën. Nuk janë të vetëdijshëm se në momentin kur i ka zënë dehja (lexo: lakmia për "vendin e merituar në Komitetin Qendror"), në vend të çekanit u kanë dhënë revole dhe drapri në bajonetë u është shndërruar. Shikoni si u është fryrë pak xhepi i brendshëm i setrës dhe u kanë dale dy tri fletë të bardha përjashtë. Ju do të pyesni se çka janë ato?

Ato janë "dokumente që ta dridhin tokën", letra, fjalë, ide, lojë fjalësh, fjalë për taktikën dhe besën e të pabesëve. Radhën e parë do t'i falim. Edhe vetë po dridhen, djersët po u rrjedhin përrua, të cilat për ndryshim nga ditët tjera as nuk janë të njelmëta e as të vala, por të ftohta dhe pa fijen e shijes.

Me një të goditur të lehtë, edhe bajoneta edhe revolja do t'u fluturoj në ajër. Të gjithë këta do t'i qesim në një pozicion jashtë loje.

Ua provuam edhe njëherë se një bashkim të cilin e idealizojnë disa është i vështirë. Por nga zhurma prapë se prapë një rezultat doli. Punëtorëve që bashkimin e duan me gjithë shpirt, ne do t´u japim armëpushime sa herë të duan, ndërsa me kompetentët do t'i vringëllojmë armët tona derisa sa t'i fusim në grykë të topit. Pas kësaj për ju puna më e

madhe për ju ka me qenë t'i ndezni topat dhe t'i përplasni në muze të gjithë këta, në një vend me Tjerin dhe Bismarkun. Ju mund të thoni se po i dërguat këta në muze, veç ua plotësoni dëshirën sepse ideali i tyre ka qenë muzeu, historia. Keni të drejtë, por këta do të fluturojnë në muzeun e bishave, sepse ideali i tyre ka qenë që ligjet e bishave të mbretërojnë në marrëdhëniet në mes njerëzve.

* * *

Pasi na thanë se me ne nuk po mund të bëka askush, atëherë çka do të bëjmë ne?

Ne do të ecim pa u trembur nën breshërinë e njëqind zjarreve.

-Po a na thanë se ne i bëjmë njerëzit pikë e pesë!?

-Po!

Ne ua dokumentuam se djemtë e vyeshëm, kompetentët, prishën çdo rregull, kurse ne do të vejmë gjithçka në vendin e vet.

Ndoshta e patën ndërmend me na thënë se ne nuk i lëmë dy gurë bashkë.

Kjo është plotësisht e vërtetë. Ne çdo gjë të keqe e rrotullojmë, e përmbysim, e bëjmë kërsh.

A kemi çka me përmbysë prej mbeturinave të së kaluarës tek ne?

Shumë!

Ne kemi pasur nevojë të madhe për një organizatë të mirëfilltë leniniste, por gjithmonë jemi menduar shumë kur ka qenë në pyetje populli, lufta e tij, sepse populli e donë një kujdes të veçantë, një dashuri të veçantë. Kërkesa për Republikë na kishte futur në mendime.

Çka do të bëjmë me emrin e Organizatës?

Emrin LRSHJ (më 17 shkurt 82) dhe LRSSHJ (më 26 qershor 1982) ne e aprovuam.

A i përgjigjet në mënyrë besnike ky emër kërkesës së popullit tonë në Jugosllavi?

Aspak!

Si arsyetonim gjatë aprovimit të këtij emri?

Arsyetimi ishte fund e krye në bazë të ligjeve të psikologjisë së djemve të vyeshëm. Ky ishte një arsyetim i vetëdijshëm i atyre me stazh, ky ishte një arsyetim i papjekur i neve që nuk kishim njohuri më të mëdha. Ai mund të vizatohet kështu: Populli po lufton për Republikën e Kosovës, për ta ngritur Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës në rangun e një Republike të federuar, që KSA e Kosovës të quhet Republika Socialiste e Kosovës. Ne si më të mençur se masat e demonstruesve në Kosovë kërkonim zgjerimin e kufijve të kësaj Republike. Me këtë taktikë ne i mbajmë të nxehtë shqiptarët në Maqedoni dhe Mal të Zi. Në politikë fusim parimet e tregtisë. Ne po rrahim një çmim më të lartë, Serbia thotë rrini si jeni, ndërsa federata me demonstruesit shqiptarë i bien këtij pazari në mes dhe thonë: Republikë po, por vetëm për KSA të Kosovës.

Me që populli nuk po na pyet sot, sepse është i padëgjueshëm, atëherë ju brezni të ardhme mos harroni me i përmend veprat tona të mëdha, si luftëtar të pakompromis që kemi qenë, sepse po harruat gjykimi i brezave do të bien mbi ju.

Ne që ishim më të rinj në Shkurt 1982, tani në Qershor 1985 këtë emër, LRSSHJ, do ta bëjmë kërsh, pluhur e hi.

Çfarë emri do të zgjedhim? Ne do të zgjedhim një terren të sigurt. Po ecëm mirë e drejtë në ato pika ku jemi plotësisht të qartë siç është çështja e Kosovës Republikë, atëherë të gjitha të panjohurat do t´i mësojmë rrugës me një lehtësi të çuditshme.

Po emri i gazetës ”Zëri i Kosovës”!

Po dalin dy Zëra! Na është bërë një ngatërrim. Ka ndodhur një vjedhje e papresedan e licencës. Nuk është mirë të vazhdohet kështu. Janë lodhur njerëzit me fjalët: “Lëvizja e egër” e “Lëvizja e butë”, “Zëri origjinal” e “Zëri i falsifikuar”, “Zëri i Zvicrës” e “Zëri i Suedisë”, “Zëri i Kosovës” e “Zëri i mërgatës”. Duhet të gjendet një zgjidhje. Ne jemi të qartë tani para vetvetes. Ua provuam për një vit se edhe para qershorit të vitit 84 kemi qenë të përgatitur me drejtua gazeta, bile në një krizë shumë më të rëndë, siç ishte koha pas atentatit të 17 janarit 1982.

Tani ne do të ndërrojmë emrin e gazetës, do ta heqim emrin "Zëri i Kosovës".

Mos po kemi frikë nga lumi i intrigave e sharjeve?

Jo!

Tani nuk ka mbetur asnjë prej jush që ta besoj, sepse me të gjitha këto dokrra ne u tallëm si me një arushë.

Ku qëndron arsyeja se ne po e ndërrojmë emrin e gazetës?

Zëri i Kosovës është një zë i madh, është një këmbanë shumë e rëndë, tingujt e të cilës ndihen në të gjithë globin. Ky emër iu kishte kërkuar Jusuf Gërvallës prej një djali të vyeshëm në mënyrë që t’i lej dokumente të forta historisë, dhe për shkak se procesi i qartësimit të pozicioneve që vazhdoi më vonë ishte në fazat embrionale, përkundër vërejtjeve të tija, ai e aprovoi këtë emër. Por Jusuf Gërvalla ishte luan me sy shqiponje, prandaj edhe këtë Zë të madh e drejtonte me lehtësi. Ne nuk mund ta bënim gjithë atë punë, ta përballonim një tempo dhe regjim pune të cilin na e kishte imponuar. Ne ishim brum, ende të paformuar, por megjithatë plumbi nuk na mundi.

Emrin ”Zëri i Kosovës” do ta ndërrojmë me një emër tjetër. Një emër simbolik për forcat tona ne nuk do ta kemi vështirë për ta gjetur. Kosova ka vetëm një Zë dhe ai nuk është zëri i frikacakëve të verbër që çmenden njëqind herë brenda 24 orëve. Zëri i Kosovës kreshnike është zëri i punëtorit, është zëri i proletarit, i trimërisë së pakufishme të klasës së shtypur të punëtorëve e fshatarëve, sepse e di se me vete i ka 3,5 miliard njerëz të globit. Në ato raste kur zemrat tona do të rrahin në rezonancë me zemrën e madhe të Kosovës, ne i bëjmë jehonë zërit të saj. Posa të hetohen çrregullimet më të vogla në këto rrahje zemrash, ne do të ndalemi për një çast, do të mbajmë vesh dhe sa më shpejt do të përpiqemi ta zëmë ritmin.

A flasim me fjalë të huaja?

Është me rëndësi që të hetojmë edhe një moment se si manovrojnë kompetentët. Ata shpesh e kanë për dëshirë të na thonë se ju folna me fjalë të huaja. Ka diçka të vërtetë në këtë pikë. Ne vërtetë dëgjojmë, mendojmë dhe flasim me fjalë të tjetërkujt, fjalë të cilat jeta i ka verifikuar se e sa herë si të drejta. Por këto fjalë ne i marrim dhe i adaptojmë për kushtet tona, dhe në çdo pyetje jemi në gjendje të përgjigjemi pikë për pikë se pse e bëmë këtë hap, pse në këtë fazë apo tjetër të kohës, në këtë apo atë vend bëmë këtë ose atë adaptim për kushtet konkrete. Por këtyre nuk u mbushet mendja për këtë dhe na quajnë dogmatik. T’i fusim edhe një herë në mes dy zjarresh dhe do të shohim si përpëliten. Ne ua kemi dëshmuar se këta vjedhin, plaçkisin ku të munden dhe si munden dhe gjithnjë bëjnë zhurmë se janë origjinal, se nuk janë dogmatik por realist. Por këta shpesh hyjnë në rrugë qorre, në lugina pa krye, dhe vetëm pasi ta shohin se ku kanë ra, për ta shpëtuar kokën e vet detyrohen me tregua se ku kanë vjedhë, ata tregojnë se ”kush i ka marrë në qaf”. Ata menjëherë do të thonë: ky e ka thënë dhe jo unë. E përkthyer kjo në gjuhën e malësorëve të mbi-Shkodrës, kjo do të tingëllonte kështu:

-Më në fund e nxore kokën Gjeto Doraci!

-Jam i pafaj Bardh Sokoli! M'u verbuan sytë, mi mori Perëndia mendtë!

-Kush qëndron pas teje?

-Xhemë Shytani!

Dëgjoni si po na shajnë për shpifje, për banalizim të gjërave. A jeni duke i dëgjuar se çka po thonë? Po thonë lere popullin në kasollen e tij, se ai nuk kupton. Ngrituni pak më lartë e të merremi vesh si "njerëz"!

Çudi! Këta të cilët gjithmonë flasin në emër të popullit dhe përbehen se flasin me gjuhën e popullit e me lejen e popullit, po e ndiejnë nevojën që të ngritemi më lartë.

Mirë po ngritemi. Gjer ku po doni?

-Prej kasollës doni që të vijmë në Universitet të Prishtinës!

-Pak!

-Edhe më tej. Në atë të Beogradit, në bibliotekat e Universitetit të Bochumit apo të Bernit.

-Më në fund ju ranë kasketat nga koka o…!

-Na u verbuan sytë. Dëgjuam për greva e demonstrata dhe menduam se do të ndërrohen vendet, sepse ne vetëm për ndërrim vendesh luftojmë, në stilin ja ai-ja unë.

-Kush qëndron pas jush?

-Markuzeja, Prudoni, Lasali, Bernshtajni.

Mund të çuditen disa teorik, se si na erdhi gjuha. Të ngratët! A i keni dëgjuar se si diskutojnë kur flasin për shkrimet? Njëri thotë: nuk është shkrim ai në të cilin nuk e lenë një pjesë të jetës. Tjetri, si për t'ia çuar mendimin në fund ia pret: unë sa herë shkruaj dridhem, bëhem valë, djersitem. Duhet t'u besoni se kjo është e vërtetë, sepse truri i tyre ka nisë me u terë, me u tha. Ata edhe kur i afrohen të vërtetës prapëseprapë në letër nuk mund ta qesin. Shkrimet e tyre kurrë nuk janë përpjekje për ta gjetur të vërtetën. Teza themelore e tyre, pikënisja e tyre është "vendi që u takon" dhe çdo germë e shkruar nga ta ka për qëllim argumentimin e kësaj teze. Dhembje të mëdha duhet të ketë truri i tyre, përderisa kah shkruajnë në kundërshtim me vullnetin e popullit vdesin edhe dromcat e fundit të ndërgjegjes.

Çka kërkojmë dhe çka do të japim?

Pasi u morëm vesh ta vazhdojmë luftën, atëherë ju mund të na pyesni se çka kërkojmë prej jush?

Ne prej juve, 1000 punëtorëve më aktiv në Gjermani dhe prej 1000 të tjerëve në Zvicër, gjatë këtij viti kërkojmë nga 1,5 marka gjermane në muaj, d.m.th. 3000 mark në muaj.

Çka do të japim ne?

Ne gjatë këtij viti kemi me ua dhënë të paktën edhe pesë numra të një gazete që do t'ua thotë të vërtetën leniniste në 2000 ekzemplarë. Çka do të na jep ne të gjithëve një gazetë e tillë?

Një gazetë e tillë do të tuboj rreth vetes dhe do të kalitë shumë militantë, të cilët të organizuar në organizata jo vetëm që do ta bëjnë Kosovën Republikë, por gjithë botën shtypëse do ta përmbysin. Ju mund të thoni se kishim me u dhënë një milion më tepër, sepse kemi mundësi, por ju që luani rolet e udhëheqësve nuk po dini me ua zënë fillin punëve. Është e vërtetë se ne nuk i ditëm të gjitha përnjëherë, dhe as nuk i mësuam ato përnjëherë, por të mos harroni se nuk është aq e lehtë të mësohet një punë e tillë, të

mësohet një art i tillë, ndoshta arti më i vështirë prej të gjitha arteve, por kur të mësohet të sjellë kënaqësi më shumë se të gjitha artet tjera.

Ne kaq u kërkojmë. Ne u treguam haptazi se çka kërkojmë gjatë këtij viti prej jush. Edhe të tjerëve u takon me u tregua, aq më tepër pasi ata kanë shpenzime shumë më të mëdha, sepse nuk është lehtë të kesh ministra, kabinete, qeveri, sindikalistë dhe të fillosh me hap bunkera.

* * *

Të dy këto variante të bashkimit janë në thelb të njejta dhe kërkojnë që të përsëriten budallallëqet e së kaluarës.

Bashkimi i llojit të dytë
Varianti i parë

Ekzistojnë dy propozime të militantëve më aktiv të Lëvizjes të një qyteti në Gjermani, të cilat po i botojmë.

Vendim

Duke ja shtruar çdo njeni vetit si obligim, e sidomos rreth që ta thotë dhe kërkon të vërtetën, siç ka vepruar Heroi Jusuf së bashku me Kadriun dhe Bardhoshin, do ta vazhdojmë luftën me porosinë e tyre, bashkim e jo përçarje, punë e jo fjalë, dhe me fjalët e tyre në mendje e besimin në zemër, ne do të vazhdojmë rrugën e tyre të drejtë, dhe do të mbrojmë gjithmonë të vërtetën.

Më 20.5.1984 prej një bisede të gjatë ne rrethi i Shtutgartit, erdhëm në përfundim duke studiuar situatën momentale, prej fjalëve të ndryshme, Qarkoreve, Njohtimeve etj. Vendosëm që ta thirrim një takim më se të domosdoshëm brenda 14 ditëve. Në këtë tubim të marrin pjesë 12 aktivistë të LRSSHJ, dhe 6 prej forumit më të lartë të jenë ……

Ne rrethi i Shtutgartit ja falim besimin që në emër tonë të marrin pjesë 3 shokë në këtë tubim. Prej rretheve të tjera kërkojmë të jenë; Rrethi i …….. t´i dërgon 3 shokë aktivistë të LRSSHJ, Rrethi i …… gjithashtu 3 shokë. Po këtyre rretheve kërkojmë në mënyrë të domosdoshme që të jenë ……

Në këtë tubim prej këtyre 12 aktivistëve kërkojmë që tre punëtorë të paanshëm të jenë udhëheqës së rendit të ditës për pikat që vijojnë.

Para se të mbahet takimi të garantohet për vend se ku do të mbahet.

Ne rrethi i Shtutgartit e marrim përsipër të sigurojmë vendin, njashtu ……..., por për takim të marrim masa dhe ta njoftojmë njëri tjetrin se kush po e merr përsipër. Të jetë … prej 3 vetave, jashtë atyre të 12 që do të jenë pjesëmarrës në këtë takim, prej anës sonë e caktojmë një shok, e poashtu nga një prej rretheve të …….

Rendi i ditës të bëhet aty për aty.

Udhëheqësia e programit të zgjidhet para takimit. Prej anës sonë është… kurse rrethet tjera i zgjedhin vetë.

Vendim; vendosëm të gjithë shokët e rrethit, njëzëri që ….. dhe …. nuk kanë kurrfarë arsye. Nëse nuk do të jenë në takim, apo nëse nuk pranon këtë vendim ndonjëri prej këtyre 7 shokëve, neve si rreth do të na ketë kundër përgjithmonë, dhe do ta luftojmë me të gjitha forcat.

Shokët e rrethit të Shtutgartit 20.5.1984

Vendimi i dërgohet…..

Propozim 26.08.1984

Rrethi i Shtutgartit në një takim e pa të domosdoshme se këto përçarje çojnë ujë në mulli të armikut. E pamë të arsyeshme që tre krahët t´i nxjerrin nga 7 anëtarë për të shqyrtuar situatën aktuale. Ne propozojmë që në këtë takim të marrin pjesë 1……, 2….., 3……, 4……., 5…….. Por megjithë propozimin këta 21 anëtarë le të vendosin për pjesëmarrjen e tyre në atë forum. Sepse bashkimi i deritashëm sipas mendimit tonë është formal, kur në emër të LRSSHJ dalin tri gazeta. Prandaj propozojmë që t´i sjellin të gjitha dokumentat që posedojnë dhe t´i shqyrtojnë në forumin e 21 anëtarëve. Për shumë arsye e për shkak të situatës nuk po zgjerohemi më tepër në këtë propozim.

Presim aprovimin e këtij propozimi
në këtë adresë……..

Këto propozime kanë mbetur në letër për shkak të frikës në njërën anë dhe për shkak të minikompetencave të iniciatorëve.

Bashkimi i llojit të dytë
Varianti i dytë

Mund të merret shkrimi i këtij artikulli dhe ajo që sqaruam në përgjithësi në këtë shkrim.

Të dy nyancat e fundit në thelb janë e njejta gjë dhe i përkasin rrugës së dytë të bashkimit, ashtu siç i përkasin dy nyancat e para rrugës së parë.

Konkluzion për përçarjen - Pse u përçamë?

Në luftë në mes jetës dhe vdekjes ne fituam, dhe me një shtëpi prej qerpiçi erdhëm gjer në mbarim të vitit 1945. Mbi themelet e Jugosllavisë së vjetër u ndërtuan gjashtë shtëpia me tulla e granit. Neve u përpoqën të na zhdukin plotësisht, mirëpo ne me kohë e kishim mundur vdekjen. Ne na lanë në shtëpinë e vjetër. Na thanë ngjyroseni dhe kalojeni kështu për një kohë. Familja jonë u shumua u bë e madhe dhe i ka të gjitha elementet e një shtëpie të madhe, të gjitha ato elemente që i kanë gjashtë shtëpiat tjera me të cilat jetojmë brenda një oborri të madh. Ja shikojeni, oda ku ka nejtë Haxhi Baba. Hambari dhe koshi i misrit në mes dhe pas tyre shtëpia. Shtëpi me oxhak ku shumë punojnë e disa nuk punojnë. E ju siç e dini në shtëpi të madhe lehtë mund të plasë sherri, sidomos kur humbë harmonia e vëllaznillaku i mirë.

Si duken problemet e brendshme?- Si nisi me humbë harmonia?

Së pari me rritjen e shtëpisë, Haxhi Baba me djemtë e mëdhenj, me vëllaznit tonë të vyeshëm hynë në odë dhe kohën më të gjatë e kalonin aty. Bënin biseda dhe pritnin mysafirë. Në shtëpi punohej, derdhej djersa, gatuhej, shikoheshin lopët, shikohej kopshti. Ne fëmijët bënim punë më të lehta. Por puna jonë më e madhe ka qenë në komunikimin në mes odës dhe shtëpisë, për t´i bajtë tepsijat. Ne shihnim më së shumti. Ne ishim edhe në shtëpi edhe në odë. Shihnim se çka bisedohej në odë, megjithëse për një kohë të shkurtë, se na çitnin jashtë duke thënë: shko merre një sepet kashtë e qitu lopëve, apo qitne plehun se ishte bërë gjer në gju. Ne vidhnim diçka nga pleqëritë. Te shtëpia rrinim më gjatë. Ne i tregonim shtëpisë të gjitha ato çka kishim dëgjuar në odë. Ne shihnim shumë gjëra edhe në shtëpi, se si përgatiten greva e demonstrata, të cilat për shkak të mosorganizimit dhe frikës nuk shpërthenin, por që ne kurrë nuk i denoncuem. Andaj

gabohen disa kur na akuzojnë se ne nuk mbajmë sekretet. Ne i mbanim sekretet e shtëpisë, por ato të odës ia tregonim gjithë lagjes. Ndërsa vëllezërit e mëdhenj më shumë u lidhën me odën, e edhe kur vinin në shtëpi, vinin plotë mendjemadhësi dhe të gjitha pyetjeve kureshtare se kush ka ardhë e çka po flitet u përgjigjeshin me fjalët se "s´kanë çka u interesojnë këto punë juve! Ju duhet të përgjigjeni vetëm për atë se pse u vonua darka dhe asgjë tjetër."

Kështu pra filloi me u mbledhë mullaku i sherrit edhe në familjen tonë.

Dhe çka mendoni ju, mos sherri plasi në shtëpi?!

Gënjeshtër e vjetër në stilin se "u ndamë se gratë s'mundën me ba në mes veti, e fëmijët u rrehshin."

Sherri plasi në odë në mes vëllezërve të mëdhenj, të cilët mbetën me e zanë vendin e Haxhi Babës. Ne megjithëse punonim më shumë në shtëpi e hanim atë që i tepronte odës, vazhdonim punën duke menduar se oda do t´i rregullonte punët.

Por jo!

Në një ditë kur mendohej se qetësia ishte e kënaqshme, murmuroi për së kthjellëti. Krisën stupcat e zhurma erdhi gjer në shtëpi. Të gjithë dolëm në oborr!

Çka me pa?!

Vëllezërit e mëdhenj, djemtë e vyeshëm, ia kishin vu thonjtë në fyt njëri tjetrit me sa fuqi që kishin. Në fytyrën e tyre shihej zemërimi e serioziteti për ta asgjësuar sa më parë njëri tjetrin. Si dolëm në oborr na u drejtuan: Ende po pritni a! Kapni sakicat, tërfurqit, kosat, kacijat e bini këtij se ky e ka fajin e prishjes së barazisë. Ky po donë me na e ndërrua planin e shtëpisë çfarë po e kërkojmë ne.

Shumica u befasuan!

-Cilit me i ra qyk shati e cilit çekan në mes dy brinave?!

Dilemë e madhe. Ndërsa shumica thoshin çka të bëhet he mos pyet për ne, se çka na ka ndodhë ne si ka ndodhur kujt. Ne pak veta e dinim se këto sherre për dreq ndodhin, përsëriten sipas disa rregullave e kushteve rigorozisht të caktuara, se kështu u ka ndodhë të gjitha shtëpive të tjera që sot i kanë punët më mirë se ne, dhe i thonim shumicës që të mos nguten.

Nejse, ish kanë pas shkrue.

Mezi i ndamë e ne e dimë se si i nxorëm të gjallë edhe njëherë prej thonjve të njëri tjetrit. Ne u përziemë në atë nguti. Ne që kishim disa njohuri të punëve të odës u kthyem menjëherë në shtëpi dhe filluem t´i konsolidojmë radhët. Në tollovinë e krijuar në shtëpi hyri edhe ndonjë djalë i vyeshëm, sepse kur kishte plasur sherri kishin thënë se këtë e bënë për interes të shtëpisë e jo të vetin.

Dhe çka mësuam me kalimin e kohës?

Kuptuam se djemtë e mëdhenj flasin me gjuhë të njejtë, edhe pse e kanë atë adet të keq për me ia ngjit për fyti njëri tjetrit, e nganjëherë përpiqen ta plasin njëri tjetrin. Por kur jemi ne në pyetje, ata janë prapë në gjendje të bëhen vëllezër të pa shibla si më parë, që të gjithë ju me thënë se këta të dashtun kurrë gjë të keqe në mes veti nuk kanë pasur. Zatën gjoja sherri jonë u prishën, sherri i grave e fëmijëve, se vëlla për vëlla këta kurrë nuk munden me gjetë më të mirë. Pastaj merreni me mend fjalën vëlla. Nuk ke ku e çon.

Këta pajtohen prapë, aq i thellë është morali i tyre në të cilin betohen orë e çast, sikur ne të pranojmë me u çua pite e përpeqa në odë, gjë të cilën nuk do ta pranojmë më. Ata veç së bashku kanë filluar të na bërtasin në stilin:

Hyni brenda e shuani më, se na bëtë gaz para botës.

Ne si japim pesë para për mysafirët, për sekretet e për kacafytjet e odës. Ne nuk na vjen turp që mysafirët tanë t´i presim në shtëpi. Ne prej tonëve nuk i fshehim harrnat e qilimave. Këto janë pra problemet e brendshme të familjes sonë.

Si duken problemet e jashtme?

Problemet e jashtme zhvillohen në këtë formë: Ne si familje e madhe nuk po mund të jetojmë më në këtë shtëpi. Gjatë gjithë këtyre viteve, ne përkundër punëve të brendshme kemi pre tulla, kemi thye gur në male, kemi sigurua armaturë, tjegulla, dyer e dritare së bashku me shumicën e veglave të punës. Jashtë janë mbledhë fqinjët dhe po sillen rrotull me të gjitha familjet e tyre dhe po shikojnë gjithë këtë material që e kemi mbledhur në truallin tonë.

Fqinji i parë, miku i dhunshëm i yni, i cili po na shtyp egërsisht, thotë: "Shikoni këta, po duan me u nda prej nesh, po duan me na e prishë miqësinë, po fusin sherr në lagjen tonë. Këta na e qitën faqen e zezë para të tjerëve, na koritën. Robët që i kemi në këtë shtëpi të vjetër po na i mundojnë. Po i qesin me mbledhë dorëza e me ecë dathun nëpër tallishtë. As opinga nuk u kanë ble. Ju kemi hy në shtëpi me vrasës të paguar që t´u themi të kenë kujdes se përkundër asaj që robët janë të tyre, gjaku është i yni."

Këtij fqinji të keq, këtij miku të dhunshëm ne i themi: Nëse gjaku juaj nuk po jeton mirë tek ne për këtë fajin e ke ti, dhe pikërisht për këtë je i interesuar ti, sepse ne vend që të më ndihmosh më vjedh qe sa e sa vite dhe më grabitë gjithë çka kam. Ty nuk të intereson që ne dhe gjaku juaj në shtëpinë tonë të jemi mirë. Këtë miqësi të dhunshme do ta prishim, dhe në vend të saj do të ndërtojmë një miqësi tjetër me ty dhe me pesë familjet tjera. Për të krijuar gjashtë miqësi të drejta, të vërteta është shumë më revolucionare të prishet një miqësi e dhunshme, banditeske e grabitçare.

Plani i shtëpisë është i njejti me atë plan me të cilin janë ndërtuar gjashtë shtëpitë (republikat) tjera. Pesë shtëpitë tjera po shikojnë dhe bëjnë sehir. Miku ynë i dhunshëm i ka gënjyer, ka bërë zhurmë se ne kemi qëllime tjera kushedi se çfarë, por të cilët dalëngadalë po lirohen nga gënjeshtra shoviniste serbomadhe.

Disa bile po na përkrahin më shumë.

Kush po na përkrahë?

Forcat e së ardhmes që thonë të ecim përpara, apo tjetër kush?

Ne po na përkrahë Sllovenia e ndritur, e bukur, e hoteleve, e asfaltit, e Cankarit, e France Kllopčičit. Sllovenia e shekullit XX po ia zgjatë dorën Kosovës së varfër, të baltës, të vuajtjeve, Kosovës së shekullit XIX dhe po i thotë eja të hyjmë së bashku në shekullin XXI.

Dhe në këtë mes, në mes më të diturit dhe më të eturit për dije, në mes më të pasurit e më të varfëritë, në rolin më të mjerueshëm, në rolin më të vajtueshëm dhe më të çoroditur na del serbi i cili shfaqet në shumë role. I cili del herë me uniformën e ushtarit okupues, e herë me penën helm në shtyllat e "Ninit" dhe "Ilustrovana Politikës", herë viktimë e planeve djallëzore të nëntokës së Beogradit në zhurmat për shpërngulje me presion, herë me mjekër së bashku me parullat fashiste, e shumë më pak me një zë të ri, duke e nënshkruar një peticion në Universitetin e Beogradit, apo ndonjë moshatar i yni i cili nga Čačaku i drejton letër redaksisë së një reviste duke i thënë: "Ne më së shumti kemi çka të mësojmë nga Svetozar Markoviči".

Na shurdhoi zëri i zingjirëve të tankeve i cili së bashku me zërin zhurmues të çelësave dhe rropëllimës së hapjes e mbylljes së dyerve nëpër korridoret e burgjeve është mbledhur në megafonin e disa shovinistëve në Kuvendin e Serbisë dhe me çjerrje histerike akuzojnë për gjenocid në Kosovë kundër serbomalazezve, për zhurmën se si të intensifikohet diferencimi (kjo në gojën e një delegati serb në Kuvendin e Serbisë d.m.th. si të intensifikohet dhuna për zhdukjen e një kombi).

Ja që edhe ne djemve të vegjël na rroplloi se si të bëjmë diferencimin sipas mënyrës sonë. T'i tregojmë familjes sonë se edhe në gjashtë shtëpitë tjera janë të gjitha elementet, gjenden të gjitha personazhet, bile në një formë shumë më të përcaktuar se sa

tek ne. Prandaj ta bëjmë këtë diferencim si në kuadrin e familjeve në përgjithësi ashtu edhe diferencimin për secilën veç e veç. Këta që bëjnë zhurmë në Kuvend të Serbisë edhe ata janë djem të vyeshëm, d.m.th. zëdhënës të Karagjorgjeviqve, prej Germani e gjer tek Pimeni. Këta e kanë humbur të drejtën të flasin në emrin e vëllezërve tanë të vegjël. Edhe tek ata në një shkallë shumë më të lartë ziejnë sherret e brendshme. Për këtë nuk mund të gjesh provë më të mirë se sa zhurmën e tyre kundër nesh, e cila duhet të na shërbej si termometri më i mirë për matjen e temperaturës së kazanit i cili zien në reshonë Kalemegdanit.

Çka thonë këta që na e duan të keqen e përvetshme, si thonë, e që në këtë rast e keqja e përvetshme në mënyrë automatike bëhet një e keqe e përgjithshme?

Thonë se gjoja ne duami të bëjmë shtëpi me ndonjë plan tjetër. Disa thonë rrini në këtë se edhe këtë çka e keni tepër e keni. Të tjerë shtojnë se ne duam diçka shumë më të mirë p.sh. si ato në Evropën Perëndimore, apo si ndonjë në jug. Në të vërtetë as dreqi nuk e din se si rrotullohen pretekstet e tyre brenda natës.

Kryqëzimi i sherreve të brendshme me ato të jashtme

Tani mbani vesh mirë se erdhëm në atë nyjën ku sherret e brendshme kanë lidhje të shkurtë me sherret e jashtme.

Çka na thonë djemtë tanë të vyeshëm kur konfrontohemi me çështjet e jashtme? Thonë rrini këtu, s'u ju nuk ju njeh kush! Se ne na kanë thirrë, se ne na ka takua me shkua nëpër vizita, se ne kemi përvojë e stazh, se jemi kalitë në revolucione, se ne kemi dëshirë me e mbajt flamurin për një këmishë e mollë të verdhë të ngulur në shtizë. Ju nuk dini me mbajt shtëpi. Ju nuk dini çka është nderi, çka është fytyra. Ju nuk jeni konopa për shtëpi. Juve kur u vjen dikush që është në zor për ndonjë sharrë, tërfurk e grebujë bëni turrë me ua dhënë e gëzoheni më shumë që po i jepni se sa ata që janë ardhë me marrë. Pra ju keni më shumë dëshirë me dhënë se sa me marrë. Ju trup keni, por mendtë ende i keni të fëmijëve. Ju jeni rritë me një parë mend.

Këto pra i thonë djemtë e vyeshëm për ne!

Çka do t'u themi ne atyre?

Sa i përket mbajtjes së flamurit për një këmishë në dasma të fqinjëve, me ne në këtë pikë ju kurrë nuk keni me u prishë, se ne kurrë nuk do të bëjmë turr me ua hangër hakun. Sa i përket nderit, moralit, emrit të familjes, stazhit, ne ua kemi provuar se të gjitha këto për ju, po t'i mbledhim, nuk japin më shumë se një kolltuk të fëlliqur, në të cilin jeni në gjendje të fëlliqeni natë e ditë e të mos lëvizni fare prej tij nga frika se mos po ua zenë kush. Ky kolltuk i fëlliqur vetëm juve u takon, ky është pra ai "vendi që u takon", dhe prej këtij vendi askush nuk ka me guxue me u heq. Se ne gëzohemi t'i bëjmë mirë dikujt kur është në hall këtë mirë e keni hetuar. Sa ishim të vegjël kur vepronim kështu nganjëherë kemi ngrënë shuplaka, por edhe kur u rritëm nga trupi, ne po me këto vese mbetëm. Por ne tani sillemi kështu me djersën dhe mundin tonë.

Ju akuzoni dhe na përqeshni se jemi rritë me një parë mend. Kjo është plotësisht e vërtetë. Ne atë tru e kemi. Vetëm se e kemi pasuruar me ide të reja. Truri ynë funksionon në mënyrë të rregullt, në mënyrë konstante. Ne nuk bëjmë halucinacione dhe çmendemi njëqind herë brenda dite. Ne si fëmijë nuk dinim se ka klasa, se ka kufij, se ka burgje, se ka vlerësime në bazë racash e pse ka ushtri. Ne u rritëm. Të gjitha këto po i shohim. Kundër të gjitha këtyre do të luftojmë, por tani si të rritur ne e gjetëm edhe rrugën si t'i luftojmë. Nga utopia socializmin e zhvilluam në shkencë. Pra këtu nuk qëndron ndonjë e pikë e dobët e jona, këtu qëndron pikërisht forca jonë.

Të hedhim dritën e reflektorëve më të fortë në vet nyjën ku lidhen divergjencat e brendshme me ato të jashtme. Ne e tubuam gjithë materialin për shtëpi. Edhe planin e kemi.

Cili është plani i shtëpisë sonë?

Që Krahina Socialiste Autonome e Kosovës të ngritet në rangun e një Republike Socialiste të Federuar. Për këtë material të mbledhur, për këtë shtëpi po flet e gjithë bota. Armiqtë e jashtëm për të na sunduar më shumë, për ta zgjatur sundimin e tyre, thonë se kjo nuk është e vërtetë. Mirëpo pasi këta armiq janë të jashtëm dhe nuk kanë kurrfarë maske, puna me ta është më e lehtë. Puna dhe problemi më i madh pra nuk qenka me sherrin e jashtëm por me atë të brendshëm. Ne brenda i kemi djemtë e vyeshëm, që na duan diçka për së tepërmi, që janë miq të popullit me zemër e me ka krejt. Këta thonë: Ne duami diçka më tepër, se kjo që po kërkon ti o popull është shumë pak. Se ti nuk din me ba tregti, por këtë e dimë ne. Ne e kërkojmë një çmim më të madh. Kështu shkon shtyrja në pazar, në mes djemve tanë të vyeshëm dhe djemve të vyeshëm të fqinjit. Të jashtmit shtyhen e luftojnë për të na zhdukur, ndërsa tanët shtyhen se na duan për së tepërmi, të cilët zemrën më të butë se të qingjit e kanë, prandaj vetëm e vetëm pse u dhimbsemi shtyhen edhe këta. (Mos të gaboj me u shkuar mendja se motivi kryesor i tyre, forca shpirtërore e tyre janë fondet me valuta të huaja apo mendjemadhësia). Këta mendjemëdhenj e lakmitarë mund të jenë në kafene, por mos ua përzieni kafenenë me atdheun sepse ndaheni keq me ta.

Ku del rezultati i gjithë kësaj pune?

Ku është qëllimi i kësaj shtyrjeje?

Qëllimi është i njejtë, qëllimi çon ujë në një mulli. Që koha të kaloi e materialin tonë të grumbulluar ta zej pa e futë në përdorim edhe një dimër. Nga kjo del se ”miqtë e tepërt”, ”të dashurit e mëdhenj”, ”patriotët e pakompromis” nën maskën e dashurisë së madhe, por t’i vështrosh me syrin e së vërtetës dhe jo me syrin sentimental të dalin armiq pa maskë dhe shumë të dëmshëm.

Të hapet zjarri mbi këtë nyje!

Gjaku është derdhur në themele. Të gjithë, pa pritur askend, t’i rrokni kazmat, kacijat, tullat, gurët dhe ashtu siç dini, ashtu siç u thotë mendja e pagabueshme dhe e çliruar prej të gjitha fëlliqësive të psikologjisë lakmitare fillojani punës që të ndërtohet shtëpia jonë. Punoni ditën sa të mundeni. Ndërsa ne do të qëndrojmë këtu natën dhe me syrin e patrembur do ta ruajmë atë që ju e keni ndërtuar ditën. Prandaj të gjithë ata që vijnë natën qoftë për ta lëvizur edhe një guri të vetëm, apo një copë dheu të arës, ne as që do ta pyesim se çfarë gjuhe flet, do ta lëmë në vend.

* * *

Siç po e shihni, në të gjitha këto ngjarje, në të gjitha këto tortura, në të gjitha këto sherre, në gjithë këtë amulli gjithçka zhvillohet sipas një rendi të caktuar. Deri më tani ne kemi ditur se vetëm për të bërë një punë të mirë duhet të ketë rend e mjeshtri, por kjo nuk mjafton. Tani ne mësuam edhe atë që është vështirësia e të gjitha vështirësive, se edhe në punët më të poshtra dhe më të liga, në egoizmin më të fëlliqur gjithçka zhvillohet në bazë të një rendi të caktuar por që bëhet me një shpejtësi aq të rrufeshme, sa vetëm me një memorje të fuqishme duke e kthyer filmin prapa, ne dallojmë çdo detal, ne dallojmë çdo moment kur ndjenja e shtazës e ka mundur atë të njeriut. Ka rregulla arti gjatë ndërtimit të një vepre, por është edhe arti tjetër i shkatërrimit të saj. Të këqijat e brendshme me ato të jashtme janë në një unitet dialektik dhe nuk mund të ndahen.

Ju folëm për djemtë e vyeshëm, për kompetentët, tek të cilët nuk ka kurrfarë rregulli, tek të cilët çdo gjë e përfshinë spontaniteti, të cilët edhe tek ne, në bazë të

rregullave të psikologjisë së tyre prishën çdo rregull, të cilët preokupim të vetëm, preokupim të parë dhe të fundit e kanë "vendin që u takon", punën për të na e mbushur mendjen që t'u japim "vendin që u takon".

Tani ju me të drejtë mund të pyesni se kush jemi ne që i morëm nëpër gojë djemtë e haxhi babës në këtë shkrim dhe në atë paraprak?

Kush jemi ne?

Kush jemi ne që në gjithë këtë amulli, në gjithë këtë pështjellim do të vejmë rregull. Kush jemi ne që jo vetëm djemtë e vyeshëm do t'i instalojmë në "vendin që u takon" por që kemi edhe aso aspiratash që gjithçka që na rrethon në realitetin tonë objektiv ta vejmë në vendin e vet. Ne jemi bijtë e nënës, ne jemi bijtë e nënave, ne jemi Pavël Vllasovët e Pellage Nillovnës, ne jemi Petro Zallamovët e Ana Krillovnës.

Kur i përcolli te dera Haxhi Baba djemve të vyeshëm u tha: "Qëndroni në mesin e artë, mos dilni as të parët as të mbramët, aty do ta keni më së miri. Luftën në mes dy vetave shpesh i treti mund ta fitoj e ky i tretë jeni ju. Po iu përmbajtët kësaj porosie ju do të bëni një jetë shumë të rehatshme." Për ta realizuar këtë mision ai djemve të vet ua la një qese të trashë me të holla të huaja të cilat i kishte mbledhur si kishte ditur vetëm ai.

Kur nëna i përcolli djemtë e vet të vegjël ua tha po ato fjalë që ua tha edhe Shtatë Shaljanëve kur ranë te Shtojt: "Luftoni me gjithë zemër edhe për lirinë time të grabitur. Në asnjë fortunë e në asnjë rrebesh mos u përkulni." Për ta kryer këtë detyrë u dha në dorë atë shpatë, (penë, ide) të cilën bijtë e vet e bartën, brez pas brezi, dorë më dorë, të cilët ranë në fushë të betejës, të cilët dergjen burgjeve të papërkulur, të cilët në shtrat topash i shtriu natyra, të cilët armiku i vrau në atentate nëpër shtetet e Perëndimit.

Konkluzion për bashkimin

E pamë një mekanizëm të cilin e quajtëm si më të përshtatshmin për një masë sa më të gjerë që të kuptohet thelbi i përçarjes. U duk se secila ngjarje sado e vogël që ishte, e ka një bazë të lindjes së vet, ashtu siç e ka më pas edhe pasojën e vet. Kur armiku na e dha edhe një plagë të rëndë, në këtë moshë rinore të Kosovës ne nuk u stepëm. Ne e deshëm bashkimin me gjithë zemër, edhe pse edhe pas atentatit të 17 Janarit 1982, përkundër goditjes së rëndë u treguam me fakte se ishim më të përgatiturit për vazhdimin e betejës. Ky fakt nuk na e rriti mendjen asnjëherë. Në ditët pas bashkimit, kur barra më e rëndë kishte ra mbi një grusht shokësh, pikërisht intrigat më të mëdha po kurdiseshin kundër tyre nëpër disa qytete të Zvicrës dhe Gjermanisë. As materialisht e as moralisht nuk kishim përkrahjen e tyre. Ndihma e vetme ishin artikujt dhe informatat që vinin në redaksi, por kjo përkrahje neutralizohej me një bilanc shumë negativ nga lumi i shpifjeve prapa kurrizit.

Një vit i tillë lufte me nerva të tendosura, një vit lufte në shumë drejtime na lodhi aq shumë sa na rraskapiti. Përkundër të gjitha këtyre, menduam se të gjitha këto me kohë do të kalonin, se ishin pjellë e një situate të jashtëzakonshme. Besuam se këta shokë ishin më të freskët se kishin më shumë energji, se do të luftonin më shumë dhe më mirë se ne. Për këtë ua dhamë një armë të mprehur në dorë. Por kjo nuk ndodhi kështu. Prej pretendimeve të tyre nuk mbeti asgjë. Aq goditje të mëdha na dha armiku gjatë vitit 1983 sa s'bëhet. Pasi u duk se ushtria jonë ishte çorientuar shumë, ne përsëri rrokëm armë të reja dhe u futëm në zjarr. Për një vit, nga qershori 1984 gjer më qershor 1985 ne u kalitëm aq shumë, u bëmë aq të fortë sa nuk do të na mundë askush.

Në tavolina mund të ketë armëpushime, mund të ketë marrëveshje për luftë kundër armikut të përbashkët. Në pikat që mund të merremi vesh mund të ketë bashkëpunim.

Bashkimi ka rend. Bashkimi i çeliktë, bashkimi i pathyeshëm i bolshevikëve (shumicës socialdemokrate) të Kosovës ka me u bë vetëm në fushën e betejës ku ka me u vu në provë trimëria, urtësia dhe pathyeshmëria.

(Skicat e këtij punimi i ka bërë gjatë një qëndrimit në Bruksel; Këtë punim e përfundova në Stockholm, dhe u botua në Zërin e Kosovës, Suedi, korrik 1985)

26. Letër e hapur e Hysen Gërvallës

Letër e hapur
Tri grupeve që, respektivisht organizatave që luftojnë në emrin e LRSSHJ-së

Që në fillim e shoh të udhës të theksoj se propozimi i parashtruar më poshtë, është mendim i lirë, i mbështetur në qëllimet më të sinqerta, të cilat ia ka imponuar koha dhe momenti çdo njeriu të ndershëm të popullit tonë e që jam i bindur se i ka parasysh secili prej jush.

Para së gjithash mendoj se të tri grupet duhet ta studiojnë këtë propozim në mënyrë sa më objektive, të paanshme e pa pasione dhe të marrin qëndrim, duke patur parasysh gjithnjë interesin e përgjithshëm dhe rrugën, e cila na shpie drejt qëllimit për realizimin e kërkesës së popullit tonë – konstituimin e Republikës së Kosovës në kuadrin e Federatës Jugosllave.

Ashtu siç është e ditur, duke filluar nga data 17 shkurt 1982, u bashkuan LNÇVSHJ dhe PKMLSHJ; respektivisht më 15 maj 1982, këtij uniteti iu bashkangjit edhe OMLK-ja. Këto grupe formuan organizatën e vetme, e cila veproi nën emrin LRSSHJ.

Duke u mbështetur në këto fakte, krijohet bindja se ky bashkim ishte vetëm formal e jo esencial. Këtë e dëshmojnë edhe ngjarjet të cilat pasuan dhe sollën deri te shpartallimi i Lëvizjes.

Mirëpo, siç thotë Lenini, bëhet një bashkim i cili dështon për të ardhur deri te një bashkim i fuqishëm (duhet të ndahemi që të bashkohemi!)

Prandaj është e domosdoshme që të bëhet një bashkim i vërtetë dhe esencial i tri grupeve, respektivisht organizatave të lartpërmendura.

Madje, edhe nëse ekziston ndonjë grup apo organizatë tjetër me orientime dhe qëllime të drejta, mendojmë se është e udhës t'i bashkohet Lëvizjes së përgjithshme.

Përvoja historike e popullit tonë dhe lëvizjet e shumta të popujve të tjerë, kanë dëshmuar se bashkimi bënë fuqinë, garanton fitoren dhe sjell deri te shpëtimi kombëtar, kurse shkapërderdhja e distribuimi i forcave çon në dështim, në zvetënim dhe në katandisje të lëvizjes.

Në bazë të këtyre dal me këtë propozim:

-që te tri grupet t'i autorizojnë përfaqësuesit e vet me të gjitha kompetencat e duhura, prej 3-5 vetave.

-bashkimi të bëhet pa asnjë kusht nga të tri grupet ekzistuese, respektivisht organizatat. (Po deshëm të arrihet mirëkuptimi, duhet t'i hedhim poshtë të gjitha pretendimet se njëra është e drejtë, se tjetra është më e fortë, apo se "akcila" është koka e kombit shqiptarë, pretendime këto megalomane, tendencioze, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi shkojnë në dobi të armikut e që pengojnë bashkimin e lakmueshëm).

Edhe pse nuk mund të mohohen anët pozitive të luftës që është zhvilluar nga këto grupe, lufta e zhvilluar që nga koha e bashkimit formal, ka qenë më tepër luftë në mes grupesh dhe individësh se sa luftë kundër armikut.

Që të shkohet përpara dhe të eliminohen të gjitha anët negative të këtyre grupeve është e domosdoshme të arrihet bashkimi i tyre në një organizatë të vetme dhe të njësuar, në mënyrë që tërë aktivitetin e vet ta drejtojë kundër armikut – shovinistëve serbomëdhenj dhe të tjerëve që na bëjnë pengesa në realizimin e kërkesës së popullit shqiptar për formimin e Republikës Socialiste të Kosovës në kuadrin e Federatës.

Mendoj se kjo do të arrihet:

1. – me shkrirjen e tri grupeve në një organizatë të vetme e cila do të emrohet: Lëvizja për Republikën Socialiste të Kosovës në Jugosllavi.

Arsyetimi:

Republikat ekzistuese në Jugosllavi emërohen sipas emrit të territorit, p.sh. RS e Sllovenisë, RS e Kroacisë etj. Prandaj e shoh të arsyeshme që të emërohet kështu edhe RS e Kosovës, në mënyrë që mos t'i mbetet rrugë dhe mundësi askujt të na sulmojë gjoja se kërkojmë Republikë "të pastër etnike".

2. – duke pasur parasysh se "Zëri i Kosovës" është Zëri i tërë popullit shqiptar në Jugosllavi dhe i atyre në mërgim, që thërret për një Republikë në kuadrin e Federatës, e shoh të arsyeshme që të mbetet emri i organit "Zëri i Kosovës".

3. – Simbolet e gjertanishme siç janë stemat dhe pushka me flamur duhet të hiqen, pasi për këto simbole duhet ta jap fjalën vet populli i Kosovës dhe ta përcaktojë vetë stemën për Republikën e tij.

-Arsyetimi:

Pushka me flamur nuk përputhet me platformën e kërkesës së popullit tonë në luftën e tij për Republikë pa përdorimin e dhunës.

Do të ishte mirë që simbol i organit të jetë libri dhe pena, të cilat në këtë moment dhe në këto rrethana specifike do të simbolizonin luftën tonë me libër e me penë dhe me mjete tjera demokratike pa u përdorur dhuna.

Lëvizja përfundimisht duhet të distancohet nga të gjitha format e luftës që mbajnë erë baroti, njëherit mendoj se është me vend mos t'i imponojë Jugosllavisë asgjë tjetër, përveç realizimit të kërkesës për konstituimin e Republikës së Kosovës, respektivisht LRSKJ-në. Jugosllavia nuk duhet të luftohet as si shtet, as në pikëpamjet e sistemit shoqëror dhe kam bindjen se me konstituimin e kësaj Republike, populli shqiptar në Jugosllavi do të jetë i barabartë me të gjithë popujt e tjerë të Federatës dhe të menjanohet rreziku i ndonjë konflikti më të gjerë në përmasa Jugosllave e Ballkanike. Për derisa populli shqiptar është i persekutuar dhe pa të drejta, nuk mund të ketë paqe dhe qetësi as për popujt e tjerë që e përbëjnë Federatën.

Këto që u cekën edhe shumë të tjera që mund të nënkuptohen, na bindin se ndihma jonë po që se është e drejtë, do të jetë shumë e madhe, po të mos jetë e drejtë – kontributi ynë do të jetë i vogël, sepse populli e di mirë rrugën e vet. Pra, bashkimi do të reflektohet si besëlidhje në vazhdimësinë e fitoreve tona dhe do të tregojë qartësinë e pjekurinë e përgatitjes sonë për luftë. Besëlidhja e fortë ka qenë gjithnjë kushti i parë, i cili ka shpënë në fitoret e pareshtura dhe përfundimtare. Na kanë mësuar rrugët e gjata dhe të hidhura se vetëm të bashkuar mund të luftojmë drejt, se gabimet e bëra gjatë luftërave të kaluara duhet të na shërbejnë si mësime të shtrenjta. Nga ana tjetër luftërat mes grupesh gjithnjë

janë paraqitur në momente kur na ka humbur qartësia, por atë – qartësinë – e kemi gjetur së shpejti, jemi bashkuar pa pengesa, duke i eliminuar gabimet e vogla, kurse të mëdhatë i kemi zvogëluar dhe kështu ka ecur shqiptari nëpër rrugën e historisë, i munduar, por kurrë i thyer, kurrë i asgjësuar. Kjo qëndresë u arrit përherë duke u mbajtur për njëri-tjetrin dhe duke i bërë pushkët strumbullarë në duart e bashkuara dhe të fuqishme.

Po që se ky bashkim nuk arrihet, do të vërtetohet edhe njëherë se në mesin tonë ka njerëz që punojnë për armikun, do të vërtetohet papjekuria jonë në çështjen e madhe, e cila duhet të qëndroj mbi çdo interes personal dhe mbi çdo tendencë individuale dhe subjektive.

Duhet t'ua theksojmë shokëve të ndershëm që të marrin drejtqëndrimin dhe ta thonë fjalën e vet, çdo njëri në emër të kësaj çështjeje të madhe, të distancohet secili pa ngurrim, pa humbur kohë dhe pa luhatje prej grupeve, prej dinastive, familjarizmit, bajraktarizmit, përkatësive primitive fisnore e të odës dhe mbi të gjitha prej "Krerëve" që pengojnë bashkimin; ta thotë secili fjalën e vet haptas, mendimin e vet të lirë e konstruktiv, sepse siç ka theksuar Ismail Qemali, çdo shqiptar i ndershëm ka të drejtë të flasë në të mirë të kombit dhe atdheut.

Nder i madh është të përcaktohesh në shërbim të atdheut, ndërsa tradhti të vihesh në shërbim të individëve destruktivë, sepse forca qëndron në masë e jo në grupe e as individë.

Delemont – Zvicër, 12 korrik 1985

27. Përgjigje në letrën e Hysen Gërvallës

Nga ti, Hysen **Gërvalla** e kemi marrë një letër të datës 12 korrik 1985. Ne e analizuam atë me kujdes, e lexuam disa herë, dhe këtu më poshtë po të japim përgjigjen tonë në letrën tuaj të datës së lartpërmendur.

Ne e dimë se jeni vëllau i madh i dy vëllezërve që u vranë më 17 janar 1982 pranë Shtutgartit. Ky është një fakt shumë domethënës dhe i mirë për ne të gjithë, por për shkak të luftës sonë, karakterit të saj, fazave të zhvillimit të saj, vetëm kjo e dhënë nuk mjafton që ne të merremi vesh në të gjitha pikat.

Prandaj prej teje kërkojmë:

Që të na tregosh për platformën tënde politike, pasi letra është shkruar në emrin personal, pasi ajo nuk na është e njohur plotësisht.

Të na tregosh se ne që na e ke dërguar këtë letër, si për kend na e ke dërguar? Sipas pikëpamjeve tuaja kush jemi ne në këtë rast para teje: A jemi grup, organizatë, dinasti, rreth familjar, bajraktarë, injorantë, grup i përkatësive primitive, komunistë, ballistë, liberal, demokratë apo nuk po e dimë as vetë kush jemi e nuk po e shohim veten. Për këtë arsye ne kërkojmë ta dimë se çka jemi para teje. Çka din ti për programin e statutin tonë dhe si qëndron në raport me to? Çka mendon për gazetën tonë dhe kujt i shërben ajo?

Të na tregosh se kush janë dy grupet tjera, që ua ke dërguar letrën dhe që je optimist se do t'i bashkosh të gjithë në një vend? çfarë pikëpamjesh politike kanë, çfarë interesash mbrohen pas fjalëve dhe deklaratave të tyre nëpër gazeta? Cili është programi e statuti i tyre, pasi ne këto nuk i dimë?

Të gjitha këto pika të ndryshimeve, të gjitha pikat e përbashkëta duhet t'i ketë të qarta një njeri që donë të bashkoj dikend, duhet t'i ketë të qarta një grup i cili donë të bashkohet me një tjetër.

Në të gjitha këto pika duami paraprakisht të sqarohemi më shumë nga ti para se nga ana jonë, të japim ty personalisht çfarëdo mendimi të mëtejshëm lidhur me (iniciativën) letrën tënde të hapur. Në vartësi nga ajo nga ajo se si do të na sqarosh në pikat që shënuam më lartë do të varet edhe qëndrimi e përgjigja jonë në të ardhshmen.

22 korrik 1985, Stockholm

***

(Shënim: Në dhjetor 2025 kësaj përmbledhjeje ia shtova punimin "Baci, Baca dhe Bacaloku", të cilin e pata përfunduar njëkohësisht me përgatitjen e kësaj përmbledhjeje dhe që për herë të parë u botua-publikua në www.shkoder.net, në shkurt 2007)

28. Baci, Baca dhe Bacaloku

Kadri Mani-Osmani: "*Unë ta kam heq kapelën për publicistikë, e ti duhet të ma heqësh kapelën për gjuhësi.*" (Shënim dërguar Xhafer Durmishit, 25 gusht 2009)

HYRJE
Argumentet pozitive të MUPit
I. Çështja e emrit
II. Magjia e germës B apo e numrit 3
III. Individualiteti i Trojkës
IV. Disa aspekte karakteristike të Stilit në punë
V. A ka fat më të madh
VI. Disa nga mrekullitë e Trojkës
VII. Mosmarrëveshjet eventuale të Trojkës
VIII. A ka fat më të madh se me lindë në epokën e Trojkës?
IX. Cili është vendi i merituar i Trojkës?
X. Çka ndodhë me ata që e lëshojnë rrugën e Trojkës?
Argumentet negative të Avokatit të djallit
I. Çështja e emrit
II. Magjia e germës B apo magjia e numrit 1
III. Individualiteti i Trojkës
IV. Disa aspekte karakteristike të Stilit në punë
V. A ka fatkeqësi më të madhe
VI. Disa nga "mrekullitë" e Trojkës
VII. "Mosmarrëveshjet eventuale" të Trojkës
VIII. A ka fatkeqësi më të madhe se me lindë në epokën e Trojkës?
IX. Cili është vendi i merituar i Trojkës?
X. Çka ndodhë me ata që e lëshojnë rrugën e Trojkës?
PËRFUNDIM

HYRJE

Shefi i Katedrës së historisë pranë Universitetit Shtetëror, dhe anëtari me renome dhe ndër më produktivët e Akademisë, prof. dr. Muhë Pirra ka marrë për detyrë nga Institucionet përkatëse që ta përgatisë lëndën, të bëjë atë që ndodhë shumë-shumë rrallë, që simbolet më të njohura të rezistencës, qëndresës dhe luftës sonë; Bacin, Bacën dhe Bacalokun t'i shpallë heronj të gjallë. Shpallja e tyre heronj mund të krahasohet me shenjtërimin që vende e besime të ndryshme u bëjnë figurave më të shquara. Përveç punës tepër të çmuar në Katedrën e Historisë dhe në Akademi, Muhë Pirra apo MUPi, siç njihet ai me emrin përkëdhelës tek të gjithë ata patriot të persekutuar nga udba, për shkak të përkrahjes së flaktë që i ka bërë idesë së ndërtimit sa më të shpejtë të Katedralës Shqiptare, është zgjedhur arkitekti shpirtëror i saj.

Idetë dhe njohuritë e tij të thella do të merren parasysh gjatë ndërtimit të këtij tempulli, ku me qiellin tonë do të flitet në gjuhën tonë, ku çdo kënd do të jetë i shfrytëzuar për bustet e pllakat përkujtimore të shenjtorëve e apostujve të popullit tonë. Idetë e MUPit do të kenë peshë të madhe edhe për atë se a do të rezervohet vend dhe nëse po cili do të jetë ai që në Katedralë do t'u jipet Bacit, Bacës e Bacalokut. Në vazhdim për të evituar përsëritjen e tepruar, nganjëherë, këtë Trekëndësh barabrinjës, këtë Triumvirat do ta quajmë Trojkë.

Deri këtu pra më duket se çdo gjë është e qartë si drita e diellit dhe nuk ka asnjë befasi për lexuesin e vëmendshëm. Ajo që është paradoksale dhe e papritur është fakti se çfarë kam unë të bëjë në këtë mes, të përzihem në këso farë punësh, kur dihet mirë se kushti më elementar për t'u marrë me simbole është që edhe vetë të jesh simbol.

Sado e çuditshme të duket, ka qenë kërkesë e vendosur e MUPit që të më zgjedhë pikërisht mua, pasi, sipas fjalëve të tij, nuk ka gjet person më të përshtatshëm për këtë detyrë. Si ka mundësi që MUPi me u drejtuar tek unë kur unë kurrë nuk kam qenë në spisak të tij. Arsyeja e vërtetë në këtë pikë është se ai të dhënat për mua ai i ka marrë nga Orakuli i Delfit. MUPi e ka përgatitë dosjen me fakte të shumta për veprën e jashtëzakonshme pozitive të protagonistëve tanë. Ai e ka marrë në përgjegjësinë e vetë arkivin e Trojkës, ndërsa roli im i përngjan "avokatit të djallit" (advocatus diaboli), d.m.th. si përçarës i vjetër dhe armik i përbetuar i idesë së pajtimit kombëtar, të "sulmoj" pozicionet e Trojkës dhe me këtë të vej në dyshim vendin e tyre pranë apostujve në Katedralë.

Këtu më poshtë në mënyrë të përgjithësuar e të koncentruar (versioni i tyre i plotë gjendet i mbledhur në disa vëllime në arkivin e Akademisë), së pari do të jipen argumentet pozitive të MUPit.

I. Çështja e emrit

Ne si akademi, dhe mbarë populli e dimë mirë se kush janë Baci, Baca e Bacaloku. Posa të përmenden këta tre emra prezantimi i tyre i mëtejmë bëhet i panevojshëm. Po të mos ishte momenti i një solemniteti të veçantë, në çdo rast tjetër prezantimi i Tyre do të ishte jo vetëm i tepërt, jo i ndershëm por do të ishte e kundërta, pra një ofendim skandaloz dhe i paturpshëm. Ne qarqet tona dhe në çdo rreth me moral e edukatë i thërrasim me emrat folklorik ashtu siç i njeh populli. Është e pamundur të mos indinjohemi kur na bien rasti (edhe pse jashtëzakonisht rrallë) që dikush të marrë paturpësinë dhe t'i thërras këta

në emrat që ua kanë lënë ndrikullat, thuase i kanë ruajt lopët apo dhentë me ta. Emrat Atyre u janë dhënë si një lloj titulli me të cilin shtresat më të gjëra të popullit tregojnë respekt për ta, tregojnë lojalitetin e vetë të pakufi ndaj tyre. Në këta emra masat tona kanë bërë be, janë përbe e janë betuar.

Është masa e popullit të thjeshtë, të çiltër e të pastër që i ka detyruar Këta të mësohen me këta emra përkundër kundërshtimeve të tyre.

II. Magjia e germës B apo e numrit 3

Ekziston mendimi se Baci, Baca e Bacaloku mund të quhen edhe Baballarë, Etër apo Atllarë të kombit. Se këta Tre, një kohë e kanë kaluar nëpër burgje. Këtu nuk është me rëndësi të diskutojmë se cili ka vuajtur më shumë e cili më pak. Këtë nuk mund ta marrim në diskutim pasi ata vetë nuk kanë dashur të flasin për këtë vetëm e vetëm për të mos i dhënë armikut shkak për të futur përçarje në mes tyre. Armiku i ka pas në shënjestër pasi Këta kanë kërkuar dhe e kanë mbajtur lartë bajrakun e bashkimit gjithëkombëtarë. Që të treve u takon merita se e kanë arritur bashkimin duke e çliruar popullin prej ideologjizmave. Por mbi të gjitha, merita e madhe e tyre është se vendet e qytetëruara na njohin si njerëz që e mbajmë fjalën e dhënë, pra si njerëz të besës.

III. Individualiteti i Trojkës

Sado të ngjashëm të duken në vështrim të parë emrat e Tyre, e në kokat e pagdhendura dhe të painformuara mund të bëhen përzierje duke menduar se nuk kemi të bëjmë me Tre veta, por vetëm me Një, gjenialiteti i masës i kombinuar me gjenialitetin e heronjve të gjallë tregon se kemi të bëjmë me një origjinalitet të rrallë i cili nuk lenë kurrfarë vendi për përzierje.

Pra vetë emrat e Tyre janë garancion i madh që ne dhe gjeneratat e ardhshme nuk do t'i përziejnë këta me njëri-tjetrin apo këta Tre t'i thjeshtojnë në Një.

Mund të mendohet se veti dalluese në mes Tyre mund të jetë mosha, vendi i lindjes, data e lindjes, të dhënat e prindërve etj. Këto janë mënyra për t'i dalluar individët anonim të turmave, të cilëve u jipet një medaljon në qafë apo ngjitet një numër serial në vesh. Zbatimi i këtyre kritereve tek Trojka është i padenjë dhe siç është thënë më lartë është ofendim e gjynah i pafalshëm.

Pra mosha e tyre e as koha e burgut dhe e persekutimeve nuk mund të merren si kriter dallimi. Prandaj e vetmja mënyrë interesante dhe e denjë e dallimit të tyre është ajo se në çfarë mënyre këta janë të mbërrimë, në çfarë mënyrë janë të përsosur, se në çfarë mënyre u komunikohet njohja absolute e botës.

a) Baci është një njeri që me keqardhje të madhe i përcjellë dredhat e përdredhat e ideve të njerëzve të vdekshëm, sidomos kur e sheh se sa larg prej mendjeve të tyre është gjer tek e vërteta. Ky e ka gjetur burimin e të vërtetës. Mësheftësitë e të gjitha mistereve i shfaqen krejtësisht të zbërthyera në ëndrrat e tij. Këto i merr dhe në mënyrë strategjike ia shfaq parisë së popullit dhe me këtë e kursen prej vuajtjeve të panevojshme e prej humbjes së kohës. Pra atributi, vetia veçuese e Bacit nga dy të tjerët është ëndrra.

b) Bacës i shfaqet e vërteta në një mënyrë krejt tjetër. Është edhe një emër tjetër i përshtatshëm për Bacën. Atë do të mund ta quanim edhe Pogllavicë, pra Pogllavica i të gjitha fiseve tona. Ky të vërtetën dhe fshehtësinë e fuqive natyrore e sheh në shullungat e tymit të duhanit që del nga llulla e vetë dhe e

bashkëbiseduesve të vetë. Në çadrën i tij për këtë qëllim përherë i mban rreth njëqind lloje të duhanit.

c) Nëqoftëse ndokush në vendin tonë me të vërtetë e meriton epitetin njeri i letrave atëherë pa dyshim ky është Bacaloku. Pra bacaloku nuk merret vesh në analizimin e ëndrrave e as në tymit të duhanit por vetëm në letra, në karta. Nuk ka ndodhë asnjë rast, sado i koklavitur të ketë qenë, që Bacaloku nuk e ka zgjedhë me anë të 52 kartave të tij.

IV. Disa aspekte karakteristike të Stilit në punë

a) Nga stili i Bacit

Për Bacin vlen thënia "trimi i mirë me shumë shokë". Të gjithë shokët e Bacit janë të mirë, e donë Atdheun, janë kuadro të formuara.

Para çdo aksioni, para çdo vendimi me rëndësi, Baci e ka për adet me i pyet shokët se mos rastësisht ndonjë prej tyre është gjynyp. Thonë se Baci është aq i përsosur sa është i vetëdijshëm (apo i ka ndodhë edhe në të vërtetë) që kur nuk i ka shkuar puna mirë në ndonjë betejë përkundër përgatitjeve të hollësishme, e ka ditur se shkaku për këtë qëndron në atë se dikush nga radhët e tij është gjynyp dhe posa është larguar ai, menjëherë punët e kanë marrë të mbarën. Se edhe një gjynyp i vetëm ia bythprap të gjitha punët e ia humbë betejën. Për këtë shkak thonë se Baci kurrë nuk rrinë pa abdes.

Pra në radhët e Bacit asgjë nuk i lehet rastit. Asnjë gabim e devijim nuk tolerohet, pasi po të bëheshin lëshime atëherë shkaku i një të keqi do të vuanin gjithë të mirët, pranë një druri të thatë do të digjeshin gjithë të njomët. Pra në rrethin e Bacit kooptimi bëhet vetëm (pasi kandidati të jetë larë në hamamxhik) me pajtimin e të gjithë shokëve.

Baci kurrë në asnjë takim me rëndësi nuk ka dalë vetëm, pa shokë e pa dëshmitarë. Në rast nevoje i ka shty takimet e të gjitha punët vetëm e vetëm në mënyrë që në takime me palë të ndryshme të paktën të ketë një apo më shumë shokë.

b) Nga stili i Bacës

Baca apo Pogllavica, pjesën më të madhe e kalon në çadrën e tij, dhe pothuajse tepër rrallë ka nevojë që të udhëtoj ndokund pasi të gjitha punët me rëndësi, konsultat e të tjera kryhen në çadrën e tij në të cilën i mban llojet e ndryshme të duhanit, me të cilin mbushen llullat e ndryshme varësisht nga situata e rangu i atyre që kërkojnë këshillat e tij. Një aspekt që e vështirëson largimin e Pogllavicës nga çadra është uniforma e tij me të gjitha pendlat e shqiponjës. Thonë se vetë Baci dhe Bacaloku shkojnë në çadrën e tij për t'u konsultuar e lëre më të tjerët. Ka mendime se Baca është aq i dobishëm për popull sa as ai vetë nuk është krejtësisht i vetëdijshëm për këtë. Edhe keq me u mundua me folë atij prapseprap fjalët i bien aq mbarë sa nuk mundet askush me i luejt.

Ai është dëshmia më e gjallë e autoktonisë sonë në trojet tona. Malet, lumenjtë, liqenjtë, kanjonet janë sfondi i Bacës, jashtë të cilave nuk mund të duket madhështia e tij.

c) Nga stili i Bacalokut

Për Bacalokun thonë se është asi burri që shoq të gjallë nuk ka.

Disa mund të thonë se Bacaloku është ujk që punët e veta i pleqnon vetë. Kurrë në karrierën e vetë të lavdishme nuk ka dalë në asnjë takim me asnjë shok. Gjithmonë takimet me të tjerët i ka bërë vetëm. Këtë ai e bënë me të vetmin qëllim që t'i shpëtoj shokët e tij të shumtë nga gjërat e tepërta. Pjesëmarrja e tyre ka qenë e panevojshme pasi Bacaloku ka pasur besimin e tyre të paluhatshëm. Nga kjo del se në rrethin e vetë Bacaloku ka qenë dhe është i vetmi njeri i pagabueshëm, i pastër dhe me veprimin e vetë

i ka shpëtuar të gjithë shokët. Për punën e Bacalokut mund të thuhet e kundërta nga ajo që e kishim tek Baci: pra, tek Ky, pran të mirit shpëton edhe i keqi. Del një i drejtë e i shpëton gjithë të shtrembërit, del një i drejt e ia sheh hajrin gjithë vendi, del një i pastër e i shpëton të gjithë gjynypat, del një i larë e i shpëton të gjithë të palarët.

Pa Bacalokun nuk ka kishin hangër as qentë.

V. A ka fat më të madh

A ka fat më të madh se sa në të njejtën kohë me i pas tre liderë të fuqishëm të formatit botëror, të cilët armiqtë tanë mezi po presin për të na i përvetësuar?

Ka mendime të shumta dhe besime në popuj të ndryshëm se brenda një periudhe të caktuar kozmike, vetëm një mundet me qenë i përsosur, më i dituri, i mbërrimë, e i zgjedhur. Është çështje delikate e Akademisë t'ia qartësoj popullit tonë se Tre heronjtë tanë janë të mbërrimë dhe na janë paraqitur në të njejtën periudhë kozmike.

Ka pasur mendime para qindra vjetësh se "Më i mirë është një gjeneral i keq se tre të mirë!" apo "Tre Atllarë në një mullar nuk lidhen".

Tek çdo popull tjetër paraqitja e Tri figurave të tilla me aftësi për hipnotizimin e masave e tërheqjen e tyre pas vetes do të paraqiste burim për konflikte të pandërprera. Është hera e parë që kjo nuk ndodhë dhe atë në kundërshtim me të gjitha parashikimet. Kjo është arrit përmes mirëkuptimit vëllazëror e shumë të drejtë që mbretëron në mes tyre.

Mirëkuptimi i sinqertë, pajtimi, fryma vëllazërore që mbretëron në Trojkë janë garanca më e plotë se vendi ynë ka hy në fazën e një stabiliteti një mijë vjeçar. Kërkesa për Trojkën dhe çmimi i saj në tregun botëror të patriotizmit është i pallogaritshëm. Është hera e parë në histori që tri figura të tilla lajmërohen në të njejtën kohë dhe në të njejtin vend dhe flasin në të njejtën gjuhë dhe të krijojnë një unitet të paparë.

Mirëkuptimi i Trojkës lidhur me ndarjen e hapësirës

Është e vërtetë se këta e kanë ndarë vendin në sferat e veta vetëm e vetëm me qëllim që shërbimet e tyre të shfrytëzohen në mënyrë optimale. Por qëllimi i ndarjes së vendit në domenet e tyre ka edhe një anë tjetër dhe ai është që të mos i lejohet asnjë tradhtari apo të pabesi të ngulitet në trojet tona.

Mirëkuptimi i Trojkës lidhur me ndarjen e kohës

Shihet qartë se me dashtë këta të Tre secili ka mund ta ketë kalendarin e vetë.

Secili ka aftësi për ta llogaritur kohën në mënyrën e vetë por këta nuk kanë dashur ta bëjnë këtë.

Në mënyrë vëllazërore janë marrë vesh që të ketë vetëm një kalendar.

Këta janë marrë vesh dhe janë koncentruar në kohën e tashme dhe punojnë me tri ndërrime, secili nga 8 orë. Këta e zëvendësojnë njëri-tjetrin tërë kohën sa herë që ndonjëri nga ta mund të sëmuret apo të jetë në pushim vjetor. Secili prej tyre shtyhet që të punoj sa më shumë në mënyrë që kolegut të vetë t'i jep sa më shumë kohë të lirë për pushim e rekreacion.

VI. Disa nga mrekullitë e Trojkës

1. Pastrimi i çështjes prej ideologjizmave

Një nga mrekullitë e Tyre mund të thuhet se në mendimet e Tyre kurrë nuk ka pasur lëkundje apo ndërrim e revizionim të ideve.

Kur jemi tek Trojka përjashtohet mundësia e çfardo konflikti për shkak të ideve, pasi këta janë të liruar nga çdo ideologjizëm d.m.th. nga çdo ide.

A ka meritë më të madhe se me e pastrua çështjen lirisë e të mirëqenies prej ideve?!

2. Nisja nga zeroja

Trojka është krijuese. Ajo nuk ka trashëguar asgjë.

Është fakt i padiskutueshëm se Këta në punën e vetë për çlirimin e Atdheut, për krijimin e shtetit janë nisë prej zeros.

Është fakt se populli ynë dhe të gjitha punët e tij janë sjellë në rreth derisa kanë ardhë këta dhe i kanë qitë punët tona në vijë njëherë e përgjithmonë.

Sikur Trojka të mos kishte dalë në skenë dhe me e marrë situatën në dorë, atëherë kish ndodhë më e keqja. Pra ka ekzistuar rreziku real që krejt fati ynë të bien në duart e udbës.

3. Bashkimi i popullit

Si është zgjedhë kjo çështje në vendin tonë?

Partneriteti e përjashton çdo gjë që ka lidhje që ka me fjalën konkurrencë.

Këta në qenien e tyre janë persona që nuk kanë konkurrencë, dhe kurrë Baci, Baca e Bacaloku nuk e kanë konsideruar konkurrent njëri-tjetrin. Vetëm një njeri i tillë i mbërrimë që në natyrën e tij nuk e ka shijuar kurrë konkurrencën, apo në rrugën e tij drejtë majave ku ka synuar ka shpartalluar me lehtësinë më të madhe çdo konkurrencë, e di se sa e dëmshme, sa humbje kohe mund të jetë ajo. Pra këta nuk janë konkurrent dhe nuk kanë qenë kurrë konkurrent në mes veti.

4. Politika e tyre e jashtme

Sjellja e tyre me atë masë, me adhuruesit e njëri-tjetrit gjatë kohës kur Njëri apo Dy nga Ata kanë munguar (me arsye) nga detyra për shkak të pushimit vjetor, sëmundjeve apo marrjes peng nga ana e udbës

Ka ndodhë që në kohë të ndryshme Një apo Dy, për shkaqet e lartpërmendura kanë mungua nga detyra. Në këto dekadat e fundit populli ynë kurrë nuk ka mbetur të paktën pa njërin prej udhërrëfyesve. Ai apo ata Dy që kanë qenë të lirë janë kujdes për simpatizuesit e anëtarët e të Tretit sikur me pas qenë anëtarët apo evladët e vetë, bile edhe më shumë vetëm e vetëm që ata të mos e ndiejnë veten si jetima.

Kurrë këta nuk e kanë shfrytëzuar mungesën e njërit për t'i demoralizuar simpatizuesit e njëri-tjetrit e për t'i poshtëruar, për t'i marrë rob, apo për akuzuar se pse e keni simpatizuar atë e jo mua. Ideja e forcimit të pozitave të njërit në kurriz të tjetrit është e poshtër për ta, është absurde.

Ta zëmë se Baci në një situatë ka qenë në krye të detyrës kurse dy të tjerët të zënë. Në këto situata, edhe pse ai ka qenë i stërngarkuar me punë, kur iu kanë nevojit edhe argat prej balte, nuk ka dashur t'ia prishë pushimin Bacës e Bacalokut. Përkundrazi ai ka insistuar dhe ka paguar mjek specialist që t'ua vazhdoj pushimin.

5. Sjellja ndaj të pakënaqurve me nafakën e vetë

Nuk janë raste të rralla e krejt të panjohura kur dikush nga radhët e njëri-tjetrit, duke menduar se do ta ketë një pozitë më të mirë tek tjetri, të nisur nga parimi se "nuk është vlerësuar si duhet, se po nuk ia din kimetin" shkojnë tek tjetri, duan të këshillohen për ndonjë punë apo shfaqin dëshirë të kalojnë në radhët e tij. Atëherë cilido prej tyre përgjigjet: Ti nuk ke nevojë me ardhë tek Unë kur e ke Bacin, Balalokun e kështu me radhë. Ka ndodhë p.sh. që një anëtarë, përkundër faktit se ia ka dhënë zakletvën Bacit,

shkon dhe i shprehë dëshirën e gatishmërinë Bacës apo Bacalokut që të kaloj në radhët e tij.

Cila është përgjigja, e mënyra e "ceremonisë së pranimit" të këtyre kalimtarëve, të cilët janë vazhdimisht në kërkim të nafakës?

Në këtë rast, ta zëmë, Bacaloku i përgjigjet, se: "sikur mos të isha Ai që jam, kurrë në këtë jetë nuk kisha pasur dëshirë më të madhe se sa me pas qenë nxënës e adhurues i Bacit, se sa të isha në vendin tënd dhe m'u për këtë shkak, në ditën e kijametit, në ditën kur kemi me u ba suhal, ti mund të jesh në pozitë shumë më të volitshme se Unë." Kur i ndëgjon këto fjalë bërësi i zakletvës pendohet, skuqet nga turpi për atë që ka dashur ta bëjë dhe kthehet si i dhiem tek Baci, me vendosmërinë përfundimtare që të mos ç'kapet më prej tij. Kështu pra sillen të Tretë me dezertorët e njëri-tjetrit.

6. Takimet, kuvendet dhe festat

Sjellja në mes veti e Trojkës kur gjenden në të njejtin kuvend, kur janë ftuar në të njejtën festë

Këto raste sjellin probleme jo të vogla. Kemi hetuar se lajmërohen tri probleme. I pari shtrohet para dere, në hyrje. Një kohë të gjatë e kalojnë duke u shty kur këta duan t'i lëshojnë njëri-tjetrit radhën për të hy i pari. I dyti; shtyrje e ngjashme bëhet për ta vendosur njëri-tjetrin në vendin e madh. I treti është insistimi për t'ia dhënë fjalën njëri-tjetrit. Edhe kur, përkundër dëshirës, detyrohen ta marrin fjalën, këta mundohen të flasin sa më shkurt e sa më pak në mënyrë që tjetrit t'i lënë kohë për të folur sa më shumë. Edhe atë kohë që e marrin në dispozicion, nuk bëjnë gjë tjetër pos e citojnë njëri-tjetrin.

VII. Mosmarrëveshjet eventuale të Trojkës

A ka pasur Trojka ndonjëherë mosmarrëveshje?

Instituti i historisë, Katedra nuk ka asnjë dokument që fletë se këta kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje.

A e kanë ofenduar ndonjëherë njëri-tjetrin?

Kurrë!

Krejt rruzulli tokësor është i mbushur me vende duelesh. Kryevepra të letërsisë botërore janë të mbushura me raste ku përshkruhen duele kaubojësh, kalorësish e aristokratësh, por asnjë rast i këtillë nuk ka në vendin tonë. Merita për këtë i takon Trojkës.

A kanë pasur nevojë të idhnohen anëtarët e Trojkës ndonjëherë në njëri-tjetrin? Kurrë! Të gjitha konfliktet, të gjitha kurthat këta i kanë identifikuar menjëherë si vepra të udbës, dhe i kanë zgjedhë në mënyrë vëllaznore.

VIII. A ka fat më të madh se me lindë në epokën e Trojkës?

Kjo mvaret nga orientimi. Kjo mvaret se në cilin taborr gjendesh. Rasti më i mirë por është i jashtëzakonshëm që dikush të ketë pasur punë me të Tretë. Ta ketë mirë me të tretë, të jet pëlqyer prej të treve.

Fat i mirë është nëse je kingj i butë për t'i thithë Tri (dy) nana.

Këta i takojnë rangut më të lartë. Kjo është fatlumësia më e madhe. Shumica e banorëve të vendit tonë në këtë pyetje të paevitueshme, me të cilën ndeshen gjatë mbushjes edhe të formularëve më elementarë në organet shtetërore, përgjigjen për atë se kujt i besojnë më së shumti, për kend janë të lidhur, apo mbas kujt janë kap.

Mjafton të jesh me njerin që të llogaritesh në mesin e fatlumëve, pasi këta në bazë të marrëveshjes për partneritet ua njohin stazhin të gjithë anëtarëve. Në rast të naivitetit e verbërisë politike del ndonjë pabesimtarë e thotë se nuk jamë me asnjerin, atëherë këta, me të drejtë e marrin në brina dhe e bëjnë pishman pse ka lindë. Nëqoftëse dikush del kundër të Treve atëherë nuk ka çfarë të thuhet për te, pos e pas vehten në qafë. Pra e keqja më e madhe është mos me u kap pas asnjërit.

Ai që mundohet me i konkurrua e sheh menjëherë se nuk ka ku me ngulë.

I vetmi ngushëllim i gjeneratave të kaluara ka qenë shpresa për ardhjen e epokës së Tyre.

IX. Cili është vendi i merituar i Trojkës?

Nuk ka dyshim se djem më hallall se këta vendi ynë nuk ka pas prej se u kurdisë dynjaja. Ekziston një legjendë shumë e lashtë që është përcjellë gojë mbas goje, me shekuj të tërë se liria e vërtetë dhe e pacënueshme vendit tonë do të vij kur ai t'i ketë "Tre djem hallall që e duan Atdheun më shumë se sa vehten." Si Tre djem hallall që janë, vendi i tyre përfundimtar është parajsa. Monumentet e tyre në Katedralë, për këta Atllarë duhet të jenë sa më afër altarit.

Si njeri i historisë mendoj se duhet ndërtuar edhe një ndërtesë ku të ruhet Arkivi i Tyre. Kjo fjalë e imja kam shpresë se do të jetë më e forta dhe më e mira, e cila do të gjendet në faqen e parë të arkivit të Bacit, Bacës dhe Bacalokut.

X. Çka ndodhë me ata që e lëshojnë rrugën e Trojkës?

Në § 10, që është edhe pika e fundit e dekalogut të Trojkës e do rendi të shqyrtohet çështja e atyre që devijojnë dhe largohen nga rruga e drejtë.

Në Statutin e tyre thuhet:

"Ai që dezerton, ai që nuk na beson, ai që tradhton, ai që ka qoftë edhe një fije dyshimi në madhështinë tonë, jo vetëm që mbetet pa iman por bënë asi gjynahi që shpërblehet me vdekje."

Pasi ta kesh dhënë zakletvën e vetmja mënyrë e ndarjes me ta është vdekja. Moralisht do të ishte shumë punë e keqe, sidomos për autoritetin dhe nderin e moralin e Trojkës, me dalë fjala se dikush e ka lënë Bacin, se dikush ua ka kthye shpinën. Me e lënë Baci apo Bacaloku dikend, apo kend të dojë, e me ua kthye shpinën nuk është asgjë, as nuk ka kush për t'u marruar pasi Baci apo Bacaloku këtë të drejtë e kanë nga pozita e lartë që e kanë fituar.

Ky nen ka për qëllim që të forcoj unitetin, t'u jep nasihat të tjerëve, në mënyrë që ata që janë kapë pas tyre të lidhen edhe më shumë në një unitetet të fuqishëm në të cilin do ta thejnë kokën tradhtarët e të pabesët. Ata që ia kthejne shpinën Bacit, Bacës e Bacalokut shpërblehen me vdekjen. Dënimi më i madh i shqiptohet sidomos atij që nga ta largohet i pari.

Argumentet negative të Avokatit të djallit (advocatus diaboli)

Për simbole mund të flas vetëm ai që edhe vet është simbol

Shtrohet pyetja; Pse Muhë Pirra, apo MUPi më ka zgjedhur pikërisht mua që të jap argumentet e mia, për të cilat jam i bindur se tregojnë natyrën e vërtetë të Bacit, Bacës e Bacalokut?

MUPi ka insistuar, pasi ai ka fakte të padiskutueshme se unë mund të merrem me këto simbole pasi edhe vet jam apo kam qenë simbol, në përputhje me të gjitha kërkesat e folklorit. Edhe unë mund të lavdohem se emri im fillon me germën b. Sa i përket burgut nuk kam argumente që mund të shtyhem me Trojkën. Është e vërtetë se si i pangueshëm i kam kaluar disa javë në popravni dom dhe nga aty jam liruar si i rehabilituar. Ndërsa anëtarët e Trojkës kanë dalë nga burgu të pathyeshëm d.m.th. të papërmirësueshëm.

Në bazë të cilave merita mund të pretendoj se edhe unë jam simbol?

Është e vërtetë se tri herë në karrierën time kam qenë Bullan.

I bazuar në këtë fakt, detyra që MUPi ma ka dhënë nuk ka të bëjë vetëm me kundërshtimin e hedhjen poshtë të argumenteve pozitive të tij. Ai më ka premtuar solemnisht se nëse fuqia ime argumentuese do të jetë bindëse e me anë të cilës do të deklasohej mundësia e Trojkës për vend në Katedralë, atëherë si simbol, ka gjasa, jo vetëm teorike, që vendi i paramenduar për Ata të më jipet mua.

I. Çështja e emrit

Nuk është e vërtetë se masa apo rrethi i ka thirr këta së pari me emrat Bac, Bacë e Bacalok.

Këta emra janë shumë të përhapur dhe nuk janë aspak origjinal dhe secili prej tyre e akuzon tjetrin për plagiat (vjedhje, kopjim) të emrit. Nuk kam dëgjuar kurrë ndonjë që së pari është përbe, betuar apo të ketë dhënë ndonjë zakletvë në emër të tyre. Është pikërisht e kundërta. Janë këta të cilët i kanë introduktuar emrat e vetë për mjesidin në të cilin janë gjetë, në stilin: ngo bac!, po bacit!, ani bacit!, kështu bacit! Eja te baci!, tregoj bacit! Janë vetë këta dhe askush tjetër që të parët janë përbe në emrat e vetë në stilin: Jo pasha bacin! Jo pasha Bacën kurrën e kurrës! Jo pasha Bacalokun nuk shkon kjo punë kështu!

Pse e përdorë Trojka këtë trik?

Mendimi më i përhapur është ai sipas të cilit Trojka e bënë me qëllim që ta shoh se cilët janë ata që në turmën e njerëzve e kuptojnë këtë përdorim, e kuptojnë këtë shenjë kopilie, këtë të bame me sy, pra cilët janë ata që e hanë. Këta veprojnë kështu pasi vetëm këtyre (prostitutave) që e hanë, që bëjnë gara për t'u hy në bythë me ka krejt, munden lirisht dhe pa fijen e frikës me ua kthye shpinën. Vetëm këtyre "besnikeve" këta u zënë besë.

II. Magjia e germës B apo magjia e numrit 1

E vërteta është se askush si Trojka nuk është përpjekë të mbjellë pabesi e përçarje në vendin tonë. Në vendet me qytetërim të mirëfilltë, kuptimi i mosmbajtjes së fjalës së dhënë mungon. Për ata është e pakuptueshme se pse një fjalë që nuk mbahet ka nevojë për t'u dhënë. Tek ne, duke iu falenderuar Trojkës e atmosferës së lëkundjeve dhe

shumëfytyrësisë së saj, ekzistenca qoftë edhe e një të vetmi që e mban fjalën quhet besë e virtyt i jashtëzakonshëm.

Pasi jam zgjedhur si i vetmi në kerrin e bullave, d.m.th. që nga ajo kohë e kam ndier veten të zgjedhur, të mbetur jo vetëm në pakicë por si i vetmi i llojit tim, të pa konkurrencë dhe si rrjedhim i gjithë kësaj, të lidhur pazgjidhshmërisht vetëm me numrin 1.

III. Individualiteti i Trojkës

Është e vërtetë se anëtarët e Trojkës dallohen shumë në mes veti dhe në të vetmen pikë ku origjinaliteti i tyre shprehet është në budallallëqet dhe bestytnitë e tyre.

IV. Disa aspekte karakteristike të Stilit në punë

I gjithë argumentimi, në këtë pikë, nga një aspekt është i vërtetë. Këto argumente janë përzierje fjalësh nga tradita, nga dëshirat e mira, nga shpresat, nga pasojat e mosdijes dhe e mbjelljes së obskurantizmit.

a) Baci nuk ka dalë kurrë vetëm sepse e ka ndier veten të dobët, prandaj për t'iu imponuar palës tjetër ai ka qenë në gjendje që brenda disa minutash kalimtarin e parë që e ka gjet në stacion të trenit apo autobusëve ta ndaj, ta bëjë ceremoninë e shpalljes (gradimit për) kalorës, për disa minuta ta bëjë anëtarë të Komitetit Qendror, dhe ta marrë me vete në një bisedë shumë të rëndësishme.

b) Pogllavica është një rast me specifikat e veta. E vetmja vërejtje që mund ta them kundër Pogllavicës është fakti se pendlat e uniformës nuk i ka të vetat. Pamja e tij pa pendlat e huazuara është një pamje jo aq e mirë. Për këtë arsye janë tepër tepër të rrallë ata që e kanë pa ndonjëherë pa uniformë.

c) Bacaloku nuk merr kurr shok në takime. Stili i tij është i kundërt me të Bacit. Ai mund të shkoj për të pi kafe e qaj tek një shok e për asgjë tjetër, por t'u thotë besimtarëve të vetë se ata nuk bënë të jenë aty, pasi tubimi është i një karakteri "sekret ku do të shqyrtohen shumë çështje delikate". Këtë e bënë ai jo për t'i kursyer shokët e vet por vetëm e vetëm që të ketë mundësi t'i manipuloj si të dojë, e t'u thotë çfarë të dojë.

I takon Katedrës së nderuar, Akademisë e akademikut t'i merr ashtu siç janë në të vërtetë. I takon akademikut të gjykoj drejtë e të merr parasysh se kjo pikë në argumentimin pozitiv, fjala dashamirëse e MUPit nuk mjafton për të zënë një vend në cilëndo qoshe Katedralës.

V. A ka fatkeqësi më të madhe

A ka fat më të keq se sa në të njejtën kohë me i pas tre liderr të pafuqishëm dhe më injorantët në botë, të cilët armiqtë tanë mezi po presin për të na i lënë në derë?

Është fatkeqësi sikur ta kishim edhe vetëm njërin prej tyre. Por fatkeqësia është më e madhe pasi këta janë Tre. Thëniet; "Është më mirë të kesh një gjeneral të keq se tre të mirë!" dhe "Tre atllarë nuk mund të lidhen në një mullar!" pikërisht për meritën e tyre janë më aktuale se kurrë më parë.

Rreth ndarjes së hapësirës

Këta nuk janë kurrë dakord me ndarjen e tokës, ndarjen e hapësirës. Ndarja paraqet vetëm ekuilibrin momental deri sa të armatosen më mirë. Qëllimi i tyre është me ia rrëmihë e me ia marrë dheun nën këmbë njëri-tjetrit.

Rreth ndarjes së kohës

Secili prej tyre lufton me çdo mënyrë që koha të llogaritet me kalendarin e vetë.

VI. Disa nga "mrekullitë" e Trojkës

1. Pastrimi i çështjes prej ideologjizmave

Këta lavdërohen se e kanë pastruar çështjen prej ideologjizmave, d.m.th. prej ideve. Sipas këtyre strategëve thirrja në nacionalizëm nuk është ideologji dhe nuk ka lidhje me ide.

Pastrimi e zhveshja e njerëzve prej ideve, pastrimi i trurit të tyre prej ideve nuk është gjë tjetër pos hap i parë për t'ua pastruar xhepat, për t'ua ngrënë djersën dhe në rast nevoje t'a disponojnë si të duan gjakun e tyre.

2. Nga "sjellja në rreth" deri tek "vendosja e punëve në vi"

Trojka është krijuese! Ajo nuk ka trashëguar asgjë!

Këtu nuk kamë nevojë për argumente të mia. Vetë Bacin e kam ndëgjua me vesh të mij kah i thotë Bacës, apo Bacalokut, "Qen, qen bir qeni!"

Pra secili për vete thotë së është krijues, se është krijuesi, ndërsa të tjerëve u thotë: "Qen bir qeni, se e ke (keni) gjet sofrën e shtruar!"

Pra ajo që për Bacën duket "zero" për Bacin e Bacalokun nuk është asgjë tjetër por "sofra e shtruar", e rrumbullakët, tavolina e rrumbullakët. Pasi këta vetë me gojën e vetë e akuzojnë secili njëri-tjetrin për "qen mosmirnjohës", bukpërmbysës ndaj "sofrës së shtruar", konkludojmë se asnjëri prej tyre nuk është nisë prej zeros por është pikërisht e kundërta, se e kanë gjet sofrën të shtruar, se tregohen të pabesë ndaj bukës së shtruar.

3. "Bashkimi" i popullit

Si është zgjedhë kjo çështje në vendin tonë?

Kurrë në jetën e tyre Trojka nuk e ka përjetuar një atmosferë jashtë konkurrencës. Kurrë në jetën e tyre këta nuk kanë pasur plan më madhështor se atë për ta asgjësuar, mundur e poshtëruar njëri-tjetrin.

4. Politika e tyre e jashtme

Sjellja e tyre me atë masë, me adhuruesit e njëri-tjetrit gjatë kohës kur Njëri apo Dy nga Ata kanë munguar (me arsye) nga detyra për shkak të pushimit vjetor, sëmundjeve apo marrjes peng nga ana e udbës

Si njerëz që e urrejnë njëri-tjetrin Këta bëjnë çdo gjë që të jetë e mundur për t'i forcuar pozitat në kurriz të njëri-tjetrit. Këshilla më elementare e Bacit për anëtarët e vetë është: "Baca dhe Bacaloku janë të poshtër, por poshtërsinë e tyre duhet ta shtjellojmë me kujdes e me takt, pasi ata shokët i kanë të mirë. Shokët e tyre na nevojiten." Edhe Bacaloku apo Baca kujdes të veçantë i kanë kushtuar punës se si me ia marrë shokët njëri-tjetrit.

5. Sjellja ndaj të pakënaqurve me nafakën e vetë

Marrja e një "shoku të ngushtë" prej njëri-tjetrit janë trofetë më të çmuara në arsenalet e gjuetisë së Trojkës. Këto raste ata i kanë përdorë si dëshmin më bindëse e më të gjallë se janë në rrugë të drejtë, në rrugën fitimtare. Dezertorët e njërit kanë pasur vendin më të lartë, "e janë vlerësuar sipas meritave të vërteta" tek tjetri.

6. Takimet, kuvendet dhe festat

Sjellja në mes veti e Trojkës kur gjenden në të njejtin kuvend, kur janë ftuar në të njejtën festë

Pikë së pari këta janë përpjekë që kurrë të mos jenë në të njejtin kuvend. Janë të njohura shprehjet e tyre: "Nëse Ai është aty Unë kurrë nuk vij, se nuk mund ta duroj e t'ia shoh surratin e qenit." Nëse më në fund pranojnë të jenë në një tubim si kusht elementar kanë shtruar që emri i njërit të jetë i pari në listën e të ftuarve dhe i emrat e dy të tjerëve në fund. Kur e kanë marrë fjalën secili është munduar të flas sa më shumë dhe mundësisht të marrë aq kohë sa të mos mbetet asnjë sekondë për të tjerët.

Ka ndodhë njëherë që edhe Bullani ka marrë ftesë për të marrë pjesë në këto lloj festash e kuvendesh, si ndëgjues. Baci, Baca e Bacaloku janë paraqitë kishe nuk po e njohin, dhe nuk i kanë kthyer sytë nga ai as gjatë fjalimeve e as gjatë pushimeve në mes seancave. I befasuar nga ky trik e pyeta një aktivist të njohur që e kisha afër në tavolinë se pse vepron Trojka në këtë mënyrë? Ai u përgjegj; "Këtë e bëjnë nga frika se mos po i jipet fjala Bullanit. Dihet se antëtarët e Trojkës në çdo të tretën fjali e akuzojnë dhe e quajnë njëri-tjetrin për 'qen bir qeni'. Ata kanë frikë të pashërueshme se pas fjalës së tij, festat e kuvendet për Ta mund përfundojnë përgjithmonë. Kjo mund të ndodhë pasi fjalimet e Trojkës, në vazhdim ka rrezik serioz që të përjetohen si lehje."

VII. "Mosmarrëveshjet eventuale" të Trojkës

Jo vetëm mosmarrëveshje, por nuk është regjistruar urrejtje më e madhe se sa ajo që kanë anëtarët e Trojkës për njëri-tjetrin. Thuhet se ata e kanë dhe nuk e heqin kurrë prej thumi njëri-tjetrin.

VIII. A ka fatkeqësi më të madhe se me lindë në epokën e Trojkës?

Është vështirë të kërkosh fatkeqësi më të madhe se sa kjo. Është atmosferë aq e zymtë në mjedisin ku garojnë këta, është mjedis aq i ngarkuar me konflikte natyrale dhe artificiale, sa sjellja normale, sjellja elementare e ndershme, thënia e sendeve ashtu siç ndihen me zemër konsiderohen si heroizma të vërtetë.

Çdo përpjekje për ta tejkaluar këtë epokë duhet konsideruar si punën më fisnike, si punën që më së shumti i jep kuptim jetës, si punë për të cilën ia vlen të jetosh.

IX. Cili është vendi i merituar i Trojkës?

Supozimi se Këta Tre, të quajtur nga MUPi "djem hallall", mund ta kenë vendin në parajsë është vështirë i besueshëm. Mendoj se këta "hallalla" vendin e merituar e kanë në Hell. Sido që të jetë puna në këtë pikë, ata nuk meritojnë asnjë bust, asnjë pllakë me emrin e tyre në Katedralë.

X. Çka ndodhë me ata që e lëshojnë rrugën e Trojkës?

Më së miri është që të mos që kesh punë me asnjërin. Largimi nga ta nuk është gjynah që shpërblehet me vdekjen por është pikërisht fitim i jetës e shpëtim i shpirtit.

Përfundim

Sa i përket çështjes së emrit, për ndryshim nga Trojka, Bullani emrin e vetë nuk ia ka caktuar apo dhënë veti.

Atributi, shenja e vetme që e ka dalluar Bullanin nga mesi i vetë ka qenë kalemi. Arma e tij e vetme ka qenë kalemi.

Unë kisha dëgjuar shumë e shumë herë ankesat e sinqerta të anëtarëve të Trojkës për atë "se nuk ka gjë më të keqe në këtë botë se mos me të punua kalemi, se sa me e pas një situatë revolucionare përpara e mos me mund me e shfrytëzua, mos me mund me e shëndrrua në ide e forcë lëvizëse".

Duke u bazuar në ankesat tyre, përkundër të gjitha vetive të tyre, kam shpreh gatishmërinë time të sinqertë që t'u ndihmoj e të ndikoj për të mirë në rrjedhën e ngjarjeve duke menduar se një ndikim i tillë është i mundshëm. Por kjo qe e pamundur pasi asnjëri prej tyre nuk tregoi besim ndaj meje dhe nuk ma kthyen kurrë shpinën, duke më konsideruar si të dyshimtë, me fjalë tjera si tradhtarë që u mundua me futë përçarje.

Për Trojkën mendoj se nuk ka nevojë për arkiv. Për ta mjafton arkivoli. Kjo fjalë e imja përfundimtare besoj dhe shpresoj se do të jetë gozhda e fundit në arkivolin e tyre.

Pasi tre anëtarët e Trojkës janë "Tre djemtë hallall" të vendit tonë, rrjedh se Bullani duhet të jetë "djal haram". Bullani është i vetmi që gjithmonë ka mund të hyj në Smolnyj pa propusnicë. Për këtë arsye vendi i vërtetë i Bullanit është haremi. Jashtë Smolnyj -it mund të imagjinohet; jashtë haremit nuk mund të imagjinohet.

Trojka i kërcënon me vdekje ata që asaj ia kthejnë shpinën.

Ato që ia ka kthejnë shpinën Bullanit çmohen dhe shpërblehen me jetë. Por shpërblimin më të madh, përmendoren më të madhe Bullani është betuar në tokë e në qiell se do t'ia ndërtoj asaj që e ka lënë më së pari, që ia ka kthye shpinën më së pari.

Bullanin mundemi pa fijen e frikës ta konsiderojmë simbol, por me një diapazon, me një shtrirje pambarimisht më të madhe se sa të Trojkës, shtrirje të cilën Trojka nuk mund ta merr me mend. Bullani nuk është simbol i luftës, i urrejtjes për vdekje për rivalët, i "mjekrave të thinjura në revolucione", i obskurantizmit, i injorancës, i bestytnive, simbol i vetëm një gjinie. Bullani është simbol i dashurisë, paqes, mirëkuptimit, i bashkimit më të rëndësishëm, i vazhdimit të jetës e përjetësisë. Ai është i pari që qëndron në prehërin e Nuses.

Bullani nuk ka pasur asnjë konkurrent. Kjo nuk ka ndodhë me kërkesën e tij. Nuk ka asnjë dëshmi, nuk ekziston asnjë letër "historike" e nënshkruar me këtë emër. Janë bullat ato që e kanë zgjedhur atë si të vetmin aktor të dasmës, të llojit të vetë. Është ai që luan në divizion krejt tjetër nga ai Trojkës, që flet me një gjuhë që nuk e ka asnjë fjalë të përbashkët me atë të Trojkës.

Apeloj tek Akademia, tek akademiku, i cili e ka marrë përsipër të na mësoj se në çfarë duhet të besojmë, i cili është duke na treguar se kush jemi, luftëtarit më të lavdishëm për liri duke përfshi këtu edhe lirinë për t'i besuar e mosbesuar kujt të duam, i cili një Perëndi ia zgjedhë kopesë, të tjerëve, ndërsa vetes ia lejon luksin që "t'i falet vetëm të vërtetës" dhe në fund tek arkitekti shpirtëror prof.dr. Muhë Pirra apo MUPi, tek ky avokat i madh i patriotëve, ta peshojnë punën mirë. Jo një pllakë përkujtimore, jo një bust por vetë, krejt Katedrala nuk është keq të quhet në emrin e Bullanit, apo në fund të fundit në emrin e Nuses.

(U botua për herë të parë në www.shkoder.net në shkurt 2007)

PERFUNDIM I LIBRIT

Shkrimet e korrikut 1985 janë shkrimet e fundit që ia kam dërguar dikujt në cilësinë e anëtarit të një organizate. Nga dy shkrimet e mia te fundit, më të gjatat, të shkruara e të botuara në maj e qershor të vitit 1985 shpallet se gazetës (Zëri i Kosovës) të cilën ne e nxirrnim duhet t'i ndërrohet emri. Do të ndërrohej edhe emri i organizatës në të cilin vepronim.

Isha shumë i bindur dhe shumë i kënaqur për zhdukjen e përzierjeve të vitit 1984. Pikërisht në kohën kur mendoja se i kishim kaluar pjesët më të vështira të rrugës sonë, shokët më të afërt të organizatës në Zvicër e Gjermani kërkuan që makina e shkrimit me të cilën ishte nxjerrë gazeta në Suedi të dërgohet në Zvicër. Me kaq, në mënyrë shoqërore, përfunduan marrëdhëniet e mia praktike politike me ta, në kohën kur unë veç sa i kisha mbushur 27 vjet. Pra është fakt i vërtetë se të gjithë ata u larguan nga unë, ata u ndanë nga unë dhe jo unë nga ata. Që nga dalja ime jashtë Kosove, në qershor 1981, jam përpjekur që pa asnjë rezervë t'i qëndroj në dispozicion rrethit në të cilin jam gjendur dhe kurrë nuk kam thënë se nuk dua a nuk mundem t'a bëjë këtë ose atë punë që më është ngarkuar, nëse kam qenë i bindur se shkon në interes të popullit. Për shkak të mosmarrëveshjeve, në korrik 1983 pata kërkuar dorëheqje nga rrethi në të cilin veproja por më është bërë presion që të mos largohem. Tërheqjen e kërkesës time për dorëheqje e konsideroj të gabueshme. Por siç thuhet në hyrje të këtij libri, këtu nuk shqyrtohen rrethanat e hollësishme të asaj kohe më tepër se sa është shkruar në faqet e shtypit.

Se si mund ta ndiej veten dikush në vetmi të plotë, kur i largohet i gjithë rrethi kam gjetur disa shembuj të cilët për vite të tëra kanë qenë ngushëllim për mua. Por ngushëllimi më i madh ka qenë qartësimi i gjërave për vetveten time, mbyllja e ciklit të parë, më të rëndësishëm të jetës sime.

Është fakt se emri i Jusuf Gërvallës më ka futur në qendër të aktivitetit për Kosovën, në mërgim, në ato vite. Nuk jam plotësisht i sigurt se a kam nevojë dhe nëse po, deri në çfarë shkalle më duhet t'ia di për nderë mbiemrit të tij, për pushimin tim të merituar nga politika ilegale e emigracionit, nga e cila nuk kam marrë asnjë ftesë që të kthehem ndonjëherë.

Hysen Gërvalla u bashkua me Lëvizjen që kishte qendrën dhe gazetën në Zvicër dhe me sa kam dëgjuar iu dha një pozitë e lartë. Se çfarë përkrahje kishte nga ata që kishin qëndruar afër gazetës në Suedi nuk e di.

* * *

Duke u bazuar në të dhënat biografike dhe veprimtarinë time politike në Gjermani, në Mars të vitit 1984, Parisi, Komuna e Parisit më pranoi si qytetar të saj, më dha statusin e refugjatit politik me leje të përhershme të qëndrimit dhe një vend pune në një laborator të kimisë, gjë që ishte profesioni im i vërtetë. Është e vërtetë se, pas njëqind ditësh, vet e lash Parisin dhe punën e ofruar me qëllim që t'u shërbej shokëve deri në çastin e fundit kur të gjithë ata u larguan nga unë në fund të korrikut 1985.

I mbetur vetëm për vetëm në anijen time, "në mes shtegtisë së kësaj jete" në korrik 1985, i liruar nga të gjitha detyrimet politike, u gjenda para një problemi të ri navigimi, u gjeta në Arkipelagun e Stockholmit, në mes 24 mijë ujdhesash, sa lundrimi nëpër Detin Jon, Mesdhe e Ngushticën e Stambollit, ku i kisha bërë hapat e parë, më dukej lojë. Thuhet se vetë nëndetëset e Posejdonit e kishin humbur rrugën në këto ujëra. I nisur për në Paris ku ende më priste puna, valët e të Zotit të detërave ndikuan që unë ta humbi orientimin. Ndikimi i shpirtrave mashtrues të Perëndive, pjesërisht e përkohësisht, mu largua vetëm

nën kujdesin e Nymfës C. Pasi e mora pak veten, kërkova ta vazhdoj rrugën time por Nymfa ma preu: "Shumë je end për sa vjet poshtë e lartë", "ke pa qytete e vise, njeh zakone, doke e gjuhë gjithfarë popujsh, shumë të ka vuajtur zemra në det me dallgë ndërsa je përpjekur shokët të shpëtosh. Tani do të qëndrosh këtu." Vetëm pas 20 vitesh, në saje të qëndresës së popullit, atyre që e vazhduan luftën dhe në mënyrë vendimtare falë intervenimit të Afërditës-Albrightit tek Zeusi mu bë e mundur që ta shoh vendlindjen përsëri.

Tri udhëtime në drejtim të vendlindjes
Udhëtimi i parë në Tiranë

Ideali im ka qenë Shqipëria me të cilën fizikisht më ka nda largësia gjeografike. Takimi real thonë se ndryshon me atë që është idealizuar për dekada.

Në Shqipëri, për herë të parë në jetën time, kam qenë i ftuar të qëndroj nga 23 shtatori gjer më 1 tetor 1996. Më kanë thënë se "në Tiranë, në javën e fundit të Shtatorit disa 'Perëndesha' do të bëjnë gara në Pallatin e Kongreseve se kush do të jetë Miss Evropa. Për shkak se je më i sinqerti, më objektivi dhe ajo që është kryesorja, ke qenë qytetar i Parisit në ditët më të vështira, është vendosur që ti t'ia japësh mollën më të bukurës. Pranimi i kësaj detyre do të jep mundësi të zgjedhësh shpërblime të ndryshme."

Besoni që po sa më kanë thënë se vëllaznit do të shtyhen se cili e ka nusen më të mirë, më të bukur, më të vyeshme, se cila çohet më heret e cila më vonë, se cila është e para që e fshin oborrin e cila ajo që e ndezë koftorrin, e kam ditur se një sherr i madh ka me dalë, se gratë kanë me i prishë. Nuk e kam pranuar këtë detyrë vullnetarisht pasi kisha fakte të gjalla se çka do të ndodhë më vonë. Kam pranuar nga presioni i akuzave se nuk po dua t'i shërbej Shqipërisë së Shenjtë ashtu siç i kisha shërbyer dikur. Se cilat janë pasojat e kësaj gare, të cilat u shfaqën pas disa muajsh në vitin 1997 dihet nga të gjithë. Në kundërshtim me të gjitha faktet patën qarkullua disa akuza të paskrupullta se gjoja unë (i nisur nga lakmia personale), i kam sjellë dëme të mëdha Shqipërisë, për shkak të "Miss-it".

Kthimi i parë në Shkup pas 17 vitesh

I pajisur me shënime të shumta, me emra kullash të djegura, me numra çadrash nëpër të gjitha kampet e refugjatëve, me numra telefonash nga gjithë Evropa ku gjendeshin të afërmit e refugjatëve, të cilët në këto vende ishin vendosur prej 30 gjer 3000 vjet më parë, në mesin e prillit 1999 kam mbërri në Maqedoni për t'u qëndruar afër Ankisëve e Askanëve në kohën më kritike për fatin e Dardanëve. Në luftë për shpëtimin e albanëve, edhe pse shumë prej tyre, e qëndrim zyrtarë tek ta ka qenë falja kultit të Prometeut, ishin përzier vetë Perënditë në krye me Alb-rightin, (Albfërditën) dhe Zeusin.

Ditën refugjatët nëpër çadra dëgjonin, përmes radiove që iu kishte shpërnda NATO-ja, lajmet e luftës. Përmes këtyre radiove, përmes BBC e DW-Dojçe Veles, lexoheshin shpalljet e pafund me të cilat ata kërkonin apo u tregonin të gjithë të afërmve nëpër të gjitha vendet se ku gjenden. Ata vizitoheshin nga mjek e motra medicinale e ngushëlloheshin nga armata e punëtorëve të shoqatave humanitare dhe oficer të ushtrive që ishin vu në veprim për t'i çliruar. Në këto ditë dhimbje, duke pritur Ditën e Madhe, ata më së shumti i ngushëllonte e gëzonte ardhja e natës sepse e dinin se NATA ishte e NATO-s, ishte koha e zhurmës së këndshme të fluturimit të aeroplanëve dhe e gjëmimeve nga eksplodimi i projektileve, të cilat të drejtuara nga Apolloni qëllonin caqet e tyre. Ishte koha kur pilotët e saj shihnin më së miri.

Ka mendime të ndryshme se çfarë Force hyjnore i solli Pilotët e Forcës më të madhe të Botës në qiellin tonë për të na shpëtuar. Disa mendojnë se Pilotët nuk ishin tjetër pos Brigadat Proletare të premtuara nga Prometeu. Të tjerë thonë se Pilotët mbi çatitë tona i solli kënga e pëllumbave e disa i kundërshtojnë duke thënë se ata i solli fishkëllima e plumbave. Qindra mijëra refugjatë ishin të vendosur nëpër çadra e shtëpi private në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni. Prej kullave të djegura ata me vete kishin marrë vetëm sendet më të çmuara që mund t'i mbanin në dorë. Ata kishin mundur të shpëtonin dhe të merrnin me vete vetëm Penatet e tyre. Urdhri për veprim Pilotëve u erdhi drejtpërdrejtë nga Zeusi. Se çka sillet në kokën e tij është punë me të cilët nuk duhet të preokupohen të vdekshmit. Megjithatë mund ta them atë që e tha njëherë në televizion. "Para syve tanë një popull i tërë nën forcën e armëve dhunohet në mënyrën më të egër, vritet e dëbohet nga vatra e vet. Është detyrë e jona që ta ndërprejmë këtë dhunë sepse në të kundërtën njerëzit mund ta humbin Shpresën, besimin në Besim, besimin në Shpirtrat e të Parëve, në Penatet, në Mbretërinë Qiellore, në Mbretërinë Tokësore, në Drejtësinë Universale, në Republikën Universale."

Në çadra bisedohej e jepeshin urata për pilotët, me aso ndjenjash e përjetimesh që fjalët ende presin për t'i përshkruar. Besoj se ajo Forcë hyjnore e udhëzuese që i drejtonte Pilotët vinte në mënyrën më të plotë dhe krejtësisht të mjaftueshme nga ata që pinin lot. Aleatët kryesor dhe vendimtarë të Pilotëve ishin pilotët. Se nuk mund të jesh Pilot, pushtues, e zot i qiellit pa e marrë mandatin për t'i shpëtuar pi-lotët e tokës.

Në kampet e Maqedonisë për refugjatë kam përkthyer dhe kam përcjellur Ankisët, Askanët dhe gratë e Hektorëve të rënë në luftë për në shumë shtete prej Alba Longës e deri në St:Albans të Albionit, prej Amerike gjer në Australi.

Kapitullimi i ushtrisë dhunuese serbe më 9 qershor 1999 më ka gjet në Kampin nr. 2 të Stenkovecit. Oficerët e ushtarët e Gjeneral kolonelit Sir Mike Jackson para të cilit përfaqësuesit e armatës okupuese e dhunuese, Gjeneralët Svetozar Marjanovic e Obrad Stevanovic kishin nënshkruar kapitullimin, në ato ditë kishin nevojë të madhe për persona me njohuri të mira gjuhësore, me njohuri të mira në reliefin gjuhësor e kulturor të popullit të Kosovës. Pas njohjes me ta, më kanë kërkuar dhe ofruar mundësinë që ta shoqëroj hyrjen e tyre me helikopterët e me kolonën e parë në Kosovë, duke më thënë se kjo do të duhej të ishte dita që e kam pritur tërë jetën. Nuk e kam shfrytëzuar këtë mundësi në pritje të një dite tjetër. Në mes të qershorit jam larguar nga Maqedonia.

Kthimi i parë në Kosovë pas 20 vitesh

Pas çlirimit të Kosovës, dalëngadalë po ktheheshin refugjatët e kohëve më të hershme dhe ata të fundit prej të gjitha skajeve të Babilonit. Filluan të kthehen vlerat më të rëndësishme për te, e në këtë drejtim edhe reliktet. Për herë të parë, vetëm pasi kishin kaluar disa ditë më shumë se 20 vjet, nga janari 1982, në tokën e Kosovës jam kthyer me atë aradhë që nga Egjipti solli eshtrat e Josefit, me atë aeroplan, me atë grup luftëtarësh të mërgimit që nga Shtutgarti shoqëroi kthimin e eshtrave të Jusufit, në ditën e pritur, një ditë para ditëlindjes së Bardhoshit, më 24 shkurt 2002.

14 mars 2006 Londër



Formulari 5
Obrazac

REPUBLIKA SOCIALISTE FEDERATIVE E JUGOSLLAVISË
REPUBLIKA SOCIALISTE E SERBISË
KRAHINA SOCIALISTE AUTONOME E KOSOVËS

SOCIJALISTIČKA FEDERATIVNA REPUBLIKA JUGOSLAVIJA
SOCIJALISTIČKA REPUBLIKA SRBIJA
SOCIJALISTIČKA AUTONOMNA POKRAJINA KOSOVO

Taksat jane paguar simpas tarifes 1 dhe 4 per Ofiqarin,

EKSTRAKT — I Z V O D
NGA LIBRI I AMZËS SË TË LINDURVE — IZ MATIČNE KNJIGE ROĐENIH

Komuna / Opština: Vuciterne
Viti i regjistrimit / Godina upisa: 1958
Vendi i regjistrimit / Mesto upisa: Stanovc Poshtem
Numri vijues / Tekući broj: 15

Emri, mbiemri, gjinia dhe shtetësia e fëmijës Ime, prezme, pol i državljanstvo deteta	Xhafer Durmishi (meshkull) R S F J	
Dita, muaji dhe viti i lindjes së fëmijës Dan, mesec i godina rodjenja deteta	14(katembedhjete)maj 1958	
Vendi dhe komuna e lindjes së fëmijës Mesto i opština rodjenja deteta	Stanovc Poshtem Vuciterne	
TË DHËNAT MBI PRINDËRIT: PODACI O RODITELJIMA:	babës — ocu	nënës — majci
Emri Ime	Mustafa	Abibe
Mbiemri(për nënën edhe i vajzërisë) Prezime (za majku i devojačko)	Durmishi	Durmishi-Berisha
Data, vendi dhe komuna e lindjes Datum, mesto i opština rodjenja	5.02.1932	5.10.1931
Shtetësia Državljanstvo	R S F J	R S F J
Vendbanimi dhe adresa Prebivalište i adresa	Stanovc Poshtem	Stanovc Poshtem

Regjistrimet e mëvonshme dhe shenimet
Naknadni upisi i pribeleške

Numër / Broj: 200/
Më / Dana: 25. 08. 1978 viti.
Prilluzhe

VV MP

Nënshkrimi i oficarit — Potpis matičara

Izdaje ISP „SAVREMENA ADMINISTRACIJA"
OOUR za izdavanje i prodaju obrazaca — Beograd · 2/78
Oznaka za porudžbinu obrazca: obr. br. K-11/85 b

Shtyp: „RILINDJA" — PRISHTINË
Stampa: „RILINDJA" — PRISTINA
Tirazhi — Tiraž 200.000

Çertifikata e datëlindjes e lëshuar nga zyra e vendit në Prilluzhë nga Mevlude Bërbatovci. Kam lindur natën e Shën Gjergjit, më 5 maj 1958, por në librin e amzës më kanë regjistruar më 14 maj 1958.



KOMMERSKOLLEGIUM

AUKTORISERAD TOLK

Kommerskollegium meddelar auktorisation som tolk för

XHAFER DURMISHI

mellan svenska och ALBANSKA

Auktorisationen gäller till och med den 30 juni 1996

Stockholm den 27 maj 1991

Leena Carlstedt

Maija Hägerbäck

DB 664227

Dëshmia e përkthyesit të parë të auktorizuar në Suedi për përkthime gojore (interpreter) në mes suedishtes dhe shqipes

KOMMERSKOLLEGIUM

AUKTORISERAD TRANSLATOR

Kommerskollegium meddelar auktorisation som translator för

XHAFER DURMISHI

från SVENSKA till ALBANSKA

Auktorisationen gäller till och med den 31 december 1998

Stockholm den 23 augusti 1993

Leena Carlstedt

Maija Hägerbäck

Translatorsnummer 543

DB 799171

Dëshmia e përkthyesit të parë të auktorizuar në Suedi për përkthime me shkrim (translator) nga suedishtja në shqip

Gjatë ushtrimit të profesionit të përkthyesit gojor dhe me shkrim në Suedi, kam qenë anëtar i bashkimit profesional DIK, që i organizon akademikët nga veprimtaritë; “kultur, komunikim dhe sektori kreativ”, organizatë e pavarur politike që është e bashkangjitur në “Sveriges akademikers centralorganisation (Saco).

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi

Xhafer Durmishi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

==========

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit

01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023

23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror."* (14 janar 1981)

==========

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Tetor 2006-Shkurt 2026